

PROGRAMI PËR
REFORMA NË
EKONOMI 2019-2021

Janar, 2019



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada–Government

PROGRAMI PËR REFORMA NË EKONOMI (PRE) 2019-2021

TABELA E PËRMBAJTJES

1.	KORNIZA E PËRGJITHSHME E POLITIKËS DHE OBJEKTIVAT	6
2.	KORNIZA MAKROEKONOMIKE	12
2.1.	ZHVILLIMET E JASHTME EKONOMIKE DHE PROJEKSIONET	12
2.2.	ZHVILLIMET E FUNDIT NË EKONOMINË KOSOVARE	14
2.2.1.	KLIMA E BIZNESIT	15
2.2.2.	PUNËSIMI, PRODUKTIVITETI, DHE PAGAT	16
2.3.	SKENARI MAKROEKONOMIK AFAT-MESËM.....	18
2.3.1.	PROJEKSIONET E LLOGARIVE KOMBËTARE	18
2.3.2.	POLITIKA MONETARE, NORMA E KËMBIMIT DHE INFLACIONI.....	21
2.3.3.	SEKTORI I JASHTËM DHE QËNDRUESHMËRIA E TIJ AFATMESME.....	22
2.3.3.1.	EKSPORTI I MALLRAVE, VLERËSIMET 2018 DHE PARASHIKIMET 2019-2021	22
2.3.3.2.	IMPORTI I MALLRAVE, VLERËSIMET 2018 DHE PARASHIKIMET 2019-2021	23
2.3.3.3.	TREGTIMI I SHËRBIME, VLERËSIMET 2018 DHE PARASHIKIMET 2019-2021.....	24
2.4.	LLOGARIA RRJEDHËSE, VLERËSIMET 2018 DHE PARASHIKIMET 2019-2021.....	25
2.4.1.	FINANCIMI I LLOGARISË RRJEDHËSE, VLERËSIMET 2018 DHE PARASHIKIMET 2019-2021.....	26
2.5.	SEKTORI FINANCIAR.....	27
2.6.	SKENARËT ALTERNATIVË DHE RREZIQET FISKALE.....	30
2.6.1.	RREZIQET FISKALE DHE POTENCIALET ZHVILLIMORE, 2019- 2021	31
3.	KORNIZA FISKALE	35
3.1.	STRATEGJIA E POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT AFATMESME.....	35
3.2.	IMPLEMENTIMI I BUXHETIT 2018	36
3.3.	PARASHIKIMET AFATMESME BUXHETORE	39
3.3.1.	PARASHIKIMI I TË HYRAVE BUXHETORE	39
3.3.2.	PARASHIKIMET E SHPENZIMEVE BUXHETORE.....	43
3.3.3.	PARASHIKIMET E SHPENZIMEVE PËR SEKTORËT E POLITIKAVE BUXHETORE	44
3.3.4.	PARASHIKIMET E SHPENZIMEVE SËPAS KATEGORIVE EKONOMIKE.....	45
3.4.	BILANCI STRUKTUROR FISKAL	46
3.5.	NIVELET DHE ZHVILLIMET E BORXHIT, ANALIZA E OPERACIONEVE TË MËPOSHTME DHE RREGULLIMET E FLUKSEVE TË STOQEVE	48
3.5.1.	DETYRIMET KONTIGJENTE	49
3.6.	ANALIZA E NDJESHMËRISË DHE KRAHASIMI ME PROGRAMIN E MËPARSHËM	50
3.6.1.	KRAHASIMI ME PROGRAMIN E MËPARSHËM	51
3.7.	QEVERISJA FISKALE DHE KORNIZAT BUXHETORE	51
3.8.	QËNDRUESHMËRIA E FINANCAVE PUBLIKE	51
4.	PRIORITETET E REFORMAVE STRUKTURE PËR PERIUdhËN 2019-2021	54
4.1	IDENTIFIKIMI I PENGESAVE KRYESORE NË KONKURRUESHMËRI DHE RITJE GJITHËPËRFSHIRËSE.....	54
4.2	PËRMBLEDHJE E PRIORITETEVE TË REFORMAVE	56

4.3	ANALIZA SIPAS FUSHËS DHE PRIORITETET E REFORMAVE STRUKTUREORE	58
4.3.1	REFORMAT NË TREGUN E ENERGISË DHE TRANSPORTIT.....	58
4.3.2	ZHVILLIMET SEKTORIALE (BUJQËSIA, INDUSTRIJA DHE SHËRBIMET).....	63
4.3.3	MJEDISI BIZNESOR DHE ULJA E EKONOMISË JO-FORMALE.....	69
4.3.4	HULUMTIMI DHE ZHVILLIMI, INOVACIONI (RDI) DHE EKONOMIA DIGJITALE	75
4.3.5	REFORMAT LIDHUR ME TREGTINË.....	79
4.3.6	ARSIMI DHE SHKATHTËSITË	82
4.3.7	PUNËSIMI DHE TREGU I PUNËS.....	87
4.3.8	PËRFSHIRJA SOCIALE, ULJA E VARFËRISË DHE MUNDËSITË E MUNDËSITË E BARABARTA .	90
5	IMPLIKIMET BUXHETORE TË REFORMAVE STRUKTUREORE.....	93
6	ÇËSHTJET INSTITUCIONALE DHE PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERESIT	94
	ANNEX 1: TABELAT E PROGRAMIT PËR REFORMA NW EKONOMI.....	95
	ANEKSI 2: KONTRIBUTI NGA KONSULTIMET PUBLIKE PWR PRE 2019-2021.....	131
	ANEKSI 3: KRAHASIMI ME PROGRAMIN E MËPARSHËM	148
	ANEKSI 4 KLAUZOLA PWR INVESTIME	149
	ANEKSI 5: LISTA E TREGUESVE TË PERFORMANCËS.....	152

Tabela e grafikëve dhe tabelave

Grafiku 1.	Rritja vjetore e BPV-së, në %	12
Grafiku 2.	Inflacioni.....	13
Grafiku 3.	Struktura e BPV-së në 2018 dhe 2019, vlerat nominale, në miliona eurod	14
Grafiku 4.	Niveli i çmimeve në Kosovë, në%.....	15
Grafiku 5.	Kontributi i Inflacionit të tregtueshëm dhe të patregtueshëm në normën e inflacionit total	15
Grafiku 6.	Treguesi i klimës së biznesit (TKB), në pika	16
Grafiku 7.	Bilancet e vlerësimit të situatës aktuale të sektorëve të biznesit (së bashku me treguesin për klimë të biznesit dhe rritjen reale të BPV-së).....	16
Grafiku 8.	Paga mesatare bruto, në Euro.....	18
Grafiku 9.	Kontributi në rritjen reale të BPV-së.....	19
Grafiku 10.	Kontributi sektorial në rritjen e BPV-së në pikë përqindje.....	21
Grafiku 11.	Parashikimi i IÇK-së mujore (së bashku me komponentin e aplikuar e të përshtatur sezonal)	21
Grafiku 12.	Diversifikimi i eksporteve sipas indexit të Herfindal-Hirschman	22
Grafiku 13.	Indeksi i hapjes së tregut, krahasimi me vendet e rajonit dhe eurozonën	25
Grafiku 14.	Struktura e IHD-ve sipas sektorëve	26
Grafiku 15.	Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare (PIN) në fund të periudhës, në miliona euro	26
Grafiku 16.	Rritje e huazimit në sektorin privat	28
Grafiku 17.	Krahasimi i skenarëve bazë: PRE 2018 ndaj PRE 2019	31
Grafiku 18.	Skenarët Alternativë, rritja reale e BPV-së, në %	33
Grafiku 19.	Trendi i të hyrave tatimore 2006-2021	40
Grafiku 20.	Trendi i të hyrave tatimore të mbledhura në kufi dhe relacioni me indikatorë ekonomik 2006 - 2021	42
Grafiku 21.	BPV-ja aktuale dhe potenciale, TM1/2011-TM2/2018	47
Grafiku 22.	Rezultatet e skenarit bazë	52
Grafiku 23.	Analiza e skenarëve: Zvogëlimi i rritjes së BPV-së me 1 p.p. (figura në të majtë) dhe ulja e bilancit bankar nga 4.5% në 3% të BPV-së (figura në të djathtë)	53
Tabela 1.	Treguesit kryesorë botërorë	14
Tabela 2.	Treguesit kryesorë të tregut të punës.....	17
Tabela 3.	Produktiviteti i punës dhe Kostot për Njësi të Punës – KPNJ.....	17
Tabela 4.	Parashikimi I eksporteve të mallrave në periudhën afatmesme	22

Tabela 5. Përbërja gjeografike e eksporteve në '000 euro.....	23
Tabela 6. Parashikimi për importet e mallrave në periudhën afatmesme	23
Tabela 7. Pjesëmarrja e mallrave të importuara në totalin e importit.....	24
Tabela 8. Përbërja gjeografike e importeve, në '000 euro	24
Tabela 9. Parashikimi për importin-eksportin e shërbimeve në periudhën afatmesme	24
Tabela 10. Parashikimi për importet-eksportet, deficitin e llogarisë rrjedhëse në periudhën afatmesme	25
Tabela 11. Skenarët Alternativë Makro- Fiskal	35
Tabela 12. Veprimtaria e Qeverisë së Përgjithshme, në miliona Euro	38
Tabela 13. Parashikimet afatmesme të të hyrave tatimore 2019-2021, në miliona Euro	39
Tabela 14. Struktura e të hyrave buxhetore si % e BPV-së	43
Tabela 15. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike 2019-2021, në mil.euro	45
Tabela 16. Elasticiteti i të ardhurave tatimore ndaj BPV-së	48
Tabela 17. Bilanci buxhetor, Bilanci i korigjuar për ciklin e biznesit, komponenti ciklik i bilancit dhe hendeku i prodhimit.....	48
Tabela 18. Borxhi i përgjithshëm (në milionë Euro)	49
Tabela 19. Garancitë shtetërore.....	50
Tabela 20. Rezultatet e skenarëve alternativë në treguesit kryesor fiskalë	50

SHKURTESAT

AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore	USAI D	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
BE	Bashkimi Evropian	MFP	Menaxhimi i Financave Publike
BEI	Banka Evropiane e Investimeve	PEFA	Shpenzimet Publike dhe Llogaridhënia Financiare
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim	ZSP	Zyra për Planifikim Strategjik
BPV	Bruto Produkti Vendor	PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Kosovës	SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
CEFTA	Marrëveshja për Tregti të lire e Evropës Qendrore	KKI	Komiteti Kombëtar për Investime
DPEP	Departamenti për Politika Ekonomike dhe Publike (MF)	OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
EDK	Ekonomia Digjitale e Kosovës	TAK	Administrata Tatimore e Kosovës
EE	Efiçienca e energjisë	PPP	Partneriteti Publiko Privat
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore	NVM	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar	MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	PKZM A	Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së
IHD	Investimet e Huaja Direkte	RFP	Rishikimi i Financave Publike
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve		
KE	Komisioni Evropian	AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë	EJL	Evropa Juglindore
KOSTT	Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu	TC	Termocentrali
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë	TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	BB	Banka Botërore
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	VECM	Modeli për korrigjimin e gabimit vektorial
MF	Ministria e Financave		
NjMB	Njësia për Menaxhimin e Borxhit (MF)	HP	Hendeku i prodhimit
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës	OTEJ L	Obzervatori Transportit për Evropën Juglindore
PIN	Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare	HZHI	Hulumtim, Zhvillim dhe Inovacion
PZHRB	Programi i Zhvillimit Rural dhe të Bujqësisë	MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
QeK	Qeveria e Kosovës	ER	Energjia e ripërtitshme
RDPP	Regjistri i të drejtave të pronës së paluajtshme	ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
SMIL	Sistemi i Menaxhimit të Lëndëve dhe Informacionit	KPJ	Kredi jo-performuese
TIK	Teknologjia Informative dhe Komunikimi	KBR	Këshilli për Bashkëpunim Rajonal
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës	SPP	Renditja e projekteve

1. KORNIZA E PËRGJITHSHME E POLITIKËS DHE OBJEKTIVAT

Procesi i hartimit të Programit të Reformave në Ekonomi (PRE) 2019-2021 është udhëhequr nga Ministri i Financave si Koordinator Nacional dhe është koordinuar nga Ministria e Financave, Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS) e Zyrës së Kryeministrit, si dhe koordinatorët e fushave nga ministritë e linjës. Koordinatorët janë takuar rregullisht për të diskutuar përmbajtjen e masave, konsistencën e tyre me dokumentet përkatëse strategjike dhe rekomandimet e politikave që kanë rezultuar nga Dialogu Ekonomik dhe Fiskal me Komisionin Evropian.

Grupet punuese ndërministrorë janë takuar për të siguruar që aktivitetet afatshkurtra nga PRE janë të përfshira në Planin Vjetor të Punës së Qeverisë (PVPQ) për vitin 2019 dhe janë në përputhje me Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) dhe Agjendën e Reformave Evropiane (ERA), si dhe propozim-buxhetin për vitin 2019. ZPS në bashkëpunim me koordinatorët e fushave ka siguruar se shumica e masave janë drejtpërdrejt të ndërlidhura me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Udhërrëfyesin për Zbatimin e saj.

Qeveria mbetet e përkushtuar në ruajtjen e një mjedisi të qëndrueshëm makroekonomik, fuqizimin e rritjes ekonomike dhe perspektivës më të mirë të punësimit. Korniza e përgjithshme e politikave të PRE-së është një kombinim i: (1) politikave fiskale të bazuara në rregulla të orientuara drejt stabilitetit të financave publike brenda hapësirës së disponueshme fiskale, në mbështetje të rritjes ekonomike përmes investimeve kapitale, rritjes së financimit për fushat prioritare, dhe lehtësirave tatimore për prodhuesit vendor; dhe (2) reformave prioritare strukturore që adresojnë pengesat kryesore për rritje ekonomike, në mbështetje të zhvillimit të sektorëve ekonomik konkurrues dhe sigurojnë se rritja ekonomike është gjithëpërfshirëse dhe synon rritjen e mirëqenies.

Politikat fiskale të planifikuara në PRE dhe KASH mbështesin rritje ekonomike dhe agjendë të reformave strukturore, duke siguruar që shpenzimet për investime publike mbarëvohen në mbi 10% të BPV-së, dhe veç përmirësimit të infrastrukturës në transport, përfshijnë investime në institucionet arsimore dhe shëndetësore, bujqësi dhe zhvillim rural, ujë dhe trajtim të ujërave të zeza. Gjithashtu, propozim-buxheti për vitin 2019 përfshin rritje substanciale të financimit për fushat prioritare: reformën e gjyqësorit, dhe ngritjen e cilësisë së arsimit dhe shëndetësisë.

Kutia 1. Adresimi i rekomandimeve të politikave nga Dialogu Ekonomik dhe Financiar në Maj 2018

1. “[1.A.] Të rrisë kapacitetet institucionale dhe të sigurojë staf adekuat në Ministrinë e Financave me qëllim të përmirësimit të planifikimit makro-fiskal, parashikimeve dhe vlerësimeve të ndikimit fiskal. [1.B.] Gjithashtu të përgatitet një dokument me opsione lidhur me themelimin e një organi të pavarur për mbikëqyrjen fiskale për konsultime të mëtejme me palët e interesit, përfshirë BE-në”.

[1.A.] Gjatë vitit 2018, Ministria e Financave ka ndërmarrë veprime konkrete për fuqizimin e kapaciteteve të stafit ekzistues për planifikim makro-fiskal të bazuar në evidencë dhe sipas modelit makro-fiskal të Ministrisë së Financave. Stafit po ashtu është trajnuar në vlerësimin e ndikimit fiskal të nismave të reja politike dhe legjislative të Qeverisë, dhe në integrimin e këtyre vlerësimeve si pjesë e parashikimit të të hyrave buxhetore. Është përfunduar për herë të parë një vlerësim ex-post i ndryshimit të politikave fiskale dhe tregtare, dhe në sajë të vlerësimit është azhurnuar edhe

parashikimi i të hyrave, përfshirë këtu edhe azhurnimin e vlerësimeve të impaktit fiskal të Marrëvshjes për Stabilizim dhe Asociim gjatë periudhës së ardhshme afatmesme.

Dokumentimi i parashikimeve të të hyrave buxhetore në draft buxhetin e vitit 2019 është përmirësuar dukshëm, me ndarje të qartë në mes të të hyrave të përcaktuara nga ndryshimi makroekonomik i bazave tatimore si dhe nga targetet për uljen e borxhit tatimor. Po ashtu, për herë të parë, azhurnimi i projeksioneve makro-fiskale është integruar si aneks në draftin e ligjit për ndarjet buxhetore. Është ndërtuar një model i ri për analizën e qëndrueshmërisë së borxhit, mbi të cilin edhe është informuar korniza makro-fiskale edhe plani për reforma në ekonomi.

Gjatë vitit 2018, MF punësoj tre zyrtar shtesë që përgjegjësi primare kanë mbështetjen e stafit ekzistues në përpilimin e projeksioneve dhe analizave ekonomike e fiskale. Gjatë vitit 2019, MF planifikon të punësoj edhe dy zyrtarë (duke e numrin e stafit të njësisë në gjashtë ekonomistë) në mënyrë që të forcohet edhe më tutje kapaciteti i Njësisë së Makroekonomisë, dhe të sigurohet kontinuitet i mjaftueshëm edhe në rast të lëvizjeve të stafit në të ardhmen.

Me ndihmën e USAID, por edhe të Qeverisë së Luksemburgut dhe Bankës Botërore, janë mbajtur trajnime për stafin për konceptet kryesore ekonomike dhe statistikore, si dhe për shfrytëzimin e modelit për planifikim dhe parashikim makro-fiskal. Si rezultat i trajnimeve, tashmë stafi i MF-së është i gatshëm të punoj në mënyrë të pavarur me modelin makroekonomik dhe të përpiloj projeksionet makro-fiskale për ndërtimin e buxhetit.

[1.B.] Pas forcimit të kapaciteteve të Njësisë së Makroekonomisë, Ministri i Financave më 2018 ka marrë vendim për krijimin e grupit punues i cili ka filluar punën në hartimin e një studimi i cili do të identifikojë opsionet për krijimin e mekanizmave të mbikëqyrjes së pavarur fiskale. Këto opsione mëtej do diskutohen me palët e interesit, duke përfshirë Komisionin Evropian. Grupi punues përfshin përfaqësues nga MF, ZK, BQK, ASK, MPMS, MBPZHR, dhe një përfaqësues nga shoqëria civile.

2. “[2.A.] Të kompletoj proceset e certifikimit të veteranëve të luftës si dhe ri-klasifikimit me synim të uljes së kostos së skemës pensionale të veteranëve të luftës në përputhje me legjislacionin aktual. [2.B.] Të forcojë kapacitetet institucionale në nivel qendror dhe lokal të qeverisë për planifikimin e investimeve shumëvjeçare dhe përgatitjen e menaxhimit të projekteve të investimeve për të përmirësuar ekzekutimin e shpenzimeve kapitale.”

Është formuar Komisioni i veçantë për kategorizimin e veteranëve. Nga ky Komision deri më tani është përgatitur rregullorja e punës së komisionit, mirëpo kjo rregullore nuk është nënshkruar ende nga Qeveria e Kosovës.

3. “[3.A.]Banka Qendrore të vazhdojë zgjerimin e instrumenteve analitike duke zhvilluar pyetësor për pritshmërinë e inflacionit. [3.B.] Gjithashtu, të sigurohet që Banka Qendrore të mos shndërrohet në "de facto" financuesin e Qeverisë së Republikës së Kosovës duke blerë letra me vlerë të emetuara nga Qeveria. [3.C.]Më tutje, të adresojë faktorët ligjor dhe institucional që pengojnë qasjen në financim të NVM-ve, [3.D.] përderisa me kujdes të monitorojë rritjen e kreditimit për ekonominë familjare. [3.E.] Të finalizohet korniza e menaxhimit të krizave dhe ndërhyrjeve të jashtëzakonshme për banka, me qëllim të fuqizimit dhe stabilitetit të sektorit bankar”.

[3.A.] Lidhur me hartimin e anketës, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka filluar diskutimet me institucionet financiare, të cilat vlerësohen të kenë ekspertizën e nevojshme në parashikimin e zhvillimeve të çmimit sepse kanë burimin primar të të dhënave nga sektori privat nëpërmjet aktiviteteve të tyre të kreditimit. Ky proces parashihet të finalizohet deri në fund të vitit 2019. Ndërkohë, si një zgjidhje e përkohshme, BQK-ja është duke konsultuar mjetet që ka në dispozicion, të cilat mund të përafrojnë pritjet e inflacionit, por jo t'i zëvendësojë ato që përftohen nga pyetësorët e hartuar posaçërisht për matjen e pritshmërive të inflacionit. Duke aplikuar Modelet Autoregresive për Parashikimin e Inflacionit (ARIMA), BQK-ja është duke bërë përpjekje që të parashikojë inflacionin në planin afatshkurtër, në bazë të sjelljes së tij në të kaluarën. Sikurse në shumicën e anketave mbi pritshmërinë e inflacionit të kryera në vendet fqinje, shumica e të anketuarve (bizneset apo klientët) përgjigjen në pyetjen lidhur me pritjet për inflacionin në 3, 6 dhe 12 muajt e fundit se “inflacioni do të mbetet i pandryshuar nga periudha paraprake,” duke konfirmuar që pritjet e inflacionit janë adaptive. Edhe në rastin e Kosovës, anketa e zhvilluar nga Oda Ekonomike lidhur me klimën afariste konstaton që më shumë se 70% e bizneseve të intervistuar u përgjigjën në këtë mënyrë. Në këtë drejtim, projeksionet që dalin nga modelet autoregresive mund të japin sinjale të besueshme për pritjet e inflacionit duke e pasur parasysh se ato modelojnë performancën e inflacionit mbi sjelljen e saj në të kaluarën.

[3.B.] Investimet e BQK-së udhëhiqen nga Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Politika e brendshme mbi Investimet e Mjeteve të BQK-se, të cilat i investon dhe monitoron shumë afër në aspektin e ekspozimit. BQK-ja ka të drejtë të blejë, të mbajë dhe të tregtojë letrat me vlerë në tregun sekondar, të lëshuar dhe të garantuar nga Republika e Kosovës. Letrat me vlerë të qeverisë blihen direkt nga shitësit kryesorë, bankat komerciale, të disponueshme dhe të gatshme për të tregtuar me letrat me vlerë me çmime të caktuara.

[3.C.] Në vitet e fundit, nëpërmjet zbatimit efikas të reformave të kërkesave legjislativë dhe rregullative, Kosova ka kontribuar dukshëm në zvogëlimin e barrierave që pengojnë qasjen në kredi. Në veçanti, progresi që është arritur në aspektin e përmbaruesve privat dhe ndryshimeve në Ligjin mbi Procedurën e Përmbarimit lidhur me sekuestrimin e llogarisë bankare dhe procedurën e përshpejtuar për shitjen e kolateralit nëpërmjet veprimeve ka pasur ndikim pozitiv në ofertën kreditore për sektorin privat dhe ndër të tjera, i ka bërë bankat të lehtësojnë dy aspekte shumë të rëndësishme të qasjes në financa, përkatësisht lehtësimin e kërkesave lidhur me kolateralin, të cilat ishin shumë të larta deri vonë dhe reduktimin e normave të interesit për kreditë.

Sektori bankar ka regjistruar rritje të qëndrueshme që nga fillimi i operimit të këtij sektori në Kosovë. Në shtator të vitit 2018, raporti kredi/BPV ishte rreth 40.1%, duke bërë që niveli i ndërmjetësimit financiar në Kosovë të konvergjohej me hapa të sigurt drejt një raporti mesatar të vendeve në rajon që qëndron në rreth 55%. Nga shtatori i vitit 2018, rritja vjetore kreditore ishte 11.4% (një rritje e ngjashme në krahasim me 10.2% të regjistruar në vitin paraprak). Kreditë për korporatat regjistruan një rritje vjetore prej 11.6% (9.0% në shtator të vitit 2017), ndërsa kreditë ndaj ekonomive familjare regjistruan një rritje vjetore prej 11.3%, duke treguar një ngadalësim në krahasim me periudhën e njëjtë në vitin paraprak (12.2% në shtator të vitit 2017).

[3.D.] Siç shihet më lartë, konkurrenca në sektorin bankar dhe mjedisi me normë të ulët të interesit ka favorizuar rritje më të fuqishme në kreditë ndaj korporatave, në krahasim me kreditë ndaj ekonomive familjare. Megjithatë, kreditë e reja ndaj ekonomive familjare shënuan një rritje vjetore

prej 12.7%. Cilësia e portofolios aktuale kreditore është e lartë (2.8% raporti i përgjithshëm i KPJ) dhe perspektivat për burimet kryesore të financave në ekonomi janë optimiste; megjithatë, BQK-ja është duke monitoruar me kujdes rritjen e qëndrueshme të lartë të kreditimit ndaj ekonomive familjare nëpërmjet kornizës së saj të politikës makroprudenciale.

[3.E.] Sa i përket kornizës për ndërhyrje të jashtëzakonshme (përfshirë likuidimin), BQK-ja ka finalizuar kornizën dhe drafti i parë i dispozitave të legjislacionit primar është hartuar dhe përfshirë në draftin e ri të finalizuar të Ligjit për Banka. Legjislacioni sekondar i përbërë nga 12 rregullore dhe dispozitat për rikuperim dhe zgjidhje, si dhe drafti i parë i Manualit për Rikuperim, Zgjidhje dhe Likuidim është përfunduar dhe formati i tij final do t'i nënshtrohet aprovimit të Ligjit për Bankat, si dhe Rregulloreve për Ndërhyrje të jashtëzakonshme. Për më tepër, BQK-ja është duke punuar intenzivisht për të finalizuar Kornizën për Menaxhimin e Krizave, e cila do të përfshijë kornizën ligjore dhe institucionale të të gjithë akterëve në aspektin e identifikimit dhe menaxhimit të krizës në nivel kombëtar dhe nivel institucional.

4. “[4.A.] Të miratohet Ligji për Eficiencën e Energjisë dhe krijimi i Fondit për Eficiencë të Energjisë. [4.B.] Të miratohen stimuj të eficiencës së energjisë për sektorin privat dhe ekonominë familjare. [4.C.] Të avancohet puna në de-rregullimin e çmimeve të furnizimit me energji elektrike dhe të përfundojë studimi me qëllim të miratimit të një plani për përshtatjen graduale të tarifave të energjisë për të pasqyruar kostot aktuale”.

[4.A.] Ligji për Eficiencën e Energjisë është miratuar në Kuvend dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2018, anëtarët e Bordit e Drejtorëve për Fondin e Eficiencës së Energjisë në Kosovë janë emëruar. Ligji parasheh periudhë 9 mujore të hartimit të rregulloreve të brendshme për funksionalizimin e Fondit. Planifikimi është që më së largu deri në qershor 2019 të funksionalizimet Fondi duke sjellë parashikimin për investimet e para në projekte në pranverën e vitit 2020.

[4.B.] Pas hartimit të rregulloreve të brendshme për funksionalizimin e fondit (Qershor 2019) fondi fillimisht parasheh mbështetjen e investimeve në sektorin publik dhe në të njëjtën kohe qëndrueshmërinë e Fondit, dhe hartimin e stimujve të eficiencës së energjisë për sektorin privat dhe ekonominë familjare.

[4.C.] Sa i përket de-rregullimit të çmimeve të furnizimit me energji elektrike, Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka miratuar Udhëzuesin për Liberalizimin e tregut të Energjisë në Kosovë. Bazuar në këtë udhëzues parashihen hapat që do të ndërmerren për de-rregullimin e çmimeve të konsumatorëve të energjisë elektrike. De-rregullimi i çmimeve është paraparë si në vijim:

- Konsumatorët e kyçur në nivelin e tensionit 110 kV janë të de-rregulluar pra i nënshtrohen çmimeve të tregut,
- Konsumatorët e kyçur në nivelin e tensionit 35 kV do të de-rregullohen më së largu më 31 mars 2019;
- Konsumatorët e kyçur në nivelin e tensionit 10 kv do të de-rregullohen më së largu deri më 31 mars 2020;

5. “[5.A.] Të miratohet Strategjia e re dhe Plani i Veprimit 2019-2022 për të luftuar ekonominë joformale e cila duhet të përfshijë objektiva cilësore dhe sasiore”.

[5.A.] Grupi punues nën asistencën e një ekspert të jashtëm i kontraktuar nga zyra e BE-së, ka hartuar Strategjinë e re dhe Planit e Veprimit 2019-2022 për të luftuar ekonominë joformale, e cila përfshinë objektiva cilësore dhe sasiore, dokumenti në fjalë ka kaluar fazën e diskutimit ndër-institucional, tani grupi punues është duke punuar për përgatitjen e dokumentit për ta dërguar në konsultim publik.

6. “[6.A.] Të monitorohet zbatimi i planit të veprimit për punësimin e të rinjve dhe të rritet fushëveprimi i masave aktive të tregut të punës, në veçanti për gratë. [6.B.] Të kryhet analiza e shkathtësive të nevojshme për identifikimin e sektorëve prioritarë për ta ndërlidhur me rishikimin e profileve profesionale dhe kurrikulave. [6.C.] Të plotësohen hapat e nevojshëm për aplikimin e skemës së përgjithshme të sigurimeve shëndetësore. [6.D.] Të rritet regjistrimi në arsimin parashkollor”.

[6.A.] Plani i veprimit për punësimin e të rinjve u miratua nga Qeveria e Kosovës më 04 janar 2018. Ky plan i veprimit do të rivlerësohet edhe tri herë gjatë periudhës së vlefshmërisë së planit bazuar në treguesit që janë vendosur në nivelin e objektivave specifike. Objektivat specifike në disa raste përmbajnë më shumë se një tregues, të cilat në shumicën e rasteve janë tregues të matshëm, por ka edhe disa tregues cilësorë. Treguesit janë vendosur si objektiva afatmesme apo afatgjata, ndërsa baza është vendosur për secilin tregues. Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit duhet të ndihmojë në përmirësimin e ekzekutimit të aktiviteteve të parapara në plan për të arritur rezultatet e synuara. Objektivat kryesore të këtij procesi janë:

- Monitorimi i zbatimit të Planit të aktiviteteve;
- Monitorimi i arritjes së Planit të objektivave;
- Mundësia e korigjimit të procesit bazuar në rekomandimet të cilat rrjedhin nga informacionet e procesit të monitorimit.

[6.B.] Me përkrahje nga LuxDevelopment, është bërë analiza e të gjitha raporteve në sektorin e arsimit dhe aftësimin profesional në lidhje me shkathtësitë “Raport mbi hulumtimin e të dhënave dytësore lidhur me publikimet aktuale lidhur me Sektorin e Arsimit dhe Aftësimin Profesional në Kosovë”. dhe po ashtu në bashkëpunim me GIZ-in është hartuar “Raporti mbi gjendjen e ofruesve të arsimit dhe aftësimin profesional”, ku përfshihen shkollat, qendrat e aftësimin dhe institucionet private. Janë dy raporte të cilat përfshijnë të dhënat e nevojshme për sistemin e arsimit dhe aftësimin profesional të cilat do të jenë udhërrëfyes për hartimin e kurrikulave por edhe për politika tjera si investimet në pajisje, trajnime, etj.

[6.C.] Sa i përket aplikimit të skemës së përgjithshme të sigurimeve shëndetësore është në proces të plotësim ndryshimit të projektligjit për sigurimet shëndetësore dhe udhëzimi administrativ për përcaktimin e kriterëve për lirim nga pagesa e kontributit, bashkë-pagesa dhe pagesave të tjera për sigurim shëndetësor për qytetarët sipas testit të varfërisë. Gjithashtu në vitin 2019 do të shtrihet platforma e informimit të fondit të sigurimit shëndetësor, si dhe do të fuqizohen kapacitetet me punësimin e 48 pozitave të reja.

[6.D.] Gjatë vitit 2018 janë licencuar 20 institucione të reja parashkollore private të cilat strehojnë 1,200 fëmijë, të cilat njëkohësisht ndikojnë në rritjen e vijueshmërisë së arsimit parashkollor.

Është miratuar Koncept dokumenti i cili i paraprin Ligjit për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme që përcakton politikat kryesore të cilat ligji i ardhshëm duhet të rregullojë dhe qartësojë në mënyrë që sistemi i edukimit parashkollor të plotësojë standardet e kërkuara dhe të nevojshme për të përmbushur nevojat e fëmijëve për edukim dhe kujdesje në nivelin e fëmijërisë së hershme. Koncept dokumenti i paraprin Ligjit për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, i cili parashihet të hartohet dhe miratohet gjatë vitit 2019.

Për të përmirësuar cilësinë në arsimin parashkollor MASHT është duke e hartuar kurrikulën bërthamë për edukim në fëmijërinë hershme për fëmijët e moshës 0-5 vjet. Procesi i hartimit të këtij dokumenti është mbështetur nga ekspert vendor dhe ndërkombëtar.


- Në kuadër të rritjes së numrit të objekteve për përfshirjen e fëmijëve në edukim parashkollor është ndërtuar objekti i ri në komunën e Gjilanit me kapacitet deri në 120 fëmijë. Gjithashtu edhe në komunën e Suharekës hapësirat e zbrazëta në kuadër të dy objekteve shkollore janë adaptuar për fëmijët të moshës 3-5 vjet si paralele të ndara të institucionit parashkollor “Fluturat” në Suharekë.
- Vetëm për vitin 2018 janë licencuar 24 institucione të reja parashkollore private që nënkupton përfshirjen e rreth 1,240 fëmijëve dhe të cilat ndikojnë në rritjen e vijueshmërisë së arsimit parashkollor
- Janë hapur 10 klasë parafillore (që përfshin fëmijët 5 vjet), 4 prej të cilave në kuadër të shkollave fillore të reja të ndërtuara si dhe në bashkëpunim me organizatën Save the Children janë hapur 6 klasë parafillore në zonat rurale në këto komuna: Mitrovicë, Klinë, Gjakovë, Pejë, Ferizaj.

2. KORNIZA MAKROEKONOMIKE

2.1. Zhvillimet e Jashtme Ekonomike dhe Projektionet

Pas rritjes së përsheptuar të ekonomisë globale që është shënuar në gjysmën e dytë të vitit 2017, gjatë gjysmës së parë të vitit 2018 rritja është ngadalësuar. Për ekonomitë e zhvilluara tashmë pritjet janë më pesimiste për ritmin e tyre të rritjes, por ekonomitë në zhvillim pritet të vazhdojnë me rritje të përsheptuar edhe në periudhën afatmesme.

Grafiku 1. Rritja vjetore e BPV-së, në %



Rritja reale botërore është projektuar të jetë 3.7% në 2018 dhe në 2019, por kjo pritje është për 0.2 pikë përqindje (p.p.) më e ulët se që ishte parashikuar në Prill 2018¹. Në ekonomitë e zhvilluara, rritja më 2018 do të jetë më e lartë se sa trendi i deritanishëm, apo rreth 2.4%, por me pritje ngadalësimi në 2.1% për vitin 2019.

Sipas FMN, masat mbrojtëse të ndërmarra në tregti pritet të kenë efekte negative në aktivitetet ekonomike. Sa i përket trendeve më afatgjata, rritja ekonomike pritet të bjerë në 1.8% nga viti

2020; pas mbarimit të impulsit nga stimuli fiskal në SHBA dhe ngadalësimit të rritjes ekonomike në Kinë. Rritja më vonë parashikohet të bjerë në një trend prej 1.4 përqind, pasi që rritja e popullsisë në moshë pune në vendet e zhvilluara vazhdon të ngadalësohet, ndërsa rritja e produktivitetit në nivel global mbetet përgjithësisht e ngadaltë.

Ekonomia e BE² ka hyrë në një periudhë zhvillimi më pak dinamike pas një rritjeje të vazhdueshme gjatë pesë viteve të fundit. Rritja e BPV-së në BE në 2019 parashikohet jetë 2.0%, ndërsa pritet të ketë një rritje prej 1.9% dhe 1.8% në 2020 dhe 2021, respektivisht. Rritja reale e BPV-së në eurozonë parashikohet të jetë 1.9% në 2019, përderisa në vitin 2020 parashikohet të rritet me 1.7%. Inflacioni i IHÇK-së në eurozonë parashikohet të rritet nga 1.5% në 2017 në 1.8% në 2018 dhe 2019 dhe me një rritje të moderuar në vitin 2020 me 1.6%. Rritja e eksportit (mallrat dhe shërbimet) është një nga faktorët kryesor për zgjerimin e vazhdueshëm ekonomik të euro zonës. Në vitin 2019, rritja e eksporteve në eurozonë parashikohet të mbetet e qëndrueshme në 3.9% (3.8% në 2018) dhe të ngadalësohet në 3.6% në vitin 2020. Ndikimi i tarifave të importit të zbatuara nga BE si përgjigje ndaj tarifave të SHBA-ve për çelik dhe alumin pritet të jetë shumë i vogël për shkak të peshës së vogël në importe të këtyre mallrave. Kushtet në tregun e punës në eurozonë vazhdojnë të përmirësohen dhe shkalla e papunësisë pritet të bie nga 8.4% në 2018 në 7.5% në 2020³.

Gjermania- pritet të ketë rritje më të ulët se mesatarja e BE-së për vitin 2019. BPV-ja në përgjithësi pritet të rritet me 1.7% në 2018, 1.8% në 2019 dhe 1.7% në 2020. Inflacioni pritet të jetë 1.8% në 2018, 1.9% në vitin 2019, dhe 1.6% në 2020. Rritja e eksporteve pritet të jetë më e ulët se në vitet e fundit,

¹ World Economic Outlook, October 2018 Update.


² EU Economic Forecast Autumn 2018

³ EU Economic Forecast Autumn 2018

përderisa importet në raport me BPV-në pritet të rriten. Tregu i punës do të vazhdojë të ketë përmirësime gjatë periudhës afatmesme. Konsumi privat pritet që të rritet në vitin 2019 dhe do të jetë më i larti në vendet e zhvilluara të eurozonës, kjo si rrjedhojë e masave mbështetëse fiskale.

Zvicrra- rritja ekonomike parashikohet të jetë 3% në vitin 2018, me tendencë ngadalësimi në 2% deri në vitin 2020, që megjithatë do të jetë mbi mesataren e dekadës së fundit (rreth 1.5% në vit). Eksportet neto pritet të mbeten kontribuesi kryesor i rritjes. Niveli aktual i normave të interesit, i cili mbështet financimin e investimeve fikse dhe të ndërtimit pritet të vazhdojë edhe në periudhën afatmesme. Inflacioni pritet të jetë rreth 1% gjatë periudhës së parashikimit.

Grafiku 2. Inflacioni



Çmimet ndërkombëtare të mallrave⁴ u rritën me 3.3% gjatë periudhës shkurt-gusht 2018 kryesisht si rezultat i çmimeve më të larta të energjisë. Indeksi i energjisë nga FMN u rrit me 11.1%. Çmimet e ushqimit pësuan rënie prej 6.4%, ndërsa indeksi i çmimeve të metaleve ka shënuar rënie prej 11.7% në periudhën janar-gusht 2018.

Që nga mesi i vitit 2017, shumica e mallrave jo-ushqimore kanë regjistruar rritje të çmimeve. Më e theksuara ka qenë rritja e çmimeve të naftës - nga rreth 30 dollarë për fuçi në qershor 2017 në mbi 76 në qershor 2018, apo rreth 70% rritje. Ky nivel (niveli më i lartë që nga nëntori 2014) reflekton rënien e prodhimit në Venezuelë, ndërprerjet e papritura në Kanada dhe Libi, dhe rënien e eksporteve iraniane pas sanksioneve të SHBA. Çmimet pësuan rënie në rreth 71 dollarë për fuçi deri në gusht, pas një vendimi nga OPEC dhe eksportuesit e naftës jo-anëtarë të OPEC (përfshirë Rusinë) për të rritur prodhimin e naftës.

Megjithatë, kjo rritje e çmimeve të naftës pritet të stabilizohet gjatë periudhës afatmesme për shkak të prodhimit më të lartë global. Duke reflektuar kryesisht në rritjen e çmimeve të mallrave, që kanë ndodhur kohëve të fundit, inflacioni parashikohet të rritet deri në 2% më 2018, nga 1.7% sa ishte në vitin 2017. Norma e peshuar e inflacionit në vendet në zhvillim dhe vendet e zhvilluara, duke përjashtuar Venezuelën, pritet të rritet në 5.0% në vitin 2018, nga 4.3% sa ishte në vitin 2017. Në Eurozonë, indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit parashikohet të rritet me ritëm të ngadaltë deri në 2% përgjatë periudhës afatmesme.

⁴ Indeksi i Çmimeve të Komoditeteve, FMN, WEO Tetor 2018

Tabela 1. Treguesit kryesorë botërorë


	2018	2019	2020	2021
BPV botërore	3.73	3.65	3.66	3.64
BPV në EU	2.03	1.88	1.65	1.55
Inflacioni në EU	1.70	1.72	1.83	1.95
Euribor 3-mujor - BQE ⁵	-0.3%	-0.2%	0.2%	
Çmimi i naftës \$/për fuçi	69.38	68.76	65.73	63.10
Çmimi i ushqimeve indeksi 2005	150.89	152.88	153.83	154.62
Çmimi i nikelit \$/ton	13,734.46	13,776.25	13,968.17	14,092.25
Çmimi i zinkut \$/ton	2,890.75	2,440.71	2,388.79	2,312.33
Çmimi i plumbit \$/ton	2,293.41	2,139.25	2,147.50	2,147.50

2.2. Zhvillimet e fundit në ekonominë Kosovare

Sipas të dhënave zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja është rritur 3.9% në periudhën Janar-Shtator të vitit 2018 (3.5% në TM1, 4.7% në TM2 dhe 3.4% në TM3). Edhe pse gjatë vitit inflacioni në çmimet e konsumit ka shënuar rritje prej 1.1%, çmimet e importit janë rritur për 2% gjatë periudhës Janar-Shtator të vitit 2018. Ndërsa, deflatori i BPV-së është zvogëluar për 0.1%.

Gjatë periudhës Janar-Shtator vlerësohet se kontributin më të madh në rritjen e BPV-së e kanë dhënë konsumi dhe investimet (5.5 p.p konsumi dhe 3.7 p.p investimet).

Grafiku 3. Struktura e BPV-së në 2018 dhe 2019, vlerat nominale, në miliona euro




Çmimet e konsumit janë rritur mesatarisht me 1.1% në vitin 2018, me një rritje të theksuar sezonale në muajt e fundit të vitit. Kjo rritje reflekton kryesisht rritjen e çmimeve të transportit me një normë prej 3.9%, të cilat filluan të ngriten pas rritjes së çmimeve të derivateve në tregjet

botërore si dhe rritjes së produkteve ushqimore (dhe pijeve jo-alkoolike) me 1.6%, dhe rritjes pijeve alkoolike dhe duhanit me normë 2.4%.

⁵ EU Forecast Autumn 2018


Grafiku 4. Niveli i çmimeve në Kosovë, në%



Burimi: ASK

Edhe kategorizimi i inflacionit total sipas sektorit të tregtueshëm dhe të patregtueshëm mbështet faktin që zhvillimet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare kanë dominuar ecurinë e indeksit të çmimeve të konsumit në Kosovë. Ashti siç tregon grafiku 5, inflacioni i tregtueshëm është ai që i ka dhënë gjithë tonin inflacionit total gjatë vitit 2018, ndërkohë që inflacioni i sektorit të patregtueshëm, i cili mat presionet inflacioniste me origjinë ekonominë e brendshme, ka qenë neglizhent dhe ndjeshëm më i vogël se në vitin 2017. Mesatarisht, inflacioni total prej 1.05% gjatë vitit 2018 i atribuohet plotësisht kontributit të inflacionit të tregtueshëm.

Grafiku 5. Kontributi i Inflacionit të tregtueshëm dhe të patregtueshëm në normën e inflacionit total




Burimi: ASK dhe kalkulimet e njësisë së makroekonomisë

2.2.1. Klima e biznesit

Bazuar në të dhënat nga Oda Ekonomike e Kosovës, indikator i klimës së biznesit ka mbetur i njëjtë gjatë vitit 2018 krahasuar me vitin e kaluar. Rezultatet e Indikatorit të Klimës së Biznesit janë paraqitur në grafikun më poshtë ku shihet se ka variacione të konsiderueshme gjatë tremujorëve. Situata e tanishme e bizneseve në sektorin e ndërtimitarisë është përkeqësuar në TM4, në krahasim me periudhën

e njëjtë të vitit të kaluar, përderisa të githë sektorët tjerë kanë treguar rritje të theksuar në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.


Grafiku 6. Treguesi i klimës së biznesit (TKB), në pika



‘Bilanci’ paraqet diferencën në mes të përqindjes së bizneseve të cilat kanë pasur një vlerësim pozitiv dhe atyre me vlerësim negativ ndaj klimës së tanishme bizneseve. Grafiku 6 paraqet vlerësimin e situatës aktuale të sektorëve të biznesit (‘Bilancin’), rritjen tremujore të BPV-së reale si dhe IKB-së të përgjithshëm. Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafik, nuk shihet ndonjë

korelacion në mes të IKB-së dhe rritjes së BPV-së, që e bën më të vështirë përcaktimin e trendit apo sezonalitetit në kontekstin e serive të shkurta kohore.

Grafiku 7. Bilancet e vlerësimit të situatës aktuale të sektorëve të biznesit⁶ (së bashku me treguesin për klimë të biznesit dhe rritjen reale të BPV-së)



Burimi: Raporti: “Gjetjet e klimës së biznesit kosovar në tremujorin e 4-të të vitit 2018” OEK-ut, ASK dhe Analiza e njësisë së Makroekonomike

Megjithatë, mund të shohim se këto të dhëna japin pasqyrim që është në përputhje me zhvillimet reale të viteve të fundit. Përmirësimet e fundit në KBI pasqyrojnë mjedis më të mirë të biznesit.

2.2.2. Punësimi, produktiviteti, dhe pagat

Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore të kryer nga ASK, në vitin 2017 popullsia në moshë pune në Kosovë ishte 1.2 milionë persona, me pjesëmarrje gjinore të njëjtë ashtu sikurse ishte në të kaluarën. Megjithatë, fuqia punëtore aktive (persona aktiv në mes të moshës 15 dhe 64 vjeç) ishte 513,578 persona nga të cilët vetëm 119,027 femra. **Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (ShPFP)⁷** për

⁶ Analiza është shkurtuar për tu përshtatur serisë ekzistuese për BPV-në tremujore të publikuar nga ASK, e që është në dispozicion vetëm për periudhën TM1 2013 - 2018 TM4

⁷ E matur si fuqi punëtore si përqindje e popullsisë së përgjithshme e aftë për punë; d.m.th. qytetarët të cilët janë të punësuar, ose në mënyrë aktive kërkojnë punë

femra është më e ulët se ajo për meshkuj (20% dhe 65.3% respektivisht), me ShPFP-në totale e cila në vitin 2017 ishte 42.8%, apo mbi 4 pikë të përqindjes më e lartë se në vitin 2016.

Tabela 2. Treguesit kryesorë të tregut të punës

Treguesi	2014	2015	2016	2017
Totali i popullsisë	1,811,521	1,757,843	1,771,604	1,793,466
Meshkuj	911,131	888,231	896,466	900,827
Femra	900,390	869,612	875,138	892,639
Mosha e popullsisë e aftë për punë	1,202,489	1,176,147	1,184,529	1,200,165
Meshkuj	600,481	594,262	598,639	604,443
Femra	602,008	581,885	585,890	595,722
Fuqia punëtore	500,251	442,716	457,831	513,678
Meshkuj	371,276	337,119	348,764	394,651
Femra	128,975	105,597	109,067	119,027
Të punësuar	323,508	296,940	331,761	357,095
Meshkuj	248,224	229,957	257,398	281,581
Femra	75,284	66,983	74,363	75,514
Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore(ShPFP)	41.6%	37.6%	38.7%	42.8%
Shkalla e punësimit	26.9%	25.2%	28.0%	29.8%
Shkalla e papunësisë	35.3%	32.9%	27.5%	30.5%

Burimi: ASK Anketa e Fuqisë Punëtore 2017(publikuar në Qershor 2018)

Popullsia totale në vitin 2017 është rritur për 1.2% në krahasim me vitin 2016, e cila njëkohësisht paraqet rritje për 1.3% të popullsisë së aftë për punë në krahasim me vitin e kaluar. Gjatë vitit 2017 ishin 357,095 të punësuar (norma e punësimit 29.8%), që paraqet rritje prej rreth 1.8 p.p. në krahasim me vitin 2016.

Ngjashëm me vitet e mëparshme, në vitin 2017 katër kategoritë kryesore me më shumë se gjysmën e numrit të përgjithshëm të të punësuarve ishin: tregtia (14.7%), prodhimi (13.2%), ndërtimtaria (12.9%) dhe arsimi (9.5%). Të dhënat tregojnë variacion të theksuar gjinor. Kategoritë kryesore në të cilat janë të punësuar meshkujt janë: prodhimi, tregtia me pakicë dhe shumicë, dhe ndërtimtaria, ndërsa gratë janë të punësuar në arsim, aktivitetet që lidhen me shëndetin e njeriut dhe punë sociale, si dhe tregti me pakicë dhe shumicë. Duhet theksuar se gjatë vitit 2017, numri i femrave të punësuar me shkollim primar dhe sekondar është zvogëluar ndërsa, numri i femrave më shkollim të lartë është rritur.

Tabela 3 paraqet të dhënat për produktivitetin e punës dhe Kostot për Njësi të Punës (KPNJ) për vitet 2017 dhe 2016, ku “produktiviteti i punës” në nivel kombëtar është rritur në krahasim me vitin 2016, përderisa KPNJ ka shënuar rënie nga 8.8% në 2016 në 3.6% në 2017.

Tabela 3. Produktiviteti i punës dhe Kostot për Njësi të Punës – KPNJ

Treguesi	2014	2015	2016	2017
Orët e punës në javë për person	41	41	41	42
Paga mesatare, bruto (ASK)	482	510	519	528
Numri i orëve të punës në një vit për person	2,119	2,132	2,145	2,184
Punësimi(AFP)	323,508	296,940	331,761	357,095
BPV nominale (në milionë euro)	5,567.50	5,807.01	6,070.11	6,413.86
Gjithsej orë të punës në vend (në milion)	685.51	633.08	711.63	779.90


Produktiviteti i punës (euro për orë)	8.1	9.2	8.5	8.2
Totali i kompensimit të punës (në milionë euro)	1,871.17	1,817.27	2,066.21	2,262.55
KPNj (proporcioni) ⁸	0.34	0.31	0.34	0.35
Produktiviteti i punës	12.0%	12.9%	-7.0%	-3.6%
KPNj ⁹	-0.7%	-6.9%	8.8%	3.6%

Burimi: ASK, analizat e njësisë së Makros

Duke krahasuar të dhënat e AFP-së nga ASK të vitit 2017 me ato të vitit 2016, produktiviteti i punës në nivel kombëtar ka shënuar rritje në vitin 2017 pas rënies së vitit 2016. Nga ana tjetër, në lidhje me konkureshmërinë sipas kostos së punës, raporti i KNjP-së (Kostos për Njësi të Punës) në vitin 2017 është zvogëluar krahasuar me vitin paraprak. Gjithashtu edhe numri i të punësuarve është rritur për 7.6% në vitin 2017.

Në horizontin afatmesëm, pritet një rritje graduale e punësimit. Krijimi i mjedisit më të mirë të të bërit biznes në sektorin privat, do të ketë ndikim pozitiv në veprimtarinë e kompanive, duke rritur mundësitë e punësimit. Gjithashtu, masat aktive të punës, të buxhetuara për herë të parë në vitin 2019, priten të prodhojnë efektin e tyre pozitiv.

Grafiku 8. Paga mesatare bruto, në Euro



Grafiku 8 tregon dallimet ndërmjet **nivelit të pagës mesatare të sektorit publik dhe atij privat** në Kosovë. Gjatë dy viteve të fundit, niveli i pagave ka patur rritje të lehtë, si rezultat i indeksimit të eksperiencës për zyrtarët publik. Megjithatë, duhet theksuar se krahasimi në mes të pagave në sektorin publik dhe privat nuk është plotësisht i qëndrueshëm, duke marrë parasysh variacionet në aftësitë e të punësuarve, kompensimin e performancës në sektorin privat,

si dhe nën-deklarimin e mundshëm të të ardhurave në sektorin privat.

2.3. Skenari makroekonomik afat-mesëm

2.3.1. Projektionet e llogarive kombëtare

Për periudhën 2019-2021, Ministria e Financave ka reviduar parashikimet e tanishme nga projeksionet e publikuara në PRE 2018-2020.

Si rezultat i ndryshimeve në bazën për vitin 2018, struktura e rritjes ekonomike varion nga projeksionet e mëparshme. Rritja ekonomike do të vazhdojë të jetë e udhëhequr kryesisht nga konsumi (publik dhe privat) dhe investimet (publike dhe private), mirëpo investimet publike pritet të luajnë rol më të lartë në rritjen e BPV-së. Largimi i pengesave për shfrytëzimin e fondeve të likudimit luan një rol kyç në këtë drejtim, por edhe zhvendosja para e implementimit të projekt-kredive. Për periudhën 2019-2021, rritja reale mesatare vlerësohet të jetë 4.6%, duke filluar nga vlerësimi prej 4.7% në 2019, 4.2% në 2020, dhe 4.8% në 2021.


⁸ KPNj-paraqet raportin në mes të totalit të kompensimit të punës me BPV nominale

⁹ Paraqet raportin KPNj proporcion të vitit aktual me vitin e kaluar

Rritja ekonomike në periudhën afat-mesme është e motivuar nga tri zhvillime kyçe: a) rritje e konsiderueshme e investimeve publike të financuara nga huamarrja dhe mjetet nga likuidimi i ndërmarrjeve, b) një ambient i jashtëm relativisht i favorshëm, i cili i ndikon të hyrat e disponueshme private të neto kompensimit të faktorëve të prodhimit si dhe nëpërmjet kërkesës së shtuar për eksporte të mallrave dhe shërbimeve, dhe c) rritja e kredihënies, e shtyrë nga normat më të ulëta të interesit dhe përmirësimi i qasjes në financim, e cila pritet të jetë shtytësi kryesor i brendshëm për **konsumin privat** në skenarin afat-mesëm.

Në të njëjtën kohë, të hyrat e disponueshme private projektohen të rriten si rezultat i përforcimit të rritjes së remitencave, rritjes së transfereve sociale, si dhe rritjes së punësimit në sektorin privat. Rritjet në shpenzimet për mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe shëndetësisë dhe punësimi më i lartë publik në sektorët e gjyqësorit dhe shëndetësisë gjithashtu pritet të rrisin volumin e konsumit publik gjatë periudhës afat mesme. Përderisa rritjet në pagat e sektorit publik kanë një impakt më të ulët në konsum për shkak të efektit të inflacionit, ato gjithashtu japin një shtytje marginale të konsumit privat nëpërmjet efektit multiplikues të parasë. **Konsumi total** pritet të rritet me një normë reale prej 4% në 2019 duke vazhduar me një rritje mesatare reale prej 3.6% në 2020 dhe 2021, që rezulton me një kontribut në rritjen reale mesatare prej 3.7 pikë të përqindjes në periudhën afatmesme.

Grafiku 9. Kontributi në rritjen reale të BPV-së



Në periudhën afat-mesme, norma e kursimeve private në të hyrat e disponueshme vlerësohet të rritet me një mesatare prej 5.1%. Në të njëjtën kohë, projeksionet për periudhën afat-mesme përfshijnë një plan ambicioz të investimeve me rritje mesatare prej 6.2% përgjatë periudhës afat-mesme. Ndaj një prirje më të lartë për kursime dhe në linjë me rritjen e pritjeve pozitive të bizneseve për periudhën e ardhshme, investimet totale pritet të kenë një kontribut mesatar ndaj rritjes prej 1.9% në periudhën afatmesme (investimet private me 0.8%, investimet publike me 1.1%).

Investimet private projektohen të rriten me 3.7%, në vlerë reale, gjatë vitit 2019, duke mbajtur trend të njëjtë në një mesatare prej 3.7% në 2020 dhe 2021. Ulja e kostos së kredive dhe përmirësimi i mundësive për kredimarrje, duke përfshirë mundësitë më të mëdha për kredimarrje nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare. (IFN) për sektorin privat, do të ofrojnë një stimul të rëndësishëm në investime. Për më shumë, rritja e kapitalit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë pritet të ofrojë më shumë qasje në financa dhe do mundësojë zgjerimin e kredihënjes për investime. Në fund, skema e re qeveritare për stimulimin e prodhimit nëpërmjet lirimit nga tatimet doganore dhe akcizave për

lëndën e parë në prodhim pritet të ofrojë shtytje për rritjen e investimeve në periudhën afatmesme duke ulur koston e prodhimit dhe duke mundësuar ri-investimin e fitimit dhe zgjerimin e bizneseve.

Investimi publik nga ana tjetër projektohet të rritet për 12.6% në terma realë, gjatë periudhës afatmesme. Për më shumë, mbi 30% e investimeve publike projektohet të financohen nga borxhi afatgjatë koncesionar dhe nga të hyrat prej likuidimit të aseteve, të cilat për momentin investohen në tregjet ndërkombëtare financiare. Investimi i mbi 500 milionë eurove brenda periudhës afat-mesme me financim nga huamarrja dhe fondet ekzistuese nga likuidimi i ndëmarrjeve shoqërore që për momentin investohen jashtë ekonomisë vendore (e jo nga taksat të cilat i ulin të hyrat e disponueshme) ndërlidhet ngushtë me efekte të multiplikimit dhe do të ofrojë një shtytje substanciale të rritjes afat-mesme.

Eksporti i mallrave projektohet të rritet gjatë periudhës afatmesme 2019-2021 me një mesatare prej 3.9%. Diversifikimi i eksportit të mallrave, i cili është evidentuar në periudhën 2017-2018 pritet të përshpejtohet në periudhën afatmesme. Kjo pritet të jetë rezultat pas lansimit të skemës qeveritare për stimulim të prodhimit, si dhe në vijë me objektivat e reformave qeveritare për të harmonizuar procedurat administrative dhe për të lehtësuar tregtinë duke zvogëluar kostot administrative dhe përmirësimin e infrastrukturës mbikqyrëse.


Nga ana tjetër, **eksporti i shërbimeve** – i cili përfaqëson 23% të BPV-së në 2018 – pritet të rritet me një normë reale prej 5.8% në periudhën afatmesme. Parashikimet e rritjes në BE ndërlidhen me kërkesë më të madhe për eksportin e shërbimeve kosovare, kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve të pushimeve të anëtarëve të diasporës kosovare por gjithashtu për shkak të rritjes së kërkesës për eksportin e shërbimeve të telekomunikimit.

Si pasojë e rritjes së investimeve, konsumit dhe eksportit, **importi i mallrave dhe shërbimeve** pritet të rritet për 5.6% në 2019 dhe të ngadalësohet në normë mesatare të rritjes prej 3.7% në 2020 dhe 2021. Sidoqoftë, gjatë periudhës afatmesme, importi i shërbimeve pritet të ulet në vijë me trendet historike, gjë që reflekton uljen e shërbimeve të financuara nga donatorët si dhe zëvendësimin e shërbimeve të telekomunikimit.

Në **anën e prodhimit**, sektori i ndërtimtarisë mbetet kontribuuesi më i madh në rritjen ekonomike. Ndërsa sa i përket shërbimeve, ngjashëm me trendet historike ato janë projektuar për të vazhduar trendin e rritjes, duke shënuar mesatarisht një rritje reale prej 1.7% gjatë periudhës së parashikuar. Duke konsideruar kërkesën për eksportin e shërbimeve të udhëtimit, si dhe nivelin e të hyrave primare dhe sekondare që futen në vend, dhe masat për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të produkteve turistike, rritja e shërbimeve është një rezultat i drejtpërdrejtë i modelit të tanishëm të rritjes. Vlera e shtuar nga sektori i industrisë pritet të rritet me një mesatare prej më shumë se 7% në periudhën afatmesme.¹⁰Ndërsa, bujqësia pritet të ketë rritje të moderuar prej 1.8% gjatë periudhës afatmesme.

¹⁰ Parashikimi i aktiviteteve ekonomike inkorporon gjykim ekspertësh dhe performance historike, rrjedhimisht këto projeksione duhen të interpretohen me rezervë.

Grafiku 10. Kontributi sektorial në rritjen e BPV-së në pikë përqindjeje




Burimi: ASK dhe kalkulimet e njësisë së Makroekonomisë

2.3.2. Politika monetare, norma e këmbimit dhe inflacioni

Në pajtim me raportin mbi zhvillimet ekonomike botërore (WEO) të FMN-së rreth çmimeve të ushqimit dhe ato të naftës niveli i përgjithshëm i çmimeve në Kosovë ka rritje në një mesatare vjetore prej 1.1% gjatë vitit 2018 (parashikimet ishin për rritje prej 1%). Në vitin 2019, indeksi i çmimeve të konsumit parashihet të jetë 1.3%, që do të vazhdojë të jetë i njëjtë edhe për periudhën 2020-2021. Çmimet e importit parashihet të rriten për 2% në secilin vit gjatë periudhës afatmesme, ndërsa deflatori i BPV-së gjatë vitit 2019 parashihet të rritet 0.6%, 1.4% në vitin 2020 dhe 0.8% në vitin 2021.

Gjithashtu, nivelet e qëndrueshme të çmimeve kanë kontribuar drejt një norme të qëndrueshme reale efektive të këmbimit (NREK).¹¹ Deri në nëntor të 2018, NREK është zhvlerësuar në një mesatare prej 0.5%, ndërsa NNEK¹² është rritur për 0.2%.

Grafiku 11. Parashikimi i IÇK-së mujore (së bashku me komponentin e aplikuar e të përshtatur sezonal)



Burimi: ASK, parashikimet e njësisë së makroekonomisë.

¹¹ NREK ofrohet nga Banka Qendrore e Kosovës (të dhënat ofrohen deri në nëntor 2018).

¹² Kursi Nominal Efektiv i Këmbimit-Kursi efektiv i këmbimit tregon nëse një valutë zhvlerësohet apo mbivlerësohet, ndaj shpirtës së matur të valutave të jashtme në vlerë nominale

2.3.3. Sektori i jashtëm dhe qëndrueshmëria e tij afatmesme

2.3.3.1. Eksporti i mallrave, vlerësimet 2018 dhe parashikimet 2019-2021

Tabela 4. Parashikimi I eksporteve të mallrave në periudhën afatmesme

	2019	2020	2021
BPV nominale	7,127	7,530	7,956
<i>Rritja%</i>	5.4%	5.7%	5.7%
Eksportet(Nominale)	2,062	2,205	2,348
<i>Rritja%</i>	6.6%	6.9%	6.5%
Mallra	370	394	411
<i>Rritja%</i>	4.9%	6.5%	4.3%
% e BPV nominale	28.9%	29.3%	29.5%


Gjatë periudhës Janar-Tetor 2018, **deficiti i llogarisë rrjedhëse** ishte 6% e BPV-së së parashikuar për vitin 2018. Ky tregues pritet të mbajë nivel të njëjtë gjatë tërë periudhës së parashikuar 2019-2021 (mesatarisht 9.2%). Bilanci tregtar për vitin 2018 përllëgaritet të arrijë në rreth -28.5% të BPV-së; me një mesatare -29.3% përgjatë periudhës së

parashikuar 2019-2021.

Në periudhën afatmesme, eksporti total në terma real pritet të rritet me normë mesatare prej 5.5%. Rritja e eksportit të mallrave do të shtyhet kryesisht nga masat për stimulimin e ekonomisë nëpërmjet përmirësimit të kornizës tatimore dhe masave për stimulimin e prodhimit të brendshëm. Në periudhën Janar-Nëntor 2018, eksporti i mallrave ka arritur vlerën prej 337.8mil €.

Për të paraqitur vlerën reale të diversifikimit të eksportit, kemi përdorur indeksin e Herfindal-Hirschman¹³. Në Grafikon 12 janë paraqitur eksportet në katër dimensione të ndryshme, ku shihet se eksportet karakterizohen nga nivel i lartë i diversifikimit të produkteve të eksporteve.

Grafiku 12. Diversifikimi i eksporteve sipas indeksit të Herfindal-Hirschman



Është e qartë se diversifikimi i eksporteve potencialisht është një nga mënyrat më të mira për të siguruar qëndrueshmërinë e eksporteve, duke kontribuar kështu në përmirësimin e bilancit tregtar të vendit. Lidhshmëria e ngjarjeve (rritja e prodhimit vendor shpie në zëvendësimin e importit që hap rrugë për diversifikim dhe rritje të eksporteve) është dëshmuar se funksionon si strategji edhe pse

lëviz me një ritëm më të ngadaltë se sa ajo që pritej. Kjo ndodh për shkak se agjentëve ekonomik u duhet kohë të shfrytëzojnë plotësisht ndryshimet në kornizën ligjore (në këtë rast, tatimet) dhe të përcjellin ritmin e shpejtë të ndryshimit të marrëveshjeve ndërkombëtare të tregtisë, veçanërisht sa i përket Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) të Kosovës për BE.

Struktura e eksportit të Kosovës aktualisht është e përqendruar në drejtim të eksportit të metaleve bazë dhe artikujve nga metalet bazë si dhe produkteve minerale, të cilat deri në nëntor 2018 përbëjnë 48.1% të totalit të eksporteve (33.7% metalet bazë dhe 14.4% produktet minerale). Megjithatë, siç mund të shihet në Grafikon 12, përqëndrimi i strukturës së eksporteve po zvogëlohet vazhdimisht, teksa prodhuesit fillojnë të rrisin cilësinë dhe kapacitetin e tyre të prodhimit.

¹³ Indeksi i Herfindal-Hirschman mat shpërndarjen sipas vlerës tregtare ndërmjet produkteve ose destinacioneve të mallrave të eksportuara (vlerat e ulëta të indeksit nënkuptojnë shpërndarje/diversifikim më të lartë)

Një sektor i rëndësishëm me një rritje të qëndrueshme është sektori i plastikës dhe gomës i cili deri në nëntor 2018 përbënte 12.3% të eksporteve totale, me rritje vjetore rreth 26.1%. Nga diversifikimi i përgjithshëm i strukturës së eksportit dhe cilësisë më të lartë të mallrave të eksporteve pritet që ekonomia lokale do të përfitojë në mënyrë të konsiderueshme në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Kryesisht, pritjet janë që rreziqet e larta të lidhura me koncentrimin e lartë të eksporteve të zvogëlohen ndjeshëm në një periudhë afatmesme, gjë që shton besimin në parashikimet tona të rritjes më të lartë ekonomike.

Tabela 5 paraqet vendet dhe grupet e vendeve (sipas viteve) që përbëjnë më shumë se 95% të totalit të eksporteve të Kosovës. Eksporti i mallrave në vendet e BE-së ka rënë në 2016 por gjatë vitit 2017 është rritur sërish, rritje e cila ka vazhduar edhe gjatë vitit 2018. Në anën tjetër, eksportet drejt vendeve anëtare të CEFTA-s gjatë periudhës Janar-Nëntor kanë rënë me 6.5%. Përveç eksporteve nga Shqipëria të cilat janë rritur për 11.7%, eksportet me vendet tjera anëtare të CEFTA-së kanë shënuar rënie.

Tabela 5. Përbërja gjeografike e eksporteve në '000 euro

Eksportet (mijëra €)	2014	2015	2016	2017	2018
EU	98,086.10	106,421.90	70,060.71	94,227.88	103,406.78
CEFTA	127,145.57	127,389.17	144,263.76	183,032.55	159,986.25
Zvicra	10,037.85	11,831.43	16,761.84	21,354.83	27,114.37
Turqia	10,365.42	8,844.84	7,630.97	7,176.94	7,845.6
Kina		4,274.63	11,693.95	5,603.07	1,348.32
India	27,425.46	43,888.11	9,425.45	52,606.48	30,656.13
Japonia	506.54	1,675.50	84.20	184.34	173.88
Tjera	50,976.21	21,914.07	49,766.78	13,824.33	7,301.38
Total Eksportet	324,543.15	326,239.64	309,687.65	378,010.43	337,832.71
Pjesëmarrja e BE-së në total	30.22%	32.62%	22.62%	24.93%	30.61%

Burimi: Llogaritjet e bazuara në ASK, Statistikat e Tregtisë së Jashtme/të dhënat në dispozicion deri në nëntor 2018

2.3.3.2. Importi i mallrave, vlerësimet 2018 dhe parashikimet 2019-2021

Tabela 6. Parashikimi për importet e mallrave në periudhën afatmesme

	2019	2020	2021
BPV nominale	7,127	7,530	7,956
<i>Rritja%</i>	5.4%	5.7%	5.7%
Importet(Nominale)	4,165	4,404	4,664
<i>Rritja%</i>	7.9%	5.7%	5.9%
Mallra	3,502	3,708	3,932
<i>Rritja%</i>	8.4%	5.9%	6.1%
<i>% e BPV nominale</i>	58.4%	58.5%	58.6%

Importi i mallrave pritet të rritet në periudhën afatmesme kryesisht për shkak të rritjes së konsumit dhe investimeve. Kjo rritje e kërkesës agregate do të mbushet pjesërisht nga zëvendësimi i importeve për shkak se prodhuesit vendor do të rrisin kapacitetet për të kënaqur kërkesën vendore. Sidoqoftë, kërkesa përmbi ofertën vendore pritet të mbushet nga importet.

Në periudhën Janar-Nëntor, importet e mallrave janë rritur për 10.4%, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Bazuar në të dhënat nga ASK-ja, pjesëmarrja e kategorive të ndryshme të importeve në nivelin total të importeve (diversifikimi i lartë i prodhimeve të importuara) mbetet i njëjtë në krahasim me vitet e kaluara. Për shembull, gjatë periudhës Janar-Nëntor 2018, pjesëmarrja e produkteve minerale të importuara në Kosovë përbënte 15.25% të totalit të importeve. Kjo kategori ka pjesëmarrje pak më të lartë në krahasim me vitin e kaluar.

Tabela 7. Pjesëmarrja e mallrave të importuara në totalin e importit

Përshkrimi	2015	2016	2017	2018
Produkte minerale	15.34%	11.74%	14.53%	15.25%
Metale bazë dhe artikuj prej tyre	9.89%	9.87%	10.08%	11.54%
Produkte bimore	5.44%	5.30%	4.88%	4.53%
Ushqime të përg. Pije dhe duhan	13.39%	13.37%	12.99%	11.7%
Plastikë, gomë dhe artikujt prej tyre	6.19%	6.75%	6.38%	6.55%
Tjera	49.75%	52.96%	51.14%	50.43%

Burimi: ASK, Statistikat e tregtisë së jashtme, I/ Të dhënat e disponueshme deri në nëntor 2018

Tabela në vijim paraqet importet, vendet dhe grupet e vendeve. Nga kjo tabelë mund të shohim se importi i mallrave nga vendet e BE-së ka pak a shumë të njëjtin nivel me vitet e kaluara. Ndërsa, importet nga vendet e CEFTA-s kanë rënë për 1.5 pikë të përqindjes, me pjesëmarrje në totalin e importeve prej 26.6%.

Tabela 8. Përbërja gjeografike e importeve, në '000 euro

Importet(në mijëra€)	2014	2015	2016	2017	2018
BE	1,081,042.0	1,125,659.7	1,202,165.4	1,312,145.5	1,299,252.8
CEFTA	720,381.92	777,376.35	753,307.54	856,097.09	808,276.31
Zvicra	30,184.66	24,225.59	21,809.98	24,327.60	31,279.07
Turqia	238,268.36	252,163.75	288,502.66	292,701.46	302,186.08
Kina	204,789.05	232,395.01	258,485.48	275,516.65	282,181.07
India	9,462.22	14,624.49	18,960.33	17,993.28	28,107.91
Japonia	11,395.54	11,746.75	11,090.51	14,342.32	11,825.54
Të tjera	242,812.89	214,380.64	235,386.53	254,082.85	273,192.37
Gjithsej importi	2,538,336.7	2,652,572.3	2,789,708.5	3,047,206.7	3,036,301.2
Pjesëmarrja e BE-së në gjithsej importe	42.59%	42.44%	43.09%	43.06%	42.79%

Burimi: ASK, Statistikat e tregtisë së jashtme, I/ Të dhënat e disponueshme deri në nëntor 2018

2.3.3.3. Tregtimi i shërbimeve, vlerësimet 2018 dhe parashikimet 2019-2021

Tabela 9. Parashikimi për importin-eksportin e shërbimeve në periudhën afatmesme

	2019	2020	2021
BPV Nominale	7,127	7,530	7,956
<i>Eksporti i shërbimeve(nominal)</i>	<i>1,692</i>	<i>1,811</i>	<i>1,937</i>
Importi I shërbimeve(nominal)	664	697	732
<i>Bilanci</i>	<i>1,028</i>	<i>1,114</i>	<i>1,206</i>
Bilanci si % e BPV nominale	14.4%	14.8%	15.2%

Bilanci i shërbimeve gjatë periudhës Janar-Tetor 2018, është rritur për 5%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Shërbimet e udhëtimit dominojnë me një pjesëmarrje rreth 80% të totalit të shërbimeve të eksportuara, përderisa

importet e shërbimeve të udhëtimit kanë pjesëmarrje prej 39% të importit të shërbimeve. Bilanci i eksporteve dhe importeve pritet të jetë relativisht konstant gjatë periudhës afatmesme. Në përgjithësi, ka një koncentrim relativisht të lartë të importit dhe eksportit të shërbimeve.

2.4. Llogaria rrjedhëse, vlerësimet 2018 dhe parashikimet 2019-2021

Tabela 10. Parashikimi për importet-eksportet, deficitin e llogarisë rrjedhëse në periudhën afatmesme

	2019	2020	2021
BPV Nominale	7,127	7,530	7,956
<i>Rritja%</i>	5.4%	5.7%	5.7%
Importet(Nominale)	4,165	4,404	4,664
<i>Mallra</i>	3,502	3,708	3,932
<i>Shërbime</i>	664	697	732
Eksportet(Nominale)	2,062	2,205	2,348
<i>Mallra</i>	370	394	411
Shërbime	1,692	1,811	1,937
Bilanci I llogarisë rrjedhëse	-681	-680	-727


Pritet që deficitin tregtar do të zgjerohet lehtë për shkak se norma e rritjes së konsumit të brendshëm dhe investimit në horizontin e parashikimit (2019-2021) do të tejkalojë dukshëm rritjen në prodhimin e mallrave për konsum të brendshëm. Ky trend shihet në rritjen e eksportit të mallrave. Sidoqoftë, siç është shpjeguar më lartë, eksporti i shërbimeve pritet të kundërpeshojë

importin e shërbimeve dukshëm kryesisht për shkak të pritshmërisë së rritjes të udhëtimit dhe diversifikimit të eksportit të shërbimeve drejt eksportit të shërbimeve të TI-së dhe shërbimeve të qendrave të mbështetjes.

Edhe pse Kosova është një ekonomi e vogël ajo ka ekonomi të hapur me një regjim liberal tregtar, e cila karakterizohet me **hapje të vogël tregtare**¹⁴. Ndërkohë që niveli i importeve vazhdon të mbetet i lartë, baza e eksporteve mbetet e ulët, e cila mbetet një nga sfidat kryesore strukturore me të cilën përballet ekonomia. Kjo ndikon drejtpërdrejt në indeksin e hapjes tregtare. Megjithatë, ndryshimet në politikat tatimore për të stimuluar prodhimin vendor pritet të rrisin eksportet dhe të zëvendësojnë importet duke ulur kështu deficitin negativ tregtar.

Grafiku 13 ilustron indeksin e ulët të hapjes tregtare, veçanërisht në krahasim me vendet fqinje. Duke e krahasuar me vitin 2016, rezultati i këtij indeksi për Kosovën është ngritur gjatë vitit 2017, gjithashtu edhe vendet fqinje si Shqipëria, Maqedonia, Serbia, dhe Mali i Zi kanë regjistruar përmirësime.

Grafiku 13. Indeksi i hapjes së tregut, krahasimi me vendet e rajonit dhe eurozonën



Llogaria e të ardhurave ka ruajtur bilancin pozitiv. Kompensimi i të punësuarve¹⁵ vazhdon të jetë kontribuuesi më i madh në bilancin e **llogarisë së të ardhurave primare**. Deri në tetor të vitit 2018,

¹⁴ Raporti tregti-BPV llogaritet si mesatare e thjeshtë (d.m.th mesatarja) e tregtisë së përgjithshme (d.m.th shuma e eksporteve dhe importeve të mallrave dhe shërbimeve) në raport me BPV-në, dhe interpretohet si "sa më i lartë indeksi, aq më shumë ka ndikim tregtia në aktivitetin e brendshëm të atij vendi"


¹⁵ Të hyrat nga të ardhurat e të punësuarve të Kosovës jashtë vendit

të ardhurat nga kompensimi i punonjësve janë rritur për 8.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, dhe pritet të rritet me një normë mesatare prej rreth 4% gjatë periudhës së parashikuar 2019-2021.

Remitencat tregojnë rritje më të ngadaltë krahasuar me vitin e kaluar, mirëpo ato vazhdojnë të përfaqësojnë më shumë se gjysmën e bilancit të llogarisë të të ardhurave sekondare. Deri në muajin tetor të vitit 2018 remitencat arritën vlerën rreth 662.76 milionë euro, me një rritje 6.3% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Edhe gjatë periudhës së parashikuar remitencat pritet të rriten me normë mesatare prej 5%, duke ruajtur mesataren prej 11.7% të BPV-së. Në këtë kuptim, remitencat mbeten kontribuues i rëndësishëm në bilancin e llogarisë rrjedhëse.

2.4.1. *Financimi i llogarisë rrjedhëse, vlerësimet 2018 dhe parashikimet 2019-2021*


Grafiku 14. Struktura e IHD-ve sipas sektorëve



Deri në muajin Tetor të vitit 2018. Investimet e Huaja Direkte kanë kapur vlerën rreth 196.7 milionë euro. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar IHD-të janë zvogëluar për 13.2%. Sektori i pasurive të paluajtshme dhe qiradhënies përbën rreth 86% të IHD-ve në periudhën Janar-Tetor 2018. Shërbimet tregtare vijonë si absorbuesi i dytë më i madh i IHD-ve, që përbëjnë 9.6% të totalit të IHD-ve.

Në tremujorin e tretë të vitit 2018, **bilanci neto i pozicionit të investimeve ndërkombëtare (PIN)** ka arritur në -113.7 milionë euro, që është 44.8% më i lartë krahasuar me tremujorin e tretë të vitit të kaluar. Struktura e aseteve dominohet nga investimet portfolio që përbën rreth 38% të aseteve, pasuar nga investimet tjera që përbën 37% të aseteve. Nga ana tjetër, investimet direkte vazhdojnë të jenë kategoria më e madhe në kuadër të detyrimeve, që përfshin 70.7% të totalit të detyrimeve deri në fund të TM3 të vitit 2018.

Grafiku 15. Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare (PIN) në fund të periudhës, në miliona euro



Burimi: BQK (2018)

2.5. Sektori Financiar

Në përputhje me rrethanat, objektivi kryesor i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) ka të bëjë me nxitjen e sigurisë, aftësisë së pagimit dhe funksionimit efikas të sistemit financiar stabil të bazuar në treg, duke inkurajuar daljen e instrumenteve financiare të sigurta në treg; dhe, pa paragjykuar këtë, të mbështesë politikat e përgjithshme të ekonomisë në Kosovë, me synim të kontribuimit në ndarjen efikase të resurseve në pajtim me parimin e ekonomisë së tregut të hapur. BQK-ja vepron si rregullatore dhe mbikëqyrëse e sistemit financiar. Mjeti i saj kryesor i politikës monetare janë kërkesat për rezervën minimale, përderisa gjithashtu ka funksion të kufizuar të kreditorit së instancës së fundit (më tej specifikuar në Rregulloren për Mbështetje Emergjente për Likuiditet, e cila është miratuar nga Bordi i BQK-së në shtator të vitit 2015). Megjithatë, përderisa politika monetare ka mbetur e fokusuar në masë të madhe në inflacion dhe punësim, stabiliteti financiar ka mbetur në masë të madhe në qasjet makro-prudenciale; me fjalë të tjera, BQK-ja plotëson mjetet e kufizuara të politikës monetare me mjetet makroprudenciale. Korniza makroprudenciale e miratuar nga BQK-ja bazohet plotësisht në Rekomandimet e Bordit Evropian për Rrezik Sistemik (ESRB) (2014a dhe 2014b) në lidhje me objektivat dhe mandatin e autoriteteve për të realizuar politikën makroprudenciale. Fokusi i BQK-së në zbatimin e politikës makroprudenciale gjendet në pesë fusha: (a) zvogëlimi dhe parandalimi i rritjes së tepruar të kredive dhe të levës; (b) zvogëlimi dhe parandalimi i mospërputhjes së tepruar të maturitetit; (c) zvogëlimi dhe parandalimi i jo-likuiditetit; (d) kufizimi i direkt dhe indirekt i koncentrimin të ekspozimeve kreditore; (e) Kufizimi i ndikimit sistemik të nxitjeve që synojnë zvogëlimin e rrezikut moral. Si rrjedhojë, BQK-ja vlerëson në baza tremujore rreziqet sistemike (nëpërmjet dimensioneve me dy cikle që i referohen shpërndarjes së rreziqeve në kohë dhe dimensioneve strukturore që i referohen shpërndarjes së rreziqeve në sistemin financiar në çfarëdo kohe) në stabilitetin financiar me qëllim të mbrojtjes së stabilitetit të sistemit financiar si tërësi.


Nga shtatori i vitit 2018, të gjithë treguesit makroprudencial ishin mbi kërkesat rregullative. Sistemi financiar i Kosovës vazhdoi të zgjerohet dhe konsolidohet gjatë vitit 2018. Asetet e përgjithshme të sistemit financiar, duke mos përfshirë Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), kanë shënuar një normë të rritjes vjetore prej 8.0%, duke qëndruar në 6.23 miliardë Euro (93.1% të BPV) nga shtatori i vitit 2018, në krahasim me normën e rritjes mesatare të dy viteve të fundit prej¹⁶ 9.9%. Bankat mbesin sektor dominues me 60.3% të gjithsej aseteve të sektorit financiar, pasuar nga fondet pensionale dhe institucionet mikrofinanciare me 26.3% dhe 3.5%, përkatësisht.

Aktiviteti kreditor vazhdoi me rritjen e tij të përshpejtuar edhe në vitin 2018 për shkak të rritjes së fuqishme vjetore të kreditimit për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare. Kreditimi i sektorit privat u rrit me 11.4% nga viti në vit, dhe nga shtatori i vitit 2018 (grafiku 16), i nxitur nga normat e favorshme të interesit, rritja e konkurrueshmërinë në banka, niveli i lartë i likuiditetit në sektorin bankar dhe përmirësimi i cilësisë së portofolios kreditore. Kreditimi i ekonomive familjare mbeti dinamik përgjatë kësaj periudhe (edhe pse ritmi ka rënë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2017), më një normë të rritjes vjetore prej 11.3% (12.2% nga shtatori i vitit 2017). Kreditimi për ndërmarrjet arriti një rritje mesatare vjetore prej 11.6% nga shtatori i vitit 2018 në krahasim me normën e rritjes prej 9.0% në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kreditë e reja hipotekare u rritën prej 11.6% vit pas viti, nga shtatori i vitit 2018, përderisa numri i kredive të reja konsumese u rrit prej 18.5% për periudhën e raportuar. Kreditë e reja për ndërmarrjet u rritën prej 4.5% në baza vjetore nga shtatori i vitit 2018, që është

¹⁶ Mesatarja në muajin shtator 2017/shtator 2016 (zbatuar edhe në krahasimet tjera në tekst)

dukshëm më e ulët në krahasim me normën vjetore të rritjes të periudhës së njëjtë në vitin e kaluar (31.7%).

Grafiku 16. Rritje e huazimit në sektorin privat



Në përgjithësi, sektori bankar është i qëndrueshëm, por ndërmjetësimi financiar mbetet i ulët. Sistemi paraqet rezerva të fuqishme të kapitalit dhe likuiditetit me raport të kapitalit rregullator ndaj asetëve të peshuara të rrezikut në 16.1% në shtator të vitit 2018 (mbi raportin e kërkuar minimal prej 12%) dhe raportin e mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurta në 36.3% (mbi minimumin e sugjeruar prej 25%). Rreziqet ndaj financimit janë mesatare pasi që bankat kryesisht mbështeten në depozitat vendore dhe sistemi

në përgjithësi është likuid me një raport të kredive ndaj depozitave që arrin në 83.5% (nga shtatori i vitit 2018). Profitabiliteti i sektorit bankar ka mbetur i lartë, me një raport të kthimit mesatar në kapital prej 18.7% nga shtatori i vitit 2018 dhe me kthim mesatar në asete me 2.3%. Vëllimet e fuqishme të kreditimeve dhe të hyrat në rritje nga jo interesi kanë kompensuar trendin rënës të normave të interesit të kreditimit. Megjithatë, normat e interesit mund të kenë arritur në një pikë ku nuk mund të bien më poshtë pa larguar primet e rrezikut të vendosura në çmim nga bankat. Pjesëmarrja e bankave të huaja në sistem është e lartë, duke përbërë 87.2% të të gjitha asetëve të sektorit bankar (nga muaji shtator i vitit 2018). Megjithatë, shkalla e përqendrimit të tregut ka vazhduar të bie ngadalë. Në shtator të vitit 2018, pjesëmarrja në treg e tri bankave më të mëdha qëndroi në 58.4% në krahasim me raportin mesatar të përqendrimit prej 62.2% në dy vitet e fundit. Rënia në shkallën e përqendrimit të tregut është shprehur edhe nga Indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI) për asete, i cili ra në 1,520 pika në shtator të vitit 2018, në krahasim me 1,664 pika në mesatare në dy vitet e fundit.

Rreziku kreditor në sistem mbetet i ulët në krahasim me standardet e homologëve, me një raport të KJP-ve ndaj gjithsej kredive që bie më tej në 2.8% në shtator të vitit 2018 dhe raportin e provizioneve për humbje nga kreditë ndaj KPJ-ve që qëndron në 156.5%. Bankat shpesh i referohen mungesës së projekteve të pranueshme bankare si pengesë në kreditimin ndaj korporatave, duke ngritur kështu shqetësimet në lidhje me ngopjen e sektorëve të qëndrueshëm dhe huamarrësve. Që nga themelimi i tij, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ka dhënë garanci për kredi që arrijnë vlerën prej 71 milionë (nga të cilat 35 milionë të garantuara nga FKGK). Garancitë e dhëna nga FKGK kanë pasur ndikim pozitiv në qasjen në financa si në marzha intensive ashtu edhe në marzha ekstensive. Në marzhën ekstensive, më shumë se 25 përqind të garancive iu janë dhënë firmave pa histori kreditore. Në marzhën intensive, kreditë e garantuara kanë pasur kushte më të mira financiare (maturitet, normë të interesit, shumë dhe vlerë të kolateralit) se sa kreditë jo të garantuara. Edhe pse nevojiten më shumë pika të të dhënave për të matur ndikimet ekonomike, vlerësimet fillestare të FKGK kanë treguar që garancitë kreditore kanë kontribuar në krijimin e mbi 2600 vendeve të punës që nga themelimi i tij. Thellësia financiare, e matur nga niveli i kredive të brendshme ndaj BPV, mbetet e ulët (40.1% që nga

shtatori i vitit 2018). Kombinimi i raportit të ulët të kredive ndaj depozitave që mbizotëron në sistem si tërësi tregon mundësinë për thellim të mëtejshëm të ndërmjetësimit financiar.

Thellimi financiar është i mirëpritur duke pasur parasysh nivelet e ulëta të ndërmjetësimit, por duhet të balancohet në mënyrë të duhur me monitorim të kujdesshëm të rritjes së kreditimit në segmentet ku është veçanërisht i lartë. Përderisa cilësia e përgjithshme kreditore e ekonomive familjare duket të jetë e mirë, rrjedha e fuqishme kreditore në kreditë konsumuese duhet të monitorohet në vazhdimësi, gjithashtu pasi që kreditë e ekonomive familjare kanë tejkaluar fuqishëm BPV reale dhe pagat, dhe papunësia duket të mbetet e lartë. Përderisa rritja e qëndrueshme kreditore është shumë e nevojshme për të nxitur prodhimin dhe zhvillimin ekonomik në vend, qasja në financa duhet të kanalizohet në prodhim dhe sektorët e tregtueshëm, në vend se të nxiten kreditë konsumuese dhe aktiviteti lidhur me patundshmëritë.

Pozita e likuiditetit e sektorit bankar vazhdoi të jetë e kënaqshme gjatë këtyre tre tremujorëve të vitit 2018. Raporti i aseteve likuide ndaj gjithsej aseteve qëndroi në 36.3% në shtator të vitit 2018 (39.8% është mesatarja për dy vitet e fundit). Gjatë periudhës së njëjtë, raporti i kredive ndaj depozitave u rrit në 83.5% nga mesatarja prej 78.7% në dy vitet e fundit. Në shtator të vitit 2018, kreditë jo-performuese pësuan rënie në 2.8% (4.3% është mesatarja për dy vitet e fundit). Kreditë jo-performuese mbesin të mbuluara mirë nga provizionet për humbjet nga kreditë, me një raport prej 156.5% (130.8% është mesatarja për dy vitet e fundit). Sektori mbetet i mirëkapitalizuar, me një raport të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 16.1%, i cili është mbi kërkesën minimale rregullative prej 12%. Nga shtatori i vitit 2018, norma mesatare e interesin në kredi qëndroi në 7.0%, që është e ngjashme me mesataren e dy viteve të fundit. Në shtator të vitit 2018, norma mesatare e interesit për ndërmarrjet qëndroi në 6.6% (6.4% është mesatarja për dy vitet e fundit); ndërsa për ekonomitë familjare qëndroi në 7.4% (7.7% është mesatarja për dy vitet e fundit). Gjatë vitit 2018, normat e interesit në depozita treguan një tendencë rritjeje në krahasim me periudhën paraprake. Në shtator të vitit 2018, norma mesatare e interesit në depozita qëndroi në 1.4% në krahasim me mesataren prej 1.0% në dy vitet e fundit, përderisa norma mesatare e interesit për depozitat e ndërmarrjeve u rrit në 1.6% në shtator të vitit 2018 (1.4% është mesatarja për dy vitet e fundit). Për depozitat e ekonomive familjare, norma mesatare e interesit qëndroi në 1.3% (0.9% është mesatarja për dy vitet e fundit). Shpërndarja e normave të interesit pësoi rënie në 5.6 pikë përqindje në krahasim me mesataren prej 6.0 pp në dy vitet e fundit.

Nga shtatori i vitit 2018, numri i përgjithshëm i kompanive të sigurimit që kanë ushtruar aktivitetin e tyre në tregun e sigurimeve në Kosovë ishte 14, ku prej tyre 12 janë sigurues jo-jetë ndërsa 2 janë sigurues jetë. Nëse i referohemi origjinës së kapitalit të tyre, 1 nga ata është sigurues me kapital të huaj dhe kapital me pronësi të përzier (Austria dhe Shqipëria), 7 tjerë në pronësi lokale, 2 me kapital sllloven dhe 4 me kapital shqiptar.

Gjithsej asetet e tregut të sigurimeve arritën në 181.0 milionë Euro, me një rritje prej 4.6%. Më 30 shtator 2018, nga gjithsej asetet e sigurimit jo-jetë, rreth 43.2% (2017 – 44.4%) janë sigurues me kapital në pronësi të huaj, ndërsa 46.9% (2017 – 44.7%) janë sigurues me kapital vendor. Pjesa tjetër e tregut të sigurimeve përbëhet nga siguruesit jetë me 10.0%. Nëse kjo periudhë krahasohet me të njëjtën periudhë të vitit 2017, mund të vërehet që asetet e kompanive të huaja të sigurimit kanë pasur pjesëmarrje më të ulët në treg. Shuma e përgjithshme e primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve në Kosovë për këtë periudhë ka arritur në 69.1 milionë Euro apo 4.8% rritje në krahasim me vitin paraprak (2017 – 65.9 milionë Euro). Ky trend i rritjes në primet e shkruara bruto është

regjistruar në sektorin e sigurimeve jo-jetë, e cila në krahasim me periudhën paraprake të vitit 2017 është rritur me 4.5%, ndërsa sektori i sigurimeve jetë ka shënuar një rritje prej 14.9%. Deri më 30 shtator 2018, primet e shkruara bruto në sigurimin jetë kanë arritur në 2.2 milionë Euro, duke shënuar një rritje prej përafërsisht 280,896 Euro në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Nga gjithsej primet e shkruara bruto, rreth 96.9% (shtator 2017 – 97.1%) të primeve përbëhen nga produktet e sigurimit jo-jetë, ndërsa 3.1% (shtator 2017 – 2.9%) të primeve përbëhen nga sigurimi jetë. Dëmet e paguara deri më 30 shtator 2018 arrijnë shumën prej 31.5 milionë Euro, duke shënuar një rritje prej 8.2% në krahasim me periudhën paraprake (2017 – 29.1 milionë). Gjatë vitit 2018, tregu i sigurimeve rezultoi me fitim në shumën prej 2.1 milionë Euro, e cila tregon që tregu i sigurimeve ka pasur fitim më të ulët në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar me një fitim prej 3.1 milion Euro. Kjo performancë pozitive vjen si rezultat i ndryshimeve në kornizën ligjore sa i përket menaxhimit të shpenzimeve, si dhe nga mbikëqyrja efikase nga BQK-ja, duke përfshirë menaxhimin më të mirë të siguruesve nga menaxhmentet dhe bordi i drejtorëve të kompanive të sigurimit.

2.6. Skenarët Alternativë dhe Rreziqet Fiskale

Skenari bazë makroekonomik që mbështet projeksionet buxhetore afatmesme dhe perspektiva ekonomike e paraqitur në këtë përditësim të ERP-së rezulton nga një shqyrtim i kujdesshëm i potencialeve zhvillimore dhe rreziqeve fiskale, të lidhura me zhvillimet ekonomike të pritura në periudhën afatmesme. Analiza e rreziqeve fiskale për PRE 2019 tregon se shumica e rreziqeve kanë më pak gjasa të materializohen se sa në PRE 2018, duke qenë se probabiliteti i ndërtimit të termocentralit të ri dhe zbatimi i mëtejshëm i reformave të biznesit është shumë më i lartë se në PRE-të e mëparshme. Kjo e fundit e zvogëlon ndjeshëm probabilitetin e ndodhjes së një goditje në ofertën e energjisë. Në një njëjtën kohë, përpjekjet e intensifikuara për reduktimin e hendekut tatimor dhe mbledhjes së borxhit tatimor në vitin 2019 dhe në dy vitet e ardhshme, do të sigurojë më shumë hapësirë fiskale në buxhet, do të formalizojë më tej tregun dhe do të mbështesë konkurrencën në tregun lokal. Krahasuar me PRE 2018, mjedisi i jashtëm është bërë më pak i favorshëm në periudhën afatmesme, e cila përkthehet në probabilitet më të lartë të realizimit të goditjeve ndaj burimeve të huaja të financimit për ekonominë e Kosovës (remitancat, investimet e huaja direkte dhe eksportet). Gjithashtu, presionet më të larta për iniciativat e reja të transfereve sociale mund të sjellin rreziqe fiskale për buxhetin e shtetit.


Fillimisht, duhet të theksohet që për PRE 2019, skenari bazë përfshin elemente që reflektojnë materializimin e pjesshëm të një sërë rreziqesh dhe potencialesh të identifikuar në PRE 2018. Skenari bazë gjithashtu reflekton të dhënat më të fundit të llogarive kombëtare, të cilat janë të ndryshme nga PRE 2018.

- Rritje lehtësisht më e ngadaltë për vitin 2017 krahasuar me rritjen e vlerësuar në PRE të vitit 2018: të dhënat e fundit të llogarive kombëtare nga ASK-ja tregojnë së BPV-ja reale u rrit me rreth 4.2% për vitin 2017, ndërsa rritja e projektuar për vitin 2017 është rreth 4.3%.
- Gjithashtu, rritja e vlerësuar e 2018-ës është rishikuar për poshtë me 0.3 pikë përqindje, nga 4.6% vlerësuar në PRE 2018 në 4.3% në këtë version të azhurnuar të PRE-së. Të dhënat e disponueshme nga ASK për tre tremujorët e parë të vitit 2018 tregojnë që ekonomia e Kosovës mesatarisht u rrit me 3.9%.

- Rishikimi për poshtë i rritjes ekonomike në vitin 2018 i atribuohet kryesisht përkeqësimit të eksportit të mallrave, i cili gjatë periudhës Janar- Nëntor regjistroi një rënie vjetore prej 3.1%. Në PRE 2018, vlerësimet për eksportin e mallrave janë ndjeshëm më optimiste, duke sugjeruar një rritje vjetore prej 5.1% në terma nominalë.
- Rritja e investimeve në vitin 2018 pritet të jetë më e ulët se ajo e vlerësuar në PRE 2018, nga 10.1% në 8% , kryesisht si rezultat i investimeve më të ulta publike se ato të planifikuara. Mos-ekzekutimi i “Klauzolës së Investimeve” prej 62 milionë Euro në vitin 2018, për shkak të pengesave në implementim dhe mungesës së disbursimeve, pritet që të ekzekutohet kryesisht në vitin 2019 dhe në vitet pasardhëse.

Efekti kumulativ i rishikimit të supozimeve mbi skenarin bazë dhe projeksioni i updatuar i rritjes ekonomike në periudhën afatmesme paraqitet në grafikun më poshtë.

Grafiku 17. Krahasimi i skenarëve bazë: PRE 2018 ndaj PRE 2019



2.6.1. Rreziqet fiskale dhe potencialet zhvillimore, 2019- 2021

Në horizontin afatmesëm, rreziqet fiskale ngelin të njëjta me vitin paraardhës, por me probabilitet të ndryshëm materializimi për disa prej tyre. Ndërkohë, presim rritje të probabilitetit për materializimin e potencialeve zhvillimore në krahasim me vitin 2018. Në tërësi, parashikimi ynë makroekonomik bazë është i balancuar.

Analiza jonë e skenarëve të riskut dhe e potencialeve zhvillimore tregon se materialimi i potencialeve do të gjeneronte një rritje reale ekonomike rreth 5.7% gjatë periudhës afatmesme 2019- 2021, ndërsa materializimi i rreziqeve fiskale do të shkaktonte një ngadalësim të rritjes reale ekonomike, e cila gjatë periudhës afatmesme do të luhatej rreth nivelit 3.5%. Ndërkohë, rritja reale ekonomike në skenarin tonë bazë, mbi të cilin është mbështetur përgatitja e Buxhetit 2019, vlerësohet rreth nivelit 4.6% për periudhën 2019- 2021.

Potencialet Zhvillimore

Gjatë horizontit afatmesëm, janë rritur potencialet zhvillimore për rritjen e investimeve në sektorin privat, si rezultat i:

Përmirësimi të ambientit të të bërit biznes;

Ndërmarrjes së një sërë reformash fiskale nga ana e Ministrisë së Financave, të cilat kanë ndihmuar në largimin e pengesave ndaj zhvillimit të sektorit privat, lehtësimin e tregtisë dhe rritjen e efikasitetit të Administratës Tatimore. Gjithashtu, implementimi i masave fiskale të filluara gjatë 2018-ës dhe që do të vazhdojë edhe gjatë 2019-ës, pritet të ketë ndikim pozitiv në rritjen e konkurrueshmërisë dhe në nxitjen e prodhimit dhe investimeve brenda vendit.

Realizimi i potencialit që vjen nga investimet strategjike **përmes Klauzolës për Investime dhe mjeteve të liruara nga procesi i likuidimit në AKP** pritet të rritet në periudhën afatmesme, si rezultat i implementimit më të përshpejtuar të projekteve gjatë periudhës 2019- 2021 dhe të hyrave më të larta nga AKP gjatë vitit 2019.

Ndërtimi i kapaciteteve të reja energjetike - me një investim të planifikuar përgjatë një periudhe 5 vjeçare, ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese do të ndikojë në rritjen e gjithsej investimeve mbi skenarin bazë, duke rezultuar në një rritje shumë më të lartë të ekonomisë. Gjithashtu, edhe investimi në përmirësimin e sistemit të transmissioinit pritet të rritet.

Efektet ekonomike të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim (MSA) priten të gjenerojnë efektet e tyre pozitive në horizontin afatmesëm, duke qenë se do të vazhdojnë të ulen pengesat dhe kostot për tregtinë e lirë mes Kosovës dhe shteteve të BE-së.

Rreziqet Fiskale

Impakti i ambientit të jashtëm në burimet e huaja të financimit (remitancat, investimet e huaja direkte, eksportet) gjatë periudhës afatmesme paraqitet si rrezik i shtuar krahasuar me vitin paraardhës. Rishikimi për poshtë i rritjes ekonomike në Eurozonë dhe pritjet për ngadalësim të kësaj rritje në tre vitet e ardhshme mund të ushtrojnë presione për rritje më të ngadaltë mbi burimet kryesore të financimit për ekonominë e Kosovës, duke patur parasysh se Eurozona është vendi kryesor ku janë lokalizuar më së shumti emigrantët kosovarë; ku origjinojnë pjesa dërrmuese e investimeve të huaja direkte; dhe ku janë të destinuara një pjesë e konsiderueshme e eksporteve të Kosovës.

Ngushtimi i hendekut tatimor dhe mbledhja e borxhit tatimor parashikimet e të hyrave bazohen jo vetëm në rritjen e të hyrave si rezultat i zhvillimeve makroekonomike, por edhe në ngushtimin e hendekut tatimor dhe në mbledhjen e borxhit tatimor me qëllim të formalizimit të tregut dhe mbështetjes së konkurrueshmërisë lokale në treg. Prandaj, hapësira e parashikuar fiskale mbi të cilën bazohet Buxheti 2019 është e varur edhe nga suksesi i politikave administrative dhe stimuluese për ngushtimin e hendekut tatimor dhe mbledhjen e borxhit tatimor. Në buxhetin e vitit 2019, për dallim nga vitet e mëhershme, janë definuar targete të qarta administrative për uljen e stokut të borxhit tatimor, të cilat mbështeten në masa konkrete për përmirësimin e administrimit. Si rezultat, rreziku i mosrealizimit të këtyre targeteve vlerësohet të jetë më i ulët se në vitet paraprake.

Rreziku i mosrealizimit i projekteve të lidhura me **Klauzolën e Investimeve** është ulur, duke patur parasysh performancën e mirë të ekzekutimit të mjeteve të likuidimit të fondeve të AKP-së gjatë 2018-ës dhe zhvendosjen e një sërë projektsh në kuadër të “Klauzolës së Investimeve” të ratifikuara gjatë 2018-ës por që kanë gjasa të mëdha implementimi gjatë 2019-ës dhe në dy vitet e ardhshme.

Probabiliteti i materializimit të rrezikut që vjen nga **kapacitetet e brishta të prodhimit të brendshëm të energjisë** pritet të ulët gjatë periudhës afatmesme, si rezultat i mundësisë së ndërtimit të Termocentralit “Kosova e Re”, i cili pritet të sigurojë furnizim të sigurt të energjisë elektrike por edhe të rrisë ndjeshëm kontributin e investimeve private në rritjen reale të BPV-së.

Rreziku që vjen nga presioni për iniciativa të reja për transfere sociale është rritur gjatë. Presioni i ngritur për përdorimin e parasë publike si rishpërndarje, sidomos kur një rishpërndarje e tillë nuk targeton varfërinë por jepet mbi kritere tjera, paraqet rrezik fiskal për një strategji fiskale që targeton zhvillim socio-ekonomik.


Rreziqet fiskale si **pasojë e akumulimit të pagesave të vonuara** që mund të lindin si pasojë e kontratave ekzistuese publike mund të prodhojnë obligime financiare për buxhetin e shtetit. Gjatë viteve të kaluara ky rrezik ishte sidomos i theksuar për nivelin lokal të qeverisjes. Duke parë ekzekutimin e buxhetit komunal dhe projeksioneve për të hyra në këtë nivel, vlerësojmë se risku mbetet në nivele të njëjta me vitin e kaluar.

Gjithashtu, edhe rreziku kontingjent, apo jashtë-buxhetor, që mund të vijë si rezultat i **performancës së dobët të Ndërmarrjeve Publike** ngelet i pandryshuar nga viti 2018, duke përcjellur kështu performancë jo të kënaqshme të ndërmarrjeve publike.

Rezultatet

Duke u bazuar në ekzaminimin kualitativ të potencialeve zhvillimore dhe rreziqeve fiskale mbi skenarin bazë, më poshtë prezantohen dy skenarë alternativë.

Grafiku 18. Skenarët Alternativë, rritja reale e BPV-së, në %



Supozimet e Skenarit Optimist: inkorporojnë mbi skenarin bazë fillimin e ndërtimit të termocentralit “Kosova e Re” dhe ekzekutim më të lartë të “Klauzolës së Investimeve” dhe të projekteve të financuara nga buxheti i rregullt.

- Ndërtimi i termocentralit të ri do të sigurojë investim privat shtesë rreth 1, 000 milionë Euro për një periudhë 5-vjeçare. Më specifikisht, kjo përkthehet në rritje të investimeve private mesatarisht të barabartë me 1.4% të BPV-së së projektuar në vitin 2019 dhe në 2% të BPV-së në të dyja vitet 2020 dhe 2021.
- Në skenarin bazë, për qëllime konservative, “Klauzola e Investimeve” projektohet të ekzekutohet në një nivel prej 50%, 60% dhe 70% për vitet 2019, 2020 dhe 2021, respektivisht. Në skenarin me rritje më të lartë, po supozojmë një nivel më të lartë ekzekutimi, rreth 80% për të tre vitet.

Gjithashtu si rezultat i stimulit pozitiv në ekonomi që vjen nga investimet totale, supozohet një nivel më i lartë i Indeksit të Çmimeve të Konsumit për periudhën 2019- 2021.

Të gjitha supozimet e tjera qëndrojnë të pandryshuara nga skenari bazë.

Supozimet e Skenarit Pesimist: për ndërtimin e skenarit pesimist, më poshtë gjenden supozimet, të cilat janë modifikuar në krahasim me skenarin bazë:

- Një rritje e shpenzimeve të subvencioneve si rezultat i performancës së dobët të NP dhe goditjeve të mundshme që mund të përjetojë prodhimi i brendshëm i energjisë elektrike. Për qëllime të këtij ushtrimi, supozohet se në rast të materializimit të këtyre ngjarjeve, subvencionet do të rriten me një masë të barabartë me rreth 0.5% të BPV-së së projektuar në periudhën 2019-2021, në kurriz të shpenzimeve kapitale publike.
- Një nivel më i ulët se ai i pritshmi për ekzekutimin e shpenzimeve kapitale – ku për qëllime të këtij ushtrimi supozohet që vetëm 50% e “Klauzolës së Investimeve” dhe 70- 75% të investimeve të financuara nga buxheti i rregullt do të ekzekutohen gjatë periudhës afatmesme.
- Importet e energjisë janë më të larta si rezultat i prodhimit më të ulët të brendshëm i energjisë elektrike. Duke u nisur nga ngjarja e vitit 2014, kur shpërthimi i termocentralit “Kosova A” shkaktoi një rritje të importit të energjisë me rreth 45.5 milionë Euro, në këtë skenar supozojmë një rritje të ngjashme në kushtet e kapaciteteve të brishta të prodhimit të brendshëm të energjisë dhe nën supozimin që termocentrali i ri “Kosova e Re” nuk do të ndërtohet.
- Rritje më e ngadaltë e eksportit të mallrave, nga 4% e parashikuar në skenarin bazë në një nivel prej 2%, si rezultat i çmimeve më të ulëta të metalit se ato që janë parashikuar në skenarin bazë dhe ngadalësimit të mëtejshëm të rritjes ekonomike në Eurozonë dhe në ekonominë globale.
- Flukse hyrëse më të ulta të remitancave dhe të investimeve të huaja direkte, si rezultat i ngadalësimit të aktivitetit ekonomik në Eurozonë. Më specifikisht, në skenarin pesimist, supozojmë një rritje mesatare të remitancave me rreth 3% për periudhën 2019- 2021, ndërkohë që në skenarin bazë, remitancat priten të rriten me rreth 5%. Ngjashëm, norma e rritjes së investimeve të huaja direkte në skenarin pesimist është reduktuar në 7% mesatarisht, ndërkohë që në skenarin bazë supozohet një normë rritje më e lartë (rreth 14% mesatarisht).

Përsa i përket çmimeve, në skenarin pesimist, supozojmë një rritje të njëjtë të Indeksit të Çmimeve të Konsumit dhe të importeve, si rezultat i çmimit më të lartë të importit të energjisë krahasuar me çmimin e energjisë së prodhuar brenda vendit. Kanalet kryesore nëpërmjet të cilave goditjet aplikohen mbi skenarin bazë janë investimet private dhe publike dhe çmimet e eksportit të metaleve. Efektet e raundit të dytë mbi konsumin dhe investimet modelohen nëpërmjet efektit të tyre në të ardhurat private të disponueshme. Asnjë prej skenarëve alternativë nuk rezulton në rritje negative të BPV- së apo të komponentëve kryesorë të saj. Ka ndryshime të ndjeshme në normën e rritjes ekonomike ndërmjet alternativave të ndryshme të skenarëve.

Realizimi i supozimeve të skenarit pesimist do ta reduktonte rritjen ekonomike në afatin e mesëm nga 4.6% në 3.5%. Nga ana tjetër, me realizimin e supozimeve të skenarit optimist rritja ekonomike gjatë periudhës 2019- 2021 do të rezultonte në një rritje ekonomike mesatarisht prej 5.7%.

Tabela 11. Skenarët Alternativë Makro- Fiskal

Përshkrimi	2019			2020			2021		
	(Ulët)	(Bazë)	(Lartë)	(Ulët)	(Bazë)	(Lartë)	(Ulët)	(Bazë)	(Lartë)
Normat reale të rritjes (%)									
BPV	3.4	4.7	5.8	3.2	4.2	5.6	3.9	4.8	5.7
Konsumi	3.6	3.9	4.6	2.2	3.8	4.1	2.8	3.8	4.4
Investimet	2.0	7.7	14.3	1.6	5.3	8.7	4.3	5.7	7.3
Eksportet	5.5	6.1	6.1	4.0	4.7	4.7	5.1	5.6	5.6
Importet	4.0	5.6	7.9	1.2	3.7	4.6	2.7	3.8	4.4
Ndryshimet e çmimeve (%)									
IÇK (mesatarja)	1.5	1.3	1.4	1.5	1.3	1.4	1.5	1.3	1.4
Deflatori i BPV-së	0.8	0.6	0.8	1.6	1.4	1.5	1.2	1.0	0.9
Çmimet e Importit	2.2	2.0	2.0	2.2	2.0	2.0	2.2	2.0	2.0

3. KORNIZA FISKALE

3.1. Strategjia e politikave dhe objektivat afatmesme

Mbajtja dhe forcimi i mëtejshëm i pozitës fiskale të vendit, vazhdon të mbetet objektivi kryesor i Qeverisë për periudhën që mbulon ky dokument. Stabiliteti fiskal dhe forcimi tutje i proceseve dhe mekanizmave që sigurojnë këtë stabilitet, ndikojnë direkt në implementimin me sukses të reformave prioritare të Qeverisë, ndërsa kjo më pas ndikon në mbështetjen direkte dhe indirekte të rritjes së aktivitetit ekonomik në sektorin privat. Në këtë kontekst, Qeveria synon të ketë një menaxhim të përgjegjshëm të financave publike duke u siguruar se planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit do të bëhet në përputhje të plotë me kornizën fiskale, ashtu sic parashihet me LMFPP, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, dhe aktet ligjore që dalin nga këto dy ligje. Me rastin e planifikimit dhe implementimit të buxheteve të ardhshme, një vëmendje e veçantë do ju kushtohet zbatimit me përpikëri të rregullave fiskale që paralelisht sigurojnë qëndrueshmëri fiskale dhe stimulim të rritjes ekonomike, sic janë:

- Kufizimi i deficitit buxhetor në 2% të BPV-së (në baza vjetore),
- Investimet shtesë përmes Klauzolës për Investime (në periudhë afatmesme & afatgjate);
- Mirëmbatja e një niveli adekuat të rezervës fiskale (në baza vjetore), dhe
- Kufizimi i borxhit publik në 40% të BPV (në periudhë afatgjate).

Implementimi me sukses i këtyre rregullave siguron stabilitet dhe qëndrueshmëri makro-fiskale, dhe në të njëjtën kohë, i jep hapësirë fiskale Qeverisë për të adresuar mangësitë kyçe të infrastrukturës publike, përmes financimit të projekteve investive me karakter publik nga kreditë koncesionare dhe fondet e likuidimit të NSH-ve, i cili financim, sipas LMFPP është i përjashtuar nga kufiri i deficitit prej 2% të BPV-së.

Krahas implementimit të rregullave të listuara më lart, Qeveria e Kosovës do ti kushtoj një vëmendje të veçantë politikave tatimore dhe administrimit të tatimeve, duke u siguruar se çdo ndryshim në sistemin aktual, do të bëhet në konsultim me të gjitha palët e interesit, e në veçanti me komunitetin e bizneseve, për tu siguruar se ndryshimet që do të mund të ndodhin, janë në funksion të stimulimit të aktivitetit ekonomik dhe punësimit, si dhe financimit të qëndrueshëm të operacioneve të Qeverisë.

Nga konteksti i administrimit të tatimeve, do të vazhdohet me automatizimin e shërbimeve për tatimpaguesit, zvogëlimin e komunikimit direkt midis zyrtarëve tatimor dhe tatimpaguesve, aplikimin e qasjes të bazuar në rrezik dhe e gjithë kjo do të ndikoj në përmirsimin e kualitetit të shërbimeve, rritjen e përmbushjes vullnetare dhe zvogëlimin e informalitetit.

Në këtë drejtim, objektivat fiskale afatmesme të Qeverisë janë si në vijim:

- Sigurimi i financimit të qëndrueshëm të aktiviteteve publike të Qeverisë, duke u siguruar se politikatat tatimore janë në funksion të stimulimit të aktivitetit në sektorin privat dhe që gjenerojnë të hyra stabile për buxhetin e shtetit;
- Mobilizimi i të hyrave duke zgjeruar bazën tatimore në vend të rritjes së normave tatimore statutore.
- Thjeshtëzimi i tarifave administrative dhe zvogëlimi i barrës rregullative.
- Mbajtja e një strukturë të balancuar të buxhetit, me një dominim të investimeve kapitale për të adresuar pengesat strukturore, përmes përmirësimit të infrastrukturës publike.
- Sigurimi i financimit adekuat për fushat me prioritet, sic janë institucionet e fushës së drejtësisë, sektori i sigurisë, shëndetësia dhe arsimit.
- Përmirësimi i efektivitetit të shpenzimeve sociale dhe subvencioneve bujqësore përmes targetimit më të mirë.
- Mbajtja e nivelit të ulët të deficitit të rregullt (sipas definicionit të rregullës fiskale), dhe kështu mbajtja nën kontroll e borxhit publik.

Bazuar në këto objektiva, buxheti i vitit 2019 ka ndarë hapësirën fiskale që rezulton nga rritja e parashikuar e të hyrave për: a) shpenzime më të larta operative për sektorët prioritarë; dhe b) shpenzime më të larta kapitale për të adresuar mangësitë strukturore. Megjithatë, një nga sfidat kryesore fiskale për arritjen e këtyre objektivave, mbetet mbajtja nën kontroll e shpenzimeve për financimin e skemave të ndryshme sociale, që nga viti në vit, po vijnë duke u rritur.

Për sa i përket të hyrave buxhetore për vitin 2019 dhe vitet në vijim, projeksionet tona janë të bazuara në supozime të arsyeshme për të gjitha burimet e financimit (të hyrat tatimore, jo-tatimore, si dhe financimi i brendshëm dhe i jashtëm). Pjesa më e madhe e humbjeve të të hyrave nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) tashmë është absorbuar dhe është plotësisht e llogaritur në periudhën afatmesme. Rritja e vetme në normat statutore, është planifikuar për akcizat e duhanit në përputhje me një plan transparent shumëvjeçar që do të përfundojë në vitin 2019.

Që nga 1 janari 2018, Qeveria gjithashtu paraqiti një skemë të re nxitjeje tatimore që liron kompanitë e çertifikuara si "prodhues vendor" nga obligimi për të paguar detyrimet doganore dhe akcizat për lëndët e tyre të para të përdorur në prodhim. Kjo masë fiskale që synon stimulimin e kapaciteteve prodhuese në vend, natyrisht do të vazhdoj edhe në vitet e ardhshme, ndërsa efektet në të hyrat tatimore, që pritet të jenë modeste, tani më janë integruar në projeksionet tatimore për periudhën afatmesme.

3.2. Implementimi i buxhetit 2018

Sipas të dhënave preliminare fiskale, buxheti i vitit 2018 përgjithësisht ka pasur një përmbushje të mirë si në anën e të hyrave, ashtu edhe tek shpenzimet. Rregulla fiskale e deficitit është respektuar duke arritur 1.02% të BPV-së së parashikuar, e që është nën kufirin prej 2%. Njëherit, bilanci i parasë së

gatshme në fundvit shënoi normën prej 4.62% të BPV-së, që poashtu është në linjë me rregullat e aplikueshme fiskale (4.5% minimum në rast të përdorimit të fondeve nga AKP).

Për sa i përket të hyrave, dy agjencionet respektive përgjegjëse për mbledhjen e të hyrave (ATK dhe Dogana) arritën një përmbushje të mirë të planit të të hyrave. Të hyrat tatimore, që vazhdojnë të jenë kontribuesit kryesor të të hyrave të përgjithshme, shënuan një përmbushje prej 97.3% në krahasim me parashikimet. Në anën tjetër, të hyrat jo–tatimore shënuan normë të përmbushjes së planit prej 94.6%. Në krahasim me vitin 2017, të hyrat tatimore shënuan rritje prej 6% përgjatë vitit 2018.

Përveq të hyrave buxhetore, kishte një përmbushje të mirë edhe për sa i përket burimeve të tjera të financimit, ku me përjashtim të financimit nga huamarrjet e jashtme, financimi i brendshëm (letrat me vlerë dhe financimi nga AKP) ishte në linjë me parashikimet buxhetore.

Sa i përket shpenzimeve buxhetore, ato shënuan normë të ekzekutimit prej 92.7%, duke përfshirë rreth 100% ekzekutim të shpenzimeve rrjedhëse dhe 76.3% të shpenzimeve kapitale krahasuar me parashikimet.

Vlenë të theksohet se në raport me buxhetin, transferet sociale shënuan rritje, si rrjedhojë e mosimplementimit të reformës për skemën e veteranëve të luftës, si dhe tejkalimit të shpenzimeve të planifikuara për skemat tjera përfituese. Përkundër faktit se buxheti i vitit 2018 kishte supozuar se do kryhet ri-kategorizimi në skemën e veteranëve të luftës, kjo nuk ndodhi dhe si pasojë, shpenzimet ishin më të larta. Shpenzimet ishin më të larta për këtë kategori edhe si rezultat i rritjes së numrit të përfituesve mbi parashikimet e kësaj skeme.

Sido që të jetë, nuk pati rishikim të buxhetit për arsye të përmbushjes së mirë të pritjeve për të hyra dhe trendit të përgjithshëm të shpenzimeve.

Të hyrat buxhetore kishin një performancë të mirë në raport me pritjet sipas buxhetit. Të hyrat tatimore u përmbushën deri në 97.3% dhe ato jo – tatimore deri në 94.6%. Në raport me vitin 2017, kjo shënoi rritje prej 4.5% dhe 9.1% të të hyrave tatimore dhe atyre jo – tatimore, respektivisht.

Të hyrat nga TVSH u rritën për 5.4% (në linjë me parashikimet), duke reflektuar rritje në konsum. Në anën tjetër, të hyrat nga detyrimet doganore, tejkaluan parashikimet, por mbetën më të ulëta në krahasim me vitin 2017. Pavarësisht pritjeve për zvogëlimin e importit të veturave të përdorura, autoritetet arritën të grumbullojnë afër 1% më tepër nga akciza se në vitin paraprak. Tatimi në të ardhura personale si kontribues kryesor në tatime direkte, tejkaloi projeksionet për 4.8%. Në anën tjetër, të hyrat nga tatimi në të ardhura të korporatave shënuan rritje prej 15.3% në raport me vitin paraprak.

Andaj në tërësi, të hyrat indirekte arritën 97.5% përmbushje të planit, ndërsa të hyrat direkte në 100.2%.

Të hyrat jo–tatimore treguan rritje krahasuar me periudhën paraprake (9.1%), por nuk arritën të grumbullohen në tërësi në raport me planin (94.6%). Arsyeja kryesore mbetet grumbullimi jo i kënaqshëm nga niveli komunal me vetëm 84.1%.

Shpenzimet buxhetore ishin më të larta se në vitin 2017, ndërsa norma e ekzekutimit sipas kategorive ekonomike ishte e ndryshme. Për kategorinë e pagave dhe mëditjeve, norma e ekzekutimit ishte 100.3%, mallra dhe shërbime & komunalitë 93.5%, subvencionet dhe transferet 106.2%, dhe shpenzimet kapitale me 76.3% - kjo e fundit e ndikuar kryesisht nga pamundësia për disbursimin e mjeteve nga klauzola investive. Përkundër këtij fakti, shpenzimet kapitale u rritën për 13.4% krahasuar

me vitin 2017. Në përgjithësi, këto ndikuan që ekzekutimi total i shpenzimeve të arrijë normën prej 92.7%, duke reflektuar një rritje prej 10.1% krahasuar me vitin 2017.

Për të **financuar deficitin** dhe për të mbajtur nivel të qëndrueshem të amortizuesve fiskal, u shtua stoku i borxhit vendor për më pak se 3% krahasuar me parashikimin. Në anën tjetër financimi nga fondet e likuidimit të NSH-ve u realizua në tërësi.

Në vazhdim është paraqitur tabela me parametrat kyç të buxhetit të vitit 2018.

Tabela 12. Veprimtaria e Qeverisë së Përgjithshme, në miliona Euro

Përshkrimi	2017	2018 Buxhet	2018 Realizimi
1. GJITHSEJ TË HYRAT BUXHETORE	1,684	1,817	1,767
<i>nga të cilat: nga ulja e stokut të borxhit tatimor</i>		8	
<i>nga përmirësimi i përmbushjes tatimore</i>			
1.1 Të Hyra Tatimore	1,496	1,607	1,564
Tatimet Direkte	238	275	267
<i>Tatimi në të ardhurat e korporatave</i>	75	84	87
<i>Tatimi në të ardhura personale</i>	137	146	153
<i>Tatimi në pronë</i>	22	33	24
<i>Të tjera</i>	3	4	3.7
Tatimet Indirekte	1,315	1,378	1,344
<i>Tatimi mbi Vlerën e Shtuar</i>	756	819	797
<i>Detyrimi Doganor</i>	126	111	124
<i>Akcizë</i>	432	446	421
<i>Të tjera</i>	1	2	2.1
Rimbursimet tatimore	-58	-46	-48
1.2 Të Hyrat Jo-Tatimore	188	203	203
Taksa, ngarkesa dhe të tjera - Niveli Qendror	103	100	109
Taksa, ngarkesa dhe të tjera - Niveli Lokal	43	55	46
Taksa koncesionare	9	10	9
Renta Minerare	31	34	25
Të hyrat nga interesi	3	4	4
1.3 Grante për mbështetje buxhetore	0	7	0
2. GITHSEJ SHPENZIMET BUXHETORE	1,766	2,104	1,947
2.1 Shpenzimet Rrjedhëse	1,282	1,386	1,398
<i>Paga dhe mëditje</i>	550	590	592
<i>Mallra dhe Shërbime</i>	226	265	248
<i>Subvencione dhe transfere</i>	506	526	558
<i>Rezerva rrjedhëse</i>	0	5	0
2.2 Shpenzimet Kapitale	468	694	530
<i>Financimi nga buxheti i rregullt</i>	468	546	444
<i>Klauzola e investimeve</i>	0	62	0
<i>Fondet e likuidimit (AKP)</i>	0	86	86
2.3 Interesi për Borxhin Publik	16	24	19
3. Bilanci buxhetor (1-2)	-82	-287	-180
4. Shpenzimet e përjashtuara nga kufiri i rr. fiskale:	27	165	111
<i>Shpenzimet nga pranimet e dedikuara për AKP/2</i>	9	11	11
<i>Shpenzimet nga të hyrat komunale të bartura</i>	18	6	14
<i>Shpenzimet kapitale nga klauzola investive dhe likuidimi</i>	0	148	86
5. BILANCI BUXHETOR, sipas kufirit të rr. fiskale (3+4)	-55	-122	-69
A. Nevoja për financim (3)	-82	-287	-180
B. Financimi i jashtëm	78	87	87
C. Financimi i Brendshëm	84	227	233
D. Ndryshimi në bilancin e pashpërndarë bankar (A+B+C)	79	28	168
C. Stoku i bilancit bankar të pashpërndarë	292	319	459

3.3. Parashikimet afatmesme buxhetore

Parashikimet fiskale për periudhën afatmesme përafërsisht pritet të rriten në linjë me rritjen nominale ekonomike. Brenda të hyrave totale, të hyrat tatimore janë projektuar të rriten mesatarisht prej 6% në vit, duke arritur në 24.3% të BPV-së në 2019 (nga 23.8% në vitin 2018), ndërsa mesatarisht pritet të jenë në 24% të BPV-së përgjatë periudhës afatmesme. Kjo rritje e projektuar, pos që pritet të vijë nga rritja e bazës tatimore, reflekton iniciativën për të ulur stokun e borxhit tatimor si dhe supozimet konservative për përmbushjen vullnetare (në linjë me të dhënat historike). Në anën tjetër të hyrat jo-tatimore pritet të rriten me një normë konstante prej 3% përgjatë periudhës afatmesme, duke arritur në 221 milionë në vitin 2021.

Përkundër të hyrave, shpenzimet e përgjithshme janë të projektuara të rriten si pjesëmarrje ndaj BPV-së, ku nga 31% në 2018 do të arrij në mesatarisht 32% përgjatë periudhës afatmesme. Trend i njejtë vazhdon edhe për shpenzimet rrjedhëse të cilat pritet të rriten nga 20.5% në 2018 në mesatarisht rreth 21.1% e BPV-së përgjatë periudhës afatmesme; duke filluar nga 22% në 2019. Kategoria e pagesave dhe mëditjeve pritet të sillet rreth 9% e BPV-së përgjatë periudhës afatmesme. Shpenzimet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve pritet të jenë mesatarisht rreth 4% e BPV-së në periudhën 2020-2021; ndërsa do të fillojnë me 5% në 2019. Edhe kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve pritet të ndjek të njejtin trend, ajo pritet të jetë rreth 8% e BPV-së në periudhën 2019 – 2021.

Në anën tjetër, projektet kapitale pritet të vazhdojnë të rriten. Prandaj edhe shpenzimet kapitale janë projektuar të jenë mesatarisht rreth 11% e BPV-së në periudhën afatmesme.

Sa i përket deficitit buxhetor sipas rregullës fiskale, ai pritet të jetë më pak së 2% e BPV-së. Deficiti pritet të jetë afër 2% në vitin 2019 duke rënë në 1.4% në 2020 dhe duke u rikthyer në 1.9% në 2021.

Tabela 13. Parashikimet afatmesme të të hyrave tatimore 2019-2021, në miliona Euro

Përshkrimi	2017	2018 Buxhet	2019 Proj.	2020 Proj.	2021 Proj.
Gjithsej Të hyrat	1,684	1,817	1,949	2,026	2,141
Të hyrat tatimore	1,496	1,607	1,731	1,800	1,909
Të hyrat jo – tatimore	188	202	208	215	221
Të tjera	0	7	11	11	11
Shpenzimet e përgjithshme	1,766	2,104	2,365	2,426	2,487
Shpenzimet rrjedhëse	1,282	1,386	1,567	1,584	1,624
Shpenzimet kapitale	468	694	770	813	835
Të tjera	16	24	28	29	28
Bilanci buxhetor	-82	-287	-416	-400	-346
Bilanci buxhetor sipas rregullës fiskale	-55	-122	-145	-107	-151
Stoku I shfrytëzueshëm i bilandcit bankar	292	319	324	339	267

Burimi: Thesari, Buxheti 2019, dhe parashikimet e Njësisë Makroekonomike, MF

3.3.1. Parashikimi i të hyrave buxhetore

Për periudhën afatmesme 2019 – 2021, parashikimet për të hyrat janë të bazuara në parashikimet e përgjithshme për zhvillimet ekonomike në vend, si dhe ndikimi i tyre në baza respektive tatimore.

Për më tepër, efekti nga masat e reja për përmirësimin e ambientit të të bërit biznes, lehtësimet në rastin e importeve për sektorin e prodhimit, lirimi nga tatimet doganore në rastin e importeve të pajisjeve teknologjike, planet për ngushtimin e hendekut tatimor dhe ekonomisë jo-formale, masat

për avancimin në efikasitetin e mbledhjes së të hyrave nga agjencitë mbledhëse, me një fokus të veçantë në zvogëlimin e stokut të borxhit, etj. konsiderohen si potencial për rritjen e nivelin të të hyrave mbi këto parashikime. Pavarësisht nga kjo, për arsye të planifikimit të shpenzimeve mbi bazën e të hyrave të qëndrueshme, është aplikuar qasje konzervative në vlerësimin e impaktit të këtyre masave.


Rrjedhimisht, duke u bazuar në projeksionet ekonomike për periudhën afat-mesme, si dhe duke marrë për bazë specifiket tjera që nuk reflektohen në bazën tatimore, të hyrat e përgjithshme buxhetore për vitin 2019 pritet të arrijnë vlerën prej 1,949 milionë EUR. Kjo vlerë rezulton të jetë për 7% apo 132 milionë EUR më e lartë se buxheti i vitit 2018. Rritje e moderuar pritet të vazhdojë edhe për pjesën tjetër të periudhës afatmesme 2020 dhe 2021, në harmoni me pjesëmarrjen e të hyrave në BPV-në e parashikuar.

Rritja e të hyrave të gjithëmbarshme vjen si rezultat i kontributit nga tatimet indirekte, tatimet direkte si dhe të hyrat jo-tatimore me pjesëmarrje prej rreth 76.5%, 14.8%, dhe 10.7% respektivisht. Ndërsa rimbursimet kanë kontribut negativ prej 2.6%. Një strukturë e tillë e të hyrave është si rezultat i deficitit të lartë tregtar të ekonomisë së vendit.

Rritja e parashikuar e të hyrave tatimore pritet të mbështetet kryesisht nga tatimet indirekte, veçanërisht nga TVSH-ja dhe akciza, përderisa parashihet një stabilizim i të hyrave nga detyrimet doganore si pjesëmarrje në të hyra tatimore, si rezultat i implementimit të marrëveshjeve për tregti të lirë me vendet e BE-së (MSA). Ndikim shtesë pritet të ketë heqja e tatimit doganor për të gjitha mallrat që hyjnë në proces të prodhimit si lëndë e parë, si dhe heqja e detyrimit doganor për pajisje të teknologjisë informative. Efektet pozitive që çojnë në prodhim më të madh se pagesa në vend pas shitjes së produkteve finale do të zvogëlojë humbjet nga këto lirime. Të hyrat nga tatimet direkte poashtu pritet të rriten në mënyrë graduale edhe pse me një bazë relativisht të ulët.

Të hyrat e mbledhura brenda vendit, historikisht kanë përcjellur trendin e aktivitetit ekonomik në vend (shih figurën 19), me një përmirësim gradual. Megjithëse baza e këtyre të hyrave vazhdon të jetë e ulët, falë disenjimit dhe implementimit të reformave strukturore, ka sinjale pozitive për një trend më të përshpejtuar të rritjes përtej asaj të shtyrë nga rritja e aktivitetit ekonomik (si rezultat i rritjes së përmbushjes vullnetare dhe ngushtimit të hendekut tatimor). Dhe falë këtyre reformave, të hyrat e arkëtuara brenda vendit pritet të rrisin pjesëmarrjen në BPV me rreth 0.7 pikë të përqindjes, me tendencë të rritjes në vitet vijuese 2020 dhe 2021.

Grafiku 19. Trendi i të hyrave tatimore 2006-2021



Burimi: Thesari dhe vlerësimet e Njesisë së Makroekonomisë, MF

Sa i përket Administratës Tatimore të Kosovës, ajo pritet që në vitin 2019 të arkëtojë rreth 516 milionë EUR, duke i përfshirë të hyrat e njëhershme nga arkëtimi i borxhit tatimor. Kjo normë shënon një rritje prej 15.9% në raport me buxhetin e vitin 2018. Specifikisht, të hyrat e arkëtuara nga ATK-ja, të ndara nëpër kategori pritet të realizohen si në vijim:

- Tatimi në të ardhurat e korporatave: parashihet që të rritet mesatarisht për periudhën afatmesme për 5.9% në vit, duke arritur kështu shumën prej 100 milionë EUR në vitin 2021, që do të reflektonte edhe rritjen e efikasitetit në mbledhjen e borxhit dhe njëherit zvogëlimin të stokut të përgjithshëm të borxhit. Për vitin 2019, projeksionet buxhetore parashohin një rritje prej 8.4%, ku ndër të tjera, zvogëlimi i stokut të borxhit të korporatave me 10%, pritet të kontribuoj në këtë rritje.

- TVSH – arkëtimi në vend: parashihet të rritet mesatarisht me 10% në periudhën afatmesme ndërsa në 2019 në raport me vitin 2018 pritet të shënojë një rritje prej 26.7% dhe në vlerë nominale do të arrijë shumën prej 258 milionë EUR. Kjo ngritje në planifikim, vjen si rezultat i ngritjes së konsumit të përgjithshëm, ku TVSH-ja mbetet një indikator i rëndësishëm i zhvillimeve në konsumin privat. Njëherit parashihet rritje e efikasitetit në mbledhjen e borxhit tatimor edhe në këtë kategori.

- Tatimi në të ardhurat personale¹⁷: parashihet të rritet mesatarisht me 7.1% në periudhën afatmesme. Në vitin 2019 pritet të shënojë rritje prej 11.9% dhe si rezultat të arrijë në shumën prej 163 milionë EUR. Kjo rritje në planifikim është mbështetur në zhvillimet dhe ecuritë ekonomike në vend dhe efektet e tyre në tregun e punës, në faturën e pagave për sektorin publik si dhe në masat për ngritjen e efektivitetit administrativ në këtë kategori tatimore.


Për më tepër, përmes thjeshtësimit të sistemit tatimor dhe doganor, ngritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj tatimpaguesve, vazhdimin të digjitalizimit të plotë të shërbimeve për tatimpaguesin, presim rritje të efikasitetit të administrimit tatimor dhe rritje të përmbushjes vullnetare të detyrimeve tatimore, që rrjedhimisht do të reflektohen pozitivisht tek të hyrat tatimore të arkëtuara në vend.

Të hyrat e mbledhura në kufi, pritet të përcjellin trendin e importit. Këto të hyra historikisht kanë përcjellur vlerën dhe sasinë¹⁸ e importit, duke përjashtuar efektin e ndryshimeve në norma tatimore. Marrëveshjet për tregtinë e lirë dhe masat e reja fiskale të implementuara në vitin 2018 si dhe masat e reja që priten të implementohen gjatë vitit 2019, priten të ngadalësojnë normën e rritjes së të hyrave të arkëtuara në kufi, ndërsa kjo do të reflektohet pozitivisht në rritje të të hyrave vendore.

¹⁷ Ky zë ngërthen në vete tatimin e mbajtur në burim, tatimin nga të ardhurat e biznesit individual si dhe tatimin në interes, qira dhe lojëra të fatit

¹⁸ Sasia dhe vlera e importit përdoret për parashikimin e arkëtitimit të të hyrave që mbledhen në kufi.

Grafiku 20. Trendi i të hyrave tatimore të mbledhura në kufi dhe relacioni me indikatorë ekonomik 2006 - 2021



Burimi: Thesari dhe vlerësimet e Njësish të Makroekonomisë, MF

Gjatë vitit 2019, Dogana e Kosovës pritet të arkëtojë 5.0% më shumë në raport me buxhetin e vitit 2018. Kjo rritje e të hyrave të mbledhura në kufi, e reflektuar në vlera nominale, do të arrijë vlerën prej 1,234 milionë EUR. Më specifikisht, të hyrat e mbledhura nga Dogana e Kosovës për vitin 2019 të ndara në kategori pritet të realizohen si në vijim:

- *TVSH*: arkëtimi në kufi në vitin 2019, TVSH-ja kufitare vazhdon të jetë kontribuesi kryesor i të hyrave doganore duke përbërë mbi 52.5% të tyre apo 647 milionë EUR, duke shënuar një rritje prej 5.1 % në raport me buxhetin e planifikuar për vitin 2018. Kjo ngritje e planifikuar për të hyrat nga TVSH-ja është kryesisht si rezultat i pritjes për rritje të importit në funksion të mbështetjes së aktivitetit të shtuar ekonomik në vend, por edhe si rezultat i monitorimit më të mirë doganor.

- *Të hyrat nga Akcizat*: - në raport me buxhetin e vitit 2018, planifikohet të rriten për 4.3% duke arritur në 465 milionë EUR. Për më tepër të hyrat nga akciza mesatarisht pritet të rriten për 4.8% përgjatë periudhës afatmesme. Ky planifikim merr për bazë rritjen në normën e akcizës për produktet e duhanit sipas kalendarit të akcizës. Gjithashtu, politikat evropiane për ndalimin e qarkullimit të veturave me naftë do të ndikojnë në rënien e çmimit të tyre dhe rrjedhimisht rritjen e importit të këtyre makinave. Për më tepër, rritja e sasisë së importuar të naftës ka vazhduar përgjatë tërë vitit 2018 duke ndikuar në rritjen e të hyrave nga akciza, përkundër rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare.

- *Detyrimet Doganore*: gjithashtu pritet të shënojnë rritje duke arritur në 7.1% mesatarisht në periudhën afatmesme. Ndërsa, në buxhetin e vitit 2019, priten të arrijnë në 120 milionë EUR. Këto të hyra pritet të vijnë si rezultat i rritjes së bazës tatimore, (rritjes së importeve rreth 8%) dhe merret parasysh efekti negativ i MSA-së në periudhën afatmesme.

Sa i përket të hyrave jo-tatimore, për periudhën 2019 parashihet një rritje më e ngadalshme që reflektohet edhe në ngadalësimin e arkëtimit të të hyrave vetanake të nivelit komunal. Për më tepër, gjatë vitit 2019, të hyrat vetanake të nivelit lokal parashihet të rriten për 2 milionë EUR dhe si rezultat do të arrijnë vlerën prej 57 milionë EUR. Ky planifikim konservativ mbetet edhe për vitet vijuese 2020 dhe 2021.

Arkëtimi nga renta minerare vazhdon të mbajë trendin konstant edhe gjatë vitit 2019, duke qëndruar në nivel të njëjtë me periudhën paraprake. Të hyrat nga pagesa e taksës koncesionare të aeroportit

“Adem Jashari” pritet të arrijnë vlerën prej 11 milionë EUR në vitin 2019, duke shënuar një rritje prej 1 milionë EUR nga viti 2018.

Tabela 14. Struktura e të hyrave buxhetore si % e BPV-së

Përshkrimi	2016	2017	2018 Buxhet	2019 Proj.	2020 Proj.	2021 Proj.
Gjithsej të hyra	26.3%	26.8%	27.2%	27.3%	26.9%	26.8%
Të hyrat tatimore	23.4%	23.8%	24.1%	24.2%	23.9%	24.0%
Të hyrat jo - tatimore	2.9%	3.0%	3.0%	2.9%	2.8%	2.7%

3.3.2. Parashikimet e shpenzimeve buxhetore

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore në vitin 2019 parashihet të rriten me 12.4% krahasuar me buxhetin për vitin 2018. Rritja e shpenzimeve parashihet të ngadalësohet në 2.6% dhe 2.5% gjatë viteve 2019 dhe 2020. Kjo rritje e shpenzimeve në vitin 2019 i atribuohet rritjes së projekteve kapitale të financuara përmes huamarrjes nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare dhe përmes të ardhurave nga likuidimi i aseteve të NSH-ve.

Shpenzimet rrjedhëse për vitin 2019 parashihet të rriten me 13.1% krahasuar me buxhetin e vitit 2018. Për vitet 2020 dhe 2021, kjo rritje parashihet të ngadalësohet në 1% dhe 2.5% respektivisht. Një nga nxitësit kryesor të rritjes së shpenzimeve rrjedhëse në vitin 2019 është kategoria e mallrave dhe shërbimeve, kjo si rrjedhojë e riklasifikimit prej shpenzimeve kapitale në këtë kategori të a) mirëmbajtjes së pajisjeve medicinale; b) mirëmbajtjes së komplekseve memoriale; c) pajisjeve për policinë e Kosovës, etj. Gjithashtu, një rritje në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve parashihet në vitin 2019 si rezultat i skemave sociale dhe rritjes së pensioneve bazike dhe kontributdhënëse.

Shpenzimet kapitale janë projektuar të rriten me 10.9% në vitin 2019 krahasuar me buxhetin e vitit 2018. Kjo rritje parashihet të jetë 5.6% dhe 2.8% në 2020 dhe 2021. Kjo rritje përfshin shpenzimet kapitale me karakter strategjik, të financuara nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare dhe nga likuidimi i aseteve të NSH-ve. Këto shpenzime janë të përjashtuara nga llogaritja e limitit ligjor të deficitit fiskal sipas rregullës fiskale dhe janë të parapara për projekte strategjike zhvillimore. Një pjesë e rëndësishme e investimeve kapitale do të jetë fillimi i projektit rrugor Kijevë- Zahaq, vazhdimi i projektit M2 për Mitrovicë, dhe investimet tjera për të përmirësuar infrastrukturën fizike, infrastrukturën arsimore, dhe digjitalizimin.

Në vitin 2019, **buxheti komunal** është rritur për 39.7 milionë euro krahasuar me buxhetin 2018. Kjo rritje prej 8.1% në financimin e buxhetit komunal pasqyron rritjen e grantit të përgjithshëm (për 16 milionë, në 196.6 milionë), grantit të arsimit (për 15.3 milionë, në 185 milionë) dhe grantit të kujdesit shëndetësor (për 5.1 milionë, në 53.4 milionë euro).

Rritja në grantin e arsimit vjen kryesisht si rrjedhojë e politikave të reja që parashohin punësimin e 100 asistentëve të rinjë për fëmijët me nevoja të veçanta prej rreth 0.5 milionë euro si dhe nga praktika profesionale e cila ka një kosto prej rreth 1 milionë euro. Gjithashtu, financimi komunal përfshin edhe 2.6 milionë euro financim shtesë për shëndetësinë sekondare dhe rezidenciale në tri komuna minoritare: Komuna e Shtërpcës, Mitrovicës, dhe Graçanicës.

Buxheti për **nivelin qendror** për vitin 2019 është rritur me 13.7% dhe përfshin 216.9 milionë EUR më shumë krahasuar me buxhetin e vitit 2018.

Në përputhje me prioritetet e Qeverisë, kjo hapësirë shtesë e shpenzimeve është ndarë për rritjen e buxhetit në fushat me prioritet.

3.3.3. Parashikimet e shpenzimeve për sektorët e politikave buxhetore

Kjo pjesë pasqyron të dhënat mbi ndarjet buxhetore për vitin 2019 dhe vitet vijuese, sipas sektorëve me prioritet të Qeverisë, të dala nga dokumentet strategjike të vendit.

Për **institucionet e rendit, ligjit dhe të sigurisë publike**¹⁹, buxheti i vitit 2019 parasheh ndarjet buxhetore në shumën prej 204.2 milionë eurosh. Kjo reflekton një rritje prej 6.2% në financim krahasuar me buxhetin 2018. Buxheti shtesë mundëson angazhimin shtesë për përmirësimin e efikasitetit dhe reduktimin e lëndëve të vjetra. Ndërsa buxheti për **Sektorin e Mbrojtjes**²⁰ është rritur për 9.4% duke arritur shumën prej rreth 58.7 milionë.

Buxheti për institucionet e **Sektorit Shëndetësor** në nivel qendror i cili përfshin Ministrinë e Shëndetësisë dhe Shërbimet Spitalore Universitare është rritur me 17.6% krahasuar me buxhetin 2018. Kjo rritje përfshin alokime shtesë për barnat esenciale dhe një rritje prej 47% në shpenzimet kapitale. Përveç kësaj rritje, granti i shëndetësisë primare komunale gjithashtu është rritur për 10%. Për **Sektorin e Mbrojtjes së Mjedisit**²¹, alokimet buxhetore janë rritur për 31.9%. Kjo rritje është bërë për të mbështetur zhvillimin e balancuar dhe të qëndrueshëm duke siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e planifikimit të duhur hapësinor.

Për institucionet përgjegjëse për **Përmirësimin e Çështjeve Ekonomike**²², për vitin 2019 ndarjet buxhetore janë rritur për 4.4% krahasuar me buxhetin e vitit 2018, duke arritur në rreth 446.5 milionë. Ndarjet buxhetore për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik në këtë sektor janë rritur me 67% krahasuar me buxhetin e vitit 2018, kryesisht nga projektet kapitale në rritje (Fabrika e Ujit të Pijshëm në Ferizaj, Projekti për Eficiencë të Energjisë dhe Energjisë së Ripërtëritshme, Ekonomia Dixhitale në Kosovës etj.).

Alokimet buxhetore për **Sektorin e Arsimit** të përbërë nga Ministria e Arsimit, Universiteti Publik, Akademia e Drejtësisë dhe Akademia e Shkencave u rritën me 13.8% duke arritur në shumën prej 106.8 milionë. Duke pas parasysh edhe grantin e arsimit në nivel lokal, shpenzimet totale për sektorin e arsimit arrijnë në 290 milionë EUR. Këto shpenzime pritet të mbështesin nismat e reja për përmirësimin e cilësisë së arsimit.

Për të mbështetur qeverisjen më të mirë, alokimet buxhetore në sektorin e **Shërbimeve të Përgjithshme Publike**²³ janë rritur me 42.7% në shumën 211 milionë euro. Për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik në këtë sektor, buxheti është rritur me 30.8% krahasuar me buxhetin

¹⁹ Ministria e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Gjykata Kushtetuese, Avokati i Popullit, Agjencioni për ndihmë juridike falas, Agjencioni Kosovar i Intelejencës, Ministria e Punëve të Brendshme.

²⁰ FSK

²¹ Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Autoriteti Rregullativ i Ujrave.

²² Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Agjencioni Kosovar I Privatizimit, Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare, Agjencioni Kosovar I Konkurrencës, Komisioni I Pavarur I Minierave dhe Mineraleve, Autoriteti I Aviacionit Civil, Autoriteti Rregullativ I Hekurudhave, Agjencioni I Shërbimeve të Navigimit Ajror. Zyra Rregullative e Energjisë, Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Ministria e Zhvillimit Rajonal.

²³ Kuvendi i Kosovës, Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Zhvillimit Rajonal, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Integritimit Evropian, Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Agjencia Kundër Korrupsionit, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Zyra për Ankesa dhe Parashesa, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Zyra Kombëtare e Auditimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Bordi i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Shpenzimet e Paparashikueshme.

2018. Buxheti për Zyrën Kombëtare të Auditimit gjithashtu është rritur me 20.3%. Ndërkaq, për të siguruar funksionimin e duhur të shërbimit diplomatik shtetëror, ka pasur një rritje prej 7.7% në buxhetin operativ të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Për më tepër, për të siguruar që ka kohezion dhe zhvillim social, buxheti parashikon rritje prej 14% të alokimeve buxhetore për institucionet e **Sektorit të Mbrojtjes Sociale** që përbëhet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe 10.5% rritje për **Sektorin e Rekreacionit, Kulturës dhe Fesë**²⁴. Kjo rritje prej 57 milionë euro për sektorin e mbrojtjes sociale synon zhvillimin, zbatimin dhe koordinimin e politikave, ligjeve dhe instrumenteve të tjera për të siguruar mbrojtjen dhe mbështetjen sociale dhe aftësinë për të ofruar shërbime për grupet më të marginalizuara të shoqërisë. Sektori i mbrojtjes sociale vazhdon ofrimin e mbështetjes për kategoritë sociale përmes mbrojtjes sociale dhe skemave të pensioneve, duke shqyrtuar infrastrukturën ligjore për të mundësuar një mbështetje më të madhe për kategoritë në nevojë.

3.3.4. Parashikimet e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike

Shpenzimet e përgjithshme qeveritare në vitin 2019 pritet të jenë 12.4% më të larta se ato në buxhetin e vitit 2018. Në periudhën afatmesme dhe në përputhje me objektivat ekonomike e fiskale, parashikimet e shpenzimeve pasqyrojnë rritje në të gjitha kategoritë ekonomike. Përveç rritjes së shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike ka shënuar një lëvizje përgjatë kategorive, ku shpenzimet kapitale kanë shënuar rritjen më të madhe dhe janë një nga komponentët kryesor të shpenzimeve.

Tabela 15. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike 2019-2021, në mil.euro

Përshkrimi	2016	2017	2018 Buxhet	2019 Proj.	2020 Proj.	2021 Proj.
SHPENZIMET TOTALE	1,658	1,741	2,104	2365	2,426	2487
SHPENZIMET OPERATIVE	1,221	1,282	1,386	1567	1,584	1624
Pagat dhe Mëditjet	544	550	590	616	649	670
Mallrat dhe shërbimet	203	226	265	337	317	334
Subvencionet dhe transferet	475	506	526	609	614	615
Rezervat periodike	0	0	5	5	5	5
SHPENZIMET KAPITALE	444	468	694	770	813	835
Të financuara nga:						
Burime të rregullta buxhetore	444	468	546	509	533	648
Rezerva buxhetore kapitale	0	0	62	121	220	187
Të ardhurat nga likuidimit i NSH-ve	0	0	86	140	60	0
INTERESI PËR BORXHIN PUBLIK	19	16	24	28	29	28

Shpenzimet për paga dhe mëditje: vazhdojnë të mbajë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale. Në terma afatmesëm, rritja e projektuar është me një mesatare prej 4.3% për 2019, 2020 dhe 2021. Shpenzimet për këtë kategori për vitin 2019 pritet të jenë 616 milionë euro. Në anën tjetër, si pjesëmarrje e BPV-së kjo kategori e shpenzimeve në buxhetin e planifikuar për vitin 2019 paraqitet me trend pozitiv nga 8.7% të buxhetit për vitin 2018, në 8.6% në vitin 2019, për të vazhduar me një rënie graduale deri në 8.4% në vitin 2021.

Subvencionet dhe transferet: shpenzimet për subvencionet dhe transferet do të vazhdojnë të rriten gjatë periudhës afatmesme. Shpenzimet e buxhetuara për këtë kategori janë rritur për 15.9% krahasuar

²⁴ Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Këshilli për Trashëgëmi Kulturore, Radio Televizioni I Kosovës, Agjencioni për Menaaxhimin e Komplekseve Memoriale, Komisioni I Pavarur i Mediave.

me buxhetin 2018, por rritja do të ngadalësohet në 0.7% dhe 0.1% në vitin 2020 dhe 2021, respektivisht. Rritja e shpenzimeve për këtë kategori për 2019 vjen si rezultat i financimit të Ligjit për Veteranët e Luftës, rritjes së pensioneve bazike dhe kontributdhënëse, dhe rritjes së numrit të përfituesve në skema të tjera. Si pjesëmarrje në BPV, subvencionet dhe transferet gjatë vitit 2019 pritet të arrijnë nivelin prej 8.6% ndërsa në vitet vijuese, planifikohet një rënie në 8.2% për vitin 2020 dhe 7.7% për vitin 2021.

Mallrat dhe shërbimet: shpenzimet për këtë kategori në vitin 2019 pritet të rriten për 27.2% krahasuar me buxhetin e vitit 2018, por rritja do të ngadalësohet ndjeshëm në periudhën afatmesme. Rritja në këtë kategori për vitin 2019 pasqyron kryesisht: riklasifikimin e shpenzimeve nga kategoria e shpenzimeve kapitale; nevoja të larta financimi për mirëmbajtjen e infrastrukturës publike; dhe kërkesa më e lartë e sektorit të kujdesit shëndetësor për produktet farmaceutike dhe furnizimet mjekësore. Në raport me BPV-në për vitin 2019, shpenzimet për këtë kategori planifikohen të jenë rreth 4.7% dhe parashihen të bien në vitet vijuese për të arritur në 4.2% në vitin 2021).

Shpenzimet kapitale: shpenzimet kapitale në vitin 2019 janë planifikuar të rriten me rreth 10.9% në krahasim me buxhetin e vitit 2018. Infrastruktura e transportit do të vazhdojë të ketë pjesën më të madhe të shpenzimeve kapitale. Një pjesë e rëndësishme e investimeve kapitale do të jetë vazhdimi i projektit të rrugës Kijevë-Zahaq, vazhdimi i projektit M2 për Mitrovicën dhe investime të tjera për të përmirësuar infrastrukturën lokale. Megjithatë, buxheti i vitit 2019 ka diversifikuar shpenzimet kapitale duke përfshirë projektet për përmirësimin e objekteve të kujdesit shëndetësor dhe sistemin arsimor. Përveç kësaj, ka pasur një rritje në financimin e projekteve për trajtimin e ujërave të zeza dhe ujitjes. Si pjesëmarrje e BPV-së shpenzimet kapitale për vitin 2019 kanë shënuar rritje në 10.8%, në krahasim me vlerën sipas buxhetit për vitin 2018, ndërsa në vitet në vijim, planifikohet të ruajnë pjesëmarrjen përafërsisht të njëjtë.

3.4. Bilanci Strukturor Fiskal

Bilanci strukturor përfaqëson bilancin fiskal të qeverisë, të korigjuar nga efektet apo luhatjet e ciklit të biznesit, të cilat nuk janë nën kontrollin direkt të qeverisë. Shpesh argumentohet se bilanci i përgjithshëm fiskal nuk ofron një panoramë gjithëpërfshirëse të pozicionit fiskal sepse ky pozicion ndikohet në një masë të konsiderueshme edhe nga ciklet e biznesit në të cilat një ekonomi kalon. Gjatë periudhave, kur një ekonomi përjeton përshpejtim të rritjes ekonomike, të hyrat tatimore kanë tendencën të rriten; ndërsa në kushtet ngadalësimit ekonomik, të hyrat tatimore, veçanërisht të hyrat nga të ardhurat dhe konsumi, zvogëlohen. Këto zhvillime në treguesit fiskalë, të cilat ndodhin pa asnjë lloj ndërhyrje diskrecionare nga qeveria, ndihmojnë në zbutjen e luhatjeve ekonomike, dhe për këtë arsye njihen si “stabilizatorë automatikë”. Bilanci fiskal strukturor (i zhveshur nga cikli biznesor) synon të masë pozicionin fiskal të pastruar nga këta stabilizatorë, me qëllimin për të kuptuar më mirë shkallën dhe intensitetin e politikës diskrecionare fiskale.

Për të përfutur bilancin strukturor është e rëndësishme që të izolohet komponenti ciklik i bilancit fiskal, i cili vjen si rezultat i hendekut të prodhimit në ekonomi. Në rastin, kur një ekonomi është në nivelin e saj potencial (hendeku i prodhimit është zero), ky komponent ciklik i bilancit fiskal do të jetë zero dhe rrjedhimisht bilanci aktual fiskal përfaqëson në të njëjtën kohë edhe bilancin strukturor.


Vlerësimi i bilancit strukturor i paraqitur në këtë seksion, duhet të interpretohet me një shkallë të lartë të kujdesit, duke marrë parasysh disponueshmërinë e kufizuar të të dhënave të BPV-së. Në këtë version

të përditësuar të PRE-së, bilanci strukturor është vlerësuar duke përdorur të dhënat tremujore që mbulojnë periudhën 2011 TM1: 2018 TM2 (gjithsej 30 observime). Duke ndjekur metodologjinë e përcaktuar në versionin e vitit të kaluar të PRE, bilanci strukturor është llogaritur duke ndjekur dy hapat e mëposhtme.

Hapi i parë përfshin llogaritjen e hendekut të prodhimit, shprehur si devijimi në përqindje i BPV-së aktuale nga niveli i vet potencial. Literatura sugjeron një sërë teknikash për vlerësimin e BPV-së potenciale (dhe rrjedhimisht të hendekut të prodhimit), por për qëllime të këtij raporti dhe në kushtet e serive kohore të shkurtra është përdorur filtri Hodrick Prescott²⁵. Të gjitha teknikat e rekomanduara në literaturë japin vlerësime të ndryshme për hendekun e prodhimit, si në magnitudë ashtu edhe në shenjë e këtij hendeku (pozitiv apo negativ). Rrjedhimisht vlerësimi i bilancit strukturor është i ndjeshëm nga metodologjia e përdorur, çka sugjeron interpretimin me kujdes të këtij treguesi nga ana e përdoruesve apo politikëbërësve. Një çështje kryesore për të cilën ky filtër vazhdimisht kritikohet lidhet me të ashtuquajturën "problemi i pikës fundore", sipas të cilit observimet e fundit të serisë kanë një ndikim të madh në trendin e serisë, veçanërisht në fund të serisë kohore. Për qëllime të llogaritjes së bilancit strukturor fiskal, ne e kemi trajtuar "problemin e pikës fundore" duke zgjatur serinë kohore të BPV-së reale deri në tremujorin e fundit të vitit 2021, duke përdorur vlerat e parashikuara.

Hendeku i prodhimit dhe BPV-ja potenciale, të përfutuara nga aplikimi i filtrit Hodrick-Prescott, janë paraqitur në grafikët e mëposhtëm:

Grafiku 21. BPV-ja aktuale dhe potenciale, TM1/2011-TM2/2018



Nga grafiku mund të vihet re se ekonomia e Kosovës është rritur nën potencialin e saj gjatë periudhës 2011 TM2: 2012 TM3 dhe gjatë periudhës 2013 TM3: 2014 TM4; ndërsa për një periudhë të shkurtër (2012 TM4: 2013TM2), ekonomia ka performuar mbi nivelin e vet potencial. Nga 2015 e tutje, rezultatet e marra nga filtri HP tregojnë për një periudhë ku BPV-ja aktuale ka qenë shumë afër nivelit të vet potencial.

Hapi i dytë përfshin llogaritjen e elasticitetit të treguesve fiskalë duke përdorur metodologjinë e aplikuar nga OECD-ja dhe Komisioni Evropian. Elasticiteti i çdo lloji të të ardhurave tatimore vlerësohet në raport me BPV-në duke përdorur regresione të thjeshta MKV (Metoda e Katrorëve të Vegjël). Elasticiteti i çdo kategorie të të ardhurave është paraqitur në tabelën më poshtë. Megjithatë, nga ana e shpenzimeve, elasticiteti mbahet zero duke pasur parasysh se nuk ka përfitime të papunësisë

²⁵ Parametric zbutës i përdorur në filtrin Hodrick Prescott, është $\lambda = 480$, sugjeruar nga BQE-ja (Bouthevillain et al. (ECB 2001), "Cyclically adjusted budget balance: An alternative approach")

të dhëna nga Qeveria dhe se shpenzimet e tjera buxhetore janë të pavarura nga luhatjet e ciklit ekonomik.

Tabela 16. Elasticiteti i të ardhurave tatimore ndaj BPV-së²⁶

Kategoria e të hyrave	TAK	TAP	Tatimet indirekte	Tatimet tjera	Tatimi në pronë	Mesatarja e peshuar
Elasticiteti	1.79	2.98	1.74	-2.54	2.69	-
Elasticiteti i peshuar	0.09	0.22	1.3	-0.009	0.04	1.64

Komponenti ciklik i bilancit buxhetor llogaritet si produkt i elasticitetit të peshuar (i paraqitur më sipër) me komponentin ciklik të BPV-së (hendeku i prodhimit). Më tej, ky komponent ciklik i zbritet bilancit buxhetor për të arritur tek bilanci buxhetor i përshtatur për ciklet.

Tabela 17. Bilanci buxhetor, Bilanci i korigjuar për ciklin e biznesit, komponenti ciklik i bilancit dhe hendeku i prodhimit

Viti	Bilanci Fiskal (mln Eur)	Bilanci Strukturor (mln Eur)	Komponenti Ciklik (mln Eur)	Hendeku i prodhimit, %
2011	-69.0	-6.6	-62.4	-0.2
2012	-128.7	-185.6	56.9	-0.7
2013	-164.0	-222.8	58.8	3.7
2014	-128.0	-12.7	-115.3	-2.9
2015	-78.0	-151.8	74.5	-0.7
2016	-54.0	-71.7	19.8	0.8
2017	-55.0	-46.2	-8.8	-0.5
2018	-69.2	-50.8	-18.4	-0.1

Ashtu siç tregon Tabela 17, efekti i ciklit ekonomik është i dukshëm në vitet 2013 dhe 2016 kur hendeku i prodhimit ka qenë pozitiv. Efeki i ciklit në këto vite ka çuar në një bilanc fiskal më të mirë se bilanci që do të rezultonte nëse ekonomia e Kosovës do të operonte rreth nivelit të vet potencial. Ndërsa, në vitet kur ekonomia ka vepruar nën potencial (kur hendeku i prodhimit ka qenë negativ), deficit fiskal ka rezultuar të jetë më i lartë se deficitit që do të rezultonte në kushtet e një hendeku pozitiv zero.

3.5. Nivelet dhe zhvillimet e borxhit, analiza e operacioneve të mëposhtme dhe rregullimet e flukseve të stoqeve

Kosova ka adaptuar një kornizë mjaft të matur ligjore me qëllim të parandalimit të praktikave të paqëndrueshme të borxhit. *Ligji për Borxhet Publike* i jep Ministrinë të Financave të drejtën ekskluzive për të hyrë në hua dhe për të negociuar kushtet e borxhit ndërkombëtar në emër të Kosovës. Sipas Kushtetutës, të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare duhet të ratifikohen në Kuvend nga një shumicë prej dy të tretat e votave. Bazuar në *Rregulloren për Emetimin dhe Administrimin e Borxheve Shtetërore, Garancive shtetërore dhe Borxheve Komunale* huatë ndërkombëtare negocohen nga një ekip zyrtar që përbëhet nga anëtarë të departamenteve të ndryshme: Njësia për menaxhimin e borxhit

²⁶ Ndryshimet në elasticitetet e paraqitura këtu ndryshojnë nga ato të paraqitura në versionin e kaluar të PRE-së si rezultat i shtimit të vrojtimeve të reja (deri në 2018T3) dhe si rezultat i përdorimit të një serie të ndryshme kohore të përdorur për BPV-në reale me çmimet vitit bazë 2014= 100).

(NJMB), Departamenti Ligjor, Kabineti i Ministrit, Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Bashkëpunimit Financiar Ndërkombëtar, Departamenti i Buxhetit dhe organizatat përkatëse buxhetore.

Ligji për Borxhin Publik është miratuar edhe nga FMN-ja dhe përfshin disa dispozita që sigurojnë stabilitet fiskal, përfshirë tavanin e borxhit publik prej 40 përqind të BPV-së si dhe kufizime të caktuara në huamarrjen komunale. Për qëllime të këtij indikator, garancitë shtetërore llogariten si borxh shtetëror. Ligji për Borxhin Publik obligon raportim të rregullt në Kuvend (neni 15) përmes përgatitjes së Programit të Borxhit Shtetëror, i cili përfshin strategjinë afatmesme të borxhit që duhet të dorëzohet për miratim në Qeveri dhe për informim në Kuvend.

Një amendament është shtuar në *Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP)*, i cili kufizon deficitin vjetor të buxhetit jo më shumë se 2% të BPV-së së parashikuar. Një tjetër ndryshim i LMFPP-së është shtuar në vitin 2015, i cili lejon qeverinë të kontraktojë borxhin që tejkalon rregullin fiskal prej 2%, vetëm nëse financimi ofrohet nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe dedikohet për projekte kapitale.

Emetimi i Letrave me Vlerë të Qeverisë autorizohet me Ligjin për Borxhet Publike dhe është i rregulluar me *Rregulloren për Tregun Primar dhe Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë*. NJMB ka ndryshuar rregulloren në mënyrë që të reflektojë nevojat aktivitet në tregun sekondar. Praktikrat e deritanishme të menaxhimit të borxhit shtetëror janë në përputhje të plotë me kërkesat që dalin nga legjislacioni primar dhe sekondar. Gjatë vitit 2018 legjislacioni primar dhe sekondar i është nënshtruar procesit të rishikimit, proces ky i cili pritet të përfundojë në fund të vitit 2019.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shifrat e borxhit për llojin e borxhit së bashku me raportin e Borxhit/BPV²⁷.

Tabela 18. Borxhi i përgjithshëm (në milionë Euro)

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	p.2019	p.2020	p.2021
Borxhi Ndërkombëtar	336.6	323.8	326.4	371.2	373.4	422.2	416.1	627.0	743.8	822.7
Borxhi i Brendshëm	73.3	152.5	256.5	377.8	478.6	574.3	676.6	771.3	871.3	971.3
Borxhi i Përgjithshëm	409.9	476.3	582.9	749.0	852.0	996.5	1,092.7	1,398.2	1,615.1	1,794.0
Garancitë Shtetërore	-	-	10.0	10.0	20.0	44.0	44.0	44.0	44.0	44.0
Raporti Borxh/BPV	8.4%	8.9%	10.5%	12.9%	14.2%	15.5%	16.2%	19.6%	21.5%	22.5%

3.5.1. Detyrimet Kontigjente

Në fund të vitit 2017 portofoli i garancioneve shtetërore përbëhej nga tre garanci shtetërore. Garancioni i parë është lëshuar në vitin 2014, në vlerë prej 10 milionë eurosh, për të garantuar FSDK-në për linjën e kreditore me BERZH-in. Garancia e dytë ndërkombëtare, u lëshua në vitin 2016, për të garantuar Trafikun Urban për huanë e siguruar nga BERZH-i në vlerë prej 10 milionë eurosh. Ndërsa në vitin 2017 është lëshuar edhe garancia e tretë në shumën 24 milion euro për të garantuar linjën e dytë kreditore të FSDK-së. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur historiku i emetimit të garancioneve që nga viti 2014:

²⁷ Programi i Borxhit Shtetëror 2019-2021

Tabela 19. Garancitë shtetërore

	2014	2015	2016	2017	2018	p.2019	p.2020	p.2021
Garancitë shtetërore	10.00	10.00	20.00	44.00	44.00	44.00	44.00	44.00
Garancioni për Linjën Kreditore DIFK	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00
Garancioni për kredinë e Trafikut Urban	0	0	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00
Garancioni për Linjën e Dytë Kreditore DIFK	0	0	0	24.00	24.00	24.00	24.00	24.00
Garancitë shtetërore (% e BPV)	0.2%	0.2%	0.3%	0.7%	0.7%	0.6%	0.6%	0.6%

3.6. Analiza e ndjeshmërisë dhe krahasimi me programin e mëparshëm

Sa i përket stabilitetit fiskal, rezultatet e përftuara nga skenari i ulët dhe skenari i lartë nuk i çënojnë rregullat fiskale pavarësisht ndryshimeve në të hyra dhe në shpenzime nga skenari bazë.

Në skenarin e ulët, të hyrat totale qeveritare do të nënperformonin mesatarisht prej 1.1% krahasuar me projeksionet bazë për vitin 2019 dhe 2.6% për vitet 2020 dhe 2021. Kjo nënperformancë do të jetë më e theksuar në kategorinë e të hyrave tatimore indirekte, të cilat do të jenë rreth 1.3%; 2.8% dhe 3.4% më të ulta se projeksionet në vitet 2019, 2020 dhe 2021, respektivisht. Gjëthashtu, në skenarin e ulët është supozuar një shkallë më e ulët e realizimit të shpenzimeve kapitale (financuar nga buxheti i rregullt, klauzola e investimeve; dhe mjetet e likuidimit të AKP-së), të cilat në total do të jenë mesatarisht rreth 6% më të ulta se shpenzimet kapitale të projektuar gjatë periudhës 2019- 2021 në skenarin bazë. Ndërsa, shpenzimet rrjedhëse do të jenë rreth 2.4% më të larta se ato të planifikuara në skenarin bazë. Si rezultat i rënies më të madhe të shpenzimeve totale të qeverisë në krahasim me rënien e të ardhurave qeveritare për shkak të ngadalësimit të rritjes ekonomike, deficitit buxhetor gjatë periudhës afatmesme do të luhet në intervalin [-0.1%: -0.6%], ndërkohë që bilanci bankar do të mbetet në nivele të kënaqshme.

Në skenarin e lartë, të hyrat do të mbiperformonin për 1.4% në raport me parashikimet bazë për 2019, dhe 2.5% në vitet 2020 dhe 2021. Të hyrat tatimore indirekte do të jenë më të larta se projeksionet në skenarin bazë me rreth 1.7%; 2.6% dhe 3.1%, respektivisht në vitet 2019, 2020 dhe 2021. Gjithashtu, në skenarin optimist është supozuar një shkallë më e lartë e realizimit të shpenzimeve kapitale, të cilat do të jenë mesatarisht 4.8% më të larta se niveli i projektuar i shpenzimeve kapitale gjatë periudhës 2019- 2021. Bilanci buxhetor dhe bilanci bankar do të vazhdojnë të qëndrojnë brenda rregullave fiskale edhe gjatë skenarit optimist.

Tabela 20. Rezultatet e skenarëve alternativë në treguesit kryesor fiskalë

Përshkrimi	2019			2020			2021		
	(Ulët)	(Bazë)	(Lartë)	(Ulët)	(Bazë)	(Lartë)	(Ulët)	(Bazë)	(Lartë)
mln Eur									
Të hyrat totale	1928	1949	1977	1978	2026	2071	2079	2141	2199
Të hyrat tatimore	1709	1731	1758	1752	1800	1845	1848	1909	1968
Të hyrat direkte	287	289	290	299	302	307	313	319	326
Të hyrat indirekte	1472	1492	1518	1508	1552	1592	1591	1647	1698
Shpenzimet totale	2117	2203	2239	2125	2279	2323	2204	2391	2410
Shpenzimet rrjedhëse	1603	1567	1567	1622	1584	1584	1664	1624	1624
Shpenzimet kapitale ²⁸	514	636	672	503	695	739	540	767	786

²⁸ Shpenzimet kapitale të paraqitura në tabelë inkorporojnë supozimet mbi shkallën e mosrealizimit të tyre për secilin skenar

3.6.1. Krahasimi me programin e mëparshëm

Duke marrë parasysh ndryshimet e fundit në ekonomine globale si dhe atë vendore, parashikimet janë rishikuar dhe si të tilla janë reflektuar ndryshimet në PRE 2019.

Në krahasim me PRE 2018, në PRE 2019 planifikohet inkasim me i ulët i të hyrave të përgjithshme për mesatarisht 0.7% për periudhën e viteve 2018 – 2020²⁹. Në anën tjetër, shpenzimet e përgjithshme janë rishikuar më lartë për mesatarisht 4.8% në krahasim me programin e kaluar.

Krahasimi i plotë me programin e mëparshëm është paraqitur në annexin 3.

3.7. Qeverisja fiskale dhe kornizat buxhetore

Nuk ka pasur ndryshime/azhurnime lidhur me qeverisjen fiskale dhe kornizat buxhetore të cilat do të ndryshonin thelbësisht nga ajo çka është raportuar në versionin e viteve të kaluara.

3.8. Qëndrueshmëria e financave publike

Qëndrueshmëria e borxhit në Kosovë

Ekonomia e Kosovës vazhdon të përjetojë rritje positive ekonomike, kryesisht të ndikuar nga rritja e konsumit privat, investimeve totale dhe përmirësimit të bilancit tregtar. Kosova vazhdon të ketë nivelin më të ulët të borxhit krahasuar me regjionin. Megjithatë, niveli i borxhit është në rritje të kontrolluar, si rezultat i rritjes së investimeve në infrastrukturë publike. Për t'u siguruar se rritja e stokut të borxhit bëhet në mënyrë të kontrolluar dhe të qëndrueshme, qeveria ka adaptuar rregullën fiskale për të limituar deficitin e përgjithshëm në 2% të BPV-së, me qëllimin për të stabilizuar nivelin e borxhit nën kufirin e lejuar ligjor (40% e BPV-së). Duke u bazuar në nivelin e ulët të borxhit në raport me BPV-në dhe nevojës për përmirësim të infrastrukturës publike, qeveria në vitin 2015 amendoi LPMFPP duke inkorporuar në këtë ligj klauzolën për investime, për të mundësuar financimin e projekteve me ndikim në rritjen ekonomike, kryesisht përmes IFN-ve. Megjithatë, projektet e parapara për 2018 përmes klauzolës investive, nuk arritën të implementohen për arsye të barrierave në implementim dhe vonesave në disbursime të këtyre projekteve. Bazuar në nevojën e Kosovës për implementim të projekteve kapitale, AQB është nërtuar duke inkorporuar klauzolën e investimeve në skenarin bazë, e pasuar nga analiza të mëtejme të ndjeshmërisë së borxhit, duke iu nënshtruar ndryshimeve në treguesit themelorë makroekonomik dhe borxhit.

AQB është bërë duke përdorur modelin (platformën) e zhvilluar nga njësia makroekonomike në kuadër të Ministrisë së Financave dhe janë bërë disa supozime mbi treguesit bazë makroekonomikë si dhe treguesit e tjerë të lidhur me borxhin, për periudhën afatgjatë 40 vjeçare (2019-2058), si në vijim:


- Rritje nominale e BPV-së prej 5.5% për periudhën 2022 - 2032, e pasuar nga një rënie e njëpasnjëshme prej 0.5 pikë përqindjeje në secilën prej 3 dekadave pasuese;
- Të hyrat e përgjithshme buxhetore do të rriten me të njëjtin ritëm si rritja nominale e BPV-së;

²⁹ Krahasimi mes dy programeve është bërë për vitet 2018 – 2020 pasi që PRE 2018 nuk paraqet parashikimet për vitin 2021

- Norma e interesit për kreditë e reja komerciale do të rritet nga 4.5% gjatë periudhës 2019-2029 në 10% gjatë periudhës 2052-2062;
- Norma e interesit të kredive koncesionare vlerësohet të luhatet rreth 2% gjatë gjithë periudhës (2019-2062);
- Norma e interesit mbi borxhin e brendshëm vlerësohet të luhatet rreth vlerës 5% deri në vitin 2040 dhe më tej të ulët në nivelin 3% në fund të periudhës së parashikimit.
- Kreditë komerciale maturohen në 10 vjet;
- Kreditë koncesionare maturohen në 15 vjet;
- Bilanci bankar ndaj BPV-së me 4.5%;
- Deficiti i përgjithshëm ndaj BPV-së në 2%;
- Klauzola e investimeve parashihet të jetë rreth 121; 220 dhe 187 milionë Euro në vitet 2019, 2020 dhe 2021, respektivisht, ndërsa në periudhën e mbetur të AQB-së (pas vitit 2021) nuk parashihet klauzolë e investimeve.

Skenari bazë (Grafiku 22) tregon se stoku i borxhit publik do të jetë i qëndrueshëm. Raporti i borxhit ndaj BPV-së tregon një trend në rritje gjatë periudhës, por do të qëndrojë nën pragun e 40% për të gjithë periudhën. Pjesëmarrja e shpenzimeve të interesit në strukturën e bilancit të përgjithshëm (deficitit) mbetet i ulët në vitet e hershme, megjithatë, me rritjen e kërkesës për financim (duke përfshirë edhe financimin mbi deficitin prej 2% përmes klauzolës për investime), rritjen e borxhit dhe rritjen e normave të interesit të borxhit të brendshëm dhe të jashtëm, shpenzimet e interesit do të vazhdojnë të kenë ndikim të rëndësishëm në deficitin e përgjithshëm. Gjithashtu, kontributi i deficitit primar (që përjashton shpenimet e interesit) në nevojën e përgjithshme të financimit, duket të jetë i ulët në krahasim me kontributin e shërbimit të borxhit në total.

Grafiku 22. Rezultatet e skenarit bazë




Ulja e BPV-së nominale për 1 p.p.: Ky skenar është ndërtuar mbi supozimin e një ndryshimi të në rritjen nominale të BPV-së e cila shënon rënie me rreth 1 p.p në raport me skenarin bazë. Rënia e

BPV-së me vetëm 1 p.p (duke mbajtur të gjitha supozimet e tjera njëjtë si në skenarin bazë) rrit nivelin e borxhit mbi kufijtë e caktuar, duke sugjeruar që pragu të shkelet pas vitit 2050. (Grafiku 23).

Ulja e bilancit bankar nga 4.5% në 3% të BPV-së: Duke pasur parasysh se një sasi e konsiderueshme e nevojës për financim rrjedh nga nevoja për të mbajtur nivele adekuatë të bilancit bankar, është kryer analiza për të parë lëvizjet në nivelet e borxhit nëse bilanci bankare (rezerva fisakle) zvogëlohet në 3% të BPV-së, duke ruajtur rritjen nominale të BPV-së si dhe supozimet tjera të njëjta si në skenarin bazë. Grafiku më poshtë, sugjeron se ulja e bilancit bankar nuk do të ndryshojë ndjeshëm nivelet e borxhit (Grafiku 23).

Grafiku 23. Analiza e skenarëve: Zvogëlimi i rritjes së BPV-së me 1 p.p. (figura në të majtë) dhe ulja e bilancit bankar nga 4.5% në 3% të BPV-së (figura në të djathtë)




Rritja e normave të interesit mbi borxhin e brendshëm dhe të jashtëm: Një rritje me 1 pikë përqindje e normave të interesit mbi borxhin e brendshëm dhe të jashtëm (koncesionar dhe komercial) në të gjithë periudhën e parashikimit, nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm mbi nivelin e borxhit publik apo në bilancin buxhetor për shkak të kufizimit të rregullës fiskale, por do të ndryshojë strukturën e bilancit buxhetor dhe të nevojës për financim si rezultat i rritjes së shpenzimeve të interesit.

4. PRIORITETET E REFORMAVE STRUKTUREORE PËR PERIUdhËN 2019-2021

4.1 IDENTIFIKIMI I PENGESAVE KRYESORE NË KONKURRUESHMËRI DHE RITJE GJITHËPËRFSHIRËSE

Kjo pjesë raporton mbi zhvillimet në lidhje me pengesat e identifikuara të rritjes ekonomike që nga PRE i fundit. Krahasuar me PRE të fundit, qasja në financa nuk konsiderohet më një pengesë detyruese dhe mjedisi rregulator është përmirësuar. Kjo do të thotë se pengesat e tjera tani janë bërë relativisht më të rëndësishme për t'u adresuar.

*Grafiku 29.: Pengesat ndaj rritjes në Kosovë **



* *Pengesat me ngjyrë të zezë* konsiderohen të jenë të *detyrueshme*, ndërsa të tjerat janë të rëndësishme dhe mund të bëhen të detyrueshme në të ardhmen. *Pengesat në kllapa* konsiderohen të dobëta.

Qasja në financa është përmirësuar përmes uljes së normave të interesit dhe mbështetjes në sigurimin e kolateralit. Që nga viti 2014 kur u është bërë edhe analiza e parë e pengesave për PRE, normat nominale të interesit për kreditë tregtare kanë rënë nga rreth 9.2% në 6.8% në dhjetor 2017 dhe rritja vjetore e kredive për korporatat jo-financiare shkoi nga 4.3% në 2014 në 9.3% në 2017. Në vitin 2014, vlera e përgjithshme e huave arriti në 1.88 miliardë euro ose rreth 32.5% më pak se shuma e përgjithshme e kredive në vitin 2017. Në këtë vit vlera e përgjithshme e kredive ishte 2.49 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.5%. Rritja kryesore e një rritjeje të tillë ishte rritja e kërkesës për kredi, e shoqëruar me uljen e normave mesatare të interesit dhe zgjatjen e maturimit të kredive. Në vitin 2017, kredia për të gjithë sektorët ekonomikë është rritur, por rritja më e madhe është në ndërtim (26.1%), bujqësia (13.4%) dhe sektori i prodhimit (9.3%). Kërkesat e kolateralit të Kosovës janë shumë strikte: bankat kërkojnë gati trefishin e vlerës së kredisë si kolateral, ndërsa 90% e të gjitha kredive kërkojnë kolateral. Sidoqoftë, qasje më e mirë për financat dhe thellimit financiar, veçanërisht për start-ups dhe aktivitetet ekonomike me rrezik të lartë, mbeten një shtysë e rëndësishme për ngritjen e potencialit të rritjes së Kosovës dhe do të adresohen më tej me masat për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave të pronësisë duke përfshirë legalizimin e të paautorizuar dhe për të përmirësuar efikasitetin e gjykatave në mosmarrëveshjet ekonomike.

Mjedisi i të bërit biznes është përmirësuar fuqishëm, por sfidat mbeten. Në Raportin e të bërit biznes të Bankës Botërore 2019 (BB RBB), Kosova ka mbajtur një renditje të përmirësuar, siç është shënuar, me një rezultat më të lartë krahasuar me standardin më të mirë të BB-së dhe njohjen e reformave në lëshimin e lejeve të ndërtimit, si dhe administratën tatimore dhe doganore. Progresi më i dukshëm u arrit në fushat e fillimit të një biznesi, marrjes së kredive dhe tregtisë përtej kufijve. Përmirësime të rëndësishme u arritën gjithashtu në zbatimin e kontratave dhe zgjidhjen e paaftësisë pagueuse, por ka ende një hendek të madh në krahasim me vendet më të mira. Ndërsa zbatimi i Ligjit të ri të miratuar

kohëve të fundit për organizatat e biznesit pritet të përmirësojë ndjeshëm mbrojtjen e investitorëve të vegjël.

Ekonomia joformale vlerësohet të jetë zvogëluar, por ende mbetet një pengesë e madhe dhe e rëndësishme. Një studim i kohëve të fundit vlerësoi se madhësia e ekonomisë joformale (e hirtë dhe e zezë) në vitin 2015 ishte në 32% të BPV-së, e cila është dukshëm më e ulët se 43% e BPV-së e vlerësuar për vitin 2013 në një metodologji të krahasueshme.³⁰ Vlera e taksave të pa-mbledhura vlerësohet në 107 milionë euro ose 1.8% të BPV-së. Ekonomia joformale është identifikuar si një sfidë kryesore në Gjendjen e Konkurrencës, veçanërisht në lidhje me mbledhjen e tatimit. Sektorët më të prekur nga informaliteti ishin ndërtimi, tregtia, pasuria e patundshme, shërbimet profesionale, akomodimi, dhe bujqësia. Në 2016 dhe 2017, rritja mesatare e të ardhurave tatimore tejkalonte rritjen nominale ekonomike dhe të ardhurat neto pozitiv nga ndryshimet e politikës tatimore, duke treguar një tkurrje të mëtejshme të hendekut tatimor. Megjithatë, kërkohet masa të mëtejshme për të rritur mobilizimin e të ardhurave vendore dhe për të siguruar një fushë të barabartë për funksionim nëpërmjet formalizimit të shtuar, duke përfshirë një administrim tatimor më të bazuar në performancë, i cili nxit pajtueshmërinë vullnetare dhe adreson përhapjen e borxheve të tepërta tatimore.

Zbatimi i dobët i kontratave dhe sundimi i ligjit mbeten një pengesë e detyrueshme. Një numër i përgjithshëm i 1124 rasteve të pazgjidhura ekonomike janë numëruar në fillim të vitit 2018. Gjatë vitit, janë pranuar 659 raste dhe janë zgjidhur 697 raste - duke rezultuar në zvogëlimin e lëndëve të grumbulluara me 3.7%. Përmirësime marginale janë shënuar edhe nga treguesit ndërkombëtarë; për shembull, në Treguesit e Qeverisjes së Bankës Botërore për vitin 2017, të cilat normalizohen në një interval prej -2,5 deri në 2,5, rezultati i Kosovës për sundimin e ligjit ishte -0,42, ndërsa për kontrollin e korrupsionit rezultati u vlerësua në -0,5. Përkundër këtyre përmirësimeve në rritje dhe indikacioneve që perceptimet negative mund të jenë të ekzagjeruara (analiza e kufijve të MCC), zbatimi i dobët i kontratave dhe sundimi i ligjit në përgjithësi mbeten një pengës e detyrueshme. Gjithashtu, mund të bëhet edhe më shumë në fushat e korrigjimit të korrupsionit, vlerësimit të rreziqeve të korrupsionit në institucionet publike, rritjes së ndërgjegjësimit dhe koordinimit të reformave kundër korrupsionit.

Në infrastrukturë, furnizimi i pamjaftueshëm dhe i paqëndrueshëm i energjisë elektrike është ende një pengesë e detyrueshme. Linja e re e transmisionit të energjisë me Shqipërinë, e ndërtuar në vitin 2016, ka përmirësuar sigurinë e furnizimit dhe ka lidhur vendin me tregjet rajonale të energjisë elektrike, por do të hyjë në fuqi vetëm pasi Kosova të jetë pranuar në Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit. Prandaj treguesit e qëndrueshmërisë së furnizimit me energji nuk tregojnë ende për përmirësim.³¹ Në sondazhin e fundit të Odës Ekonomike të Kosovës³², pothuajse 90% e kompanive theksuan se përmirësimet në rrjetin e KEDS nuk e kanë ngritur konkurrueshmërinë e tyre dhe dy të tretat e tyre nënvizuan se kostoja e energjisë elektrike dhe sistemi tarifor si një problem madhor për biznesin e tyre. Raporti i të Bërit Biznes i BB-së për vitin 2019 rendit Kosovën në vendin e 113-të në botë sa i përket lehtësimit të marrjes së energjisë elektrike.

Investimet në rrjetin rrugor dhe hekurudhor, të rëndësishme për lehtësimin e qarkullimit tregtar dhe mobilitetit të punës, vazhduan edhe gjatë vitit 2017 dhe 2018. Krahasuar me furnizimin me energji elektrike, lidhjet e pazhvilluara të transportit konsiderohen si një pengesë më pak e detyrueshme. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se rritja e aktiviteteve të transportit gjeneron një gamë të kostove të jashtme dhe mund të rrisë kostot e logjistikës, Kosova duhet të përfshijë qëndrueshmërinë, elasticitetin dhe konkurrencën afatgjate si objektiva qendrore të politikave.

Shërbimet mjedisore janë konsideruar si një pengesë në shfaqje e sipër. Analiza e Pengesave e MCC propozoi që të përfshihen edhe “shërbimet mjedisore” në mesin e pengesave të detyrueshme. Kosova përballet me nivele të larta të ndotjes së mjedisit nga një sërë burimesh, duke përfshirë prodhimin e

³⁰ Anketa mbi Shtrirjen dhe Parandalimin e Ekonomisë Ilegale dhe Pastrimit të Parave në Kosovë, raport i projektit të financuar nga BE-ja ‘Forcimi i kapacitetit të Kosovës për të luftuar pastrimin e parave dhe korrupsionin’, 2014.

³¹ Sipas Raportit të të Bërit Biznes për 2018, indeksi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve të sistemit (SAIDI) është 62.1 dhe indeksi i frekuencës mesatare të ndërprerjes së sistemit (SAIFI) është 34.7, i cili është i ngjashëm me vlerat në raportin e vitit 2016

³² Sektori i Energjisë në Kosovë- Barrierat në Miliona Euro- Energjia Elektrike”, Oda Ekonomike e Kosovës, 201

energjisë elektrike, minierat dhe industrinë, automjetet që përdorin gazin me plumb dhe nga largimi i paligjshëm ose i parregulluar i mbeturinave të ngurta. Të gjithë lumenjtë në Kosovë janë klasifikuar si tepër të ndotur dhe ka shumë pak impiante komunale për trajtimin e ujërave të ndotura.

Sipas studimit të MCC, disa firma raportojnë se ato vetë bëjnë trajtimin e ujërave të zeza (ndotura), por ndotja e mjedisit nuk duket të prekë fermerët dhe firmat nuk u ankuan për çështjet shëndetësore që të kenë penguar njerëzit në punë. Çështjet mjedisore sigurisht ndikojnë në shëndetin dhe cilësinë e jetës së njerëzve, ndërkohë që ndikimi i tyre negativ në konkurrueshmëri mund të bëhet më i theksuar në të ardhmen. Sidoqoftë disa nga masat e përfshira në këtë PRE, adresojnë disa nga qështjet mjedisore (përmes rritjes së efijencës së energjisë, kapacitetet e reja gjeneruese duke shfrytëzuar BRE, apo duke përdorur teknologji të reja, dhe prioritizimin e investimeve në trajtimin e ujërave të zeza, përmes klauzolës së investimeve)

Hendeku i shkathtësive ndërmjet arsimit / trajnimit dhe nevojave të tregut të punës mbetet një pengesë e detyrueshme për rritjen dhe punësimin. Një sondazh i kryer në fund të vitit 2015 konfirmoi gjetjet e mëparshme të Raportit BEEPS të vitit 2013.¹⁹ Më tepër se një e treta kanë raportuar se kanë probleme për gjetjen e personave të aftësuar me rastin e rekrutimit të teknikëve, profesionistëve, dhe punëtorëve për servisim, në fushën e bujqësisë, ndërtimit dhe profesione të tjera. Mangësitë e tjera janë gjuha, kompjuteri dhe shkathtësitë e buta. Analiza e Pengesave e MCC vlerësoi shkallët e kthimit në arsim në Kosovë dhe arriti në përfundimin se ato janë në përputhje me hipotezën se **cilësia e ulët e arsimit** është një pengesë e detyrueshme e rritjes, gjë që u konfirmua edhe nga rezultatet e studimit PISA 2015. Kjo tregon që problemi i hendekut të shkathtësive është i lidhur me nivelet e pjesëmarrjes në arsim, me kompetencat dhe shkathtësitë specifike siç janë gjuhët e huaja, aftësitë kompjuterike ose të ashtuquajturat shkathtësi të buta dhe me cilësinë e përgjithshme të arsimit.

Ekzistojnë edhe ***pengesa të tjera të rëndësishme për punësimin.*** Struktura e tanishme ekonomike, kryesisht e bazuar në produkte dhe shërbime jo të sofistikuara dhe më të ulëta të vlerës së shtuar, nuk është në gjendje të krijojë një numër të mjaftueshëm të vendeve të punës me shkathtësi të larta. Përdorimi mbizotërues i kanaleve joformale nga ana e firmave në rastin kur kërkojnë punëtorë zvogëlon hapësirën për vendosjen (shpalljen) e vendeve të punës nga shërbimet e punësimit. Remitencat rrisin nivelin e pagës rezervë dhe informaliteti i përhapur zvogëlon numrin e vendeve formale të punës. Mungesa e institucioneve për kujdesin e fëmijëve dhe kujdesi institucional për të moshuarit, të kombinuara me mungesën e aranzhimeve fleksibile të punës dhe paragjykimëve kulturore, dekurajojnë pjesëmarrjen e femrave në fuqinë punëtore.

4.2 Përmbledhje e prioriteteve të reformave

Seksioni vijues përfshinë 19 masa prioritare të reformave strukturore të identifikuar për Programin për Reforma në Ekonomi që mbulojnë periudhën 2019-2021. Masat e përzgjedhura përfaqësojnë prioritete ekzistuese dhe të reja strategjike që Kosova i ka identifikuar si më të rëndësishmet për të adresuar pengesat kryesore për rritje ekonomike dhe konkurrueshmëri siç janë theksuar në seksionin 4.1. Këto masa përfshijnë gjithashtu një listë të Indikatorëve kryesorë të Performancës të cilat janë identifikuar për monitorimin dhe vlerësimin e efekteve të masave të reformës në segmente ose sektorë të veçantë të ekonomisë. Treguesit janë paraqitur në formën narrative të Programit, por hollësitë e mëtejshme janë paraqitur edhe në Aneksin 5 - Lista e Treguesve kryesorë të Performancës. Masat e paraqitura këtu janë shqyrtuar në kuadër të një dialogu gjithëpërfshirës të politikave me strukturat qendrore dhe lokale të qeverisjes, sektorin privat dhe shoqërinë civile. Në përgjithësi, ato rrjedhin nga Programi i Qeverisë 2017-2021, Strategjia Kombëtare për Zhvillim, Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, Agjenda për Reforma Evropiane dhe strategjitë përkatëse sektoriale të vendit. Shumë prej masave përfshijnë aktivitete të cilat duhet të implementohen në vazhdimësi.

I. Reforma e tregut të energjisë dhe transportit

Masa #1: Ulja e konsumit të energjisë nëpërmjet masave të efijencës së energjisë - qëllimi i është zbatimi i masave të efijencës së energjisë në sektorin publik dhe atë të ekonomive familjare, duke kontribuar kështu në reduktimin e konsumit të energjisë me qëllim të arritjes së synimi për kursimin e energjisë prej 92ktoe ose 9% të konsumit final të energjisë elektrike.

Masa #2: Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve prodhuese të energjisë - synimi i masës është adresimi i sigurisë së energjisë përmes zhvillimit të kapaciteteve të reja gjeneruese, dhe investimeve në BRE.

II. Zhvillimet sektoriale – bujqësia, industria dhe shërbimet

Masa #3: Ndryshimet strukturore në sektorin e agro-përpunimit – masa adreson rolin dhe rëndësinë së rritjes së prodhimit, dhe uljes së importin e produkteve bujqësore, të mbështesë projektet e investimeve në infrastrukturën rurale dhe ristrukturimin e potencialit fizik të fermave si dhe mbështetje të drejtpërdrejtë për prodhimin bujqësor.

Masa #4: Zgjerimi i fermave përmes konsolidimit dhe rregullimit të tokave bujqësore - adresimin e fragmentimit të tokës dhe rritjen e madhësisë së fermës përmes përmirësimit të politikës dhe kuadrit ligjor mbi tokën bujqësore, përveç zbatimit të inventarit vullnetar dhe projekteve të konsolidimit.

Masa #5: Rritja e konkurrueshmërisë në industrinë prodhuese – kjo masë synon të përmirësojë konkurrencën në sektorët e industrisë prodhues në Kosovë duke vënë theks të veçantë në mekanizmat që përmirësojnë bashkëpunimin midis NVM-ve, rrisin rrjetëzimin me kompanitë e tjera rajonale dhe të BE-së, përmirësojnë dialogun publiko-privat dhe rrisin cilësinë e prodhimit në sektorët e prodhimit industrial.

Masa#6: Rritja e konkurrueshmërisë në Sektorin e Turizmit dhe Hotelarisë - qëllimi i kësaj mase është të promovojë zhvillimin dhe konkurrencën e sektorit të turizmit duke promovuar produktet e turizmit, duke promovuar zhvillimin e produkteve në mënyrë që të depërtojnë në tregun e turizmit, bashkëpunimin me aktorët përkatës, duke zbatuar standardet e turizmit dhe hotelarisë dhe duke përmirësuar infrastrukturën ligjore sipas praktikave evropiane.

III. Mjedisi i të bërit biznes dhe ulja e ekonomisë jo-formale

Masa #7: Zhvillimi i politikave bazuar në të dhëna dhe ulja e barrës administrative - qëllimi i masës është të thjeshtojë legjislacionin dhe të krijojë një sistem të vlerësimit të ndikimit rregullator, duke përfshirë zvogëlimin e barrës administrative për bizneset.

Masa #8: Sigurimi i të drejtave pronësore duke adresuar informalitetin në sektorin e pronës së paluajtshme - objektivi kryesor është fuqizimi i sistemit të të drejtave pronësore për pronat e paluajtshme, në mënyrë që qytetarëve t'u sigurohet qasja në procese administrative efikase dhe financiarisht të përballueshme lidhur me themelimin dhe transferimin e titullarëve të pronës.

Masa #9: Rritja e efikasitetit në gjyqësor në zgjidhjen e rasteve - kjo masë synon përmirësimin e efikasitetit të gjyqësorit në trajtimin e kontesteve ekonomike duke reduktuar rastet e grumbulluara dhe duke përmirësuar sistemin e menaxhimit të rasteve (SML)

Masa #10: Reforma e përgjithshme e inspektimeve - masa synon reformën e inspektimeve përmes përmirësimit të koordinimit ndërinstitucional dhe digjitalizimit të procesit të inspektimit.

Masa #11: Zvogëlimi i ekonomisë informale - Qëllimi i masës është përmirësimi i cilësisë së shtetit të së drejtës dhe qeverisjes ekonomike në Kosovë si kufizime për rritjen ekonomike dhe gjenerimin formal të punësimit. Kjo masë është pjesë e masave më të gjera të politikave që qeveria e Kosovës planifikon të ndërmarrë përmes Strategjinë kundër ekonomisë informale.

IV. Inovacioni, zhvillimi dhe hulumtimet dhe ekonomi digjitale

Masa #12: Përmirësimi i mjedisit për ndërmarrësi dhe inovacion - synon krijimin e kornizës së politikave dhe bazës ligjore, ngritjen e kapaciteteve të brendshme për kërkimet shkencore dhe inovacion, rritjen e nivelit të bashkëpunimit të komunitetit akademik dhe atij industrial, si dhe pjesëmarrjes së institucioneve shkencore të vendit në programet dhe projektet evropiane dhe rajonale, dhe mbështetjen e aktiviteteve të inovacionit në përgjithësi.

Masa #13: Shtirirja e infrastrukturës përkatëse të rrjetave dhe shërbimeve të TIK-ut për zhvillim socio-ekonomik - kjo reformë synon zgjerimin e qasjes dhe përdorimit të TIK-ut përmes shtirirjes së infrastrukturës brezëgjere në viset e pambuluara, forcimit të kapitalit njerëzor dhe mbështetjes së bizneseve dixhitale, si dhe dixhitalizimit të bizneseve tjera.

V. Reformat lidhur me tregtinë

Masa #14: Lehtësimi i tregtisë nëpërmjet rritjes së efikasitetit për kosto të transaksioneve ndërkombëtare tregtare – synon të rrisë efektivitetin e kostos së transaksioneve të tregtisë ndërkombëtare nëpërmjet thjeshtimit dhe standardizimit të të gjitha formaliteteve dhe procedurave në kufi.

Masa #15: Zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës së cilësisë dhe fuqizimi i rolit të autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut me fokus produktet e ndërtimit – kjo masë synon të zhvillojë më tej cilësinë dhe sigurinë e infrastrukturës duke harmonizuar legjislacionin kombëtar me acquis të BE-së, duke koordinuar sistemin ndërinstitucional me bizneset dhe aktorët e tjerë, si dhe anëtarësimin në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare.

VI. Arsimi dhe shkathtësitë

Masa #16: Rritja e cilësisë së arsimit dhe aftësimin profesional bazuar në kërkesat e tregut të punës – kjo masë synon harmonizimin e programeve të arsimit dhe aftësimin profesional me kërkesat e tregut të punës nëpërmjet zhvillimit të standardeve të reja profesionit dhe rishikimit të kurrikulave ekzistuese, bazuar në dialogun me sektorin e biznesit.

Masa #17: Përmirësimi i cilësisë dhe rritjes së përfshirjes së fëmijëve në arsimin parauniversitar - kjo masë synon të përmirësojë cilësinë në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar dhe të rrisë pjesëmarrjen në këtë nivel me një fokus të veçantë në edukimin parashkollor. Masa adreson rekomandimin e politikave # 6.

Masa #18: Reforma në Arsimin e Lartë – synon të arrijë reformat në arsimin e lartë nëpërmjet kompletimit dhe zbatimit të infrastrukturës ligjore të arsimit të lartë, avancimin dhe zhvillimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë dhe rritjen e pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

VII. Tregu i punës dhe punësimi

Masa #19: Rritja e qasjes së të rinjve dhe grave në tregun e punës përmes ofrimit të shërbimeve cilësore të punësimit, masave aktive të punësimit dhe ndërmarrësisë –kjo masë synon të rrisë pjesëmarrjen dhe punësimin në veçanti të grave dhe të rinjve duke adresuar sfidat e shkathtësive të fuqisë punëtore dhe mospërputhjet ndërmjet nevojave të tregut dhe ofertës përmes forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve të shërbimeve publike të punësimit, zgjerimit të gamës së shërbimeve.

VII. Përfshirja sociale, ulja e varfërisë dhe mundësitë e barabarta

Masa #20: Përmirësimi i shërbimeve sociale dhe shëndetësore - synon krijimin e një sistemi të financimit të qëndrueshëm shëndetësor, me theks të veçantë në krijimin e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor dhe funksionimin e fondit të sigurimeve shëndetësore.

4.3 ANALIZA SIPAS FUSHËS DHE PRIORITETET E REFORMAVE STRUKTURORE

4.3.1 REFORMAT NË TREGUN E ENERGJISË DHE TRANSPORTIT

Analiza e pengesave kryesore

Gjendja aktuale: Me gjithë përmirësimin e ndjeshëm të të gjithë treguesve të performancës së sektorit të energjisë elektrike dhe asaj termike, nevojitet ende punë për sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me energji për bizneset, shërbimet dhe ekonomitë familjare. Është arritur përmirësim i ndjeshëm i furnizimit si në sasi ashtu edhe në cilësi me ngrohje për qytetarët e Prishtinës. Treguesit për matjen e kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjes në furnizimin me energji të treguar për konsumator kanë vlera prej 62.1 orë dhe 34.7 ndërprerje përkatësisht. Kërkesat për energji elektrike mbuloheh kryesisht nga prodhimi vendor dhe pjesërisht (10-14%) nga importet. Kërkesa totale e sistemit të energjisë elektrike

në vitin 2017 ishte 5686 GWh. Termocentralet kanë prodhuar 5300 GWh (96.8%) ndërsa BRE-ja ka prodhuar gjithsej 179.25GWh ose 3.2% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike. Kërkesat e naftës dhe mbulohen 100% nga importet. Kërkesat e ngrohjes mbulohen kryesisht nga biomasa (kryesisht dru zjarri) dhe masa e energjisë elektrike, ndërsa ngrohja qendrore mbulon 3-5% të kërkesave. Kosova nuk ka ndonjë infrastrukturë të gazit natyror. Prodhimi i energjisë elektrike kryhet nga dy termocentrale; Kosova A dhe Kosova B. Këto termocentrale kanë teknologji të vjetërsuara dhe joefikase që nuk janë miqësore me mjedisin dhe rrjedhimisht duke rezultuar me furnizim të paqëndrueshëm. Në këtë drejtim, nevoja për investime në kapacitetet e reja gjeneruese është e rëndësishme, në mënyrë që të adresojë edhe shqetësimet mjedisore - mbyllja e TC Kosova A dhe rehabilitimi i TC Kosova B. Energjia elektrike e prodhuar nga impiantet e BRE-ve aktualisht përbën rreth 3% të energjisë së prodhuar gjithsej. Sa i përket kapacitetit aktual, qymyri ka 57% të kapacitetit të përgjithshëm të energjisë, 28% vaj, 14% biomasa dhe pjesa tjetër janë hidro dhe diellore. Sa i përket kapaciteteve të reja të energjisë në vitin 2018 kapacitetet janë rritur për 64.85 MW, të gjitha këto nga energjia e Ripërtëritshmë.

Me gjithë ndërmarrjen e masave të shumta ligjore dhe rregulltave për liberalizimin e plotë të tregut, efektet e tyre vazhdojnë të jenë shumë të kufizuara për shkak se Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka kontroll në rrjedhat ndërkufitare të energjisë elektrike si pasojë e moszbatimit të Marrëveshjes për Energji nga ana e Serbisë.

Tek Efiçienca e energjisë megjithëse është identifikuar një potencial shumë i lartë i kursimit të energjisë, kryesisht në sektorin e banimit. Ligji për Efiçiençën e Energjisë është miratuar nga Qeveria. Ligji i miratuar përfshin gjithashtu krijimin e një fondi për të mbështetur investimet e efiçencës së energjisë. Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), më 30 tetor 2018, ka nxjerrë një vendim mbi tarifën e energjisë elektrike me pakicë që do të zbatohen nga Ofruesi i Shërbimeve Universale (FSHU - KESCO). Sipas këtij vendimi, tarifën e reja që do të aplikohen nga 1 nëntori 2018 për familjet shtëpiake do të mbeten të njëjta, ndërsa ato të konsumatorëve të ndriçimit industrial, komercial dhe publik do të bien për 5%. Kjo është pjesë e planit për të zvogëluar subvencionimin e tarifave të energjisë elektrike midis tarifave të grupit me theks të veçantë në eliminimin e subvencionimit të tarifave të energjisë elektrike të konsumatorëve komercialë dhe vendas, e cila pritet të eliminohet plotësisht gjatë vitit të ardhshëm subvencionimi midis tarifave të grupit.

Sa i përket transportit, pozita gjeografike e Kosovës nënvizon rëndësinë e zhvillimit të një rrjeti efikas rrugor, duke e integruar plotësisht me atë të vendeve fqinje dhe rajonin. Rrugët përfaqësojnë më shumë se 90% të infrastrukturës së transportit për nga gjatësia, dhe 98% ajo e ofrimit të shërbimeve. Kosova ka një “dendësi të lartë të transportit rrugor”, por kur matet si “gjatësi mesatare e rrugës për mijëra persona”, dendësia rrugëve është në mesatare duke pasur parasysh projektet që janë duke u zhvilluar në fushën e transportit dhe ato që do të zhvillohen deri në vitin 2019, besojmë se gjendja e transportit rrugor do të përmirësohet dukshëm dhe do të ketë ndikim në zhvillim ekonomik. Gjithashtu, autostrada që kalon nëpër Gjilan është aktualisht në ndërtim e sipër.

Në sektorin hekurudhor, SEETO ka përcaktuar korridoret kryesore hekurudhore për Evropën juglindore, ku pjesë e këtyre korridoreve është edhe Kosova me linjën 10 hekurudhore (Leshak-Hani i Elezit) e cila i përket rrjetit gjithëpërfshirës të SEETO-s dhe e lidhë Kosovën me Serbinë dhe Maqedoninë. Hekurudhat e Kosovës shtrihen në tërë territorin e Kosovës, me gjatësi prej 335 km linjë e hapur hekurudhore, me gjatësi prej 105 km në stacione dhe 103 km vija industriale, por kryesisht linjat hekurudhore duhet të modernizohen për të mundësuar shërbime më të mira të transportit. Legjislacioni për hekurudha është në linjë me legjislacionin e BE-së. dhe i cili mundëson hapjen e tregut hekurudhor për ofrimin e shërbimeve të transportit të udhëtarëve dhe mallrave.

Në sektorin e transportit ajror, Kosova nuk ka ligj të veçantë për transportim të mallrave, por ky transport realizohet së bashku me atë të udhëtarëve. Qeveria e Kosovës është duke hartuar politikat rreth aviacionit civil i cili di të jetë pjesë e rishikimit të Strategjisë për Transport Multimodal i cili do të realizohet gjatë vitit 2019.

Pengesat strukture: Pengesat kryesore në **sektorin e transporti** janë: (i) mirëmbajtje jo duhur e rrugëve ekzistuese; (ii) gjendje jo e mirë e linjave të hekurudhës; (iii) mungesa e mjeteve lëvizëse hekurudhore; (iv) mungesa e një hekurudhës funksionale në veri ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, për shkak të barrierave politike. Pengesat kryesore në **sektorin e energjisë** janë (i) termocentralet e vjetruara të energjisë (ii) Diversiteti i ulët i burimeve të energjisë (iii) Mungesa e përdorimit efikas të energjisë nga bizneset. Rritja e kërkesës për energji elektrike është për shkak të (i) përdorimit të energjisë elektrike për ngrohjen e hapësirës; (ii) 11% e sistemit të shpërndarjes së energjisë përdoret në mënyrë të paautorizuar; (iii) humbjet teknike në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike arrijnë në rreth 13%; (iv) përdorimi joefikas i energjisë, veçanërisht në sektorin e banimit

Ndikimi i pengesave strukture: Furnizimi i paqëndrueshëm me energji ndikon negativisht në konkurrueshmëri, rritë koston dhe ndikon negativisht tek bizneset. Qëndrueshmëria e furnizimit me energji elektrike, paraqet faktor të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjeve, qoftë për themelimin e bizneseve të reja apo investimin për zgjerimin e atyre ekzistuese. Çmimi i energjisë është faktor tjetër i rëndësishëm ndikues në konkurrueshmëri. Një tjetër pengese është edhe vazhdimi i obstrukcioneve nga Serbia në sektorin e energjisë. Në fushën e transportit lidhjet jo adekuate ndërkombëtare shtojnë kohën dhe koston e transportit dhe udhëtimit, në këtë mënyrë zvogëlojnë qarkullimin tregtar dhe mobilitetin e fuqisë punëtore me ndikim negativ në punësim. Lidhjet jo adekuate ndërkombëtare të hekurudhës ulin nivelin e transportit të udhëtareve dhe mallrave dhe kanë ndikimin negativë në zhvillimin e konkurrencës në transportin hekurudhor. Mungesa e rrjetit hekurudhor, që e ngarkon rrjetin e rrugor.

Masa e reformës #1: Ulja e konsumit të energjisë me anë të masave të efijencës së energjisë

Përshkrimi i masës: Si vazhdim i programit të mëparshëm, objektivat kryesore të kësaj mase janë: zbatimi i masave të EE në ndërtesat publike dhe private dhe amvisëri, arritja e objektivave të kursimit të energjisë prej 92ktoe ose 9% të konsumit përfundimtar të energjisë elektrike dhe rritjes së investimeve në projekte përmes fondit të EE. Kjo masë bazohet në Planin Kombëtar të Veprimtimit për Efijencë të Energjisë, SKZH dhe Strategjinë së Sektorit të Energjisë. Një studim që tregon se përqindja e objektivit është arritur do të publikohet në qershor të vitit 2019. Reduktimi i kostove të energjisë do të ndihmojë bizneset dhe do të nxisë investimet private.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2019: 1) Zbatimi i masave të efijencës së energjisë në rreth 50 ndërtesa publike dhe fillimi i zbatimit të masave të efijencës së energjisë në 30 ndërtesa tjera publike (MZHE); 2) Zbatimi i masave të efijencës së energjisë në amvisëri në kuadër të projektit “Reliable Energy Landscape” (REL) në 600 shtëpi, dhe 5 ndërtesa shumë-banesore dhe Instalimi i njehsorëve për matjen e konsumit të ngrohjes, si dhe valvuleve termostatike për rreth 3000 amvisëri në Prishtinë (Millennium Foundation Kosovo - MFK) 3) Dhënia e garantëve për masa të efijencës për bizneset e grave në kuadër të projektit “Reliable Energy Landscape” (MFK); 4) Ndërtimi i ngrohtores qendrore në Gjakovë me burim të energjisë me biomasë (MZHE); 5) Funksionalizimi i fondit të EE. 6) Zbatimi i planit të investimeve kapitale për forcimin, zgjerimin e rrjetit dhe projektet e tensionit të mesëm për të zvogëluar humbjet teknike dhe komerciale (KESCO).

b. Aktivitetet e planifikuara për 2020: 1) Zbatimi i masave të efijencës së energjisë në rreth 25 ndërtesa publike (MZHE/ AKEE); 2) Zbatimin e masave të efijencës së energjisë në amvisëri në kuadër të projektit “Reliable Energy Landscape” (REL) në 1200 shtëpi, dhe 10 ndërtesa shumë-banesore dhe instalimi i njehsorëve për matjen e konsumit të ngrohjes, si dhe valvuleve termostatike për rreth 4500 amvisëri në Prishtinë (MFK); 3) Dhënia e garantëve për masa të efijencës për bizneset e grave në kuadër të projektit “Reliable Energy Landscape” (MFK); 4) Krijimi i Bordit të Drejtorëve dhe miratimi i të dy paketave IR për fondin EE. 5) Zbatimi i planit të investimeve kapitale për forcimin, zgjerimin e rrjetit dhe projektet e tensionit të mesëm për të zvogëluar humbjet teknike dhe komerciale (KESCO)..

c. Aktivitetet e planifikuara për 2021: 1) Zbatimin e masave të efijencës së energjisë në amvisëri në kuadër të projektit “Reliable Energy Landscape” (REL) në 1200 shtëpi, dhe 10 ndërtesa shumë-

banesore dhe instalimi i njehsorëve për matjen e konsumit të ngrohjes, si dhe valvuleve termostatike për rreth 4'500 amvisëri në Prishtinë (MFK); 2) Dhënia e garantëve për masa të efijencës për bizneset e grave në kuadër të projektit “Reliable Energy Landscape” 3) Zbatimi i planit të investimeve kapitale për forcimin, zgjerimin e rrjetit dhe projektet e tensionit të mesëm për të reduktuar humbjet teknike dhe komerciale (KESCO).

Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri: Zbatimi i masave të EE do të kontribuojë si reduktimin e konsumit dhe koston e energjisë elektrike kontribuon pozitivisht në rritjen e punësimit dhe orientimin e energjisë elektrike drejt zhvillimit ekonomik. dhe do të nxisë investimet në sektorin privat. Po ashtu, rritja e sigurisë dhe efijencës së energjisë mund të ndikojë pozitivisht në rritjen investimeve, rrjedhimisht përmirësimit të konkurrueshmërisë së tregut. Kjo rritje e investimeve mund të rezultojë në rritje ekonomike. Së fundi, reduktimi i humbjeve teknike do të ndihmojë në uljen e koston totale të energjisë.

Indikatorët kyç të performancës:

- Intensiteti i energjisë së BPV-së, ka qenë 0.048 Toe në vitin 2016 ndërsa objektivi për vitin 2021 për këtë tregues është 0.043 Toe.
- Konsumi energjetik për punëtorë në vitin 2016 ka qenë 8.12 toe/punëtor ndërsa objektivi për vitin 2021 është 7.93 toe/punëtor.
- Humbjet e realizuara teknike dhe komerciale kanë pësuar rënie nga 24.5% në vitin 2016 në 24% në vitin 2017. Planifikimi për vitet në vijim ka për qëllim uljen e mëtejshme duke synuar uljen deri në 18.9% në vitin 2021

Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit: Kostoja totale për zbatimin e kësaj mase nga buxheti i Kosovës, kredi, fonde të IPS-së dhe grante pritet të jetë rreth 68,931,475.00 € për 2019-2021 kurse kostoja e investimeve private për këto 3 vite do të jete 98,646,000.00. Nga kjo shumë totale 6,900,000.00 € vijnë nga buxheti i Kosovës si vijon: 2,900,000.00 € për 2019, 2,000,000.00 € për vitin 2020 dhe 2,000,000.00 € për vitin 2021. Fonde të IPA-së janë 10,000,000.00 € për vitin 2020. Kredi për Projekte 11,550,000 € për vitin 2019, 9,950,000 € për vitin 2020 dhe 3,000,000 € për vitin 2021. Fonde nga MCC do të jenë: 7,227,151 € për vitin 2019, 10,238,182 € për vitin 2020 dhe 10,066,142 € për vitin 2021.

Ndikimi i pritur në punësim dhe çështje gjinore: Zbatimi i projekteve të EE krijon mundësi për hapje të vendeve të punës përmes ndërmarrjeve prodhuese dhe ndërtimore. Në bazë të indikatorëve të projektit të Bankës Botërore për vitin 2018 pritet që pas zbatimit të masave të EE në 32 ndërtesa, do të këtë 7494 përfitues si shfrytëzues të ndërtesave, ku minimum 33% e tyre janë gra. Për më tepër aktiviteti “Dhënia e granteve për masa të efijencës për bizneset e grave” do të kontribuon në punësimin e grave, rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, ulje të varfërisë dhe fuqizim të grave në përgjithësi.

Rreziqet potenciale: Vonesat në themelimin e mekanizmit financiar paraqet mangësi për nxitjen e investitorëve, zhvillimin dhe zbatimin e programeve/projekteve në fushë të EE-s, duke rezultuar në dështimin e arritjes së caqeve të planifikuara të kursimit. Zvarritja e transpozimit të direktivës së re të Bashkimit Evropian EED në ligj të EE dhe ligjet tjera të energjisë mund të ndikoj gjithashtu në investime. Gjithashtu tek masa të efijencës për bizneset e grave mund të jenë edhe mundësitë e kufizuara për pjesëmarrje dhe bashkëfinancim si dhe kapacitetet e pamjaftueshme organizative nga palët kyçe të interesit (amvisëritë, shoqatat e pronarëve të ndërtesave në bashkëpronësi, komunat, dhe sektori privat, etj.).

Masa e reformës #2: Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve prodhuese të energjisë

Përshkrimi i masës:

Objektivat kryesorë të kësaj mase janë: Zhvillimi i kapaciteteve të reja të gjenerimit të energjisë dhe përmirësimi i sigurisë së energjisë. Kjo masë është në përputhje me prioritetet strategjike të vendit të shprehura përmes NDS dhe strategjisë së energjisë. Sa i përket kapaciteteve të reja, janë instaluar gjashtë (6) hidrocentrale me kapacitet total prej 31.31 MW, kurse për sa i përket energjisë diellore, dy (2) gjeneratorë me panele fotovoltaike funksionojnë me një kapacitet total prej 0.6 MW . Në vitin

2018-2020, gjenerimi i përgjithshëm i fotovoltaiikës totale do të jetë 6.6MW, 3MW dhe 0.4 MW respektivisht. Në terma të burimeve të tjera të energjisë, era, një (1) turbinë me erë po operon me një kapacitet prej 1.35 MW dhe një (1) gjenerator tjetër nga 32.4 MW pritet të instalohet deri në fund të vitit. Në nëntor 2017, plani 5-vjeçar i investimeve kapitale iu dorëzua ZRRE-së për rishikim dhe miratim, në bazë të të cilit është hartuar lakorja teknike e komerciale për reduktimin e humbjeve.

Me qëllim të adresimit të problemit të sigurisë afatgjatë të furnizimit me energji, Strategjia e Energjisë 2017-2026 parashikoi një kapacitet prej 1436 MW në 2025, nga të cilat 450 MW janë nga burimet e rinovueshme. Me këtë kapacitet prodhues parashikohet të prodhojë rreth 7703 GWh energji elektrike në vit, nga të cilat 934 GWh ose 12.1% vijnë nga Burimet e Ripërtëritshme. Kjo do të mbulojë nevojat lokale të energjisë, ndërsa një pjesë do të eksportohet në tregun rajonal dhe më gjerë, kryesisht në sezonin veror.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2019: 1) Fillimi i ndërtimit të Termocentralit “Kosova e Re” (MZHE); 2) Zbatimi i katërbëdhjetë projekteve të reja nga hidrocentralet e vogla me kapacitet total të instaluar prej 61.8 MW, (MZHE); 3) Zbatimi i dy projekteve të reja nga energjia e erës me kapacitet total të instaluar prej 32.4 MW, (MZHE); 4) Zbatimi i dy projekteve të energjisë diellore me kapacitet total prej 3MW dhe 0.4MW gjithsej.

b. Aktivitetet e planifikuara për 2020: 1) Vazhdimi i ndërtimit fizik të Termocentralit “Kosova e Re” (MZHE); 2) Zbatimi i katërbëdhjetë projekteve të reja nga Hidrocentralet të vogla me kapacitet total të instaluar prej 37.86 MW, (MZHE); 3) Zbatimi i tri projekteve të reja nga energjia e erës me kapacitet total të instaluar prej 105 MW, (MZHE); 4) Hartimi i planit të Kosovës për energji dhe klimë (MZHE).

c. Aktivitetet e planifikuara për 2021: 1) Vazhdimi i ndërtimit fizik të Termocentralit “Kosova e Re (MZHE).

Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri: Furnizimi i pandërprerë, cilësor, i besueshëm dhe me kosto të përbalueshme me energji elektrike paraqet një nga kushtet kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm të bizneseve dhe rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve. Zbatimi i kësaj mase rrit sigurinë e furnizimit me energji elektrike si kusht për rritjen e konkurrueshmërisë.

Indikatorët kyç të performancës:

- Përqindja e energjisë së prodhuar nga BRE u vlerësua të jetë 18.8% në vitin 2016 ndërsa objektivi për vitin 2021 është 25%.
- Treguesi për nivelin e emetimeve të CO₂ ka qenë 6.68 ton në 2016, kurse për vitin 2021 objektivi është që ky indikator të zbritet në 6.00 ton.
- Kapaciteti i prodhimit nga BRE, në vitin 2016 ishte vlerësuar të jetë 27 GWh, ndërsa në vitin 2018 ky u rrit në 349 GWh. Objektivi për vitin 2021 parasheh një rritje të mëtejshme duke arritur në vitin 2021.

Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit: Kostoja totale për zbatimin e kësaj mase nga buxheti i Kosovës pritet të jetë rreth 6,000,000 € për 2019-2021. Nga kjo shumë 2,000,000 € për 2019, 2,000,000 € për vitin 2020 dhe 2,000,000.00 € për vitin 2021.

Ndikimi i pritur në punësim dhe çështje gjinore: Projekti TC Kosova e Re, vlerësohet se të ndikojë në çështjet sociale dhe në punësim përgjatë periudhës 5-vjeçare të ndërtimit (2018-2022). Projekti TCKR pritet të ndikojë në masën prej 200 milion euro në vit në rritjen e GDP-së (apo 3% vlerë e shtuar e GDP-së vetëm nga ky projekt). Po ashtu, zhvillimi i projekteve të centraleve nga BRE-të do të ketë efekte në rritjen e punësimit dhe rritjen e investimeve vjetore për 70 milion EUR.

Rreziqet potenciale: Investimet për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike parashihen që të bëhen nga investitorë privat. Përsëritja e ndonjë krize ekonomike mund të paraqet rrezik për investime në këto projekte dhe për pasojë do të zvogëlohet mundësia që investitorët privat t'i bëjnë investimet sipas planifikimeve. Një rrezik tjetër është marrja e investimeve private, pasi Banka Botërore u tërhoq nga propozimi origjinal.

4.3.2 ZHVILLIMET SEKTORIALE (BUJQËSIA, INDUSTRIJA DHE SHËRBIMET)

Analiza e pengesave kryesore:

Gjendja aktuale sektori i Bujqësisë: Pjesëmarrja e sektorit të bujqësisë në BPV ka shënuar rënie për mbetet e rëndësishme me 10.8% të BPV-së në vitin 2017. Nga regjistrimi i bujqësisë i vitit 2014 llogaritet se në bujqësi janë të punësuar 86,620 persona me orar të plotë, prej të cilëve rreth 50% janë anëtarë të familjes që angazhohen në fermë, rrjedhimisht në vitin 2017 kishte rritje për 4.2% ndryshe nga viti 2016. Qarkullim më të madh ka pasur në përpunimin e produkteve ushqimore me vlerë të qarkullimit 227.4 mil. €. Nga degët tjera të agro-industrisë, prodhimi i pijeve ka pasur qarkullim prej 95.7 mil. €, pasuar nga prodhimi bimor dhe shtazor, gjuetia dhe shërbimet e lidhura me to, që kishin qarkullim prej 48 mil. €. Me vlerë të përafërt të qarkullimit ishte edhe industria e drurit dhe produkteve të drurit me qarkullim vjetor prej 35.1 mil €. Gjatë viteve 2008-2016, pjesëmarrja më e ulët e eksportit (1-24) në eksportin e përgjithshëm (1-98) ka qenë në vitin 2011 me 8.2%, ndërsa pjesëmarrje më e lartë u arrit në vitin 2017 (16.2%). Në shkëmbimin tregtar të produkteve bujqësore, vërehet se në vazhdimësi kemi një trend të lehtë të rritjes së eksportit për vitet 2008-2017. Rritje më e madhe e vlerës së eksportit të produkteve bujqësore ka qenë në vitin 2017 (61.3 mil. €), që është rritje e eksportit për 35.5% më shumë se sa në vitin 2016. Vlen të ceket se vlera e eksportit në vendet e BE-së në vitin 2017, ishte mbi 18.3 mil. €, që në krahasim me vitin paraprak del të jetë 53.4% më e lartë. Si edhe në vendet tjera zhvillimit të agriondustrisë i është dhënë vëmendje e veçantë përmes Politikave Programore të zhvillimit, duke e konsideruar si një sektor të industrisë që gjeneron vende pune, ku një numër i madh njerëzish varen drejtpërdrejt ose në mënyrë indirekte për mirëqenien e tyre. Bazuar në të dhënat e ASK-së shohim se, duke filluar nga viti 2012 deri në vitin 2014 mesatarja e pjesëmarrjes së aktiviteteve bujqësore të regjistruara në regjistrin e biznesit ndaj aktiviteteve tjera ishte 7.6%. Filluar nga viti 2015, kemi një rritje prej 9.6%, pasuar me rritje të pjesëmarrjes në 10.4% në vitin 2016. Ndërsa në vitin 2017 kjo pjesëmarrje ishte 8.9%. Sa i përket rritjes së numrit të aktiviteteve në bujqësi rritje më e hovshme ka qenë në vitin 2015, me 945 aktivitete bujqësore apo 40.2% më shumë se sa në vitin 2014, duke vazhduar me rritje në vitin 2016 në 1,090 aktivitete, apo 15.3% më tepër se sa në vitin 2015. Ndërsa në vitin 2017 kishte 268 biznese më pak në krahasim me vitin 2016 apo rënie prej 24.6%. Bazuar në të dhënat që merren nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, agrobizneset kanë shënuar rritje nga viti në vit. Nga viti 2011-2016, mesatarisht për këto vite qarkullimi i përgjithshëm ka qenë 307 mil. €, duke vazhduar me rritje prej 19.9% në vitin 2017, krahasuar me mesataren e gjashtë viteve (2011-2016).

Pjesa e sektorit të industrisë në BPV është e krahasueshme me disa nga vendet e rajonit. Madhësia relative e aktiviteteve ekonomike matet nga të dhënat e BPV-së, ku për vitin 2017 rritja reale e BPV-së në Kosovë krahasuar me vitin 2016 ishte 4.23%. Përveç aktiviteteve të tjera ekonomike në BPV, në këtë rritje reale sektori i ndërtimit përbën 8.6%, industria nxjerrëse 3.1% dhe industria përpunuese 3.0%. Sektori privat ende ka një nivel të ulët zhvillimi dhe vazhdon të karakterizohet nga mungesa e njohurive dhe inovacionit, njohja e pamjaftueshme e raportimit financiar, mungesa e cilësisë së produktit, qasja në informata, rrjetëzimi i duhur, pasuar nga kapaciteti i ulët sa i përket sasisë së prodhimit dhe punës në gjendje të përballojnë kërkesën relativisht të madhe. Këto dobësi rezultojnë me të ardhura të ulëta dhe rezultojnë që produktet e Kosovës nuk janë konkurruese në tregjet ndërkombëtare.

Sa i përket sektorit të shërbimeve, është e rëndësishme të theksohet se aktivitetet e shërbimeve janë shtylla kryesore e sektorit privat në Kosovës. Aktivitetet e shërbimeve krijojnë 87.3 përqind të qarkullimit total të ndërmarrjeve në ekonomi dhe përfaqësojnë 88.8 përqind të shpenzimeve totale. Tregtia në shërbime për periudhën janar-shtator 2018 arriti në 1652 milion euro. Nga kjo shumë, eksporti total arriti në 1178.2 milionë euro, ndërsa importi arriti në 473.8 milionë euro. Kjo tregon një bilanc pozitiv tregtar prej 704.4 milionë eurosh. Nëse e krahasojmë atë me periudhën janar-shtator 2017, shohim se eksporti i shërbimeve ishte 1129.1 milion euro, ndërsa importet rezultuan 410.3 dhe 718.8 milion euro në tregtinë ndërkombëtare të shërbimeve.

Sektorët kryesorë që kontribuan në bilancin pozitiv tregtar për periudhën janar-shtator 2018 janë: Udhëtimi (turizmi) me një bilanc prej 769.7 milionë eurosh, pasuar nga shërbimet qeveritare me 14.8 milionë euro, shërbimet e ndërtimit me 11.2 milionë euro. Shërbimet e udhëtimit dhe turizmit kryesisht i atribuohen diasporës së Kosovës dhe shtetasve të huaj që punojnë në Kosovë. Vlerësohet se rritja e aktivitetit të biznesit turistik gjatë dy viteve të fundit ishte rreth 25%, ndërsa pritjet e rritjes në vitet e ardhshme janë edhe më të larta se 40%. Kjo reflektohet edhe në punësimin në sektorin e "strehimit dhe shërbimit të ushqimit", i cili është rritur me 13.4% nga viti 2014 në 2016.

Kosova është në një nivel të moderuar të zhvillimit të turizmit si sektor, një nga më të mëdhatë në industrinë e krijimit të vendeve të punës në krahasim me sektorët e tjerë. Numri më i madh i turistëve në Kosovë është gjatë verës. Vizitorët ndërkombëtarë janë rritur në numër gjatë gjithë vitit me rritjen më të madhe nga 2015 në 2017, dhe qëndrimet e natës janë rritur pothuajse gjatë gjithë vitit, rreth 13% nga viti në vit. Nga 24,616 vizitorë në 2008 në 86,032 vizitorë në vitin 2017.

Pengesat strukturore: Pengesat strukturore kryesore që pengojnë zhvillimin e sektorit të bujqësisë mbeten pothuajse të pa ndryshuara dhe ato ndërlidhen me madhësinë mesatare të vogël të fermës, fragmentimi i tokës, infrastruktura e ujitjes, kapacitetet e deponimit, mosfunksionimi dhe jo efikasiteti i tregut të tokës, lidhjet e dobëta apo jofunksionale në mes të prodhuesit primar dhe përpunuesve dhe ndërmjet prodhuesve dhe tregut dhe mungesës së specializimit. Sa i përket sigurisë së ushqimit dhe përputhshmërisë me standardet e cilësisë, niveli i zbatimit të standardeve si ato vendore po ashtu edhe ato të BE-së ende mbetet i ulët.

Pengesat në zhvillimin e përgjithshëm të sektorit të industrisë, kanë të bëjnë me nivelin e ulët të IHD-ve dhe me sfidat që lidhen me shfaqjen e grupimeve industriale. Në veçanti përfshihen bashkëpunimi i dobët ndërmjet kompanive dhe institucioneve arsimore dhe hulumtuese dhe mungesës së inovacionit. Si rezultat e këtyre pengesave dhe strukturës së ndërmarrjeve, prodhimi industrial dominohet me prodhim të vlerës së ulët, mungesë të inovacionit, dhe mungesë të konkurrueshmërisë në tregjet e jashtme dhe vendore.

Përkundër zhvillimeve pozitive të viteve të fundit, produktet dhe shërbimet turistike në dispozicion mbeten ende të kufizuara. Pengesat kryesore në këtë sektor mbetet mungesa e kornizës ligjore adekuate dhe koordinimi i duhur institucional, me informata pakta në lidhje me vendet turistike, bukuritë si dhe për produktet dhe shërbimet në dispozicion. Mungon zhvillimi i produkteve turistike potenciale në komunitet dhe 'tour' operatorët në zonat rurale dhe malore të cilat mund të ofrohen për shitje. Si rezultat, niveli aktual i zhvillimit të sektorit të turizmit mbetet larg prej potencialit të tij me mundësi të të ardhurave dhe punësimit që mbeten të pashfrytëzuara.

Masa e reformës#3: Ndryshimet strukturore në Sektorin Agropërpunues

Përshkrimi i masës: Zhvillimi i sektorit agro-rural vazhdon të mbetet njëri ndër prioritetet kyçe dhe planifikohet të ketë trajtim të veçantë edhe në periudhën e ardhshme afatmesme 2019-2021, Në këtë drejtim, masat do të përqëndrohen në rëndësinë së ofertës financiare për masat e zhvillimit rural përmes të cilave do të synohet që të mbështet rritja e prodhimtarisë, zvogëlimi i importit të produkteve bujqësore dhe njëherazi rritjes së punësimit. Masat në kuadër të këtij sektori do të kenë për synim mbështetjen e projekteve investive në infrastrukturë rurale dhe ristrukturimin e potencialit fizik të fermës, si dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë për prodhimtarinë bujqësore.

Aktivitetet e planifikuara për 2019: 1) Hartimi i Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2021-2027; 2) Hartimi i master plani për ujitje e tokave bujqësore në nivel vendi, i miratuar. 3) Përmirësimi e infrastrukturës së ujitjes, 1200 ha e sipërfaqeve bujqësore nën ujitje. 4) Ofrimi i shërbimeve për edukimin dhe trajnimin e 4000 fermerëve; 5) Zbatimi i programit për pagesa direkte për rritjen e sipërfaqeve në sektorin e drithërave, sektorinë e hortikulturës dhe atë të blegtorisë duke mbështetur 29.200 fermer, 60.000 ha tokë, 16.500 krerë lopë dhe 11.000 koshere; 6) Zbatimi i programit për investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore dhe investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore duke mbështetur me 557 projekte; 7) Investimet në ngritjen e depove me kapacitete të mëdha të ruajtjes, selektimit dhe paketimit të pemëve dhe perimeve në regjionin e

Mitrovicës; 8) Investimet në ngritjen e fabrikës për përpunimin e mbetjeve organike në regjionin e Gjilanit, Investimet e ngritjen e një fabrike për përpunim të bojlerëve në regjionin e Pejës.

Aktivitetet e planifikuara për 2020: 1) Miratimi i Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2021-2027; 2) Zbatimi i programit për pagesa direkte për rritjen e sipërfaqeve në sektorin e drithërave, sektorin e hortikulturës dhe atë të blegtorisë duke mbështetur 30.000 fermer, 65.000 ha tokë, 17.000 krerë lopë dhe 14.000 koshere; 3) Zbatimi i programit për investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore dhe investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore duke mbështetur me 650 projekte; 4) Investimet në ngritja e depos me kapacitete të mëdha të ruajtjes, selektimit dhe paketimit të pemëve dhe perimeve në regjionin e Mitrovicës; 5) Investimet në ngritjen e fabrikës për përpunimin e mbetjeve organike në regjionin e Gjilanit, Investimet e ngritjen e një fabrike për përpunim të bojlerëve në regjionin e Pejës.

Aktivitetet e planifikuara për 2021: Aktivitete kryesore në kuadër të kësaj do të jenë të ndërlidhura me zbatimin e masave që dalin nga PZHRB 2021-2027 dhe që kanë për qëllim arritjen e objektivave të këtij programi. Masat të cilat do të zbatohen gjatë kësaj periudhe planifikuese do të jenë në harmoni me programin e ri 2021 – 2027 ku do të ketë edhe ndryshime varësisht prej politikave e do të jenë në PPB:

Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri: Zbatimin e kësaj masave synon të përmirësojë standardeve të cilësisë së prodhimit të pemëve dhe perimeve, si dhe përmirësimi i infrastrukturës dhe pajisjeve në fermë, me qëllim të arritjes së qëndrueshmërisë dhe konkurrueshmërisë për të gjithë sektorin e mbështetur si pemëve dhe perimeve dhe produkteve të tyre në treg të brendshëm dhe të jashtëm. Gjithashtu masa synon përmirësimin e standardeve të higjienës dhe ushqimit në industrinë e përpunimit të qumështit, mishit, në logjistikën dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve.

Indikatorët kyç të performancës:

- Përqindja e ekstra vlera së shtuar/në vit ishte 30.90% në vitin 2016, 38.29% në vitin 2018 dhe objektivi është që të jetë 52.43% në vitin 2021.
- Treguesi për numrin e vendeve të reja të punës ishte 1,047 në 2016, në vitin 2018 rrit në 1,579 dhe objektivi është që të arrihet vlera 2,400 në vitin 2021.

Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit: Zbatimi i këtyre aktiviteteve do të jetë në formën e partneritetit publiko privat, grante me bashkëfinancim 60/40%, dhe për disa masa në 65/35%, në favor të sektorit privat. Kostoja totale për zbatimin e kësaj mase pritet të jetë rreth 154,765,562 €, nga buxheti i Kosovës pritet të jetë rreth 145,915,559 € për 2019-2021. Nga kjo shumë 44.772.690 € për 2019; 49,526,669 € për vitin 2020 dhe 51,616,199 € për vitin 2021 kurse kostoja nga kredi prej BB pritet të jetë 8,850,003 € për 3 vite, nga kjo shumë 2,950,000 € për vitin 2019; 2,950,001 € për vitin 2020 dhe 2,950,002 € për vitin 2021.

Ndikimi i pritshëm në politika sociale: Zbatimi i kësaj mase do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në punësim, duke përfshirë edhe punësimin e grave - siç tregohet në treguesin e mësipërm.

Rreziqet e mundshme: Sfida e vetëm në këtë masë do të jetë rritja e transparencës, mungesa e kapaciteteve logjistike për kontroll në teren si dhe vështirësi në përshtatjen adekuate të programit karshi nevojave të sektorit.

Masa e reformës #4: Konsolidimi dhe inventarizimi i tokës bujqësore

Përshkrimi i masës: Konsolidimi dhe inventarizimi i tokës bujqësore është një ndër mjetet kryesore për ristrukturimin e tokës bujqësore i cili do të ketë ndikim në: zgjidhjen e çështjeve pronësore juridike të pjesëmarrëseve në konsolidimin e pa përfunduar dhe regjistrimit të pronave të pronareve në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme (RDPP) në Zyre Kadastrale komunale. Përcaktimi i kualitetit dhe klasave të tokës, rritja e madhësisë së fermës, me qëllim që fermeri të jete konkurrues në treg, me përfundimin dhe regjistrimin e pronareve në RDPP do të mundësohet krijimi dhe zhvillimi i tregut të tokës si parakusht shumë i rëndësishëm në ekonominë e tregut të lirë.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2019: 1) Hartimi i Koncept Dokumentit mbi Inventarizimin e Tokave Bujqësore në Kosovë; 2) Hartimi i Koncept Dokumentit për rregullimin e Tokës Bujqësore në

Kosovë; 3) Konsolidimin vullnetar i 25 ha tokë bujqësore në Komunën e Rahovecit; 4) Rregullimi i mëtejshëm i tokës bujqësore dhe mbrojtja nga ndërrimi i destinimit të pa planifikuar të tokës bujqësore duke mbështetur komunat në përgatitjen e hartave zonale komunale në Pejë, Drenas, Podujevë, Gjiilan dhe Lipjan; 5) Zhvillimi i sistemit të integruar nacional GIS – Baza e të dhënave

b. Aktivitetet e planifikuara për 2020: 1) Konsolidimin vullnetar i 25 ha tokë bujqësore në Komunën e Rahovecit; 2) Rregullimi i mëtejshëm i tokës bujqësore dhe mbrojtja nga ndërrimi i destinimit të pa planifikuar të tokës bujqësore duke mbështetur komunat në përgatitjen e hartave zonale komunale në 5 komuna tjera të Kosovës; 3) Zhvillimi i aplikacionit GIS Web; 4) Raporti mbi klasifikimin e tokave bujqësore sipas sistemit World Reference Base for Soil Resources (WRB), Pjellorisë së tokës, metaleve të rënda, cilësisë së ujit, përcaktimin e zonave me rreziqe natyrore.

c. Aktivitetet e planifikuara për 2021: 1) Konsolidimin vullnetar i 25 ha tokë bujqësore në Komunën e Rahovecit; 2) Rregullimi i mëtejshëm i tokës bujqësore dhe mbrojtja nga ndërrimi i destinimit të pa planifikuar të tokës bujqësore duke mbështetur komunat në përgatitjen e hartave zonale komunale në 5 komuna tjera të Kosovës; 3) Raporti mbi klasifikimin e tokave bujqësore sipas sistemit World Reference Base for Soil Resources (WRB), Pjellorisë së tokës, metaleve të rënda, cilësisë së ujit, përcaktimin e zonave me rreziqe natyrore.

Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri: Projektet i inventarizimit dhe komasacionit vullnetar do të ndikonin në rritjen e madhësisë së fermës, qasjen në pronësi, zgjidhjen e çështjes pronësore etj. Projektet e konsolidimit do të kontribuonin në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave bujqësore dhe rurale. Realizmi i projektit të konsolidimit të pa përfunduar do të ndihmonte në realizimin e projektit të Sistemit të identifikimit të parcelave LPIS, shpërndarjen e drejt të subvencioneve nga buxheti i shtetit për pronaret dhe shfrytëzuesit e këtyre pronave, kontroll me të mire të këtyre pronave tokësore dhe monitorim me të mire të këtyre subvencioneve.

Indikatorët kyç të performancës:

a. Gjithsej 5277 ha tokë bujqësore ishin të konsoliduar në vitin 2015, ndërsa në vitin 2021 planifikohen që të jenë në total 5302 ha tillë. Në vitin 2015, 8616 ha janë regjistruar në regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme, ndërsa objektivi për vitin 2021 është që kjo të arrijë në 8641 ha.

Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe ndikimi buxhetor: Kostoja totale për zbatimin e kësaj mase pritet të jetë rreth 3,802,668 € për 2019-2021. Nga kjo shumë 1,402,668 € për 2019; 1,200,000 € për vitin 2020 dhe 1,200,000 € për vitin 2021. Prej buxhetit të Kosovës do të jenë 702,668 € për vitin 2019 dhe nga 500,000 € për vitet 2020, 2021 kurse nga GIZ do të jenë nga 700,000 € për 2019, 2020 dhe 2021.

Ndikimi i pritur në punësim dhe çështje gjinore: Do të ketë ndikim pozitiv në punësim dhe në gjininë, pasi do të rrisë kapacitetet e fermave dhe për këtë arsye potencial më të madh për investime.

Rreziqet potenciale: Mungesa e bashkëpunimit dhe mungesa e shprehjes së vullnetit nga qytetarët për konsolidim vullnetar të tokës. Supozimi kryesor mbi të cilin qëndron konsolidimi vullnetar i tokës është mundësia e Ministrisë për të ofruar asistencë teknike falas dhe përkrahje në lidhje me koston e transaksionit si një stimulim i fuqishëm ndaj të cilit fermerët mund të reagojnë.

Masa e reformës #5: Rritja e konkurrueshmërisë në industrinë prodhuese

Përshkrimi i masës: Si vazhdimësi e PRE 2018-2020, kjo masë synon përmirësimin e konkurrueshmërisë në sektorët e industrisë prodhuese në Kosovë duke vendosur një theks të veçantë tek mekanizmat që: përmirësojnë bashkëpunimin në mes NVM-ve, e rrisin rrjetëzimin me kompani të tjera rajonale dhe të BE-se, përmirësojnë dialogun mes sektorit publik dhe privat, rrisin kualitetin e prodhimit në sektorët industrial prodhues me qëllim të rritjes së eksporteve si dhe zëvendësimin e importeve. Në Kosovë ende vazhdon të jetë i lartë deficitin tregtar për shkak të cilësisë së ulët të prodhimit industrial. Sektorët me potencial më të madh industrial që do të përkrahen përmes kësaj mase janë: përpunimi i metaleve, letrës, tekstili, dhe përpunimi i lëkurës, përpunimi i drurit, sektori i industrisë kimike, plastikës dhe gomës. Kjo masë është e ndërlidhur me dokumentet kryesore

strategjike, përkatësisht: Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016- 2021, Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së dhe Programi i Qeverisë 2017-2021.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2019: 1) Analiza e të dhënave për zhvillimin e Sektorëve Industrial; 2) Studimi i zingjirit të vlerës për njërin nga sektorët me potencial më të madh të zhvillimit industrial; 3) Organizimi i së paku 10 Panaireve Ndërkombëtare ku do të dërgohen 70 kompani prodhuese nga Kosova, me potencial eksportues; 4) Përkrahja për 15 NVM në subvencionim në certifikimin e produktit dhe në ofrimin e këshillimeve me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë dhe rritjes së eksportit; 5) Ndërtimi i infrastrukturës fizike të tri zonave ekonomike, respektivisht të parqeve të biznesit (Suharekë, Viti dhe Vushtri); 6) Organizimi i 4 forume për investime, të cilat kanë për qëllim mbështetjen dhe rritjen e investimeve dhe eksportit.

b. Aktivitetet e planifikuara për 2020: 1) Plotësim –ndryshimi i ligjit për zona ekonomike; 2) Analiza e të dhënave për zhvillimin e Sektorëve Industrial; 3) Studimi i zingjirit të vlerës për njërin nga sektorët me potencial më të madh të zhvillimit industrial dhe krijimi i data-bazës për sektorin e përzgjedhur; 4) Organizimi i së paku 10 Panaireve ndërkombëtare ku do të dërgohen 70 kompani prodhuese nga Kosova, me potencial eksportues; 5) Përkrahja e 15 NVM-ve për subvencionim në certifikimin e produktit dhe në ofrimin e këshillimeve me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë dhe rritjes së eksportit; 6) Ndërtimi i infrastrukturës fizike të tri zonave ekonomike, respektivisht të parqeve të biznesit (Suharekë, Viti dhe Vushtri); 7) Organizimi i 4 forume për investime, të cilat kanë për qëllim mbështetjen dhe rritjen e investimeve dhe eksportit.

c. Aktivitetet e planifikuara për 2021: 1) Analizimi i raportit vjetor për zhvillimi e politikave në Sektorët Industrial; 2) Studimi i zingjirit të vlerës për njërin nga sektorët me potencial më të madh industrial dhe krijimi i data-bazës për sektorin e përzgjedhur; 3) Organizimi i së paku 10 Panaireve Ndërkombëtare ku do të dërgohen 70 kompani prodhuese nga Kosova, me potencial eksportues; 4) Përkrahje e 15 NVM-ve për subvencionim në certifikimin e produktit dhe në ofrimin e këshillimeve me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë dhe rritjes së eksportit; 5) Organizimi i 4 forume për investime, të cilat kanë për qëllim mbështetjen dhe rritjen e investimeve dhe eksportit.

Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri: Zbatimi i kësaj mase do të ketë ndikim në përmirësimin e prodhimit të sektorëve industrial dhe përmirëson dialogun në mes sektorit publik dhe privat. Kjo masë rrit cilësinë e prodhimit në sektorët industrial prodhues, me qëllim edhe rritjen e eksporteve si dhe zëvendësimin e importeve. Zhvillimi i politikave në sektorët industrial do të kenë ndikim në krijimin e mundësive të reja dhe identifikimin e fushave për përmirësimin e mjedisit të biznesit si dhe rritëzimin e ndërmarrjeve në sektorët me potencial zhvillimi, përmes zingjirit të vlerës.

Indikatorë kyç të performancës

- a) Pjesëmarrja e industrisë përpunuese në eksportin e përgjithshëm ishte 55.23% në vitin 2016 ndërsa objektivi për vitin 2021 është që kjo të rritet në 62%.
- b) Pjesëmarrja e industrisë përpunuese në BPV ishte 10.49% në vitin 2016 kurse objektivi për vitin 2021 është që kjo pjesëmarrje të rritet në 12%.
- c) Trendi i eksporteve në industrinë përpunuese ishte negativ për 6.70% në 2016 dhe 18.45% në vitin 2017. Për vitin 2021, objektivi është që të ketë një rritje prej 2% krahasim me vitin 2017.

Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit: Kostoja totale e vlerësuar për zbatimin e masës pritet të jetë rreth 13,700,000 € për vitet 2019-2021, prej të cilave 13,400,000 € janë ndarë nga buxheti i Kosovës dhe 300,000 € nga donatorët. Nga shuma e përgjithshme për 2019, 5,300,000 € janë nga BRK dhe 100,000 € nga donatorët; për vitin 2020, 3,900,000 € janë nga BRK dhe 100,000 € nga donatorët; për 2021, € 4,200,000 janë nga BRK dhe 100,000 € nga donatorët.

Ndikimi i pritur në punësim dhe çështje gjinore: Si rezultat i zbatimit të kësaj mase pritet që të krijohen mundësi punësimi për rreth 450 persona në vit. Ofrimi i këshillimeve me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë dhe rritjes së eksportit si dhe krijimi i start-up bizneseve në kuadër të kësaj mase do të ndikojë që një numër i konsiderueshëm i përfituesve t'i takojë gjinisë femërore.

Rreziqet e mundshme: Disa nga rreziqet kryesore për zbatimin e kësaj mase janë: mungesa e kapitalit financiar të bizneseve për të rritë potencialin për zhvillim dhe integrim, mungesa e gatishmërisë të të

gjithë akterëve relevant për të vepruar në të njëjtën kohë me qëllim të rritjes së kualitetit të produkteve të tyre për eksport. Mungesa e financave do të mund të përmirësohet përmes Fondi Kosovare për Garanci Kreditore (FKGK), duke ofruar kështu qasje më të lehtë në financa për kompanitë kosovare, që do të kontribuojë në krijimin e vendeve të punës, rritjen ekonomike, si dhe në rritjen e mundësive për sektorë ekonomikë e kategori që janë shërbyer më pak, si gratë, pakicat, bujqit, ndërmarrësit dhe rinia.

Masa e reformës#6: Ngritja e Konkurrueshmërisë në Sektorin e Turizmit dhe Hotelerisë

Përshkrimi i masës: Qëllimi i kësaj mase është nxitja e zhvillimit e konkurrueshmërisë në sektorin e turizmit me qëllim të rritjes së vlerës ekonomike të turizmit, rritjen e punësimit si dhe përmirësimin e kualitetit të shërbimeve. Masa synon rritjen e ofertës turistike nëpërmjet promovimit të produkteve turistike, nxitjes së zhvillimit të produkteve me qëllim të depërtimit në tregun turistik, bashkëpunimit mes aktorëve relevant, përdorimit të standardeve turistike dhe hoteliere, njëkohësisht duke përmirësuar infrastrukturën ligjore sipas praktikave evropiane. Masa është vazhdimësi nga PRE e vitit 2018. Kjo masë ndërlidhet drejtpërdrejtë me Draft Strategjinë e Sektorit Privat 2019-2022 dhe indirekt ndërlidhet me SKZH 2017-2021, Programin Qeveritar të Republikës së Kosovës 2017-2020, si dhe masa që lidhet me subvencione për zhvillimin e turizmit rural përmes Programit për bujqësi dhe zhvillim rural në MBPZHR, si dhe në aspektin e promovimit të trashëgimisë kulturore, ndërlidhet me Strategjinë Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore

a. Aktivitetet e planifikuara për 2019: 1) Hartimi i Strategjisë për turizmin; (MTI); 2) Hartimi i Ligjit të turizmit (MTI); 3) Hartimi i akteve nënligjore që dalin nga ligji i turizmit (Udhëzimi Administrativ për Klasifikim dhe Kategorizim të Objekteve akomoduese, Udhëzimi Administrativ për licencimin e Agjencive Turistike dhe Udhëzimi Administrativ për Guidat Turistike) MTI; 4) Investime në zhvillimin e turizmit rural dhe turizmit bujqësor 25-30 fermat në projektin tradicional të turizmit rural dhe fermave (MBPZHR); 5) Zhvillimi dhe funksionalizimi i Webportalit për turizëm të Republikës së Kosovës (MTI);

b. Aktivitetet e planifikuara për 2020: 1) Hartimi i akteve tjera nënligjore që dalin nga ligji i turizmit (Udhëzimi Administrativ për caktimin e kriterëve për zonat turistike, Udhëzimi Administrativ për taksën e akomodimit); 2) Certifikimi i Guida Turistike (MTI); 3) Vlerësimin e potencialeve dhe qasjeve grupore (Kllasterave) për zhvillimin e turizmit në regjione dhe zona të ndryshme në Kosovë; (MTI); 4) Investime në zhvillimin e turizmit rural dhe turizmit bujqësor 25-30 fermat në projektin tradicional të turizmit rural dhe fermave, (MBPZHR).

c) Aktivitetet e planifikuara për 2021: 1) Zhvillimi i produkteve turistike në zonat e trashëgimisë kulturore (Lipjan, Graçanica, Prizreni); 2) Digjitalizimi i destinacioneve turistike, dhe përfshirja në Web portalin e turizmit; 3) Investime në zhvillimin e turizmit rural dhe turizmit bujqësor 25-30 fermat në projektin tradicional të turizmit rural dhe fermave, (MBPZHR).

Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri: Rritja e cilësisë së shërbimeve të harmonizuara me standardet e BE-se dhe të ofertës turistike ndikon direkt në rritjen e konsumit të shërbimeve turistike dhe pjesëmarrje në zinxhirët e vlerave turistike duke ju ofruar një mundësi për të shtuar më shumë vlerë në industritë turistike lokale dhe si rezultat nxit punësimin dhe rritjen e mirëqenies. Kjo masë do të ndikon në uljen e informalitetit në sektorin e turizmit, promovimin e vlerave konkurruese në rajon dhe vendeve të BE-së.

Indikatorë kyç të performancës:

- Numri i të punësuarve në sektorin e turizmit ishte 21.3 mijë në vitin 2016 dhe është rritur në 25 mijë në 2018. Parashihet që në vitin 2021 rreth 32,025 individ të punësohen në këtë sektor.
- Numri total i bujtjeve në vitin 2016 ishte 193,996 ndërsa në vitin 2018 kjo u rrit në 200 mijë. Objektivi për vitin 2021 është që ky numër të jetë 290 mijë.
- Numri i ardhjeve ndërkombëtare në vitin 2016 ishte 83,710, në vitin 2018 u rrit në 92 mijë dhe objektivi për vitin 2021 është që të rritet deri në 120,440.

Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit: Kostoja totale e vlerësuar për zbatimin e kësaj mase për vitin 2019-2021 pritet të jetë rreth 1.763.000 €, 582.000 € për vitin 2019, 593.000 € për vitin 2020 dhe 588.000 € për vitin 2021.

Ndikimi i pritshëm në punësim dhe çështjet gjinore: Zhvillimi i turizmit do të zgjerohet në zonat rurale dhe malore ku synohet rritja e punësimit në këto zona, rritja e bizneseve familjare ku femrat do të kenë mundësi të lehta të punësimit, sidomos në fushën e kulinarisë dhe arti zanateve. Deri në fund të vitit 2021 numri i të punësuarve në fushën e turizmit pritet të rritet rreth 35 %. Ndërsa, pjesëmarrja e të punësuarve femra në fushën e turizmit synohet që deri në vitin 2021, nga 3,800 sa janë të punësuar në 2017, të rritet rreth 20%.

6. Rreziqet e mundshme

Mungesa e pamjaftueshme e kapaciteteve njerëzore institucionale në fushën e turizmit mund të jetë rrezik në zbatimin e plotë të kësaj mase. Duke qenë se shumë aktivitete ndërlidhen me komunitatet dhe institucionet tjera ndërlidhëse, kjo mund të jetë rrezik nëse nuk ka bashkëpunim të mjaftueshëm. Përmes Këshillit për turizëm do të adresohen sfidat e dala nga akterët e përfshirë në këtë fushë, si dhe do të koordinojë aktivitetet me donatorët potencial dhe qeverinë për ofrimin e trajnimeve profesionale në fushën e turizmit.

4.3.3. MJEDISI BIZNESOR DHE ULJA E EKONOMISË JO-FORMALE

Analiza e pengesave kryesore

Gjendja aktuale: Sipas raportit të Bankës Botërore “Të bërit biznes”, Kosova nuk është më ndër 10 ekonomitë në mbarë botën me përmirësimet më të dukshme në reformat e të bërit biznes. Këtë vit Kosova rangohet në vendin e 44 nga 190 vende për lehtësirat e të bërit biznes, e 13-ta për fillimin e biznesit, e 12-ta për kredi marrje, 51-ta për tregti ndërmjet kufijve, 100-ta për leje të ndërtimit, 95-ta për mbrojtjen e investitorëve të vegjël, 113-ta për qasje në energji elektrike, 50-ta për fuqizimin e kontratave, 44-ta për pagesën e taksave, 37-ta për regjistrimin e pronës dhe 50-ta për zgjidhjen falimentimit.

Sipas këtij raporti, Kosova ka forcuar regjimin e të drejtave pronësore, duke e bërë më të lehtë marrjen e lejeve të ndërtimit duke thjeshtuar sistemin e inspektimit përmes inxhinierit të brendshëm. Kosova gjithashtu po merr masa për të adresuar informalitetin në shkallë të gjerë në sektorin e pronës së paluajtshme si pengesë për sigurimin e një tregu dinamik të tokës. Kosova, në veçanti, po merr masa për të siguruar qasje në procese administrative efikase dhe të përballueshme për të siguruar njohjen ligjore të të drejtave që aktualisht ushtrohen de facto. Raporti thotë se Kosova ka lehtësuar pagesën e tatimeve duke i lejuar tatimpaguesit të kërkojnë kthimin e tatimit mbi vlerën e shtuar nëpërmjet një forme standarde të kthimit. Ndërsa, duhet të theksohet se krahas progresit në indikatorët e theksuar më lartë, Kosova ka shënuar regres në disa indikatorë të tjerë të rëndësishëm si: fillimin e biznesit, mbrojtjen e investitorëve të vegjël, qasje në energji elektrike, fuqizimin e kontratave, regjistrimin e pronës dhe për zgjidhjen e falimentimit. Në aspektin ekonomik, përpjekjet jo të mjaftueshme për zhvillimin dhe promovimin e mëtejshëm të aktiviteteve në sektorin privat në Kosovë vazhdojnë të krijojnë nevojën për një partneritet më të madh në mes të sektorit publik dhe privat, kjo do të thotë se procesi i përgatitjes së politikave dhe legjislacionit nuk ka mbështetjen e mjaftueshme në analizat e hollësishme lidhur me kostot dhe përfitimet e mundshme ekonomike dhe sjellë si pasojë mos evidentimin e nevojës për të vlerësuar ndikimet e mundshme gjatë procesit të vendimmarrjes.

Do të thotë se këto ndikime nuk janë analizuar në mënyrë sistematike në kornizën aktuale për përgatitjen e vendimeve të qeverisë. Edhe pse kjo është në kundërshtim me rregullat e përcaktuara për ndikimet mjedisore të projekteve të infrastrukturës për të cilat Kosova ka krijuar një kornizë rregullative.

Nga një aspekt tjetër, informaliteti dhe mungesa e transparencës financiare lidhur me fitimet individuale dhe të ardhurat e biznesit, si dhe cilësia e ulët e raportimit financiar (posaçërisht sa i përket segmentit të NVMM-ve) ka rezultuar me një nivel të lartë të kreditimit të kolateralizuar, në vend të analizës së qarkullimit të parasë së gatshme nga bankat. Disa studime dhe vlerësime në fushën e

ekonomisë informale dhe boshllëqet tatimore kanë treguar se shtrirja e ekonomisë informale në Kosovë është mbi 30% e PBV-së me humbje të konsiderueshme për tatimet kryesore të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Vlerësimet e hendekut tatimor deri në vitin 2014 tregojnë se boshllëqet përkatëse tatimore për këto taksa të mëdha shkojnë në mes 30-40%.

Prania e një niveli kaq të madh të ekonomisë joformale është e dëmshme për qeverisjen ekonomike pasi që minon konkurrencën e ndershme dhe prodhimin e punonjësve në sektorë të ndryshëm jetësorë të ekonomisë së Kosovës si ndërtimi, shërbimet në përgjithësi dhe sidomos me shumicë dhe pakicë, Strehim, restorante dhe transporte që punësojnë një pjesë të madhe të fuqisë aktive të punës në Kosovë, duke pasur parasysh nivelin e lartë të punësimit (30%).

Pengesat strukturore: Mjedisi biznesor është përmirësuar por pengesa dhe sfida të rëndësishme mbesin akoma: konkurrenca jolojale nga sektori jo-formal; zbatimi i ngadaltë dhe jo konsistent i ligjit tek kontekstet ekonomike; inspektime të shpeshta, të pakoordinuara dhe të kushtueshme; koordinimi i dobët në mes të institucioneve publike dhe atyre private, veçanërisht institucioneve financiare, në mbledhjen dhe ndarjen e informatave financiare të ndërmarrjeve; pamundësia e realizimit të vlerës së kolateralit për shkak të mangësive në sistemin e të drejtave pronësore informaliteti në shkallë të gjerë në sektorin e pronës së paluajtshme përkthehet në një mospërputhje midis shënimeve zyrtare kadastrale dhe posedimit de facto, duke kontribuar kështu në pasigurinë në pronësi dhe tregun e dobët të tokës; zbatimi i legjislacionit të pronës së të drejtës intelektuale. Këto pengesa e ulin konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve Kosovare dhe mundësive të tyre për investime, rritje dhe krijim të vendeve të punës. Zbatimi i dobët i të drejtave pronësore dhe raportimi financiar ndikojnë negativisht në mundësitë dhe kapacitetet e NVM-ve për të siguruar financim si dhe investimet e jashtme dhe partneritetet biznesore. Konkurrenca e padrejtë nga ekonomia jo-formale redukton mundësitë për punësim formal me siguri më të lartë të punës dhe krijimin dhe zgjerimin e kompanive të vogla, dhe bizneseve individuale.

b. Masat e reformës

Masa e reformës #7: Miratimi i politikave të bazuara në të dhëna dhe adresimi i ngarkesave administrative

Përshkrimi i masës: Në vijim të reformave thelbësore për thjeshtësimin e legjislacionit dhe vendosjen e sistemit të vlerësimit të ndikimit rregullativ, kjo masë ka për qëllim përmirësimin e zhvillimit të politikave dhe legjislacionit të bazuar në të dhëna, dhe proces të mirëfilltë konsultimi. Në këtë drejtim do të fuqizohet sistemi aktual i koncept dokumenteve për përgatitjen e propozimeve të politikave dhe legjislative, që eventualisht do të zëvendësohet me një sistem të vlerësimit të ndikimit.

Kjo masë është në përputhshmëri me SKZH dhe Strategjinë e ndryshuar për Rregullim të Mirë.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2019: 1) Miratimi i Koncept dokumentit për ngarkesat administrative i cili do të përfshinë edhe përcaktimin e caqeve përkatëse (ZKM); 2) Inicimi i Programit për uljen e ngarkesës administrative për traqetin e përcaktuar në Koncept Dokumentin e miratuar dhe Inicimi i procesit për thjeshtësimin, shkrirjen ose shfuqizimin e lejeve dhe licencave (ZKM); 3) Vazhdimi me trajnimin e stafit lidhur me aplikimin e udhëzimeve dhe mjeteve analitike për vlerësimin ex-ante të politikave (gjithsejtë do të organizohen 12 trajnime) (ZKM); 4) Zhvillimi i kapaciteteve për MSK - Ofrimi i trajnimeve për MSK nga trajnuesit e certifikuar (gjithsej 6 trajnime deri në fund të 2019-ës) (ZKM);

b. Aktivitetet e planifikuara për 2020: 1) Vazhdimi i procesit për thjeshtësimin, shkrirjen ose shfuqizimi i 10% të lejeve dhe licencave krahasuar me gjendjen bazë të 2018-së (480 licenca dhe leje) deri në fund të vitit 2020 (ZKM); 2) Trajnimi i mëtejshëm i stafit lidhur me aplikimin e udhëzimeve dhe mjeteve analitike për vlerësimin ex-ante të politikave (gjithsejtë do të organizohen 12 trajnime) (ZKM); 3) Ofrimi i trajnimeve për MSK nga trajnuesit e certifikuar (gjithsej 6 trajnime deri në fund të vitit 2020) (ZKM);

c. Aktivitetet për vitin 2021: 1) Zbatimi i Programit për uljen e ngarkesës administrative sipas caqeve të përcaktuara në Koncept dokumentin e miratuar nga Qeveria (ZKM); 2) Vlerësimi i përdorimit të matjeve të MSK-së në Koncept Dokumentet e miratuara për vitin përkatës që përfshinë edhe Informatat

e Obligueshme për Bizneset (ZKM); 3) Trajnimi i mëtejshëm i stafit lidhur me aplikimin e udhëzimeve dhe mjeteve analitike për vlerësimin ex-ante të politikave (gjithsejtë 12 trajnime) (ZKM); **Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri:** Cilësia e politikave dhe legjislacionit do të përmirësohet dhe do të largohen pengesat e panevojshme. Vendosija e modelit standard të kostimit do të nxisë të kuptuarit e ndikimeve të legjislacionit tek bizneset dhe qytetarët. Testi i NVM-ve do të sensibilizoj politikëbërësit dhe vendimmarrësit për nevojat e veçanta të bizneseve, dhe në kuadër të kësaj posaçërisht mikro-ndërmarrjet, që janë dominante në strukturën ekonomike të Kosovës. Testi i konkurrueshmërisë rregullativë do të kontribuojë në një mjedis biznesor më konkurrues dhe profil të përmirësuar të biznesit dhe rregullativës në Kosovë krahasuar me vendet tjera në rajon.

Indikatorët kyç të performancës:

- a) Përqindja e e lejeve dhe licencave të thjeshtuara, shkruara ose shfuqizuara ka qenë inekzistente deri më tani dhe për vitin 2021 ky indikator ka për objektiv vlerën prej 10%.

Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit: Kostoja për zbatimin e aktiviteteve për arritjen e caqeve të përcaktuara pritet të ketë ndikim buxhetor në shumën prej 500,600 euro për dy vitet e ardhshme (2019-2020). Në vitin 2019 kjo kosto do të jetë në shumë prej 136,000 euro dhe në vitin 2020 64,000 euro. Këto fonde janë planifikuar në buxhetin e vitit 2019 dhe projeksionet për vitin 2020. Kostoja për zbatimin e aktiviteteve mbulohet në kuadër të Zyrës së Kryeministrit në formë të granteve të ofruara si mbështetje buxhetore nga partnerët zhvillimor, si dhe në formë të mbështetjes me ekspertizë që arrijnë vlerën prej 300,000 euro për periudhën 2019-2021

Ndikimi i pritur në punësim dhe çështje gjinore: Përmirësimi i mjedisit biznesor do të kontribuojë në rritje ekonomike duke inkurajuar bizneset fillestare dhe formalizimin e aktiviteteve biznesore. Gjithashtu, futja e mjeteve shtesë për analizimin e politikave të fokusuar në rritjen e konkurrueshmërisë shoqërohet me integrimin e vlerësimit të ndikimit gjinor në procesin e zhvillimit të politikave. Kjo do të kontribuon në një kornizë të politikave dhe rregullative që është e orientuar në politika gjinore dhe në pajtueshmëri me agjendën e Kosovës për barazi gjinore.

Rreziqet potenciale: Konsiderojmë se shkalla e rrezikshmërisë është e ulët bazuar në faktin se janë krijuar kushtet e nevojshme financiare, korniza e politikave dhe rritja e stafit përkatës në ZKM me ndikim për zbatimin e këtyre aktiviteteve. Mbetet të përmirësohet koordinimi ndërinstitucional.

Masa e reformës #8: Sigurimi i të drejtave pronësore duke adresuar informalitetin në sektorin e pronës së paluajtshme

Përshkrimi i masës: Si vazhdimësi e reformave të paraqitura në PRE 2016-2018, për fuqizimin e sistemit të të drejtave pronësore, kjo masë fokusohet në adresimin e informalitetit të gjerë në sektorin e të drejtave pronësore duke rregulluar legjislacionin e Kosovës në lidhje me të drejtat pronësore. Masa bazohet në SKZH dhe Strategjinë Kombëtare për të Drejtat Pronësore e miratuar në janar 2017. Me përfundim të zbatimit të këtyre masave, përpjekjet strategjike duhet të drejtohen në nxjerrjen e akteve nënligjore dhe administrative.

a. Aktivitetet e planifikuara për vitin 2019: 1) Hartimi i akteve nënligjore dhe masave tjera administrative që dalin nga Ligji për Procedurën Jo-Kontestimore, Ligji për Noterinë dhe Ligji për Trashëgiminë që kanë të bëjnë me adresimin e mospërputhjeve midis akteve ligjore; juridiksionin e dyfishtë të gjykatave dhe noterëve për të proceduar kërkesat e trashëgimisë së pa kontestuar; sigurimi i taksave të përbalueshme noteriale dhe të arsyeshme; dhe krijimi i masave mbrojtëse për mbrojtjen e të drejtave pronësore të grave (MD); 2) Themelimi dhe funksionalizimi i divizionit për mbikëqyrjen e profesioneve të lira (MD); 3) Hartimi i akteve nënligjore që dalin nga Ligji i Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës. AKKVP (ZKM); 4) Transformimi i Gazetës Zyrtare në platformë të unifikuar elektronike për njoftim të palëve në procedurat pronësore juridike, duke përfshirë procedurat e trashëgimisë dhe procedurat e AKKVP-së; 5) Integrimin të Zyrave Komunale Kadastrale në Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe thjeshtësimin e procedurave të regjistrimit në bazë të ligjit të integruar mbi kadastrën, që përfshinë Ligjin për Kadastrën dhe Ligjin për Themelimin e Regjistrimit të Pronave (MMPH); 6) Hartimi i akteve nënligjore për zbatim të Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve Pa

leje, me qëllim të përfundimit të procesit të legalizimit. (MMPH); 7) Shfuqizimi i tatimeve komunale për bartjen e pronësisë dhe zbatimin vetëm i tarifave të parapara me UA 08/2014 mbi tarifave për Shërbimet e Regjistrimit të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme nga Zyrat Kadastrale Komunale (MMPH);

b. Aktivitetet e planifikuara për 2020: 1) Monitorimi i zbatimit të Ligjit të AKKVP-së lidhur me vendosjen e kërkesave për njohje ligjore të të drejtave pronësore jo-formale nga Komisioni për Kërkesa Pronësore i AKKVP (ZKM, AKKVP); 2) Krahasimi dhe verifikimi i të dhënave kadastrale të Kosovës me ato të zhvendosura në Serbi gjatë luftës (AKKVP);

c. Aktivitetet e planifikuara për 2021: 1) Vlerësim i mandatit të AKKVP-së për adresimin e informalitetit që burojnë nga kontratat jo-formale (ZKM); 2) Vazhdimi i krahasimit dhe verifikimit të dhënave kadastrale të Kosovës me ato të zhvendosura në Serbi, po që se krahasimi dhe verifikimit fillon në 2020. (AKKVP).

Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri : Krijimi i një sistemi efektiv të të drejtave të pronësisë krijon siguri ligjore për investitorët dhe rrjedhimisht rrit mundësitë për investime, ndërsa kjo u krijon shtetasve më shumë mundësi për të përdorur pronën si kolateral dhe për këtë arsye përmirëson qasjen në financa. Fuqizimi i të drejtave pronësore gjithashtu përmirëson indikatorët e Bankës Botërore për mjedisin e të bërit biznes, duke përfshirë regjistrimin dhe administrimin e pronës, si dhe zgjidhjen e kontesteve pronësore.

Indikatorët kyç të performancës:

- a) Treguesi për rritjen e kërkesave në zyrën noteriale për zgjidhjen e rasteve të trashëgimisë së vjetër për vitin 2018 është 0. Në vitin 2019, ky tregues pritet të rritet në 20% dhe objektivi për vitin 2021 është 50%.
- b) Numri kërkesave për formalizim të transaksioneve jo-formale në vjet nga AKKVP në vitin 2018 ishte 0, ndërsa për vitin 2021 objektivi është që të arrihet vlera 3000.
- c) Treguesi i të dhënave kadastrale të vjetëruara në lidhje me pronësinë në gjeoportalin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, duke kontribuar në informacionin simetrik për një treg dinamik dhe të drejtë të pronës së paluajtshme është 0 për vitin 2018, megjithatë objektivi për vitin 2021 është 30%.

Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit: Kostoja totale e zbatimit të kësaj mase është 972,000 €, me 84,500 € të mbuluara nga Buxheti i Kosovës, dhe pjesa tjetër 845,500 € të mbuluara nga partnerët e zhvillimit (USAID dhe KE). Ndarja sipas viteve të planifikuara është 486.650.00 € për vitin 2019 dhe 193.115.00 € për vitin 2020 dhe 250.235 € për vitin 2021.

Ndikimi i pritur në punësim dhe çështje gjinore: Fuqizimi i të drejtave pronësore kontribuon në uljen e pabarazisë gjinore. Për gratë dhe vajzat, informaliteti i gjerë në sektorin e pronave - kur prona shkëmbehet jashtë sistemit formal - përjashton ato shitblerjet apo trashëgimitë mbi të cilat ato posedojnë të drejta legjitime. Me posedim të pronës, gratë pavarësohen ekonomikisht, duke shfrytëzuar pronën si kolateral për marrjen e kredive bankare për fillim të një biznesi të ri që krijon vende të reja pune, apo për marrjen e subvencioneve për shfrytëzim efektiv të tokave bujqësore.

Rreziqet potenciale: Ekziston konsensus në spektrin politik të Kosovës për fuqizimin e të drejtave pronësore si parakusht për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Miratimi i legjislacionit që del nga kjo masë varet nga dinamika dhe agjenda e Kuvendit të Kosovës.

Masa e reformës #9: Rritja e efikasitetit në gjyqësor në zgjidhjen e rasteve

Përshkrimi i masës: Kjo masë synon të përmirësojë efikasitetin e gjyqësorit në trajtimin e kontesteve ekonomike duke reduktuar numrin e rasteve të grumbulluara përmes zbatimit të sistemit të menaxhimit të rasteve SMIL. Fokusi në përmirësimin e efikasitetit të gjyqësorit duhet të jetë në zvogëlimin e numrit të lëndëve përmes stimulimeve dhe marrëveshjeve të shpejta në gjykatë, rritje të përkohshme të stafit për zgjidhjen e rasteve, fuqizimin e kapaciteteve të Departamentit Administrativ përkatësisht Divizioni Fiskal të Gjykatës Themelore Prishtinë, përfshirë fushat e tatimeve dhe doganave. Kjo masë është vazhdimësi e PRE 2018-2020, dhe është e bazuar në SKZH dhe ERA.

a. Aktivitetet e planifikuara për vitin 2019: 1) Angazhimi i 14 bashkëpunëtorëve profesional nga USAID; 2) Vazhdimi i rekrutimit të bashkëpunëtorëve profesional në gjykata themelore (KGJK); 3) Funkcionalizimi i SMIL në regjionin e Prishtinës përfshirë edhe Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme (KGJK/Projekti SMIL) 4) Rekrutimi i 12 trajnereve në projektin SMIL për regjionet e Prishtinës (Projekti SMIL)

b. Aktivitetet e planifikuara për vitin 2020; 1) Gjyqtarët e emëruar në 2018, pas përfundimit të trajnimit fillestar do të fillojnë me zgjidhjen e lëndëve, e cila do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në rastet e grumbulluara (KGJK); 2) Funkcionalizimi i SMIL në regjionin e Prishtinës në lëmin civil (KGJK /Projekti SMIL); 3) Avancimi i mëtutjeshëm i SMIL-it, (KGJK/Projekti SMIL); 4) Vazhdimi i trajnimeve dhe përkrahjes për përdorues të sistemit të SMIL(Projekti SMIL)

c. Aktivitetet planifikuara për vitin 2021: 1) Funkcionalizimi i SMIL në regjionin e Prishtinës në lëmin civil (KGJK /Projekti SMIL); 2) Avancimi i mëtutjeshëm i SMIL-it, (KGJK/Projekti SMIL); 3) Vazhdimi i trajnimeve dhe përkrahjes për përdorues të sistemit të SMIL(Projekti SMIL); 4) Avancimi i raporteve statistikore me të dhëna të detajuara me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe performancës së gjykatave.(KGJK); 5) Ndërlidhja e SMIL me sistemin e policisë (KGJK).

Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri: Kursimet kohore nga zvogëlimi i kohës dhe kostoja së vendosjes së rasteve janë të mëdha. Sipas analizave vlera e një dite të kursyer është 8.1 € përcaktuar si kostoja marginale e gjyqimeve/arbitrazhit pjesëtuar me kursimet kohore marginale. Duke përdorur këtë parametër, vendosja e shpejtë për një rast kursen 2.5 mijë euro dhe kur e shumëzojmë këtë me numrin e përgjithshëm të rasteve të ardhura, vlera e përgjithshme e kursyer për shoqërinë është 140 milionë euro. Shtimi i besueshmërisë së investitorëve në sistemin e drejtësisë dhe rritja e investimeve.

Indikatorët kyç të performancës:

- a) Indikator i mbi reduktimin e rasteve të vjetra ishte 7% në vitin 2018 dhe për vitin 2021 objektivi është që ky indikator të rritet në 30%.
- b) Indikator i mbi funksionalizimi e plotë të SMIL-it ishte 24% në vitin 2018 dhe planifikohet të rritet deri në 70% në vitin 2019 me cak kryesor që në vitin 2021 të funksionalizohet 100%.

Kostoja e vlerësuar e aktivitetëve dhe burimi financimit: Kostoja e zbatimit për këtë masë pritet të jetë 3,556,184 EUR për tre vitet e ardhshme 2019 - 2021 me 2,056,184 € të mbuluara nga Buxheti i Kosovës. Ndarja sipas viteve të planifikuara është 618,728 € për vitin 2019, 618,728 € për vitin 2020 dhe 818,728 € për vitin 2021. Pjesa tjetër 1,500,000 € e mbuluar nga grandet, 750,000 € për vitin 2019 dhe 750,000 € për vitin 2020.

Ndikimi i pritur në punësim dhe çështje gjinore: Reduktimi i kohës së zgjidhjes së lëndëve dhe rritja e efikasitetit të gjykatave dhe sigurisë ligjore do të jetë dobishme për secilin që kërkon drejtësi në gjykata e posaçërisht bizneseve.

Rreziqet e mundshme: Rreziqet kryesore ndërlidhen me vullnetin e aktorëve të ndryshëm brenda sistemit gjyqësor dhe pritet për zbatimin e reformave.

Masa #10: Reforma e përgjithshme e inspektimeve

Përshkrimi i masës: Masa synon reformën e inspektimeve me qëllim realizimin e dy objektivave: Zvogëlimin e numrit të inspektimeve në 16 deri në 18 lloje të trupave inspektues për adresimin e koordinimit ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj lokale në aspektin e inspektimeve duke përfshirë edhe inspektime të dyfishta, dhe objektiva e dytë është të përmirësojë efikasitetin duke digjitalizuar procesin, duke rritur qasjen inspektuese. Prandaj, një kontroll më efektiv do të reduktojë informalitetin duke mbështetur biznesin dhe prodhimin e kualifikuar dhe të rregulluar. Kjo masë është në përputhje me SKZH dhe ERA.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2019: 1) Miratimi i ligjit për inspektimet, (MTI) 2) Ndryshimi i legjislacionit horizontal duke lejuar dhe rregulluar legjislacionin sekondar për implementimin e ligjit të riu për Inspektime (MTI dhe ZKM); 3) Themelimi i zyrës qendrore të inspektimeve që koordinon inspektimet dhe përshtatja e strukturës relevante organizative (MTI dhe ZKM);

b. Aktivitetet e planifikuara për 2020: 1) Ndryshimi i legjislacionit horizontal duke lejuar dhe rregulluar reformën e inspektimeve (MTI dhe ZKM); 2) Ngritje e kapaciteteve njerëzore, që nënkupton trajnimin e inspektorëve dhe zyrtarëve tjerë relevant duke i përgatitë për zbatimin e plot të konceptit të ri të inspektimeve (MTI dhe ZKM); 3) Zhvillimi dhe implementimi i platformës elektronike 'E-Inspektori' dhe pajisja e inspektorëve të organeve inspektuese me pajisje të specializuara elektronike që mundëson ndërlidhjen e inspektorëve dhe shkëmbimin e informatave/raporteve në kohë reale (MTI dhe ZKM).

c. Aktivitetet e planifikuara për 2021: 1) Ngritje e kapaciteteve njerëzore, që nënkupton trajnimin e inspektorëve dhe zyrtarëve tjerë relevant duke i përgatitë për zbatimin e plot të konceptit të ri të inspektimeve (MTI); 2. Zhvillimi dhe implementimi i platformës elektronike 'E-Inspektori' dhe pajisja e inspektorëve të organeve inspektuese me pajisje të specializuara elektronike që mundëson ndërlidhjen e inspektorëve dhe shkëmbimin e informatave/raporteve në kohë reale (MTI).

Ndikimi i prituri në konkurrueshmëri /arsyetimi i masës: Masa synon krijimin e një sistemi të unifikuar i cili siguron, koordinim ndërinstytucional të qëndrueshëm, mbikëqyrje efikase dhe transparencë të plotë gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies me rastin e zbatimit të kompetencave dhe përgjegjësive ligjore nga ana e autoriteteve inspektuese. Ky mision pritet të përmirësoj konkurrueshmërinë duke lehtësuar ambientin e të bërit biznes, përmes zvogëlimit të barrës mbikëqyrëse për bizneset,

Indikatorët kyç të performancës:

a) Numri i ankesave të konsumatorëve të adresuara/trajtuara është rritur nga 92 në vitin 2017 në 144 në 2018. Ndërsa për vitin 2021, një target prej 350 është caktuar për këtë tregues.

Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit: Kostoja totale për zbatimin e kësaj mase është 9.029.730 euro për vitet 2019-2021. Nga buxheti i Kosovës do të jetë 141,000 € në të cilën për vitin 2019 do të jetë 28,200 €, për vitin 2020 do të jetë 56,400 € dhe 2021 do të jetë 56,400 € dhe kredi në vlerë prej 8,888,730 € nga BB në të cilën për 2019 do të jetë 1,955,492 €, 2020 do të jetë 2,933,238 € dhe 2021 do të jetë 4,000,000 €.

Ndikimi i prituri në punësim dhe çështje gjinore: Masa e propozuar nuk ka ndikim të drejtpërdrejt në punësim, mirëpo e përmirëson efektivitetin administrativ sa i përket inspektimeve dhe zvogëlon barrierën e kontrollit që ushtrohet ndaj bizneseve.

Rreziqet potenciale: Ndryshimi rrënjësor në strukturë kërkon kapacitete administrative për të qenë në gjendje t'i zbatojnë konceptet e reja, mund të hasim në mungesë të këtyre kapaciteteve dhe vullnetit poashtu.

Masa e reformës # 11: Zvogëlimi i Ekonomisë Informale

Përshkrimi i masës: Qëllimi i masës është përmirësimi i sundimit të ligjit dhe qeverisjes ekonomike në Kosovë si pengesë në rritjen ekonomike dhe gjenerimin e punësimit formal. Përveç kësaj, politika fiskale e vendit është me rëndësi jetike për politikën e rritjes makroekonomike dhe punësimit; prandaj ulja e informalitetit dhe rritja e të ardhurave fiskale (23-24% e PBV-së) është vendimtare për rritjen e cilësisë së shtetit të ligjit në përgjithësi. Masa është në përputhje me draft Strategjinë e re Kundër Ekonomisë Joformale dhe Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2019-2023. Ajo është gjithashtu në përputhje me Strategjinë aktuale të Zhvillimit të Kosovës dhe gjithashtu marrëveshjen e vendit në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit

a. Aktivitetet e planifikuara për 2019: 1) Vlerësimi i Ndikimit Ekonomik dhe Rregullativ lidhur me pragun më efikas dhe efektiv për uljen e transaksionit aktual prej 500 € për biznes në para kesh; 2) Vlerësimi i Ndikimit Ekonomik dhe Rregullativ për futjen e pagesës elektronike obligative për i) të gjitha pagat dhe mëditjet e punonjësve në të gjithë sektorët e veprimtarisë; ii) punësimin, papunësinë dhe pagesat e sigurisë sociale / shëndetësore për të gjithë banorët e Kosovës; 3) Ndryshimi i kornizës së nevojshme ligjore, miratimi dhe nxjerrja e akteve nënligjore për zbatimin e alternativave të zgjedhura sipas aktiviteteve 1 dhe 2; 4) Përmirësimi i statistikave të biznesit statistikor (Regjistri i Bizneseve të Kosovës) përmes lidhjes automatike dhe procedurave të përditësimit në sistemet

përkatëse të menaxhimit të informatave të këtyre institucioneve për të pasqyruar aktivitetin ekonomik real (siç është verifikuar nga Autoritetet Tatimore dhe Agjencia për Statistika); 5) Vlerësimi i Ndikimit Ekonomik dhe Rregullativ për ofrimin e qasjes në ATK në të gjitha transaksionet financiare (sektori bankar) dhe transaksionet e pasurive të paluajtshme.

b. Aktivitetet e planifikuara për 2020: 1) Vlerësimi ex post i zbatimit të masave 1, 2 dhe 3 dhe llogaritja e efekteve në të ardhurat fiskale, gjenerimi i punësimit formal, boshllëqet tatimore (hendeku teorik dhe i pajtueshmërisë në përputhje me metodologjitë e FMN dhe BE). 2) Hartimi i masave të nevojshme korigjuese, ndryshimeve dhe zbatimit. 3) Sigurimi i statistikave dhe publikimi në përgjithësi.

c. Aktivitetet e planifikuara për 2021: 1) Vazhdimi i bazës ex-post 2 vjeçare të efekteve të zbatimit të të gjitha masave dhe raportimit

Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri: Reduktimi i ekonomisë joformale do të përmirësojë mjedisin e të bërit biznes në përgjithësi, konkurrencën luajale dhe për rrjedhojë do të mundësojë rritjen e atyre sektorëve ku Kosova ka avantazhe më konkurrues, duke krijuar më shumë mundësi për të gjeneruar punësim të qëndrueshëm të fuqisë punëtore aktuale.

Indikatorët kyç të performancës:

- a) Nuk ka matje për zvogëlimin e hendekut tatimor në vitin 2018, megjithatë në vitin 2019 ky tregues pritet të rritet në 50%, ndërsa objektivi për vitin 2021 është 100%.
- b) Në vitin 2018 nuk ka pasur matje për reduktimin e ekonomisë informale. Ky indikator pritet që në vitin 2019 të arrijë 50%. Objektivi për këtë tregues për vitin 2021 është që të arrihet 100%.

Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit:

Shpenzimet për 3 vlerësime të ndikimit për vitin 2019 do të ishin 150,000 €, secila nga këto vlerësime do të kushtojë rreth 50,000 €. Pjesa tjetër e aktiviteteve përbëhet nga shpenzimet administrative që absorbohen nga buxheti kombëtar gjatë rrjedhës normale të aktivitetit. Për vitin 2020 dhe 2021 nuk do të kishte kosto shtesë pasi metodologjitë e zhvilluara në vitin e parë (2019) do të zbatohen në dy vitet e ardhëshme.

Ndikimi i pritur në punësim dhe çështje gjinore: Ndikimi kryesor në punësim do të ishte përmirësimi i niveleve zyrtare të punësimit në sektorët me nivelin më të lartë të informalitetit.

Rreziqet e mundshme: Rrezik kryesor mund të jetë mungesa e vullnetit politik dhe vendosmërisë së autoriteteve kombëtare për të ndjekur këtë axhendë të reformave. Ndërsa angazhimi i autoriteteve është shprehur në dokumentet kryesore të politikave kombëtare, rreziku mbetet i ulët për të moderuar. Do të monitorohet dhe zbutet përmes dialogut politik të vazhdueshëm në nivelet më të larta të vendimmarrjes politike.

4.3.4. HULUMTIMI DHE ZHVILLIMI, INOVACIONI (RDI) DHE EKONOMIA DIGJITALE

Analiza e pengesave kryesore

Gjendja aktuale: Sistemi i HZHI i Kosovës është një nga më të pa zhvilluarit në rajon. Ai u rendit si i parafundit nga Raporti i OECD 2016 dhe shënoi rezultat të dobët në të katër fushat e politikave: qeverisja e politikave të HZHI; baza kërkimore; aktivitetet e HZHI në sektorin privat; dhe bashkëpunimi midis biznesit dhe akademisë. Qeveria ka miratuar edhe Ligjin për Inovacion dhe Transferimin e Dijes Teknologjisë dhe ka proceduar në Kuvend. Sipas Ligjit Nr. 04 / L-135 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore, Qeveria e Kosovës duhet të ndajë 0.7% ose 14 milionë euro në vit për shkencën dhe inovacionin në MASHT, por për shkak të mungesës së fondeve deri në vitin e kaluar janë ndarë, vetëm 500,000 Euro dhe nga viti 2019 ndarja vjetore për këtë kategori është rritur në 1,600,000 euro. Nuk ka të dhëna statistikore mbi shpenzimet private për biznesin (R&D). Por NVM-të të cilat kanë për qëllim zhvillimin e produkteve apo aktiviteteve inovative nuk kanë shprehur interesim për absorbim të ndihmave përmes ‘vaucherëve’ dhe përkrahjeve tjera institucionale.

Kosova ka katër institucione kërkimore shkencore të përfshirë si partnerë në projektet e Horizontit 2020. Pozita e Kosovës në kuadër të këtij programi kornizë nuk lejon që institucionet e Kosovës të jenë bartëse dhe kjo zvogëlon mundësinë e përfitimit nga ky program, edhe pse tashmë Kosova ka nënshkruar marrëveshjen me BE-në për të marr pjesë në programet e BE-së. Projektet e zhvilluara deri më tani në institucionet e hulumtimeve shkencore janë përqendruar në punime shkencore, ndërsa komercializimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore nuk ka treguar ndonjë zhvillim. Kosova vitin e kaluar ka themeluar edhe Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe me këtë është rritur edhe financimi për aktivitetet e inovacionit. MIN ka filluar së hartuari Strategjinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Kërkohet koordinimin më i mirë ndërmjet MASHT dhe MIN në këtë fushë.

Ekonomia dixhitale - rrjetet fikse të telekomunikimeve janë të përhapura gjerësisht në zonat urbane por jo edhe në të gjitha zonat rurale. Penetrimi i linjës fikse është 3.5% krahasuar me mesataren e BE-së prej 24,%. Penetrimi i telefonisë mobile është rreth 103% të popullsisë dhe vlerësohet se përdorues të internetit përmes rrjetit 3G dhe 4G janë 91% të banorëve krahasuar me 126% në BE; penetrimi i internetit me qasje fikse vlerësohet të jetë 90% të familjeve krahasuar me 87% në BE. Me hyrjen në fuqi (nëntor 2012) të Ligjit nr.04/L-109 për Komunikimet Elektronike është hequr regjimi i licencimit dhe është vendosur regjimi i autorizimit të përgjithshëm për përfshirje në aktivitete të komunikimeve elektronike. Sipas të dhënave të raportuara në ARKEP investimet në infrastrukturën e telekomunikuese kanë shënuar rënie të vazhdueshme, gjatë vitit 2015 kanë qenë afër 52 mil. € ose 0.9 % e BPV së përgjithshme, gjatë vitit 2016 rreth 30 mil. € ose 0.5 % e BPV së përgjithshme, ndërsa gjatë vitit 2017 kanë qenë rreth 27 mil. € apo 0.42 % e BPV së përgjithshme të Kosovës. Përdorimi i gjithmbarshëm i TIK-ut në industri është ende i kufizuar dhe përfitimet e saj konkurruese nuk janë kuptuar siç duhet nga shumë firma, veçanërisht nga NMVM-të (Micro, Small & Medium Enterprises). Në lidhjet brezgjere, fokusi duhet të jetë në zonat e pambuluara për të përmirësuar pozitën e Kosovës në krahasim me vendet e rajonit (në fund të vitit 2017, shkalla e penetritimit të linjave brezgjere në nivel vendi ishte 15.13% e popullsisë, të përqendruara kryesisht në qytete). Në nivel të kompanive të sektorit të TIK ka nevojë për ngritje kapacitetesh me fokus në aplikimin e standardeve për ofrimin e shërbimeve që kanë të bëjnë me softuer dhe aplikacione të reja. Vlerësohet se në sektorin e TIK-ut janë të punësuar rreth 2000 punëtorë, apo më pak se 1% nga numri total i të punësuarve krahasuar me 3,7% në nivel të BE. Nga 571 biznese të regjistruara me TIK-un si aktivitet parësor, vetëm rreth 120 prej tyre konsiderohen biznese me produkt shërbime të fushës së TIK, ndërsa të tjerat janë biznese shitëse e servisuere të harduerit.

Pengesat strukturore: Pengesa kryesore është mungesa e kornizës ligjore dhe të politikave për mbështetje të hulumtimeve dhe zhvillimit (R&D), aktivitete dhe mbështetje të fragmentuara; infrastrukturë e pamjaftueshme e butë (p.sh. ekspertë/konsulentë për RDI) dhe infrastrukturë të forte (p.sh. laboratorë, pajisje). Mos pjesëmarrja në programet e Horizon 2020 pengon ndërmarrjet nga bashkëpunimi në fushën e rritjes së mençur, që synon industrinë e reja, duke bërë kështu ato të humbasin mundësinë për t'u përfshirë në zhvillimet moderne industriale në lidhje me mallrat dhe shërbimet e reja. Gjithashtu mungesa e bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat, sektorit publik dhe institucioneve të arsimit të lartë pengon transferimin efektiv të njohurive duke rezultuar gjithashtu në humbjen e mundësisë për zhvillim ekonomik.

Mungesa e shtrirjes së infrastrukturës së internetit brezgjere ndikon negativisht në produktivitetin dhe konkurrueshmërinë globale të kompanive, si dhe ulë mundësitë për vetë-punësim, punë nga distanca, të mësuarit dixhital, dhe tregtimin dixhital. Shpërndarja e infrastrukturës së TIK-ut në Kosovë është relativisht e pa balancuar, duke rezultuar me mungesë të qasjes në infrastrukturën brezgjere. Raportet hulumtuese kanë treguar se ka vështirësi në sigurimin e kuadrove të reja me aftësi të nevojshme të fushës së TIK.

Planet e reformave prioritare

Masa e reformës #12: Përmirësimi i mjedisit për Inovacion dhe Ndërmarrësi

Përshkrimi i masës: Kjo masë synon që të krijohet një bazë të mirë ligjore në fushën e hulumtimit dhe kërkimit shkencor, inovacionit në vend si dhe të rrisë financimin e projekteve në fushën e inovacionit

dhe ndërmarrësisë. Ndërsa Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN), në kuadër të kësaj mase ka për qëllim të stimuloj idetë dhe aktivitetet inovative në Kosovë, me qëllim rritjen e produktivitetit ekonomik dhe institucional, zhvillimin e ndërmarrësisë dhe iniciativës private përmes inovacionit me fokus në zhvillimin e bizneseve (NVM-ve, bizneseve fillestare Start-Up) dhe njëkohësisht, nxitjen e bashkëpunimit të ngushtë në mes të akademisë, sektorit publik dhe sektorit privat. Kjo masë ndërlihet me SKZH, ERA, PKZMSA dhe KASH.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2019: 1) Hartimi dhe Miratimi i Ligjit për Inovacion dhe Ndërmarrësi dhe infrastruktura sekondare; UA mbi themelimin dhe funksionalizimin e qendrave të Inovacionit; UA për Themelimin e mekanizmit për implementimin e fondit për I&N (MIN) 2) Miratimi i Strategjisë për Përkrahjen e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN); 3) Vazhdimi i mbështetjes direkte financiare për idetë, projektet dhe aktivitetet inovative për NVM-të, bizneset fillestare Start – Up dhe OJQ-të; 4) Funksionalizimi qendrave të themeluara dhe themelimi dhe Qendrave Rajonale për I&N në Gjakovë, Pejë, Mitrovicë dhe Gjiilan; 6) Fillimi i krijimit të mekanizmit për implementimin e fondit për I&N; 7) Grantet për projekte shkencore dhe për mobilitete afatshkurtra të shkencëtarëve, grante për VOUCHER të Inovacionit si dhe për studime PHD (MASHT); 8) Hartimi dhe miratimi i akteve tjera nënligjore që rrjedhin nga Ligji për Inovacion dhe TDT; 9) Hartimi i Udhërrëfyesit të Infrastrukturës për Kërkim, Inovacion dhe Zhvillim (MASHT);

b. Aktivitetet e planifikuara për 2020: 1) Vazhdimi i mbështetjes direkte financiare për projektet dhe aktivitetet inovative për NVM-të, bizneset fillestare Start –Up dhe OJQ-të; 2) Funksionalizimi i qendrave rajonale të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë: zhvillimi i inkubatorëve dhe pajisja e qendrave me laborator dhe pajisje të tjera të nevojshme; 3) Hartimi i Infrastrukturës ligjore sekondare; 4) Vazhdimi i funksionalizimit të mekanizmit për implementimin e fondit për I&N; 5) Grantet për projekte shkencore dhe për mobilitete afatshkurtra të shkencëtarëve, grante për VOUCHER të Inovacionit si dhe për studime PHD;

c. Aktivitetet e planifikuara për 2021: 1) Vazhdimi i mbështetjes direkte financiare për projektet dhe aktivitetet inovative për NVM-të, bizneset fillestare Start –Up dhe OJQ-të; 2) Hartimi i Infrastrukturës ligjore sekondare; 3) Grantet për projekte shkencore dhe për mobilitete afatshkurtra të shkencëtarëve, grante për VOUCHER të Inovacionit si dhe për studime PHD; **Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri/arsyetimi i masës:** Implementimin e aktiviteteve për këtë masë, synon të rrisë performancën e ndërmarrjeve ekzistuese dhe hapjen e bizneseve të reja me qëllim të gjenerimit të vendeve të reja të punës (me prioritet gratë dhe të rinjtë), rritjen e konkurrueshmërisë dhe potencialit për eksport për produkte e shërbime të bizneseve kosovare. Stimulimin dhe orientimin e të rinjve për edukim dhe kualifikim në shkencë, teknologji dhe shkolla profesionale.

Indikatorët kyç të performancës:

a) Në vitin 2018 janë mbështetur gjithsej 200 NVM, ndërmarrje të reja, dhe OJQ. Objektiv i është që ky tregues të rritet në 220 në vitin 2021.

Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit: Kostoja për zbatimin e aktiviteteve për këtë masë parashikohet të jetë 36,825,003 euro për 2019-2021. Nga buxheti i Kosovës do të jetë 33,625,000 euro në të cilat 10,775,000 për 2019, për vitin 2020 do të jenë 11,425,000 dhe 2021 do të jenë 11,425,000. Fondet nga IPA do të jenë 2.000.000 në të cilat 1.000.000 do të jenë në vitin 2020 dhe 1.000.000 në 2021. Grantet tjera janë 1,200,000 EUR në të cilat 400,000 EUR janë të ndara për 2019-2021.

Ndikimi pritshëm në punësim dhe çështje gjinore: Përkrahja direkte financiare sipas fondit apo grantit për Inovacion dhe Ndërmarrësi për NVM-të, Start –Up qartëson, synimin e qeverisë për rritjen e punësimit (me përparësi gratë dhe të rinjtë). Sipas kriterëve të Programit për implementimin e kriterëve të vlerësimit për subvencione të projekteve dhe ideve inovative MIN, me 10 pikë më shumë i vlerëson projektet që janë të udhëhequra nga gratë dhe të rinjtë. Po ashtu përparësi për edukim dhe trajnime në do të jetë avancimi i grave dhe të rinjve.

Rreziqet e mundshme: Ngecja e bashkëpunimit ndër-institucional; Ngecja e bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat, sektorit publik dhe akademisë, për zbatimin e ideve dhe projekteve inovative në

ndërmarrje; Zvogëlimi i fondit për Inovacion dhe Ndërmarrësi; Qëndrueshmëria e Start-up dhe shndërrimi i tyre në biznese stabile me potencial për rritje; Popullimi i Qendrave Rajonale të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë; Mungesa ekspertizës së nevojshme të stafit akademik për inovacion, shkencë, teknologji, ekonomi digjitale për ngritje të kapaciteteve humane.

Masa e reformës #13: Shtrirja e infrastrukturës përkatëse të rrjetave dhe shërbimeve të TIK-ut për zhvillim socio-ekonomik

Përshkrimi i masës: Masa është vazhdimësi nga PRE 2018-2020 dhe ka për qëllim zgjerimin e qasjes dhe përdorimit të TIK-ut përmes shtrirjes së infrastrukturës brezëgjere në viset e pambuluara, forcimit të kapitalit njerëzor dhe mbështetjes së bizneseve dixhitale, si dhe dixhitalizimit të bizneseve tjera. Programi i Ekonomisë Dixhitale i Kosovës do të mbështetet nëpërmjet financimeve të jashtme (Banka Botërore) për të cilën është nënshkruar një marrëveshje financimi. KODE do të zbatohet gjatë viteve 2019-2023. Kjo masë është në përputhje me SKZH, Axfordën Dixhitale të Kosovës 2013-2020 dhe Strategjinë e Kosovës për TI. Sa i përket digjitalizimit të bizneseve tradicionale për vitin 2020 dhe 2021 është paraparë përmirësimi i mjedisit për biznesin e e-tregtisë/e-biznesit dhe "Mbështetja e digjitalizimit të NVM-ve", e cila parashikon vlerësimin e nevojave të TIK-ut për NVM-të dhe do të ofrojë mbështetje për NVM-të që adresojnë nevojat përmes shërbime të specializuara konsulente.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2019: 1) Shtrirja e Infrastrukturës brezëgjere në vise të pambuluara përmes programit KODE- faza I; 2) Zhvillimi i Resurseve Njerëzore për Ekonominë Dixhitale dhe mbështetje për bizneset dixhitale - ofrimi i trajnimeve për të paktën 400 të rinj; 3) Funkcionalizimi i parkut teknologjik për nevoja të bizneseve të TIK. 4) Zbatimi i projektit për krijimin e Qendrave Kreative për Shkollat e Mesme të Kosovës.

b. Aktivitetet e planifikuara për 2020: 1) Shtrirja e Infrastrukturës brezëgjere në vise të pambuluara përmes programit KODE - faza II; 2) Zhvillimi i Resurseve Njerëzore për Ekonominë Dixhitale dhe mbështetje për bizneset dixhitale - ofrimi i trajnimeve për të paktën 400 të rinj; 3) Dixhitalizimi i bizneseve tradicionale dhe ngritja e përdorimit të teknologjive të TIK në sektorin privat – faza I.

c. Aktivitetet e planifikuara për 2021: 1) Shtrirja e Infrastrukturës brezëgjere në vise të pambuluara përmes programit KODE - faza III; 2) Zhvillimi i Resurseve Njerëzore për Ekonominë Dixhitale dhe mbështetje për bizneset dixhitale - ofrimi i trajnimeve për të paktën 400 të rinj; 3) Dixhitalizimi i bizneseve tradicionale dhe ngritja e përdorimit të teknologjive të TIK në sektorin privat – faza II.

Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri: Studimi i BB arrin në përfundim që rritja e penetrimit të infrastrukturës fikse brezëgjere prej 10% do të përcillet me një rritje prej 1.21% të GDP-së në ekonominë e zhvilluar dhe 1.38% të GDP-së në ekonominë në zhvillim. Krijimi i kushteve të përshtatshme përmes shtrirjes së infrastrukturës përkatëse të rrjetave dhe mundësimit të shërbimeve brezëgjere do të mundësojë përmirësimin e qasjes në tregje ndërkombëtare, zhvillim të modeleve të reja të biznesit, duke i lejuar njerëzit dhe kompanitë të punojnë pavarësisht lokacionit dhe me orar fleksibil, dhe në përgjithësi përsheptimin e procedurave dhe proceseve, duke rritur dinamizmin ekonomik dhe duke përmirësuar konkurrueshmërinë, përmirësim i tregut të punës dhe mjedisin e biznesit.

Indikatorët kyç të performancës:

- Gjithsej 37 zona kadastrale ishin të mbuluara me infrastrukturë fikse brezëgjere në vitin 2018. Në vitin 2019 ky numër pritet të rritet në 90, ndërsa objektivi është që në vitin 2021 të jenë rreth 190 zona të mbuluara me këtë lloj infrastrukture.
- Në total 43 institucione publike patën qasje në internet brezëgjere përmes Programit KODE në vitin 2018. Në vitin 2021 objektivi është që ky numër të zgjerohet deri në 155.

Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit:

Kostoja totale për zbatimin e kësaj mase pritet të jetë rreth 23,386,087€ për 2019-2021. Nga kjo shumë totale, 4,136,087 € vijnë nga buxheti i Kosovës si vijon: 856,087 € për 2019 dhe 1,640,000 € për vitin 2020 dhe 1,640,000 € për vitin 2021. Një numër aktiviteteve do të mbështeten përmes fondeve të IPA 2017, me 750,000 € çdo vit gjatë 2019-2022. Aktivitetet në lidhje me zbatimin e zgjerimit të infrastrukturës brezëgjere në zonat e pambuluara do të financohen përmes një kredie të BB që pritet të

disbursohet si më poshtë: 2,000,000 euro në vitin 2019, 6,000,000 euro në vitin 2020 dhe 9,000,000 euro në vitin 2021.

Ndikimi i pritur në punësim dhe çështje gjinore: Kjo masë do të ketë ndikim pozitiv në punësim duke zgjeruar mundësitë për punë dixhitale, me fokus të veçantë tek të rinjtë, gratë dhe personat me aftësi të kufizuara. Sipas disa anketimeve infrastruktura brezëgjërë (broadband-i) është vlerësuar si një mundësues kryesor i punës fleksibile, në më shumë se $\frac{3}{4}$ e bizneseve të anketuara duke e cekur zgjerimin e infrastrukturës brezëgjërë si faktor që ndikon në këtë. Si rezultat direkt i komponentit të dytë të Programit KODE është planifikuar krijimi i 400 vendeve të reja të punës në bizneset e softuerit të TI-së, si dhe janë planifikuar trajnime në TIK të 2000 personave, të cilët potencialisht mund të konsiderohen vende të reja të punës (të punësuar apo vetë-punësuar).

Rreziqet e mundshme: Si rreziqe të mundshme për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara mund të konsiderohen vonesat eventuale në realizimin e projekteve me Bankën Botërore dhe të IPA-së. Si rrezik tjetër i mundshëm janë edhe kapacitetet e kufizuara absorbuese në mesin e fuqisë punëtore potenciale të TIK dhe bizneseve të TIK. Si aktivitet lehtësues është planifikuar shqyrtimi i hollësishëm, në fazën e hershme të zbatimit të aktivitetit, të fuqisë punëtore potenciale të TIK dhe bizneseve ekzistuese të TIK në lidhje me kriteret për pranim në aktivitet, duke përdorur mjetet më efikase të TIK-ut për testimin dhe vlerësimin e kandidatëve potencialë.

4.3.5. REFORMAT LIDHUR ME TREGTINË

Analiza e pengesave kryesore

Gjendja aktuale: Kosova ka ndërmarrë hapa thelbësorë në liberalizimin e ekonomisë dhe tregtisë së jashtme. Hapa të rëndësishëm ishin anëtarësimi në CEFTA që nga viti 2007 dhe Marrëveshja e Stabilizim Asociimit me BE. Megjithatë, tregtia e mallrave në Kosovë mbetet e dominuar nga importet që përbëjnë pothuajse 90% të tregtisë totale, ndërsa në eksportet e shërbimeve janë dy të tretat e tregtisë totale. Duke pasur parasysh këtë rol të rëndësishëm të shërbimeve për konkurrencën e Kosovës, heqja e barrierave tregtare për zhvillimet në sektorin e shërbimeve është vendimtare. Sa i përket eksporteve të mallrave, mungesa e diversifikimit të produkteve është veçanërisht akute kur bëhet fjalë për eksportet e Kosovës në tregjet e zhvilluara (BE, EFTA) me indeksin Herfindahl-Hirschman prej 0.52 dhe 0.6. Nga ana tjetër, eksportet në CEFTA janë më të larmishme me indeksin HH prej 0.25.

Në nivel rajonal, Kosova është pjesëmarrëse në reformat e lehtësimit të tregtisë përmes mekanizmave të CEFTA-s. Agjenda e lehtësimit të tregtisë të vendeve të CEFTA-së është e lidhur me Marrëveshjen e OBT për Lehtësimin e Tregtisë. Sipas raportit të vetë-vlerësimit që Kosova e ka bërë në bazë të Marrëveshjes së OBT-së, kërkohen masa të menjëhershme për një numër çështjesh, duke përfshirë: shkëmbimin e informacionit, kontrollit pas zhdoganimit, menaxhimin e rrezikut, procedurat e parambërritjes, pagesa elektronike, procedurat e njoftimit, procedurat e konsultimit, tarifa dhe ngarkesa mbi importet dhe eksportet, operatorët e autorizuar dhe fusha të tjera. Në Raportin e Politikave të konkurrenshëmërisë 2016 të OECD-së, politikat e lehtësimit të tregtisë së Kosovës u renditën më të ulëta në mesin e 6 vendeve të SEE. Veçanërisht kritike janë fushat e standardeve teknike dhe masat sanitare dhe fitosanitare me rezultatet 1,4 dhe 1,6 (nga 5). Rezultati për licencat e importit ishte gjithashtu më i ulëti në SEE ndërsa sa i përket barrierave administrative për tregtinë, performanca e Kosovës është e krahasueshme me vendet e tjera. Në raportin e të bërit Biznes 2019 Kosova ka lehtësuar eksportimin e mallrave duke riorganizuar zhdoganimin në kufi. Përveç kësaj, Kosova ka nënshkruar Deklaratën e Përbashkët të Bashkëpunimit me Shtetet e EFTA-s në nëntor 2018, e cila çon në një MTL me Shtetet e EFTA-s gjatë vitit 2019.

Pengesat strukturore: Përveç zvogëlimit të shpenzimeve administrative, zhvillimi i infrastrukturës së cilësisë (standardizimi, akreditimi dhe certifikimi i cilësisë së produktit) është një pengesë tjetër për eksportet dhe zëvendësimin e importit. Reduktimi i pengesave teknike për tregtinë është pra një element po aq i rëndësishëm i lehtësimit të tregtisë. Ngjashëm, Kosova ka identifikuar barrierat logjistike dhe kufitare si një nga pengesat më të mëdha për qarkullim më të madh të mallrave midis partnerëve rajonal, si dhe për një integrim më të thellë me pjesët tjera të botës. Barrierat dhe kostot e

larta të tregtisë ndërkuftare zvogëlojnë nivelin e eksporteve të Kosovës dhe rrisin koston e importeve, që ndikon tek shumica e prodhuesve të Kosovës që përdorin materiale të importuara, ashtu edhe tek konsumatorët që përdorin mallra të importuara. Edhe më e rëndësishme, reduktimi i pengesave procedurale, cilësore, logjistike dhe kufitare për eksportin do të kontribuonte në rritjen e nivelit aktualisht shumë të ulët të eksporteve të mallrave.

b. Planet e reformave prioritare

Masa e reformës 14: Lehtësimi i tregtisë përmes rritjes së efikasitetit për kosto të transaksioneve tregtare ndërkombëtare

Përshkrimi i masës: Kjo masë do të adresojë dhe reduktoj barrierat tregtare, posaçërisht përmes thjeshtëzimit dhe standardizimit të të gjitha formaliteteve dhe procedurave në kufi, që pritet të reduktojnë shpenzimet ndërkuftare dhe kohën. Kosova tashmë ka marrë detyrime në nivel rajonal dhe global, nëpërmjet CEFTA, SAA, OBT dhe OBD. Lehtësimi i tregtisë respektivisht adresimi dhe reduktimi i barrierave janë elaboruar në Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat 2017-2021, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim; Programi i Qeverisë dhe Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2019: 1) Plotësim/ndryshimi, harmonizimi i Kodit Doganor dhe i Akcizave (KDA) dhe UA për zbatim të KDA, ligjeve tjera të zbatueshme nga Dogana, akteve dhe strategjive; Grupi Punues është funksional (MF- Dogana); 2) Licencimi i Operatorëve Ekonomik të Autorizuar (AEO) (Dogana); 3) Hartimi dhe finalizimi i fizibilitetit të Dritares së Vetme Kombëtare (MTI-Dogana-ASHI); 4) Hartimi dhe aprovimi i Ligjit të ri për Tregti të Brendshme nga Kuvendi i Kosovës (MTI); 5) Negocimi i marrëveshjes me vendet e EFTAs (MTI); 6) Aderimi në Konventën PEM (MTI-MPJ); 7) Ndërtimi i platformës për anëtarësimin e Kosovës në OBT (MTI); 8) Racionalizimi i listës së tarifave dhe pagesave në lidhje me licencat e importit dhe eksportit të mallrave (MTI); 9) Studimi i Lirimit Kohor (Doganat e Kosovës).

b. Aktivitetet e planifikuara për 2020: 1) Finalizimi i shkëmbimit të informatave përmes SEED+ në nivel nacional në agjencitë kufitare (Dogana – Agjencitë kufitare); 2) Përgatitjet për platformën e projektit NCTS (Dogana - MF); 3) Hartimi dhe aprovimi i Ligjit të ri për Tregti të Jashtme (MTI); 4) Hartimi i dokumentit të ri për Politika Tregtare (MTI); 5) Ratifikimi i marrëveshjes me vendet e EFTA's nga kuvendi i Kosovës (MTI); 6) Ekzaminimi i procesit për fillimin e negociatave për anëtarësim në OBT (MTI); 7) Racionalizimi i listës së tarifave dhe pagesave në lidhje me licencat e importit dhe eksportit të mallrave (MTI); 8) Krijimi i platformës për dritare të vetme (Dogana e Kosovës).

c. Aktivitetet e planifikuara për 2021: 1) Finalizimi i shkëmbimit të informatave në nivel rajonal SEED+ të vendeve të CEFTAs (Dogana); 2) Fillimi i implementimit të NCTS (Dogana- MF); 3) Fillimi i negociatave për anëtarësim në OBT (MTI);

Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri: Vlerësimet tregojnë se lehtësimi i tregtisë mund të ulë koston tregtare me një mesatare prej 14.3% dhe të nxisë tregtinë globale deri në \$ 1 trilion në vit, me fitimet më të mëdha në vendet më të varfra. Analizat ndërkombëtare tregojnë se në shumë vende, në nivelin makro reduktimi i kohës për tregti vetëm për një ditë mund të rrit aktivitetin tregtar në më shumë se 5%. Sipas OECD-së, lehtësimi tregtar është i ndërlidhur transaksione më të lehta, efikase për koston, më të shpejta dhe me efektive, në këtë mënyrë lehtëson qarkullimin tregtar.

Indikatorët kyç të performancës:

- a) Koha e zhdoganimit në importe dhe eksporte: e para ka për cak përmisimin e mëtejshëm nga një bazë prej 2.44 orësh në vitin 2016 - e cila u zvogëluar më tej në vitin 2018 në 2.22 orë - në 2 orë në vitin 2021. Objektivi për kohën e zhdoganimit të eksporteve është që të zvogëlohet nga baza krahasuese e vitit 2016 prej 1.39 orësh dhe e cila u ul në vitin 2018 në 1.30 orë, në 1.10 orë në vitin 2021.

- b) Indikatori mbi tarifrat, pagesat dhe licencat për Imp / Exp, në vitin 2018 tregon se i pari është 352 € dhe ky i fundit 63. Objektivi për 2021 për tarifrat dhe pagesat është që të ulet në 320 €, ndërsa për licencat është që të zvogëlohet në 50.
- c) Numri i autorizimit për OEA është 0 për vitin 2018, ndërsa objektivi i parashikuar për 2021 është 9.

Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe ndikimi buxhetor: Kostoja totale për tre vitet e ardhshme do të jetë 342,000.00 € të ndara për tre vitet e ardhshme me 114,000 € në vit. Prej tyre, 30,000 € do të financohen nga buxheti qendror, 60,000 € nga IPA dhe 24,000 € nga grantet e tjera.

Ndikimi i prituri në punësim dhe çështje gjinore: Deri më tani institucionet vendore dhe shoqatat e biznesit nuk kanë bërë ndonjë hulumtim që mund të ilustrojë ndikimin e lehtësimit të tregtisë në punësim mirëpo bazuar në studime ndërkombëtare, masat e ndërmarra në fushën e lehtësimit të tregtisë mund të rezultojnë në përfitime globale me vende të reja të punës deri në 21 milion njerëz, ku në vendet në zhvillim punësimi mund të arrijë mbi 18 milionë vende të reja pune dhe në vendet e zhvilluara arrin numri deri në 3 milion njerëz.

6. Rreziqet potenciale

Rreziqet në lidhje me zbatimin e masës dhe aktiviteteve përfshijnë mungesën e bashkëpunimit rajonal, mungesën e bashkëpunimit ndërmjet Ministrive respektive dhe agjencive kufitare; vonesat në miratimin dhe zbatimin e legjislacionit; vonesat në implementimin e projekteve; rreziqet në pengesat e ndryshme në lidhje me përfaqësimet rajonale dhe anëtarësimet në organizatat ndërkombëtare që lidhen me tregtinë dhe çështjet e tregtisë.

Masa e reformës #15: Zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës së cilësisë dhe fuqizimi i rolit të autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut me fokus produktet e ndërtimit

Përshkrimi i masës: Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës së cilësisë (Standardizimi, Akreditimi, Metrologjia, Vlerësimi i Konformitetit - Rregullimi Teknik dhe Inspektorati i Tregut) duke harmonizuar legjislacionin kombëtar me acquis të BE-së dhe zbatimin e tij është bazë për forcimin dhe koordinimin e sistemit ndërinstitucional me bizneset dhe aktorët e tjerë, si dhe anëtarësimin në shtyllat e Infrastrukturës së Cilësisë në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare. Objektivi i përgjithshëm për zhvillimin e mëtejshëm të Infrastrukturës së Cilësisë dhe Mbikëqyrjes së Tregut është përafrimi i mëtejshëm dhe zbatimi i legjislacionit të BE-së në mënyrë që: të rritet siguria dhe cilësia e produkteve ndërtimore, shërbimet e ofruara në tregun e brendshëm, si dhe integrimi në BE dhe në tregjet e tjera; eliminimin e pengesave teknike për tregtinë dhe mbikëqyrjen efektive të tregut nga autoritetet kompetente. Sektori i ndërtimit është një nga kontribuesit më të mëdhenj të PBV-së të Kosovës (7.06% në vitin 2017) dhe kontributi i këtij sektori ka shënuar një rritje të vazhdueshme gjatë viteve. Prandaj është thelbësore që produktet e ndërtimit që tregtohen dhe përfshihen në punimet e ndërtimit duhet të jenë të sigurta dhe cilësore.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2019: 1) Hartimi i udhëzimit administrativ për sistemin e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës (AVCP) së produkteve të ndërtimit (DIC); 2) Themelimi i Pikës së Kontaktit për produktet e ndërtimit (DIC); 3) Ndërtimi i kapaciteteve administrative për mbikëqyrjen metrologjike (rekrutimi i 4 zyrtarëve) 4) Emërimi dhe akreditimi i trupave për vlerësimin e konformitetit duke përfshirë trupat certifikues dhe laboratorët testues për fushën e produkteve të ndërtimit (DIC & DAK); 5) Ngritja e kapaciteteve për mbikëqyrjen e produkteve të ndërtimit (3 module trajnimi); 6) Promovimi i infrastrukturës së cilësisë me të gjitha palët e interesit (organizimi nga të gjitha shtyllat e IC i së paku katër eventeve me bizneset, trupat për vlerësimin e konformitetit dhe dhomat kombëtare të tregtisë); 7) Ofrimi i asistencës teknike për së paku tre (3) prodhues të produkteve ndërtimore. Mbështetje prodhuesve për të plotësuar kërkesat për të vendosur shenjen e konformitetit në produktet e tyre (DIC); 8) Hartimi dhe zbatimi i programit sektorial për mbikëqyrjen e tregut sipas legjislacionit në fuqi dhe fuqizimi i rolit të Trupit për Koordinimin e Mbikëqyrjes së Tregut në lidhje me implementimin e legjislacionit teknik për fusha të caktuara të produkteve duke i vënë në prioritet/fokus produktet e ndërtimit (Inspektorati i Tregut); 9)

Studim fillestar për legjislacionin kombëtar që mbulon grupe të caktuara të produkteve për plotësimin e obligimeve nga nenet 34-36 TFEU (DIC); 10) Nënshkrimi i marrëveshjes multilaterale (MLA), respektivisht bilaterale (BLA) me Korporatën Evropiane të Akreditimit (EA) për laboratorët testues, që nënkupton njohjen reciproke të test raporteve të lëshuar nga këta laboratorë;

b. Aktivitetet e planifikuara për 2020: 1) Vlerësimi mbi zbatimin e programit sektorial për Mbikëqyrjen e Tregut, në lidhje me implementimin e legjislacionit teknik për produktet e ndërtimit (Inspektorati i Tregut); 2) Zgjerimi i skemave të akreditimit sipas kërkesave të reja (EN ISO/IEC 17065) duke përfshirë edhe ato të rregullave teknike (DAK); 3) zgjerimi i fushave të metrologjisë (themelimi i laboratorëve për para paketim dhe akreditimi i laboratorëve të AMK-së.) (AMK). 4) Hartimi i planit kombëtar për plotësimin e obligimeve nga nenet 34-36 TFEU që rregullojnë lëvizjen e lirë të mallrave (DIC); 5) Anëtarësimi i AMK-së në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare përkatëse (BIPM);

c. Aktivitetet e planifikuara për 2021: 1) Rishikimi i ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve (DIC). 2) Hartimi i akteve nënligjore për produktet e ndërtimit si: dyer dhe dritare, betoni, agregatet dhe produktet e betonit (DIC). 3) Nënshkrimi i marrëveshjes multilaterale (MLA), respektivisht bilaterale (BLA) me Korporatën Evropiane të Akreditimit (EA) për trupat inspektues dhe certifikues (DAK);

Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri: Sistem rregullator i qëndrueshëm i cili iu mundëson prodhuesve vendor që duke përmirësuar sigurinë dhe cilësinë e produkteve ndërtimore të jenë konkurrues me produktet të cilat kanë shenjën CE, vendosje në treg e produkteve të certifikuara të nivelit të njëjtë me produktet e vendeve të Bashkimit Evropian. Ky sistem do të siguron ngritje të aftësive konkurruese të bizneseve duke iu mundësuar qasjen e tyre në tregjet ndërkombëtare dhe në zvogëlimin e disbalancit tregtar për produktet e ndërtimit. Bizneset më konkurruese mundësojnë një mjedis më të mirë për rritjen e punësimit dhe kështu japin bazë për një rritje të qëndrueshme.

Indikatorët kyç të performancës:

- a) Bilanci tregtar i produkteve të ndërtimit ishte rreth minus 208.52 milionë euro në vitin 2016, duke arritur në minus 232.85 milionë euro në vitin 2017. Objektivi për vitin 2021 është që bilanci tregtar të jetë minus 155 milionë euro

Kostoja e vlerësuar e aktiviteve dhe burimi i financimit: Kostoja totale për zbatimin e masës për tri vitet e ardhshme është 2,204,329.32, përkatësisht 687,358.66 Euro për vitin 2019, 930,104.00 euro për vitin 2020 dhe 586,866.66 euro për vitin 2021. Nga këto fonde 430,599.32 euro sigurohen nga buxheti qendror (136,866.66 euro për vitin 2019, 156.866.00 euro për vitin 2020 dhe 136.866.66 për vitin 2021). Nga fondet e IPA shuma totale e financuar do të jetë 500,000 euro, e ndarë në vite: 150,000.00 për vitin 2019; 200,000.00 për vitin 2020 dhe 150,000.00 për vitin 2021. Ndërsa përmes projektit të huasë të Bankës Botërore shuma totale e financimit është: 1,273,730.00 euro, përkatësisht 400,492.00 për vitin 2019, 573,238.00 për vitin 2020 dhe 300,000.00 për vitin 2021.

Ndikimi i pritshëm në punësim dhe çështje gjinore: Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit rregullator për produktet e ndërtimit pritet të ketë edhe ndikim më të gjerë në shoqëri përmes nxitjes së investimeve në sektorin privat, hapjen e vendeve të reja të punës si dhe nxitjen e bizneseve që të zbatojnë standardet për të arritur sigurinë dhe cilësinë e produkteve ndërtimore dhe shërbimeve të palët e interesit.

Gjithashtu masa pritet të ketë ndikim edhe më të madh në shoqëri duke nxitur investimet e sektorit privat, hapjen e vendeve të reja të punës si dhe inkurajimin e bizneseve për të zbatuar standardet të arrijë sigurinë dhe cilësinë e produkteve ndërtimore dhe shërbimeve të palëve të interesuara.

Rreziqet potenciale: Rreziqet e mundshme për realizimin e kësaj mase mund të jenë mos anëtarësimi në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare, vonesat në miratimin dhe zbatimin e legjislacionit si dhe mungesa e kapaciteteve teknike profesionale.

4.3.6. ARSIMI DHE SHKATHËSITË

a. Analiza e pengesave strukturore

Gjendja aktuale: Gjatë viteve të fundit është arritur një progres në zhvillimin e shkathtësive, përmirësimin e cilësisë dhe qasjes në arsim. Në vitin 2017-2018³³ përfshirja e fëmijëve në arsimin parashkollor (3-5 vjeç) ka qenë 36%, para-fillor (5 vjeç) 92.4 %. Në edukimin parashkollor 45.9 % janë femra, ndërsa 54.1% janë meshkuj. Në nivelin para fillor (mosha 5 vjeç) 48.2% janë femra ndërsa 51.8% janë meshkuj. Në institucionet parashkollore private në edukimin parashkollor janë 45.3% femra dhe 54.7% meshkuj ndërsa në nivelin para fillor 46.7% janë femra dhe 53.3% janë meshkuj. Në arsimin fillor (klasa 1-5) shkalla e regjistrimit bruto ka qenë 98,4 %, në arsimin e mesëm të ulët (klasa 6-9) 91,2% ndërsa në arsimin e mesëm të lartë (klasa 10-12) 90,2 %. Në testin e maturës në afatin e qershorit kalueshmëria ka qenë 73.3%, ndërsa në afatin e gushtit kalueshmëria ishte 62,7 %. Rezultati në testin e arritshmërisë të klasës së nëntë ka qenë 61%. MASHT me mbështetje të Projektit të BB është duke punuar në rritjen e besueshmërisë dhe vlefshmërisë së testeve kombëtare. Pas pjesëmarrjes së Kosovës në testin ndërkombëtar PISA në vitin 2015 për herë të parë (pozita e 69 nga 72 vende), në vitin 2018 është mbajtur faza finale ku pritet rritje krahasuar me vitin 2015. Që nga viti 2012 e deri më tani janë licencuar me licencë të karrierës 95 % e mësimitdhënësve të kualifikuar. Zhvillime pozitive janë arritur në programet e avancimit dhe rikualifikimit të mësimitdhënësve. Kjo përfshin trajnimin e vazhdueshëm të mësuesve (gjatë vitit 2017 janë trajnuar 9300 dhe gjat 2018 – 5412) për zbatimin e KK së re, për parafillor, klasën 1, 6 dhe 10 (për gjimnaze të përgjithshme). Megjithatë, zbatimi i vlerësimit të performancës së mësuesve duhet të bëhet për zhvillimin e karrierës së mësimitdhënësve (që do të ndikojnë në motivimin dhe përmirësimin e cilësisë në arsim), zhvillimin e një baze të dhënash për licencimin e mësimitdhënësve, qëndrueshmërinë e trajnimit, ngritjen e kapaciteteve të trajnerëve lidhur me kurrikula, përgatitjen e dy programeve të zhvillimit profesional të bazuara në Planin mësuesor për metodologjinë e mësimitdhënies, rishikimin e udhëzimit administrativ për financimin e mësimitdhënësve, hartimin e UA për ngritje në karrierë të mësimitdhënësve. Përfshirja e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë profesional në vitin 2017-2018 është 52.1% ndërsa në vitin shkollor 2016-2017 ka qenë 51.6%. MASHT me qëllim të përafrimit të AAP me tregun e punës ka hartuar draftin e kornizës së kurrikulës për sistemin e AAP në të cilën ka përfshirë edhe sektorin privat dhe palët e tjera me interes në këtë fushë, duke u bazuar u bazuar në nevojat e tregut të punës. Kjo kornizë është bazuar në klasifikimin e profesioneve të Kosovës (ISCO 08) që përdoret nga Kombet e Bashkuara, organizata ILO dhe përmban në të udhëzime për hartimin e standardeve të profesionit, kurrikulave bërthamë për profile në bashkëpunim me sektorin ekonomik dhe duke u bazuar në ISCED-Foet që janë fusha që përdoren nga UNESCO dhe OECD. Edhe pse është duke u punuar prapë se prapë ka nevojë të madhe për ndërlidhjen e tregut të punës me AAP, ngritje të kapaciteteve dhe bashkëpunim ndër-institucional për të siguruar qasje të njëjtë drejt hartimit të politikave qeveritare. Është rritur përfshirja në arsimin e lartë në vitet e fundit dhe shifrat aktuale e rendisin Kosovën në mesin e vendeve rajonale me më shumë studentë për 100.000 banorë. Numri i programeve të studimit ende mbetet i lartë në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë. Sfidë mbetet harmonizimi i programeve me kërkesat e tregut të punës. Një e arritur në këtë kontekst është edhe hartimi dhe miratimi i rregulloreve për trupat këshillëdhënëse në institucionet publike të arsimit të lartë ku edhe janë themeluar trupat këshillëdhënëse.

Pengesat strukturore: Pengesat kryesore në sektorët e arsimit janë horizontale dhe vertikale, kështu që lidhen drejtpërdrejt me nivelet e arsimit, por ka edhe pengesa të përbashkëta. Në këtë drejtim, në pengesat e arsimit parashkollor kanë të bëjnë me: përfshirje e ulët e fëmijëve në arsimin parashkollor, që vjen si rezultat i mungesës së infrastrukturës fizike, mos-financimit të duhur, rregullimi dhe licencimi i institucioneve private, zhvillimi profesional i edukatorëve dhe zhvillimi i instrumenteve kombëtare për përcaktimin e cilësisë së arsimit parashkollor janë sfida të cilat po ndikojnë në tërë sistemin e arsimit. Në arsimin e obliguar pengesat lidhen me përfshirjen e nxënësve, cilësinë, kjo është e evidente tek grupet e margjinalizuara, komunitetit rom, ashkali dhe egjiptianë dhe e nxënësve me aftësi të kufizuara. Zhvillimi i shkathtësive për shumicën e fushave përkatëse profesionale, sipas

³³ Në vitin 2016-2017 përfshirja në arsimin parashkollor (3-5 vjeç) ka qenë 33.9 %, para-fillor (5 vjeç) - 87.6 %, fillor 96.2 %, arsimin e mesëm të ulët 93.3 %, arsimin e mesëm të lartë 88.1%.

hulumtimeve nuk korrespondojnë me kërkesat dhe shkaktojnë efekte negative në zhvillimin ekonomik të vendit. Pengesat tjera vazhdojnë të mbesin trajnimi i mësimdhënësve në fushën pedagogjike, kualifikimi i instruktorëve, bashkëpunimi me bizneset për praktikë profesionale, pajisja e shkollave me infrastrukturë të TI. Mekanizmat dhe praktika e sigurimit të cilësisë ende mbeten të pazhvilluar; zhvillimi i mësimdhënësve sipas kriterëve dhe standardeve të kornizës strategjike për ZHPM dhe lidhja e gradave me sistemin e pagesave. Në përgjithësi, mospërputhja e arsimit dhe aftësisë profesionale me tregun e punës ndikon në zvogëlimin e investimeve dhe pengon zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe në rritjen e papunësisë dhe të varfërisë. Si rrjedhojë në aspektin afatgjatë pengesat e paraqitura ndikojnë në shkathhtësitë e fuqisë punëtore. Mos aprovimi dhe zbatimi i planit të veprimit për Kornizën e kurrikulit për sistemin e AAP-se, standardeve të profesionit, kurrikulave bërthame për profil për vitin shkollor 2018/2019 do të ketë efekte negative në fuqinë punëtore në sektorin ekonomik.

Duhet të bëhet analiza e shkathhtësive të nevojshme për identifikimin e sektorëve prioritarë për ta përkrahur në vazhdimësi me rishikimin e profileve profesionale dhe kurrikulave bërthame për profil.

b. Planet e reformave prioritare

Masa e reformës #16: Ngjitja e cilësisë në arsimin dhe aftësimin profesional bazuar në kërkesat e tregut të punës

Përshkrimi i masës: Ngjitja e cilësisë në arsimin dhe aftësimin profesional (AAP) synohet të arrihet përmes hartimit dhe rishikimit të standardeve, kurrikulave³⁴, materialeve mësimore dhe praktikës profesionale në ndërmarrje dhe shkollë, pajisjes së punëtorëve si dhe harmonizimit të AAP me kërkesat e tregut të punës përmes bashkëpunimit me ndërmarrjet. Në këtë drejtim, duhet të zbatohet UA për kushtet dhe kriteret që rregullojnë krijimin e formave të dyfishtë të arsimit dhe aftësimin profesional, në të cilin realizohen të mësuarit paraprak dhe përvojën në ndërmarrje. Kjo masë ndërlidhet me SKZH, PSAK, PKZMSA, KASH, ERA.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2019: 1) Hartimi i 25 standardeve të profesioni dhe verifikimi i tyre; 2) Trajnimi i 40 i instruktorëve/trajnerë dhe mësimdhënësve bazuar në kurrikulën e re; 3) Hartimi dhe pilotimi i formulës së financimit specifike për AAP bazuar në koston për profil; 4) Hartimi i materialeve mësimore bazuar në kurrikulën e re; 5) Pajisja e 10 shkollave profesionale me pajisje adekuate për profilet prioritare pas analizës së gjendjes; 6) Vazhdimi i lidhjes së marrëveshjeve shkollë-biznese për praktikë profesionale.

b. Aktivitetet e planifikuara për 2020: 1) Hartimi i standardeve të reja të profesioni dhe verifikimi i tyre sipas nevojës dhe kërkesës së tregut të punës; 2) Trajnimi i 40 i instruktorëve/trajnerëve dhe mësimdhënësve bazuar në kurrikulën bërthamë nga MASHT, MPMS; 3) Plotësim ndryshimi i formulës së Financimit të Grantit Specifik të Arsimit bazuar në koston për sektor dhe profil; 4) Hartimi i materialeve mësimore bazuar në kurrikulën e re sipas nevojës dhe kërkesës së tregut të punës; 5) Pajisja e 10 shkollave profesionale me pajisje adekuate për profilet prioritare pas analizës së gjendjes; 6) Vazhdimi i lidhjes së marrëveshjeve shkollë-biznese për praktikë profesionale.

c. Aktivitetet e planifikuara për 2021: 1) Monitorimi i implementimit të kurrikulave të integruara bazuar në standardet e profesionit; 2) Trajnimi i instruktorëve/trajnerëve dhe mësimdhënësve bazuar në mësimin në vendin e punës; 3) Pajisja e shkollave profesionale me pajisje adekuate për profilet prioritare pas analizës së gjendjes; 4) Vazhdimi i lidhjes së marrëveshjeve shkollë-biznese për praktikë profesionale.

Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri: Zbatimi i kësaj mase ndikon në zhvillimin e kompetencave të fuqisë punëtore, rrit cilësinë e produkteve dhe efikasitetin e ndërmarrjeve, nxit inovacionin, si dhe krijon mundësi për punësim dhe vetëpunësim deri në 30 % për periudhën 2019-2021.

Indikatorët kyç të performancës

³⁴ Kurrikulat bërthamë për profile nuk janë rishikuar për shkak se është hartuar dokumenti bazë për Kornizën e kurrikulit për AAP. Janë hartuar udhëzuesit për hartimin e kurrikulave bërthamë janë mbajtur trajnimet për mësimdhënësit bazuar në udhëzuesit. Formula e financimit për AAP është analizuar në bashkëpunim me institucionet e tjera relevante dhe këto analiza dhe të dhëna do të plotësojnë rishikimin e formulës financiare të arsimit parauniversitar, pjese e se ciles do të jetë edhe formula për AAP.

- a) Në vitin 2016 rreth 20 kurrikula janë inkuadruar në shkollat e AAP-së, ndryshe me vitin 2018 ku nuk ka pasur ndonjë kurrikul që është inkuadruar në këtë sistem. Për vitin 2021 caku është që të inkuadrohen 150 kurrikula në shkollat e AAP-së, ndërsa deri atëherë planifikohet inkuadrimi i gjithsej 300 kurrikulave (nga 2016 deri 2021).
- b) Gjithsej 40 mësimdhënës janë trajnuar për kurrikulën e re të AAP-së në vitin 2017. Një rritje e mëtejshme planifikohet për vitin 2021 me synim që të trajnohen 230 mësimdhënës.

Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit: Kostoja totale për zbatimin e kësaj mase pritet të jetë rreth 3,795,144.00 EUR për vitet 2019-2022, prej nga 150,000.00 janë nga buxheti qendror, 3,000,144.00 EUR janë nga buxheti komunal dhe 645,000.00 janë të planifikuara nga grantet tjera. Për vitin 2019 totali i masës është 1,759,048.00 EUR, prej nga 105,000.00 EUR nga buxheti qendror, 1,000,048.00 EUR janë nga buxheti komunal nga kategoria mallra dhe shërbime dhe 645,000.00 EUR grante të tjera. Për vitin 2020 janë 30,000.00 EUR nga buxheti qendror dhe 1,000,048.00 EUR nga buxheti komunal nga kategoria mallra dhe shërbime. Për vitin 2021 janë 15,000.00 EUR nga buxheti qendror dhe 1,000,048.00 EUR nga buxheti komunal nga kategoria mallra dhe shërbime.

Ndikimi pritshëm në punësim dhe çështje gjinore: Kjo masë në aspektin afatgjatë rrit cilësinë në sistemin arsimor, mundësinë e punësimit, përmirëson cilësinë e fuqisë punëtore, kontribuon në rritjen e investimeve dhe zhvillimin ekonomik.

Rreziqet e mundshme: Procedurat e prokurimit për implementim të planeve për implementim janë rreziqe që na kanë përcjellë gjatë implementimit të planit të veprimit të vitit 2018 për realizim të aktiviteteve.

Masa e reformës #17: Përmirësimi i cilësisë dhe rritja e përfshirjes së fëmijëve në arsimin parauniversitar

Përshkrimi i masës: Bazuar në PSAK dhe SKZH, përmes kësaj mase do të adresohet infrastruktura ligjore dhe fizike për të rritur përfshirjen e fëmijëve në arsimin parashkollor, do të zhvillohen programe cilësore të cilat do të kenë efekt në ndërtimin e shkathtësive bazë dhe reduktimin e pabarazive dhe përgatitjen e studentëve me njohuritë dhe shkathtësitë që do të rezultojnë me cilësinë e të nxënësve në nivele të tjera. Rritjen e përfshirjes dhe mundësive të barabarta për zhvillim, arsim dhe trajnim të çdo individi në arsimin parauniversitar dhe ky qëllim duhet të arrihet përmes rritjes së numrit të institucioneve publike parashkollore dhe hartimit të kurrikulës bërthamë për arsimin parashkollor. Pas miratimit të Koncept Dokumentit, Ligji për Edukimin e Fëmijërisë së Hershme do të hartohet në vitin 2019, i cili do të rregullojë dhe sqarojë standardet e kërkuara dhe të nevojshme për të plotësuar nevojat e fëmijëve për arsim dhe kujdes në nivelin e fëmijërisë së hershme. Kjo masë ndërlidhet me drejtpërsëdrejti me prioritetet e Qeverisë, Kornizën Strategjike të BE-së 2020, SKZh, PSAK, PZMSA KASH.

a) Aktivitetet e planifikuara për 2019: Ligji për Edukimin e Fëmijërisë së Hershme (MEST); 2) Përfundimi i 4 objekteve të reja të institucioneve parashkollore; 3) Zhvillimi dhe zbatimi i programeve mësimore sipas lëndëve dhe klasave³⁵; 4) Zhvillim profesional i mësimdhënësve duke u bazuar në programet me prioritetet e MASHT dhe vlerësimi i performancës së mësimdhënësve

b. Aktivitetet e planifikuara për 2020: 1) Finalizimi, pilotimi dhe monitorimi i kurrikulit bërthamë për edukimin e fëmijërisë së hershme për moshën 0-5 vjeç në 7 institucione parashkollore; 2) Përfundimi i ndërtimit të 3 objekteve të reja të institucioneve parashkollore; 3) Zhvillimi dhe zbatimi i programeve mësimore sipas lëndëve dhe klasave³⁶; 4) Vazhdimi i ripërtëritjes së licencës, gradimi

³⁵ Hartimi i draft programeve lëndore për klasat 4,5,9 të cilat si draft zbatohen në gjitha shkollat pilot gjatë vitit shkollor 2019/2020, hartimi i programeve për gjuhën shqipe për nxënësit e komunitetit jo shqiptarë për klasat 4,7,11; Rishikimi dhe finalizimi i programeve lëndore për klasat: 3,8,12, për gjuhën shqipe, turke dhe boshnjake në 2019/2020 zbatohen në gjitha shkollat e Kosovës.

³⁶ Rishikimi dhe finalizimi i programeve lëndore (për klasat 4,5,9, të cilat në vitin 2020/2021, do të zbatohen në gjitha shkollat e Kosovës. Hartimi i programeve për Gjuhën shqipe për nxënësit e komunitetit jo shqiptarë për klasat 5,8,9,12; këto programe zbatohen (PILOTOHEN) në gjitha shkollat, ku nxënësit e zgjedhin këtë lëndë gjatë vitit shkollor 2019/2020);

për 200 mësimdhënës që paraqet 3% të mësimdhënësve; 5) Zhvillim profesional i mësimdhënësve duke u bazuar në programet me prioritet të MASHT dhe vlerësimi i performancës së mësimdhënësve³⁷,

c. Aktivitetet e planifikuara për 2021: 1) Zbatimi i kurrikulës bërthamë për edukim në fëmijërinë e hershme mosha 0-5 vjeç në të gjitha institucionet parashkollore; 2) Fillimi i ndërtimit të 1 objekti dhe përfundimi i 6 objekteve të reja të institucioneve parashkollore; 3) Zbatimi i kurikulave lëndore / programeve mësimore³⁸; 4) Vlerësimi i procesit të zbatimit të Kurrikulës;

Ndikimi i prishëm në konkurrueshmëri/arsyetimi i masës: Kjo masë ndikon në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies, në përgatitjen e nxënësve për jetë. Gjithashtu përmirëson rritjen e përfshirjes në arsimin para-universitar me fokus te veçantë në arsimin parashkollor, e cila ndikon në ngritjen e cilësisë në arsim dhe në minimizimin e pabarazive në shoqëri, luftimin e diskriminimit, shmangien e marginalizimit dhe të përjashtimit, si dhe sigurimin e mirëqenies për të gjithë.

Indikatorët kyç të performancës:

- a) Treguesi që mat rritjen e numrit të fëmijëve në institucionet parashkollore për 3-5 vjeçar ishte 33.6% për vitin akademik 2016/17, ndërsa objektivi për vitin akademik 2021/22 është 44%.
 - a. Për 5 vjeçar, indikator i që mat rritjen e numrit të fëmijëve në institucionet parashkollore ishte 87.6% për vitin akademik 2016/17 ndërsa objektivi për vitin akademik 2021/22 është 100%.
- b) Gjithsej 4500 mësimdhënës janë trajnuar për zbatimin e kurrikulës së re dhe programeve të tjera në vitin 2016. Në vitin 2021, numri i mësuesve që marrin pjesë në këto trajnime synohet të jetë 6000, si rezultat i të cilave gjithsej 36,712 mësimdhënës pritet të trajnohen në këtë aspekt.
- c) Vlera e arritshmërisë në testin ndërkombëtar të PISA në vitin 2015 ishte 347 për lexim, 378 për shkencën dhe 362 për matematikë. Objektivi është që të tejkalohet 430 në të tri fushat në vitin 2021.

Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit: Kostoja totale për 2019-2021 pritet të jetë 8,430,892 euro. Për vitin 2019, janë planifikuar 6,688,161 euro, prej të cilave 1,688,161 euro janë nga buxheti qendror dhe 5,000,000 euro nga IPA. Për vitin 2020, 909.970 euro janë planifikuar nga buxheti qendror dhe për vitin 2021, 832.761 euro janë planifikuar nga buxheti qendror.

Ndikimi prishëm në punësim dhe çështje gjinore: Kjo masë rrit mundësitë për avancimin e mësimdhënësve pa dallime gjinore punësim dhe cilësinë e zbatimit të reformës në sistemit arsimor, i cili do të përmirësojë cilësinë e fuqisë punëtore dhe kontribuojë në rritjen e investimeve dhe zhvillim ekonomik. Gjithashtu ndihmon në parandalimin e varfërisë, integrimin për të gjithë pjesëtarët e shoqërisë.

Rreziqet e mundshme: Mos qëndrueshmëria deri në përfundim të ciklit të reformës, mos-mobilizimi i mekanizmave për zbatim të Kurrikulës si MASHT, DKA, Shkollë, Prind, kapacitete të kufizuara për zbatim në nivel komunal, koordinimi në nivel qendror dhe lokal.

Masa e reformës #18: Reforma në Arsimin e Lartë

Përshkrimi i masës: Reforma në arsimin e lartë synon të arrihet nëpërmjet kompletimit dhe zbatimit të infrastrukturës ligjore të arsimit të lartë,³⁹ avancimit dhe zhvillimit të mekanizmave për sigurimin e cilësisë dhe rritjes së pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore. Kjo masë ndërlihet me SKZH, PSAK, ERA, PKZMSA dhe KASH.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2019: 1) Kompletimi dhe zbatimi i infrastrukturës ligjore të arsimit të lartë (miratimi i Ligjit për Arsimin e Lartë dhe kompletimi i legjislacionit sekondar); 2) Draftimi

³⁷ Sipas ligjit nr. 06/L- 46 te inspektoratit te arsimit i cili eshte fuqizuar nga 27 gushti 2018.

³⁸ Zbatimi i kurikulave lëndore / programeve mësimore për klasat 4,5,9, të cilat në vitin 2020/2021, do të zbatohen në gjitha shkollat e Kosovës. Zbatimi i programeve mësimore për Gjuhën shqipe për nxënësit e komuniteteve jo shqiptare për klasat 5,8,9,12; këto programe zbatohen në gjitha shkollat, ku nxënësit e zgjedhin këtë lëndë gjatë vitit shkollor 2020/2021)

³⁹ Ligji i arsimit të lartë është rishikuar sërish dhe aktualisht është në procedurë parlamentare për miratim.

dhe miratimi i ligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim; 3) Aplikimi i standardeve të reja ndërkombëtare (ri-vlerësimi nga ENQA dhe EQAR) ; 4) Hartimi i UA për formulën e financimit të IAL; 5) Rritja e pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore; 6) Nënshkrimi i Marrëveshjes rajonale për Profesionet e Rregulluara; 7) Krijimi i bazës së të dhënave për kualifikimet profesionale bazuar në bazën e të dhënave të BE-së për kualifikime profesionale.

b. Aktivitetet e planifikuara për 2020: 1) Hartimi i akteve nënligjore që plotësojnë Ligjin e AKA; 2) Krijimi i mekanizmave për monitorimin e cilësisë në arsimin e lartë; 3) Rritja e pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore. 4) Harmonizimi i programeve akademike me tregun e punës; 5) Analiza rreth profilizimit të IAL-ve; 6) Pilotimi i një profesioni të rregulluar.

c. Aktivitetet e planifikuara për 2021: 1) Avancimi i mekanizmave për monitorimin e cilësisë në arsimin e lartë; 2) Fillimi i procesit të profilizimit të IAL-ve; 3) Rritja e pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore; 4) Harmonizimi i programeve akademike me tregun e punës; 5) Pilotimi i dy profesioneve të rregulluara.

Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri/arsyetimi i masës: Zbatimi i aktiviteteve të parapara në kuadër të kësaj mase ndikon në rritjen e konkurrueshmërisë së IAL si dhe krijimin e vendeve të reja të punës, zvogëlimin e pabarazive dhe nivelit të varfërisë.

Indikatorët kyç të performancës

- Raporti profesor-student është vlerësuar vlerën 1.67 të vitit 2016. Në vitin 2021, objektivi është që ky raport të jetë 1.29.
- Numri i raporteve të mobilitetit/bursave në programet ndërkombëtare ishte 98 në 2016 dhe është rritur në 220 në vitin 2018. Në vitet e ardhshme kjo vlerë pritet të rritet më tej me objektivin që të jetë 250 në vitin 2021.

Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit: Kostoja totale e zbatimit të kësaj mase për 2019-2021 pritet të jetë 3.177.781 €. Për vitin 2019, kostoja totale është 1,095,527 € nga të cilat 792,707 € janë nga BRK, ndërsa 302,820 € nga grantet tjera. Kostoja totale për vitin 2020 është 1,101,127 €, nga të cilat 798,307 € nga buxheti qendror, ndërsa 302,820 € nga grantet tjera dhe kostoja totale për 2021 është 981,127 €, nga të cilat 678,307 € nga buxheti qendror dhe 302,820 € nga grantet tjera.

Ndikimi i pritshëm në punësim dhe çështje gjinore: Fokusi kryesor është krijimi i sistemit për analizën e tregut të punës në nivel nacional, rajonal dhe lokal për krijimin e mekanizmave për një parashikim të shkathtësive sektoriale, në bazë të sondazheve të punëdhënësve dhe punëmarrësve, për t'u plotësuar kërkesën aktuale për ofrues të arsimit të lartë, për ata që diplomojnë dhe për pjesëmarrësit në tregun e punës. Informatat e mbledhura për tregun e punës duhet të përfshijnë mekanizmat për të vlerësuar qasjen, pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e femrave dhe meshkujve në tregun e punës, si dhe masat e mundshme që mund të ndërmerren për të zbutur çfarëdo mospërputhje.

Rreziqet e mundshme: Mospunësueshmëria e të diplomuarve për shkak të problemeve strukturore ekonomike të sektorit publik dhe privat në Kosovë, si dhe prolongimi i miratimit të ligjit të arsimit të lartë dhe akteve përkatëse.

4.3.7 PUNËSIMI DHE TREGU I PUNËS

Analiza e pengesave kryesore

Gjendja aktuale: Pothuajse dy të tretat e popullsisë së Kosovës është në moshë pune (15-64 vjeç). Pritet që popullsia në moshë pune të rritet shpejt gjatë dekadës së ardhshme pasi Kosova është ndër vendet me popullsinë më të re në Evropë. Nga popullsia në moshë pune, edhe pse ka lëvizje të lehta në krahasim me vitin 2016, ende 57.2 % nuk janë ekonomikisht aktivë (në vitin 2016 ishin 61.3%), që do të thotë se ata nuk janë të punësuar dhe nuk kanë qenë aktivë në kërkim të punësimit gjatë katër javëve të kaluara dhe/ose nuk janë të gatshëm të fillojnë punë brenda dy javësh. Nga 42.8 % e popullsisë, që janë ekonomikisht aktivë (në vitin 2016 ishte 38.7 %), 30.5 % (156,583 persona) janë të papunë (në vitin 2016 ishte 27.5 % apo 126,070 persona). Kjo do të thotë se 69.5% (357,095) e

personave ekonomikisht aktivë janë të punësuar, duke krijuar një raport punësimi ndaj popullsisë (shkalla e punësimit) prej 29.8 %. Ende ekzistojnë dallime të mëdha gjinore në tërë tregun e punës. Vetëm një në pesë (20.0 %) femra në moshë pune janë aktive në tregun e punës në vitin 2016 ishin 18.6%), krahasuar me rreth tri të pestat (65.3 %) e meshkujve në moshë pune (në vitin 2016 ishin 58.3). Në mesin e fuqisë punëtore, papunësia është më e lartë për femrat se sa për meshkujt (36.6 % krahasuar me 28.7 %) (në vitin 2016 ishin 31.8 % krahasuar me 26.2 %). Shkalla e punësimit në mesin e femrave në moshë pune është vetëm 12.7 %, krahasuar me 46.6 % për meshkujt, vlera përafërsisht të njëjta me vitin paraprak. Kjo shkallë shumë e ulët e papunësisë te femrat rrjedh nga kombinimi i pjesëmarrjes shumë të ulët në fuqinë punëtore dhe papunësisë së lartë. Femrat ishin të punësuar kryesisht në sektorët e arsimit, të shëndetësisë dhe tregtisë (48.4 % e femrave të punësuar). Meshkujt ishin kryesisht të punësuar në sektorët e ndërtimit, prodhimit dhe tregtisë (duke punësuar me 45.9 % të meshkujve të punësuar).

	2. Vlerësimi i të gjitha inspektimeve që bëhen sot, i pasuar me eliminimin e aktivitetëve të panevojshme ose shkrirjen e aktivitetëve inspektuese.	4
Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse zbatimi është i pjesshëm apo nuk është zbatuar fare	1. Koncepti Dokumenti është miratuar dhe ligji është hartuar, por nevojiten konsultime të mëtejshme pasi që janë përfshirë shumë akter, dhe plani është që ligji të miratohet gjatë vitit 2019.	
	2. Inspektimet ekzistuese janë vlerësuar gjatë hartimit të konceptit dokumentit, struktura e re do të miratohet pas miratimit të ligjit horizontal në inspektim dhe plani është të miratohet struktura e re deri në fund të këtij viti	
Masa e reformës #12: Përmirësimi i mjedisit për Inovacion dhe Ndërmarrësi		Faza e zbatimit të reformës(1-5)
	1. Hartimi dhe miratimi i akteve tjera nënligjore që rrjedhin nga Ligji për Inovacion dhe Transferimin e Diturisë dhe Teknologjisë	0

Aktivitetet e planifikuara për 2018	2. Hartimi dhe Miratimi i Ligjit për Inovacion dhe Ndërmarrësi (MIN) dhe Strategjisë së Inovacionit (MIE);	4
	3. Hartimi i infrastrukturës ligjore sekondare bazuar në Ligjin për Inovacion dhe Ndërmarrësi (MIE);	0
	4. Zhvillimi i inkubatorëve të biznesit dhe të paktën 3 qendrave të ndryshme inovative	5
	5. Zhvillimi i ideve inovative dhe ndërmarrësisë nëpërmjet programeve trajnuese/konsultim;	0
	6. Funkcionalizimi i Këshillit Shtetëror për Inovacion dhe Ndërmarrësi;	5
	7. Mbështetja direkte financiare e NVM, “start-up” bizneseve, iniciativave private me qëllim të zhvillimit të produkteve, proceseve dhe shërbimeve të reja.	4
Përshkrimi i implementimit dhe shpjegimi nëse implementimi është i pjesshëm apo nuk është implementuar fare	1. Hartimi i legjislacionit dytësor që rrjedh nga Ligji për Inovacion dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë ende nuk ka filluar	
	2. Koncept Dokumenti për Projektligjin për Inovacionin dhe Ndërmarrësinë është hartuar dhe pritet të miratohet në TM3 2019. Strategjia Kombëtare për Inovacion dhe Ndërmarrësi është në fazën e konsultimit publik dhe pritet të miratohet në TM1 2019	
	3. Infrastruktura ligjore sekondare e bazuar në Ligjin për Inovacionin dhe Ndërmarrësi shtyhet për TM1 2020.	
	4. Në vitin 2018, MIE ka krijuar 2 Qendra Rajonale për Inovacion dhe Ndërmarrësi: në kuadër të objektit të Fakultetit të Makinerisë dhe Inxhinierisë në Prishtinë dhe në ish-shtëpinë e kulturës në Ferizaj, në bashkëpunim të ngushtë me komunën dhe universitetin. Ndërsa janë në proces të krijimit të qendrave për Inovacion dhe Ndërmarrësi në Universitetin Publik “Isa Boletini” në Mitrovicë dhe Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë. Transformimi i kampit të KFOR-it Gjerman në Prizren në “Parkun për Inovacion dhe Trajnim” është një projekt i përbashkët i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë Federale të Gjermanisë. MIE do të jetë autoriteti implementues në emër të Qeverisë së Kosovës. Për këtë destinacion, MIE do të investoj 8 milion euro për 3 vite.	
	5. Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe ideve inovative përmes programeve trajnuese/konsultimit do të fillojë në vitin 2019 gjatë fazës së ideve fillestare (start-up) dhe projekteve, (aplikantët përfitues të granteve) do të zhvillojnë idetë për produkte dhe shërbime të reja në Qendrat rajonale për Inovacion dhe Ndërmarrësi.	
	6. Këshilli Kombëtar për Inovacionin dhe Ndërmarrësinë është funksional.	
	7. Është lansuar programi për mbështetje të drejtpërdrejtë financiare për vitin 2018. Nga 7.15 milion euro të ndara për kategorinë e subvencioneve dhe transferimeve kanë përfituar skemat e mëposhtme të granteve: 2.3 milionë euro për 63 OJQ përfituese ; 1.2 milion euro për 160 "start-upe" përfituese; 3.0 milion euro për NVM - nuk ka përfitues, kjo skemë është anuluar për shkak të tejkalimit të afateve ligjore për ekzekutimin e pagesave nga buxheti qeveritar. 1.2 +1.2 milion euro nga fondi për NVM-të, MIE dhe projekti CETEP janë në fazën e vlerësimit të zbatimit - organi implementues është ICK (Qendra Kosovare për Inovacion)	
Masa e reformës #13: Shtrirja e infrastrukturës përkatëse të rrjetave dhe shërbimeve të TIK-ut për zhvillim socio-ekonomik		Faza e zbatimit të reformës(1-5)
Aktivitetet e planifikuara për 2018	1) Realizimi i Pilot Projektit për shtrirjen e infrastrukturës brez-gjerë që do të përfshijë katër apo më shumë lloje (zonat rurale);	5
	2) Finalizimi i marrëveshjes me Bankën Botërore (BB) për kredinë që përfshinë investimet gjatë viteve të ardhshme për realizimin e Programit KODE;	5
	3) Adaptimi dhe funksionalizimi i parkut teknologjik për nevoja të bizneseve të TIK.	4

<p>Përshkrimi i implementimit dhe shpjegimi nëse implementimi është i pjesshëm apo nuk është implementuar fare</p>	<p>1. Si pjesë e përgatitjeve për komponentin e përfshirjes digjitale të programit KODE, Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, gjatë këtij viti ka zbatuar një sërë pilot-projektsh për zgjerimin e infrastrukturës brez-gjerë në zonat e pambuluara rurale. Janë zbatuar katërbëdhjetë (14) pilot projekte për zgjerimin e infrastrukturës brez-gjerë, duke përfshirë 40 fshatra. Pilot projektet e përfunduara janë:: Lot 1 – Breznicë-Kozaricë; Lot 2 – Oshlan-Hercegovë-Balincë-Liqej; Lot 3 – Pjetërshan-Kusar-Dol; Lot 4 – Pouskë. Gjithashtu, janë në fazën e realizimit lotet: Lot 5 – Zym-Karashëngjergj; Lot 6 – Stubëll e Epërme-Leticë; Lot 7 – Pobërxhë-Voksh-Bogë; Lot 8 - Rahovë-Zhazhë-Lipë-Boletin; Lot 9 - Gërgoc-Zhabel-Bardhaniq-Ratish; Lot 10 – Gadish-Sllakovc-Kishnapol-Zhegoc-Vërbicë e Zhegocit; Lot 11 – Llabjan-Dragoc; Lot 12 – Prapashticë-Koliq-Keqekollë; Lot 13 – Rekë e Allagës - Joshanicë (Stankaj); and Lot 14 – Firzë-Zhub-Zylfaj.</p> <p>Për zbatimin e këtyre katërbëdhjetë pilotëve, është shpenzuar buxheti në shumën prej € 1,190,000.</p> <p>2. Marrëveshja për financim mes Ministrisë së Financave dhe Bankës Botërore në shumën prej 20.7 milionë euro është nënshkruar më 20 korrik të vitit 2018. Ndërsa, Ligji për Ratifikimin e kësaj Marrëveshjeje është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 20.09. 2018. Gjatë muajve nëntor-dhjetor u themelua Njësia për Zbatimin e KODE dhe që nga fillimi i vitit 2019 do të fillojë zbatimi i këtij programi.</p> <p>3. Është duke u zbatuar projekti për aprovimin dhe operacionalizimin e parkut teknologjik për bizneset e TIK. Si pjesë e marrëveshjes me përfituesin - STIKK (Shoqata për Teknologji Informative të Kosovës), MZHE ka marrë përsipër realizimin e shumicës së punëve të nevojshme për aprovimin dhe operacionalizimin e parkut (punimet arkitekturale, makinerisë, energjisë elektrike, ujit dhe kanalizimit) . Kjo pjesë e punës pothuajse është përfunduar, apo shprehur në përqindje, rreth 90% e realizuar.</p>	
<p>Masa e reformës #14: Lehtësimi i tregtisë përmes rritjes së efikasitetit për kosto të transaksioneve tregtare ndërkombëtare</p>		<p>Faza e zbatimit të reformës(1-5)</p>
<p>Aktivitetet e planifikuara për 2018</p>	<p>1) Ndërtimi i një platforme për identifikimin e kërkesave për bashkimin e sistemeve të institucioneve kryesore në kuadër të Dritares së Vetme Kombëtare (që përfshinë të gjitha kërkesat dhe nevojat për zhvillimin e sistemeve nga institucionet);</p> <p>2) Rregullimi i tarifave për shfrytëzim të terminaleve doganore përmes hartimit të Udhëzimit Administrativë për Menaxhimin e Terminaleve Doganore;</p> <p>3) Zhvillimi i Legjislacionit për nënshkrimin digjital;</p> <p>4) Përgatitja e platformës, procedurave dhe kërkesës për aderim në NCTS;</p> <p>5) Zbatimi i sistemit për menaxhimin e kontratës (ECM)</p>	<p>2</p> <p>2</p> <p>2</p> <p>3</p> <p>5</p>
<p>Përshkrimi i implementimit dhe shpjegimi nëse implementimi është i pjesshëm apo</p>	<p>1. Takim i organizuar nga Banka Botërore me Administratën Doganore dhe MTI u mbajt në nëntor të vitit 2018. Qëllimi i takimit ishte të zhvillojë një studim të analizës së boshllëqeve mbi zbatimin e konceptit të “dritares së vetme kombëtare”.</p> <p>2. Është hartuar Udhëzimi Administrativ për Përdorimin dhe Menaxhimin e Terminaleve Doganor dhe është dërguar për procedura të mëtejshme në Ministrinë e Financave</p> <p>3. Projektligji për Nënshkrimin Digjital është hartuar dhe i është dërguar Kuvendit për procedurat e mëtutjeshme.</p> <p>4. Në prill të vitit 2018, Ministria e Financave i ka dërguar DG TAXUD kërkesën për anëtarësimin e Kosovës në CTC si dhe marrjen e statusit të vëzhguesit në Grupin e Përbashkët Punues të Vendeve Tranzit të BE-së dhe vendimi pritet të merret në mbledhjen e Komitetit të Përbashkëta që do të mbahet më 4 dhjetor 2018 në Bruksel.</p>	

nuk është implementuar fare	5. Instalimi i moduleve për ECM është përfunduar dhe tani Administrata Doganore është në fazën përgatitore të testimit dhe pritet të prezantoj modulet e përfunduara. Modulet për digjitalizimin e procesit të punës janë përfunduar për: Zyrën e Arkivit, Bashkëpunimit Ndërkombëtar, Tarifës, Vlerësimit, Laboratorit, Origjinës, Ndikimit Ekonomik, Akciza etj., dhe nga 1 janari 2019 do të fillojë përdorimi.	
Masa e reformës #15: Zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës së cilësisë dhe fuqizimi i rolit të autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut me fokus produktet e ndërtimit		Faza e zbatimit të reformës(1-5)
Aktivitetet e planifikuara për 2018	1) Miratimi i pakos ligjore në lidhje me infrastrukturën e cilësisë: Ligji për standardizim, ligji për produkte të ndërtimit, ligji për metrologji dhe ligji për Kërkesa Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit;	5
	2) Miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e ligjeve nën aktivitetin 1;	4
	3) Adoptimi i standardeve të reja duke i dhënë prioritet standardeve të harmonizuara për produktet e ndërtimit;	4
	4) Nënshkrimi i marrëveshjes multilaterale me Korporatën Evropiane të Akreditimit për laboratorët testues;	0
	5) Ngritja e sistemit të menaxhimit të cilësisë për laboratorët e metrologjisë;	4
	6) Promovimi i infrastrukturës së cilësisë duke ofruar asistencë specifike teknike për prodhuesit e produkteve ndërtimore.	4
Përshkrimi i implementimit dhe shpjegimi nëse implementimi është i pjesshëm apo nuk është implementuar fare	1. Gjatë kësaj periudhe janë miratuar 4 ligje: Ligji Nr. 06/L-019 për Standardizim, Ligji nr. 06/L-033 për Produktet Ndërtimore, Ligji nr.06/L-037 për Metrologjinë dhe Ligjin nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësimin e Konformitetit;	
	2. 12 aktet nënligjore të miratuara për zbatimin e ligjeve nën aktivitetin 1. I vetmi përjashtim është akti nënligjor që rrjedh nga Ligji për Produktet Ndërtimore.	
	3. Gjatë kësaj periudhe, 587 standarde evropiane janë miratuar si standarde të Kosovës.	
	4. Marrëveshja shumëpalëshe me Bashkëpunimin Evropian për Akreditim (EA) për laboratorët testues nuk është nënshkruar për shkak të vonësave në rregullimin/përcaktimin e strukturës organizative të DAK. Funkcionimi i Sistemit të Menaxhimit të DAK ka hasur në stagnim, prandaj DAK nuk ka arritur të bëjë mbylljen e mos-konformiteteve, që ishte kushti fillestar që duhej përbushur para se të kërkohej nga "Bashkëpunimi Evropian për Akreditim" të caktojë ekipin e vlerësimit në nëntor 2018. Në nëntor të vitit 2018 është emëruar Drejtori i ri i Përgjithshëm i DAK	
	5. Procesi ka filluar për 4 laboratorë të metrologjisë: laboratorin e masës, termometrisë, vëllimit si dhe shtypjes dhe forcës së rrjedhës	
	6. Tre (3) trajnerë nga projekti i SIDA "Infrastruktura e Cilësisë në vendet e Ballkanit Perëndimor" janë certifikuar dhe do të ofrojnë trajnime për prodhuesit e produkteve ndërtimore. Për më tepër, me mbështetjen e këtij projekti, për prodhuesit janë hartuar "Udhëzuesit për Produktet Ndërtimore". Ky aktivitet është zhvilluar më 18 dhjetor të vitit 2018.	
Masa e reformës #16: Harmonizimi i ofertës dhe kërkesës të shkathësive përmes hartimit të standardeve të profesionit dhe rishikimit të kurrikulave		Faza e zbatimit të reformës(1-5)
Aktivitetet e planifikuara për 2018	1) Hartimi i 25 standardeve të profesionit të cilat verifikohen nga AKK;	4
	2) Rishikimi i 20 kurrikulave të AAP dhe trajnimi i 40 trajnerëve dhe mësuesve bazuar në kurrikulën bërthamë;	3
	3) Rishikimi i formulës së financimit specifike për arsim dhe aftësim profesional bazuar në koston për sektor dhe profil.	2

Përshkrimi i implementimit dhe shpjegimi nëse implementimi është i pjesshëm apo nuk është implementuar fare	1. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve gjatë vitit 2018 ka verifikuar gjithsej 11 standarde profesionale: 1.Instruktor i shoferëve; 2.Kultivues i perimeve/ Kultivuese e perimeve; 3.Konservuesit e frutave , perimeve dhe të ngjashme; 4.Vreshtar/Vreshtare; 5.Rrobaqepësit, rrobaqepëset, gëzofpunuesit dhe kapelabërësit; 6.Modelist, prerës dhe punues të tekstilit dhe të tjerë të ngjashëm; 7.Agjent/agjente turistike dhe i/e informimit për udhëtimet; 8. Asistent i Nutricionizmit dhe Sigurisë së ushqimit; 9.Ndërtimtari; 10.Punëtorët e të mbjellave; 11.Punëtorët e prodhimit – Paketuesit me dorë. Janë hartuar këto standarde të profesionit: Dizajner i enterierit - prodhimet e drurit; Marangoz dhe zdrukthëtar. Teknik i Inxhinierisë Teknike (Niveli 5); Hidraulikë dhe teknik të ujësjellësit (niveli 4); Mekanika dhe instaluesit elektrik (niveli 4) dhe instaluesit dhe montuesit e kulmeve.	
	2. Bazuar në Vendimin me Nr. 2-2145 të Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT-it, është krijuar një grup ekspertësh dhe koordinatorësh për kurrikulat bërthamë të AAP. Grupi do të koordinojë procesin e përpilimit të programeve lëndore për klasat 10-12, ndërsa grupet e ekspertëve kanë filluar shqyrtimin e kurrikulave për klasën e 10. 40 trajnerët janë trajnuar dhe tani janë pjesë e grupeve punuese për rishikimin dhe hartimin e kurrikulave.	
	3. Sa i përket financimit të Qendrave të Arsimit dhe Aftësisë Profesionale, me mbështetjen e Bankës Botërore dhe GIZ, është realizuar analiza e kostos për disa profile (mjekësi, ekonomi dhe disa profile teknike), të cilat do të plotësojnë formulën e financimit që do të zhvillohet sipas Planit Strategjik të Arsimit 2017-2021. Gjatë dy viteve të fundit është realizuar një analizë e shpenzimeve totale me qëllim të krahasimit me shpenzimet aktuale. Në korrik, të gjitha të dhënat e shpenzimeve në shkollat profesionale janë mbledhur nga thesari dhe janë duke u analizuar. Formula e financimit për arsimin para-universitar po analizohet dhe parashihet rishikimin e formulës së shkollave të AAP-së si pjesë e arsimit para-universitar.	
Masa e reformës #17: Reforma në Arsimin Parauniversitar		Faza e zbatimit të reformës(1-5)
Aktivitetet e planifikuara për 2018	1) Zhvillimi i bazës së të dhënave për licencim, sipas skemës së re të integritit të dhënave në sistemin e SMIA;	2
	2) Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve (5 %) sipas gradimit në sistemin e licencimit;	2
	3) Vlerësimi i nxënësve për nivelin 5,9 dhe 12 dhe publikimi i rezultateve;	4
Përshkrimi i implementimit dhe shpjegimi nëse implementimi është i pjesshëm apo nuk është implementuar fare	1. Është në fazën përfundimtare të vlerësimit të ofertave dhe ne jemi duke pritur përzgjedhjen e kompanisë fituese për zhvillimin e sistemeve qendrore, i cili do të integrojë edhe bazën aktuale për licencimin e mësimdhënësve.	
	2. Në tremujorin e katërt të vitit 2018, duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-046 mbi Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, UA 04/2017 mbi vlerësimin e Institucioneve Arsimore në Arsimin Para-Universitar, UA 14/2018 mbi Vlerësimin e Performancës së Mësimdhënësve dhe Inspektoratin Arsimor, janë realizuar këto aktivitete: - Vlerësimi i performancës së institucioneve arsimore në arsimin para-universitar ka filluar në 7 shkolla në vend. Aspektet kryesore për vlerësimin e performancës janë: fushat e cilësisë (aspekti vertikal i cilësisë), kriteri i cilësisë (zgjerimi) dhe treguesit e performancës (vlerësimi më i thellë). - Vlerësimi i performancës së shkollave ka filluar me 217 mësimdhënës në mbi 60 shkolla në 25 komuna në Kosovë. Aspektet kryesore të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve janë: Fushat e cilësisë dhe standardet e përcaktuar në Kornizën strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënies në Kosovë.	

	<p>3. Vlerësimi i nxënësve për nivelin 5 nuk është realizuar për shkak të organizimit të Testit të TIMSS për klasën e IV në klasat e përzgjedhura në nivel të vendit. Testit të Maturës në qershor i janë nënshtruar 27750 nxënës, ku niveli i kalueshmërisë ishte 73.3% ndërsa në periudhën e gushtit ishin 3750 nxënës dhe niveli i kalueshmërisë ishte 62.5%. Testi për klasat e nënta është mbajtur në muajin maj dhe rezultati ishte 61%. Me mbështetjen e projektit KESIP të BB-së, MASHT-i ka përzgjedhur një kompani për bashkëpunim drejt rritjes së kredibilitetit dhe vlefshmërisë së testeve kombëtare. Pas pjesëmarrjes së Kosovës për herë të parë në testin ndërkombëtar të PISA-së në vitin 2015 (e renditur si e 69 nga 72 vende pjesëmarrëse), viti 2018 është faza përfundimtare ku pritet të ketë ngritje në krahasim me vitin 2015. Rezultatet e testit publikohen në faqen e internetit të MASHT.</p>	
Masa e reformës #18: Ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë në Arsimin e Lartë		Faza e zbatimit të reformës(1-5)
Aktivitetet e planifikuara për 2018	1) Rishikimi dhe kompletimi i infrastrukturës ligjore të arsimit të lartë;	3
	2) Funkcionalizimi i Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë (SMIAL);	4
	3) Inicimi i procesit të zhvillimit të sistemit të rangimit për IAL (formimi i njësisë për menaxhimin e sistemit të rankimit);	0
	4) Rritja e pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore.	4
Përshkrimi i implementimit dhe shpjegimi nëse implementimi është i pjesshëm apo nuk është implementuar fare	<p>1. Ligji për Arsimin e Lartë u miratua nga Qeveria e Kosovës në nëntor të vitit 2018. Është hartuar dhe aprovuar Udhëzimi Administrativ 01/2018 për Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension", që rregullon procesin e avancimit të stafit akademik në IAL.</p> <p>U miratua një Udhëzim i ri Administrativ për Procedurën dhe Kriteret për Përzgjedhjen dhe Emërimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Cilësisë, përkatësisht U.A nr. 05/2018. Pas thirrjes për nominim dhe thirrjes së hapur për aplikime, Komiteti i pavarur ka zgjedhur anëtarët e Këshillit Kombëtar të Cilësisë. Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditim është amendamentuar ashtu që të përfshijë një dispozitë për themelimin e Komisionit të Apeleve. MASHT-i është gjithashtu në procesin e finalizimit të një koncept dokumenti mbi Ligjin për Agjencinë e Akreditimit të Kosovës.</p> <p>Pas miratimit të Ligjit për Profesionet e Rregulluara, ka filluar hartimi i udhëzimeve administrative. MASHT-i si sponsor i ligjit, në koordinim dhe bashkëpunim me institucionet tjera, ka themeluar Ekipin Negociues për Njohjen e 4 Kualifikimeve Profesionale (mjek i përgjithshëm, dentist, arkitekt, inxhinier ndërtimi) me vendet e Ballkanit Perëndimor.</p> <p>Udhëzimi Administrativ nr. 12/2018 për parimet dhe procedurat për njohjen e diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, është miratuar në shtator të vitit 2018 për të lehtësuar njohjen e diplomave.</p>	
	2. Funkcionalizimi i Sistemit të Menaxhimit të Informatave të Arsimit të Lartë (SMIAL) është pilotuar në disa institucione të arsimit të lartë në vitin 2017 dhe ka qenë plotësisht funksional në vitin 2018. Në tetor të vitit 2018 u rishikua Udhëzimi Administrativ për SMIAL, i cili eliminoi mangësitë në këtë sistem, dhe përmes tij është krijuar dhe funksionon SMIAL-ja. Gjithashtu, UA-ja përcakton efikasitetin, besueshmërinë dhe përgjegjësinë për të dhënat në sistem, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e MASHT-it dhe institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, afatet ligjore për regjistrimin dhe vendosjen e të dhënave, afatet e fundit për raportimin e listave të studentëve etj.	
	3. Inicimi i procesit të zhvillimit të sistemit të rangimit për IAL-të (krijimi i një njësie për menaxhimin e sistemit të rangimit) nuk ka pasur përparim për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe mbështetjes.	

	<p>4. MASHT-i ka mbështetur studentët e Kosovës me bursa për studime në lëmi deficitare të universiteteve publike (teknikë, bujqësi, arsim, shkenca natyrore, që janë paraparë edhe në SKZH) dhe personave me shkathtësi të veçanta - gjithsej mbi 600 studentë në vit për nivelet Bachelor dhe Master. Gjithashtu, në kuadër të kornizës për bashkëpunim ndërkombëtar janë dhënë mbi 220 bursa për mobilitet dhe studime jashtë vendit, përfshirë edhe fushat që përputhen me kërkesat e tregut të punës, përkatësisht 50 bursa në vit në bujqësi, shkenca natyrore ose teknologji ushqimore.</p> <p>MASHT mbështet pjesëmarrjen në programin Horizon 2020 duke koordinuar programin, mbështetur pikat kombëtare të kontaktit sipas fushave tematike, si dhe organizimit të trajnimeve përkatëse për pikat e kontaktit. Bazuar në dokumentin themelor të "Standardeve Minimale dhe Parimeve Udhëzuese të KE", është hartuar dhe miratuar një rregullore për të rregulluar strukturën, financimin dhe funksionalizimin e pikave të kontaktit të Kosovës për - Horizonti 2020.</p> <p>Në koordinim të plotë me PKK të MASHT-it, Komisioni Evropian, përkatësisht Drejtoria për Hulumtim dhe Inovacion, ka realizuar seminarin informues dy ditor (13-14.11.2018) mbi mundësitë e ofruara nga programi Horizon 2020. Përafërsisht 90 pjesëmarrës për çdo ditë kanë përfituar nga këto sesione informuese. Së bashku me Pikat Kombëtare të Kontaktit është realizuar edicioni i parë i "buletinit" (Buletini i PKK të Kosovës) i cili do t'u shpërndahet të gjitha grupeve të interesit. Ky dokument synon të informojë publikun për mundësitë që ofrohen nga programi Horizon 2020 dhe të promovoj mekanizmat mbarëkombëtar të mbështetjes për programin, si dhe të promovoj punën e Pikave Kombëtare të Kontaktit. Pikat kombëtare të kontaktit janë trajnuar me mbështetjen e projektit HERAS.</p> <p>Kosova ka marrë pjesë në 11 projekte të Horizonti 2020. Gjatë vitit 2018 janë paraqitur 7 aplikacione për projekte të reja. Kosova ka një normë të përgjithshme prej 18.3% të aplikacioneve të suksesshme. Në përgjithësi, Kosova ka bërë 67 aplikacione për Horizonti 2020, nga të cilat 62 janë vlerësuar të përmbushin kriteret dhe 11 kanë qenë të suksesshme. Për të mbështetur pjesëmarrjen në Horizon 2020, MASHT-i ka mbështetur promovimin e programit duke zbatuar rregulloren për pikat kombëtare të kontaktit për Horizont 2020. Bazuar në politikën e BE-së për zgjerim, Kosova do të ketë një status të përditësuar. Programi i BE-së "Horizonti" i cili do të zbatohet në periudhën mes 2021-2027 do të përmirësojë mundësitë e Kosovës në të ardhmen për hulumtim dhe inovacion.</p>	
Masa e reformës #19: Rritja e qasjes së të rinjve dhe grave në tregun e punës përmes ofrimit të shërbimeve cilësore të punësimit, masave aktive të punësimit dhe ndërmarrësisë		Faza e zbatimit të reformës(1-5)
Aktivitetet e planifikuara për 2018	<p>1) Realizimi i një studimi, për identifikimin e sektorëve (në nivel lokal) me potencial për punësimin e të rinjve;</p> <p>2) Funksionalizimi i plotë i APRK-së (përfshi plotësimin me staf, përmirësimin e infrastrukturës fizike;</p> <p>3) Ngritja e kapaciteteve të mëtutjeshme të APRK për të dizajnuar, zbatuar, monitoruar dhe vlerësuar masat aktive të tregut të punës;</p> <p>4) Implementimi i masave aktive të tregut të punës për grupet në fokus (rritja e ndërmjetësimeve në MATP për 11% si dhe zhvillimi dhe implementimi i programit të vetëpunësimit dhe ndërmarrësisë;</p> <p>5) Modernizimi i programeve dhe shërbimeve të ofruara të aftësisë profesionale, përfshirë: ri-validimi i profileve aktuale, zhvillimi i 5 standardeve të reja, 5 kurrikula dhe 5 paketa mësimore, akreditimi i 7 Qendrave të Aftësisë Profesionale për njohjen e mësimin paraprak, furnizimin e kabinetëve me pajisje moderne, ngritja e kapaciteteve dhe zgjerimi i shërbimeve cilësore në aftësim profesional;</p> <p>6) Zhvillimi i modulit për ofrimin e shërbimeve për migracionin të punësimit, si dhe modulit për orientim në karrierë në kuadër të Sistemit Informues të Tregut të Punës (SITP);</p>	<p>4</p> <p>5</p> <p>4</p> <p>4</p> <p>3</p> <p>5</p>

	7) Mbështetja e nismave për punë vullnetare, me kontribut në punësimin e të rinjve;	5
	8) Praktika në punë për të sapo diplomuarit nga arsimi i lartë (KIESA)	5
Përshkrimi i implementimit dhe shpjegimi nëse implementimi është i pjesshëm apo nuk është implementuar fare	<p>1. Një studim i tregut lokal të punës sa i përket punësimin të të rinjve është në proces e sipër. Të gjitha fazat e studimit janë përfunduar dhe pritet që në tremujorin e parë të vitit 2019 të bëhet publikimi i rezultateve të studimit. Pyetësi dhe fazat e tjera janë përpiluar në bashkëpunim me EARK dhe gjithçka ka shkuar mirë.</p> <p>2. Funksionalizimi i plotë i EARK përmes përmirësimit të infrastrukturës dhe ngritjes së kapaciteteve ka pasur progres. Agjencia është plotësisht funksionale dhe vazhdon të ndërtojë kapacitetet teknike të stafit përmes projekteve të ndryshme. Me projektin Swiscontact është bërë trajnimi i 14 Këshilltarëve të Punësimin për këshillimin për punësimin dhe ndërmarrësinë. Gjithashtu, 16 këshilltarë për punësim janë trajnuar për monitorimin e granteve.</p> <p>3. Vazhdon ndërtimi i kapaciteteve të Agjencisë për hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e masave aktive të tregut të punës. Gjithashtu, janë zhvilluar masat e reja sidomos për grupet e cenushme. Ekziston një rregullore e re mbi masat aktive të tregut të punës që është plotësisht funksionale.</p> <p>4. Zbatimi i masave aktive të tregut të punës për fokus grupet (rritja e ndërmjetësimit të MATP për 11%) si dhe zhvillimi dhe zbatimi i programit të vetëpunësimin dhe ndërmarrësisë. Synimi i rritjes së punësimin me 11% është në proces të arritjes. Deri në fund të nëntorit të këtij viti, rreth 2692 punëkërkuar janë punësuar përmes masës aktive të tregut të punës.</p> <p>5. Me mbështetjen nga projekti EYE, kurrikulat e bazuara në standarde dhe pakot mësimore janë zhvilluar për 4 (katër) kualifikime; përpunimi i qumështit, furrtari, floktari, artist makijazhi. Më mbështetjen nga DVV International, shtypja e këtyre librave është bërë me materiale mësimore në ekzemplar të nevojshëm për punën e kandidatëve në kabinetet trajnuese të QAP. Gjithashtu, me mbështetje nga EYE, është duke u finalizuar kurrikula dhe pakot mësimore të bazuara në standardet profesionale për 2 kualifikimet: rrobaqepësi dhe automekanik, të cilat pritet të finalizohen deri në fund të vitit.</p> <p>Sa i përket akreditimit të të mësuarit paraprak dhe kualifikimeve nga AKK, janë përzgjedhur institucionet që do të pilotohen për njohjen e të mësuarit paraprak, ku nga Qendrat e Aftësimin Profesional është përzgjedhur QAP-Gjilan në kualifikimin e Saldimit. QAP Gjilan ka aplikuar për akreditim sipas procedurave dhe formatit të aplikuar nga AKK dhe është duke pritur vlerësimin e aplikacionit për të hyrë në procesin e akreditimit;</p> <p>Furnizim me pajisje i QAP-Prizren për profesionin e furrtarisë si dhe furnizimi me kompjuter i dy kabineteve të TIK-ut; 16 kompjuterë për QAP Prishtinë dhe 16 kompjuterë për QAP-Pejë nga organizata DVV International, si dhe nga Buxheti i Republikës së Kosovës janë furnizuar me pajisje të avancuar këto profile: kuzhinieri, pastiqeri, zdrukthëtari, saldimit, automekanik, dizajn grafik dhe përpunimi i qumështit;</p> <p>6. Platforma e orientimit të karrierës është zhvilluar në Sistemin për Informimin e Tregut të Punës që është lansuar më 30 Nëntor 2018. Linku i SITP është http://sitp.rks-gov.net/.</p> <p>7. Është zhvilluar platforma elektronike për vullnetarët në Kosovë. http://kosovovolunteers.org/ dhe në këtë platformë deri tani janë regjistruar 3455 vullnetarë. I kemi 184 organizata aktive të regjistruar në platformë, 135 mundësi të krijuara për vullnetarizëm.</p> <p>8. Në fund vitin e 2017-ës ka filluar praktika e studenteve të sapo diplomuar dhe ka përfunduar në mars të vitit 2018, ku me këtë rast janë certifikuar 200 studentë që kanë përfunduar këtë praktikë. Qëllimi kryesor i këtij projekti është zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë, formësimi i kuadrove të reja dhe zbatimi i njohurive teorike në praktikë.</p>	

Masa e reformës #20: Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe sociale		Faza e zbatimit të reformës(1-5)
Aktivitetet e planifikuara për 2018	1) Shtrirja e Platformës së Sistemit të Informimit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore;	1
	2) Fuqizimi i kapaciteteve administrative në Fondin e Sigurimeve shëndetësore përmes punësimit të 24 zyrtarëve;	4
	3) Aplikimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore në shtëpi dhe miratimi i pakos bazike të shërbimeve shëndetësore;	5
	4) Fuqizimi i kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve kardiologjike dhe kardiokirurgjike;	4
	5) Hartimi i kornizës ligjore dhe operative për fillimin e zbatimit të Testit të Varfërisë të kategorive sociale, për lirim nga pagesa e premie për Sigurime Shëndetësore;	2
	6) Hartimi i koncept dokumentit për rregullimin e fushës së shërbimeve sociale;	5
	7) Dizajnimi i formulës së financimit (granti specifik) dhe kritereve për alokimin e buxheteve për shërbime sociale nga komunat;	3
	8) Hartimi i kornizës ligjore sekondare dhe operative për zhvillimin e ndërmarrësisë sociale; Angazhimi i përfituesve në programet trajnimit dhe punësimit	1
Përshkrimi i implementimit dhe shpjegimi nëse implementimi është i pjesshëm apo nuk është implementuar fare	1. Fondi i sigurimeve shëndetësore është në proces të përgatitjes për zhvillimin dhe funksionalizimin e platformës së informacionit shëndetësor, e cila do të zbatohet plotësisht deri në fund të vitit 2019	
	2. Fondi i Sigurimeve Shëndetësore ka punësuar gjashtë punonjës deri në dhjetor të vitit 2018. shtatë punonjës janë në procesin e rekrutimit	
	3. Ministria e Shëndetësisë përmes Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare ka siguruar 12,940 vizita në shtëpi gjatë periudhës janar-nëntor 2018.	
	4. Ministria e Shëndetësisë ka funksionalizuar sallën e dytë të operative. Investimi i përgjithshëm ka arritur në 2.1 milion euro.	
	5. Është përgatitur drafti Udhëzimi Administrativ në lidhje me kategoritë dhe përjashtimin nga pagesa e primeve për sigurimin shëndetësor. Nuk ka zhvillime të mëtejshme lidhur me Testin e Varfërisë. Grupi i Punës, nën drejtimin e Drejtorit të Fondit të Sigurimeve Shoqërore dhe me mbështetjen e Bankës Botërore, në tetor të vitit 2018 ka hartuar draftin fillestar të Udhëzimit Administrativ dhe Manualin Operacional.	
	6. Koncepti Dokument për Shërbime Sociale nga Grupi i Punës i udhëhequr nga MPMS ishte në konsultime publik deri më 5 dhjetor të vitit 2018 dhe është planifikuar të procedohet për miratimin nga Qeveria	
	7. Ministria e Shëndetësisë ka përgatitur propozimin për formulën e financimit (granti specifik për shëndetësinë) për kujdesin parësor shëndetësor. Draft Raporti dhe Analiza për Financimin e Shërbimeve Sociale nga Projekti Mbështetës i BE-së u hartua në nëntor të vitit 2018, që u aprovua nga Koncept Dokumenti i Qeverisë së Kosovës për Financat e Pushtetit Lokal, ku është përfshirë propozimi i MPMS-së për krijimin e një Granti Special për Shërbimet Sociale.	
	8. Në nëntor të vitit 2018, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Ndërmarrjet Shoqërore, ne presim që deri në fund të vitit do të nënshkruhet nga Presidenti i Kosovës dhe pastaj të fillojmë me përgatitjet për kornizën e akteve nënligjore të cilat jemi duke i mbështetur me asistencë teknike nga projekti i Zyrës së BE-së.	

ANEKSI 2: KONTRIBUTI NGA KONSULTIMET PUBLIKE PWR PRE 2019-2021

Hyrje

Kosova ka vendosur marrëdhënie kontraktuale me Bashkimin Evropian nëpërmjet Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe mbi këtë bazë Kosova është ftuar të angazhohet në dialogun e strukturuar lidhur me qeverisjen ekonomike si pjesë e bashkëpunimit të vazhdueshëm institucional ndërmjet Kosovës dhe BE-së.

Programi i Reformave Ekonomike (PRE) 2019-2021 është një dokument i hartuar në baza të rregullta vjetore nëpërmjet të cilit, duke ndërlidhur kornizën makrofiskale afatmesme dhe politikat ekonomike me prioritetet e Qeverisë, procesi i zbatimit të reformave bëhet më i qartë. PRE përmban projeksionet makroekonomike afatmesme (duke përfshirë rritjen e PBB-së, inflacionin, bilancin tregtar dhe qarkullimin e kapitalit), planet buxhetore për tre vitet e ardhshme dhe një agjendë për reformat strukturore që përfshijnë reforma për të rritur konkurrueshmërinë dhe për të përmirësuar kushtet për rritje gjithëpërfshirëse dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Në mënyrë për një koordinim më të mirë të procesit të PRE-së dhe duke u bazuar në Udhëzuesin e Komisionit Evropian, Qeveria e Kosovës ka caktuar Ministrin e Financave si Koordinator Kombëtar për PRE. Koordinator Kombëtar në nivel teknik është mbështetur nga: Departamenti për Politika Makroekonomike dhe Bashkëpunim Financiar Ndërkombëtar në Ministrinë e Financave për pjesën e kornizës makrofiskale dhe Zyra e Planifikimit Strategjik të Kryeministrit për agjendën e reformave strukturore.

Struktura dhe përmbajtja e ERP janë të paracaktuara me Udhëzuesin e Komisionit Evropian lidhur me PRE-në. Programi përbëhet nga tre kapituj kryesorë dhe përfshin: kornizën makroekonomike, kuadrin fiskal dhe prioritetet e reformës strukturore për tre vitet e ardhshme.

Lidhur me agjendën e reformave strukturore, koordinatorët e fushave janë emëruar sipas udhëzuesit të KE-së, sic vijon: Reformat në Tregun e Energjisë dhe Transportit; Zhvillimet Sektoriale (Bujqësia, Industria dhe Shërbimet); Mjedisi i biznesit dhe reduktimi i ekonomisë informale; Inovacioni, Hulumtimi dhe Zhvillimi (RDI) dhe Ekonomia Dixhitale; Reformat lidhur me tregtinë; Arsimi dhe Shkathësitë; Punësimi dhe Tregu i Punës; dhe Gjithpërfshirja Sociale, Ulja e Varfërisë dhe Mundësitë e Barabarta.

Gjatë vitit 2019-2021 në kuadër të fazës së planifikimit të Programit të Reformave Ekonomike janë mbajtur takime individuale me të gjithë koordinatorët e fushave në ministritë relevante, ndërsa takime të nivelit të lartë politik u zhvilluan edhe gjatë hartimit të dokumentit si dhe punëtori me përfaqësuesit e ministrive.

Programi i Reformave Ekonomike 2019-2021 gjithashtu është vendosur edhe në procesin e konsultimeve ndërministrore, në përputhje me Nenin 7 të Rregullores së Punës së Qeverisë, si dhe konsultimeve publike përmes një platforme elektronike për konsultime me organizatat e shoqërisë civile. Finalizimi i dokumentit u krye në bazë të kontributeve të marra nga

Progresi i procesit të konsultimit

Konsultimet për hartimin e PRE 2019-2021 u zhvilluan që nga fillimi i procesit të hartimit. Më 27 qershor, ZPS filloi procesin e PRE 2019-2021 me pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile dhe të sektorit të biznesit. Në shtator / tetor 2018, ZPS zhvilloi takime individuale me koordinatorët e fushave përkatëse nga ministritë e linjës, ndërsa gjatë hartimit të dokumentit u zhvilluan disa takime për përgatitjen e masave të PRE 2019-2021 dhe monitorimin dhe raportimin e tyre gjatë periudhës tetor- nëntor. Ndërsa më 18 shtator u mbajt një takim i nivelit të lartë të Qeverisë dhe Komisionit Evropian.

Programi i Reformave Ekonomike u publikua për konsultime me publikun në platformën elektronike të konsultimit publik më 18 dhjetor 2018 dhe ishte i hapur për komente deri më 8 janar 2019, sipas Rregullores mbi Standardet Minimale për Konsultime Publike.

Pas mbylljes së procesit të konsultimit, u analizuan të gjitha kontributet e pranuar dhe në bazë të tyre janë plotësuar ndryshimet e nevojshme në dokument, në mënyrë që versioni përfundimtar t'i dorëzohet Qeverisë për miratim dhe më pastaj të dorëzohet në Komisionin Evropian jo më vonë 31 janar 2019.

Metodat e konsultimit	Metodat e konsultimit	Numri i pjesëmarrësve / kontribuuesve
1. Publikimi në uebfaqe / Platforma elektronike	15 ditë pune	2 kontribuues
2. Takimi i nivelit të lartë ndërmjet QeK dhe KE dhe OECD	18/09/2018	50 pjesëmarrës
3. Takime të përbashkëta me koordinatorët e PRE dhe ministritë e linjës <ul style="list-style-type: none"> • Reformat në Tregun e Energjisë dhe Transportit; • Zhvillimet Sektoriale (Bujqësia, Industria dhe Shërbimet); • Mjedisi i biznesit dhe reduktimi i ekonomisë informale; • Inovacioni, Hulumtimi dhe Zhvillimi (RDI) dhe Ekonomia Dixhitale; • Punësimi dhe Tregu i Punës; Gjithëpërfshirja Sociale, Ulja e Varfërisë dhe Mundësitë e Barabarta dhe • Reformat lidhur me tregtinë; Arsimi dhe Shkathtësitë; 	20 tetor – 30 nëntor	6 pjesëmarrës 9 pjesëmarrës 8 pjesëmarrës 5 pjesëmarrës 6 pjesëmarrës 4 pjesëmarrës

Përmbledhje e kontributeve të marra gjatë procesit të konsultimit

Kontributet lidhur me PRE 2019-2021 ofrohen kryesisht gjatë punëtorive të mbajtura me ministritë e linjës. Janë dhënë gjithashtu kontribute përmes platformës së konsultimeve publike online.

Çështje të tjera

Të gjitha kontributet e pranuar janë shqyrtuar nga Zyra për Planifikim Strategjik në Zyrën e Kryeministrit. Raporti i detajuar mbi komentet e pranuar, kontribuuesit dhe statusi i kontributeve paraqitet në Aneksin nr. 1 të këtij raporti.

Hapat e ardhshëm

Programi i Reformave Ekonomike 2019-2021 është finalizuar dhe është proceduar për miratim në Qeverinë e Kosovës.

Tabela e detajuar me informata lidhur me kontribuuesit, arsyetimet për komentet e pranuar dhe të refuzuara

Programi i Reformave Ekonomike 2019-2021				
<p>Koment i përgjithshëm Instituti për Studime të Avancuara GAP - ka komentuar mbi reformën e tregut të energjisë dhe transportit, respektivisht në masën 1: 'Zvogëlimi i konsumit të energjisë përmes masave të efijencës së energjisë' dhe masën 2: Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve gjeneruese të energjisë; fusha prioritare # 2 Zhvillimet Sektoriale - (Bujqësia, Industria dhe Shërbimet) Masa 5: Rritja e konkurrencës në industrinë prodhuese; Fusha Prioritare 5 Reformat lidhur me tregtinë - Masa # 14: Lehtësimi i tregtisë duke rritur efektivitetin e kostos së transaksioneve ndërkombëtare të tregtisë; dhe fusha prioritare # 7: Arsimi dhe Shkathtësitë, Masa # 16: Rritja e cilësisë së arsimit profesional dhe trajnimit bazuar në kërkesat e tregut të punës dhe Masa # 17: Përmirësimi i cilësisë dhe rritjes së përfshirjes së fëmijëve në arsimin parauniversitar - kjo masë synon të përmirësojë cilësinë në të gjitha nivelet e para - të rritet pjesëmarrja në këtë nivel me një fokus të veçantë në edukimin parashkollor. Masa adreson udhëzimet e politikës #6. Gjithashtu, ai ofroi një koment ndërsektorial mbi ndikimin në tregun e punës dhe çështjet gjinore ku ata konkluduan se në këtë seksion nuk është dhënë ndonjë shpjegim se si vlerësimi i ndikimit gjinor do të matet në atë fushë, por vetëm është treguar mbi ndikimin e mundshëm pozitiv në tregun e punës në përgjithësi. Oda Ekonomike Amerikane - OEA ka komentuar në përgjithësi si më poshtë dhe të gjitha këto janë komente të përgjithshme që mund të adresohen në të ardhmen. Sa i përket masave të reja të propozuara nga OEA, masat e reja të propozuara mund të merren parasysh gjatë ciklit të ardhshëm të PRE-së, duke qenë se numri maksimal i masave për PRE është 20, që është plotësuar tani me draftin aktual.</p>				
	Komente	Komentu ar nga:	Statusi i komenteve -i pranuar, i pranuar pjesërisht dhe nuk pranohet.	Komentet (Komenti për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin e komenteve është i detyrueshëm)
Fusha Prioritare I. Reforma e tregut të energjisë dhe transportit: Masa #1: Ulja e konsumit të energjisë nëpërmjet masave të efijencës së energjisë	Te shtohet si tregues “Konsumi i energjisë elektrike për ngrohje nga ekonomitë familjare (kËh/m2)”. Të dhënat për këtë tregues mund të mblidhen nga Agjencia e Statistikave të Kosovës si pjesë e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare. Ky është njëri nga indikatorët kyç që tregon efektin e masave të efijencës së energjisë ndër vite.	GAP	Nuk pranohet	Ky tregues mund të merret në konsideratë vitin e ardhshëm duke pasur parasysh natyrën e aktiviteteve të PRE për këtë vit, sepse qëllimi ynë është të zvogëlojmë konsumin e energjisë që synon arritjen e objektivave të kursimit të energjisë prej 92 ktoE ose 9% të konsumit përfundimtar të energjisë elektrike.

Masa #2: Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve prodhuese të energjisë.	Ndërtimi i Termocentralit Kosova e Re do të ndikojë në rritjen e çmimit të energjisë elektrike në vend. Kjo është konfirmuar dhe nga një raport zyrtar i ZRrE-së të cilët në një model konservativ të tyrin vlerësojnë që ndikimi i ndërtimit të TC Kosova e Re në tarifat e energjisë elektrike me pakicë do të jetë 51.7%. ⁶³ Ky raport i është dorëzuar dhe kuvendit dhe deputetëve. Kurse, në një analizë tonën, ku kemi ndërtuar një model që përfshin më shumë variabla, sikurse investimet që parashihen të ndodhin në fushën e energjisë sipas MZHE, del se ndikimi në tarifat e energjisë elektrike do të jetë më i theksuar, rreth 60.4%. ⁶⁴ Në PRE 2019-2021 nuk përmendet tek rreziqet potenciale, rreziku nga ngritja e tarifave të energjisë elektrike si rrjedhojë e futjes në punë të TC Kosova e Re dhe ndikimi që do të kenë sidomos në familjet që financohen nga Skema e Ndhmës Sociale	GAP	Nuk pranohet	Nuk inkorporohet sepse vendimi për investitorin ende nuk është marrë dhe BB u tërhoq nga propozimi origjinal.
	Indikatori kyç i performancës mbi “Përqindjen e energjisë që prodhohet nga burimet e ripërtërishme të energjisë” përmban të dhëna të pasakta. Siç e cekni në indikatorin pasues, kapaciteti i prodhimit të BRE në 2017 ishte 76 MË, që i bie që edhe sikur të ishte përdorur i gjithë ky kapacitet gjatë tërë vitit do të mund të prodhoheshin maksimum 665 GËh apo 13% e energjisë totale për 2017. Ndërsa, nga raporti i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) 2017 kuptohet që nga 77.09 MË kapacitet neto për prodhim nga BRE janë prodhuar 179 GËh që	GAP	Nuk pranohet	Sipas MZHE, të dhënat mbi treguesit kryesorë të performancës mbi "Përqindjen e energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë" - janë të sakta.

⁶³ Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Vlerësim indikativ i ndikimit të TC Kosova e Re në çmimet e energjisë elektrike, Maj 2018.

⁶⁴ Instituti GAP. Ndikimi i Termocentralit “Kosova e Re” në Tarifat e Energjisë Elektrike, 2018. Burimi: <https://bit.ly/2uLijzo>.

	<p>përbën 3.4% të prodhimit total të energjisë elektrike. Marrë parasysh që Strategjia e energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026 e përcakton cakun e pjesëmarrjes së BRE-vë në bruto konsumin final të energjisë dhe jo prodhimin e energjisë, atëherë përqindja do të ishte edhe më e vogël se 3.4%. Ndërsa, nëse është menduar për prodhimin e energjisë totale nga sektorë dhe burime të ndryshme, sikurse lëndë djegëse, ngrohje dhe energji elektrike, tabela duhet të korrigjohet dhe sqarohet më mirë. Edhe pse, bazuar në njësinë e paraqitur për këtë indikator, GËh, kuptohet se flitet vetëm për energjinë elektrike;</p> <p>Po ashtu, në përshkrimin e të njëjtës masë, paraqitet gabimisht nga termocentralet janë prodhuar 5300 GËh energji elektrike ndërsa nga BRE-të 179.25 GËh, pra në total 5479.25 GËh. Prodhimi i gjithëmbarshtëm nga termocentralet dhe BRE-të sëbashku në 2017 ka qenë 5300 GËh, ku 5121 GËh janë prodhuar nga termocentralet dhe 179 GËh nga BRE-të, pra gjithsejt 5300 GËh (shih raportin e ZRrE 2017);</p>			
<p>Masë e re: Zhvillimi i liberalizimit të tregut të energjisë elektrike</p>	<p>Krahas dy masave të paraqitura, është e rëndësishme që të adresohet edhe zhvillimi i liberalizimit të tregut të energjisë elektrike. Edhe pse Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) ka miratuar udhëzuesin për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, hyrja në funksion e TC Kosova e Re do ta vështirësoj këtë qëllim. Aktivitet 2019: ZRRE të jap vlerësimin e kontratës së nënshkruar me kompaninë ContourGlobal për ndikimin e këtij projekti në udhëzuesin e liberalizimit të tregut të energjisë edhe nëse këto dy janë kompatible;</p>	<p>GAP</p>	<p>Nuk pranohet</p>	<p>Numri për masat e propozuara është maksimumi 20 masa siç përcaktohet në Udhëzuesin e KE-së. Gjithashtu, sa i përket rëndësisë për të adresuar zhvillimin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, mund të parashikohet për ciklin e ardhshëm të ERP.</p>

<p>Fusha Prioritare II. Zhvillimet sektoriale – bujqësia, industria dhe shërbimet:</p> <p>Masa #5: Rritja e konkurrueshmëri së në industrinë prodhuese.</p>	<p>Është e nevojshme që në 2019 të shtohet si aktivitet kryerja e një studimi për vlerësimin e ndikimit të zonave aktuale ekonomike në nxitjen e prodhimit, rritjen e punësimit, përqindjen e shfrytëzimit të hapësirave në to. Për më shumë, të vlerësohet se sa nga bizneset në këto zona janë krijuar aty, ndërsa nga ato zhvendosurat nga ndonjë vend tjetër sa prej tyre e kanë rritur numrin e punëtorëve apo prodhimin. Po ashtu, raporti do të duhej të përmbaj sfidat e secilave nga këto zona ekonomike. Kësisoj, aktiviteti “7) Përkrahja financiare për ndërtimin e infrastrukturës fizike të tri zonave ekonomike, respektivisht të parqeve të biznesit (Suharekë, Viti dhe Vushtri);” do të duhej të shtyhej potencialisht për vitin 2020 varësisht nga të gjeturat e studimit.</p>	GAP	Nuk pranohet	Pas miratimit për krijimin e këtyre tre zonave ekonomike, studimi nuk paraqet një reformë
	<p>Të shtohet si aktivitet për vitin 2019 tek kjo masë dhe përshtatja e Ligjit për Zona Ekonomike me EU acquis siç rekomandon dhe Raporti i progresit për Kosovën 2018.65</p>	GAP	Pranohet	<p>Aktiviteti për vitin 2019 për këtë masë "Përshtatja e Ligjit për Zonat Ekonomike me acquis të BE-së" siç rekomandon edhe Raporti i Progresit për Kosovën 2018. - PRANOHET DHE DO TË JETË FUTET NË PRE.</p>
<p>Fusha Prioritare III: Mjedisi i të bërit biznes dhe ulja e ekonomisë jo-formale.</p> <p>Masë e re: Zhvillimi i konkurrueshmërisë</p>	<p>Përveç masave të paraqitura, është e rëndësishme që të ketë masa shpesh për zhvillimin e konkurrueshmërisë që dalin edhe si rekomandime nga Raporti i progresit të vitit 2018. Departamenti për ndihmë shtetërore ka mungesë të kapaciteteve humane të hetoj dhe marrë vendim për projektet, grantet apo subvencionet që bëjnë shkelje të Ligjit për ndihmë shtetërore. Me një zyrtar dhe një drejtor është pothuajse e pamundur ushtrimi i mandatit për verifikimin, auditimin dhe ndalimin e masave që kanë të bëjnë me ndihmë shtetërore. Po ashtu, Komisioni për ndihmën shtetërore, me pesë anëtarë, që është përgjegjës për zbatimin e Ligjit për ndihmën</p>	GAP	Nuk pranohet	<p>Numri për masat e propozuara është maksimumi 20 masa siç përcaktohet në Udhëzuesin e KE-së. Megjithatë, ky propozim mund të merret parasysh për ciklin e ardhshëm dhe gjithashtu qëllimi kryesor i PRE është të adresojë pengesat lidhur me konkurrueshmërinë.</p>

⁶⁵ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, faqe 65. Burimi: <http://bit.ly/2uZViIP>.

	shtetërore ende nuk është emëruar. Mungesa e zbatimit të këtij legjislacioni mundëson një konkurrencë jo të drejtë në treg. Andaj si aktivitete për 2019 të jenë rritja e stafit të zyrës për ndihmë shtetërore dhe krijimi i komisionit për ndihmë shtetërore.			
Fusha Prioritare V. Reformat lidhur me tregtinë: Masa #14: Lehtësimi i tregtisë përmes rritjes së efikasitetit për kosto të transaksioneve tregtare ndërkombëtare	Kjo masë adreson mirë çështjet e ngritura dhe përgjigjet ndaj rekomandimeve të politikave nga Dialogu Ekonomik dhe Financiar në mes të BE-së, Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, mirëpo këto objektiva do të duhej të përfshijnë edhe mundësinë e vendosjes së masave të reciprocitetit siç parashihet në nenin 42 të marrëveshjes së CEFTA-së e cila përkon me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/76 për vendosjen e taksës 100% për produktet e importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina si dhe me vendimin nr. 06/82 ku amandamentohet vendimi i parë për të përfshirë edhe vendosjen e taksës ndaj brendeve të njohura ndërkombëtare të cilat prodhojnë në Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë.	GAP	Nuk pranohet	Natyra e PRE nuk është relevante me këtë koment

<p>Fusha Prioritare VI. Arsimi dhe shkathësitë:</p> <p>Masa #16: Ngjitja e cilësisë në arsimin dhe aftësimin profesional bazuar në kërkesat e tregut të punës dhe Masa #17 Përmirësimi i cilësisë dhe rritja e përfshirjes së fëmijëve në arsimin parauniversitar</p>	<p>Këto masa janë të qarta dhe po ashtu pjesa e përfshirjes së më shumë fëmijëve në parashkollor dhe ndërtimit të katër objekteve të institucioneve parashkollore është e mbështetur edhe me ndarjen e buxhetit për ndërtimin e çerdheve për 2019, 2020 dhe 2021, mirëpo sa i përket objektivës së blerjes së pajisjeve për 10 shkolla profesionale, në projektet kapitale në Projektbuxhetin e vitit 2019 figurojnë vetëm ndërtimi i shkollave dhe rregullimi infrastrukturor i atyre ekzistuese, ndërsa nuk figuron në mënyrë të qartë ndarje për blerjen e pajisjeve për shkolla profesionale për profilet prioritare, andaj kjo çështje duhet të elaborohet më qartë ose të largohet si aktivitet. Po ashtu, sipas raportit të fundit të monitorimit të Institutit GAP, PIPS, dhe GJPS, mjetet për profilet në aftësimin dhe arsimin profesional (AAP) janë siguruar nga thesari dhe divizioni i AP ka bashkëpunuar me BB, GIZ dhe MF për të ardhur me një formulë për financimin e arsimit parauniversitar, ku përfshihet edhe për AAP, por në PB 2019 nuk shihet ndonjë projekt kapital në këtë drejtim. Ndërkaq në PRE parashihet riformulimi i kësaj formule.</p>	GAP	Nuk pranohet	Kjo varet nga marrëveshja me KfE dhe donatorë të tjerë.
Koment gjithëpërfshirës	<p>Të gjitha masat nga #14-20 tek seksioni lidhur me ndikimin në tregun e punës dhe çështje gjinore, nuk ofrojnë kurrfarë shpjegimi se si do të matet ndikimi në çështjet gjinore në fushën e caktuar, por vetëm tregojnë ndikimin pozitiv potencial në tregun e punës në përgjithësi. Nëse kjo çështje nuk trajtohet, pra nuk shpjegohet ndikimi në çështje gjinore, atëherë duhet të hiqet edhe në nëntitull tek pjesa e analizës së gjendjes aktuale të masës përkatëse.</p>	GAP	Nuk pranohet	Ky seksion është vendosur sipas Udhëzuesit të Komisionit Evropian për përgatitjen e PRE dhe iu takon atyre të vendosin për këtë.

	<p><i>1. "Qasja në financa nuk është më një pengesë e detyrueshme." (fq. 51) .</i></p> <p>Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse është subjekt i konsistencës të masave të ndërmarra për përmirësimin e ambientit të të bërit biznes në përgjithësi, e vecanërisht të qasjes në financa. Oda Ekonomike Amerikane vlerëson lart angazhimin e insitucioneve qeverisëse në mundësimin e një qasjeje më të lehtë në financa e cila rezulton në një mjedis më të favorshëm për themelimin, zhvillimin dhe zgjerimin e bizneseve, ndër të tjera. Specifikisht, rënia e normave nominale të interesit për kreditë tregtare, e rënë me 4 pikë të përqindjes dhe rritja e numrit të kredive ndaj korporatave jo-financiare ka mundësuar për një zhvillim të hovshëm të sektorit privat. Lehtësimi i qasjes në financa është reflektuar gjithashtu dhe në studimin e bërë nga Oda Amerikane "Pulsi i Sektorit Privat mbi MSA-në" me një mostër prej 500 bizneseve, i zhvilluar gjatë vitit paraprak 2018, ku ka rezultuar se rreth 20% e bizneseve e konsiderojnë qasjen në financa si një sfidë kryesore. Megjithatë, zbrërthimi i qasjes në financa në grupe të shoqërisë në baza gjinore, ngrit nevojën për të bërë më tepër për të mundësuar grupet shoqërore të nënshërbyera dhe të pambrojtura me mundësi më të shumta për qasje në financa. Përkatësisht, niveli i lartë prej mbi 80% i grave joaktive në tregun e punës dhe me një normë prej vetëm 12% të punësuarave ngrit nevojën për një rishikim të thellësishëm në problematikat e grave në tregun e punës. Për më tepër nga norma e të punësuarave rezulton se vetëm 10% e tyre janë në pronësi të bizneseve private. Përvec barrierave të ndryshme sociale të cilat e vështirësojnë angazhimin e grave në fuqi punëtore si dhe vecanërisht në ndërmarrësi, Oda</p>	<p>Oda Ekonomik e Amerikan e</p>	<p>As nuk pranohet dhe nuk refuzohet pasi që është më shumë një vlerësim.</p>	<p>Mund të merret parasysh në ciklin e ardhshëm ERP</p>
--	---	----------------------------------	---	---

	<p>Ekonomike Amerikane beson se dhe pengesat ekonomike të cilat vijnë si rezultat politikave të trashëguara historike maskiliste përbëjnë një vështirësi të konsiderueshme të qasjes të grave në financa për shkak të pamundësisë së lënies së kolateralit, ndër të tjera aspekte. Duke përmendur këto, Oda Ekonomike Amerikane vlerëson se çështja e qasjes së grave në financa duhet të konsideruar me një prioritet më të lartë pasi që përbën një pengesë kryesore në rritjen gjithëpërfshirëse ekonomike. Andaj cilësojmë, se qasja në financa duhet të konsiderohet si një pengesë e rëndësishme e cila duhet të trajtohet me rëndësi të madhe në vitet në vijim.</p>			
	<p>2. <i>“Mjedisi i të bërit biznes është përmirësuar fuqishëm, por sfidat mbeten.” (fq.52)</i> Oda Ekonomike Amerikane vlerëson lart angazhimin e institucioneve qeverisëse në përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes, i cili ka ardhur si rezultat i një koordinimi të nevojave të sektorit privat me strukturat qeverisëse. Megjithatë, vlen për t’u theksuar se Raporti i Bankës Botërore i të Bërit Biznes për 2019 hedh dritë mbi nevojën për vazhdimin e reformave në këtë aspekt. Përkundër përmirësimeve me pikë të përqindjes teje të vogla të cilat në praktikë dhe mund të kenë pasur efekt të vogla, Kosova rezulton të ketë humbur 4 pozita në renditje, kjo për shkak dhe të reformave të shteteve të tjera të marra si mostër nga Banka Botërore. Oda Ekonomike Amerikane, beson fuqishëm se zbritja në renditje duhet të shërbejë si një këmbanë për marrjen e iniciativave të vazhdueshme për përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes. Oda Ekonomike Amerikane konsideron se ndërlikohja e politikës me raportet ekonomike dhe tregtare nuk i shërben përmirësimit të të bërit biznes, përkundrazi,</p>	<p>Oda Ekonomike Amerikane</p>	<p>Nuk pranohet</p>	<p>PRE nuk merr parasysh vendimet jashtë fushëveprimit të saj</p>

	<p>niveli i ulët i dialogimit të sektorit privat me atë publik i evidentuar nga Oda Amerikane gjatë viteve të fundit i kontribuon përkëqisimit të mjedisit të të bërit biznes, gjë që është reflektuar dhe në norma të ulëta të investimeve të huaja direkte gjatë viteve të fundit, ndër të tjera. Oda Amerikane beson se tregtia e lirë është një faktor i rëndësishëm në të mundësuarit e rritjes ekonomike përmes efikasitetit dhe inovacionit të shtuar, mundësive të eksportit si dhe cilësisë më të lartë dhe mallrave me çmime më të ulëta për konsumatorët, prandaj vendosja e barrierave jotarifore dhe tarifore është jashtë frymës dhe zotimeve në kontekst të marrëveshjeve për tregti të lirë, si dhe zotimeve që vendi ka ndërmarrë për avancimin e rrugës së integrimit evropian, edhe pse në periudha afatshkurtëra mund të ofrojnë efekte pozitive. Andaj duhen ndërmarrë masa konkrete të parashikueshme përmes marrëveshjeve të tregtisë së lirë në mënyrë që të mos çënohet integrimi i Kosovës në tregjet e jashtme dhe të garantohet përmirësimi i të mjedisit të të bërit biznes brenda suazave të vendit.</p>			
	<p>3. <i>“Ekonomia joformale vlerësohet të jetë zvogëluar, por ende mbetet një pengesë e madhe dhe e rëndësishme.” (fq. 52)</i> Ekonomia joformale paraqet një problematikë kyce e cila rrënjësisht pengon zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit privat duke çenuar rrenjësisht konkurrueshmërinë. Në studimin e Odës Ekonomike Amerikane mbi Pulsin e Sektorit Privat mbi MSA-në, ekonomia joformale dhe konkurrenca jo e drejtë përbën një problem kyc në zhvillimin e sektorit privat. Pasuar nga korrupsioni dhe sundimi i dobët i ligjit janë këto komponenta të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në operimet e bizneseve. Andaj,</p>	<p>Oda Ekonomik e Amerikan e</p>	<p>Pranohet</p>	<p>Ekonomia joformale është kualifikuar në mesin e prioriteteve kryesore, prandaj është futur në PRE si një masë e vetme që nga ky cikël</p>

	<p>Oda Ekonomike Amerikane vlerëson se ekonomia joformale duhet të trajtohet me një prioritet të lartë në mënyrë që të garantohet për konkurrencë të drejtë. Oda Amerikane konsideron se rënia e ekonomisë joformale nga 43% e BPV-së në vitin 2013 në 32% në vitin 2015 është një indikator pozitiv, megjithatë në periudhën e fundit që nga viti 2015 deri në 2019 nuk është vërejtur ndonjë përmirësim. Në këtë mënyrë, efektet pozitive të gjeneruara nga politikat e viteve 2013-2015 të cilat kanë rezultuar të suksesshme janë reflektuar dhe në rritje të vazhdueshme të sektorit privat, megjithatë këto politika kanë rezultuar të pasuksesshme për të ulur normat e informalitetit në vitet në vijim. Në këtë mënyrë, Oda Amerikane vlerëson që ekonomia joformale të konsiderohet si një pengesë e madhe dhe e rëndësishme, normat e së cilës janë shqetësuese dhe që kërkojnë ndërmarrjen e hapave të menjëhershme për përmirësimin e ambientit e që pastaj reflektohet në zhvillim të hovshëm ekonomik.</p>			
	<p>4. <i>“Zbatimi i dobët i kontratave dhe sundimi i ligjit mbeten një pengesë e detyrueshme.” (fq. 53)</i> Normat e larta të korrupsionit dhe sundimi i ligjit përbëjnë pengesa kryesore në ekonominë e vendit dhe janë reflektuar në studime të shumta të bëra nga organizatat vendore dhe ato ndërkombëtare. Studimi i fundit i Odës Amerikane mbi perceptimin e korrupsionit ka gjetur se mbi 75% e bizneseve besojnë se korrupsioni në Kosovë është sistemor, derisa faktorët që mundësojnë korrupsionin janë sundimi i dobët i ligjit, mungesa e vullnetit politik për të luftuar korrupsionin dhe korniza e mangët ligjore, derisa mbi 50% e bizneseve të anketuara besojnë se niveli korrupsionit ka</p>	<p>Oda Ekonomik e Amerikan e</p>	<p>As nuk pranohet dhe nuk refuzohet pasi që është më shumë një vlerësim.</p>	<p>Mund të merret parasysh në ciklin e ardhshëm të PRE-së</p>

	<p>mbetur i njëjtë krahasuar me pesë vite më parë. Oda Amerikane vlerëson se një gjyqësor efikas dhe llogaridhënës do të ishte jetik në çrrënjosjen e korrupsionit, derisa perceptimi mbi institucionet e korruptuara të drejtësisë rrënon besimin e bizneseve dhe dekurajon rolin e tyre aktiv në raportimin e veprimeve korruptive. Studimi mbi perceptimin e korrupsionit ka gjetur se vetëm 15% e bizneseve kanë raportuar rastet e korrupsionit tek autoritetet përkatëse. Andaj, krahas vlerësimit të rreziqeve të korrupsionit në institucionet publike, rritjes së ndërgjegjësimit dhe koordinimit të reformave kundër korrupsionit, Oda Ekonomike Amerikane vlerëson se nevojitet një qasje serioze më serioze gjithëpërfshirëse për të mundësuar çrrënjosjen e korrupsionit dhe garantimin e sundimit të ligjit. Në këtë drejtim, Oda Ekonomike Amerikane fuqishëm beson në promovimin e arbitrazhit si një metodë efikase dhe të shpejtë e cila garanton për zgjidhjen e drejtë të kontesteve. Oda Amerikane që nga viti 2013 përmes Këshillit Kombëtar të Zhvillimit Ekonomik ka ngritur nevojën për ndryshim-plotësimin e Ligjit të Prokurimit Publik në mënyrë që të promovohet edhe përfshirja e klauzolave të arbitrazhit në kontratat e prokurimit publik. Në adresimin e ceshtjeve ekonomike, Oda Amerikane gjithashtu mbështet iniciativën e Ministrit të Financave, Bedri Hamza për themelimin e Bordit Shyqrtues të Pavarur për zgjidhjen e ankesave drejtuar Administratës Tatimore dhe Doganave, pasi që si e tillë do të ulte ndjeshëm kohën e nevojshme për zgjidhjen e kontesteve dhe do rezultonte në efikasit më të madh. Në këtë mënyrë, Oda Amerikane vlerëson se nevoja për promovimin e arbitrazhit në zgjidhjen e kontesteve duhet të parashihet si një alternativë e duhur dhe efikase</p>			
--	--	--	--	--

	dhe për t'u përfshirë në Programin e Reformave Ekonomike për vitet në vijim.			
	<p>5. <i>“Në infrastrukturë, furnizimi i pamjaftueshëm dhe i paqëndrueshëm i energjisë elektrike është ende një pengesë e detyrueshme.” (fq. 53)</i></p> <p>Bizneset në Kosovë, e në veçanti sektori i prodhimit, kanë identifikuar energjinë elektrike si një pengesë të konsiderueshme në zhvillimin e tyre që nga periudha e pas luftës. Furnizimi jostabil me energji elektrike përgjatë viteve i ka shkaktuar dëme shumëmilionëshe industrisë vendore si dhe ka penguar fuqizimin e sektorit të prodhimit në vend. Krahas zhvillimeve pozitive viteve të fundit në aspekt të rritjes së stabilitetit dhe parashikueshmërisë së furnizimit, Kosova vazhdon të përballet me nevojën imediate për krijimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike. Ndërtimi i termocentralit të ri do t'i mundësonte Kosovës të zgjeronte kapacitetet gjeneruese dhe rrjedhimisht të ulte varësinë nga importi i energjisë elektrike. Termocentralet ekzistuese operojnë me teknologji shumë të vjetër, ndërsa një defekt më serioz i tyre do të përballte Kosovën me krizë energjetike, si dhe do të rriste varësinë ndaj importit, duke nxitur rrjedhimisht edhe rritjen e çmimit të energjisë. Në anën tjetër, Oda Amerikane vlerëson lart miratimin e Ligjit për Eficiencë të Energjisë i cili parasheh për themelimin e Fondit të Eficiencës të Energjisë nga i cili institucionet publike do të përfitojnë fillimisht, por që parashihet të zgjerohet dhe për sektorin privat në të ardhmen. Poashtu, roli i Zyrës së Rregullatorit për Energji është për t'u vlerësuar në uljen e normave të ngarkuara për</p>	Oda Ekonomik e Amerikan e	As nuk pranohet dhe nuk refuzohet pasi që është më shumë një vlerësim.	Mund të merret parasysh në ciklin e ardhshëm të PRE-së

	<p>energji elektrike ndaj bizneseve, megjithatë, Kosova mbetet i vendi i vetëm ku normat janë më të larta ndaj sektorit privat se sa ndaj familjeve. Marrë parasysh zhvillimet e fundit në sektorin e energjisë, Oda Ekonomike Amerikane beson thellësisht se duhet të ndërmerret një qasje serioze në mënyrë që të garantohet furnizimi stabil me energji elektrike pasi që ndërprerjet shkaktojnë humbje të mëdha të bizneset, e vecanerisht ne sektorin e prodhimit.</p>			
	<p>6. <i>“Hendeku i shkathtësive ndërmjet arsimit / trajnimit dhe nevojave të tregut të punës mbetet një pengesë e detyrueshme për rritjen dhe punësimin.” (fq. 53-54)</i> Studimi i Odës Amerikane mbi disponueshmërinë e shkathtësive, paraqet qartazi nevojën e sektorëve të prodhimit, tregtisë dhe shërbimeve për ngritjen e kapaciteteve njerëzore. Oda Ekonomike Amerikane cilëson se sistemi arsimor në Kosovë ka nevojë për një reformim të rrënjësishëm duke marrë parasysh praktikat më të mira të shteteve të zhvilluara të Bashkimit Evropian dhe më gjërë. Në këtë aspekt, Kosovës i mungon një sistem dual i arsimit i cili do të mundësonte për aftësimin e studenteve teorik dhe për punë praktike e që ka rezultuar të jetë tejet e suksesshme. Në këtë aspekt, Oda Amerikane beson se është e nevojshme inkuadrimi i një mase e cila parasheh për një bashkëpunim më të mirëfilltë në mes të institucioneve arsimore dhe sektorit privat në mënyrë që të garantohet zhvillimi i kadrove të duhura për tregun e punës. Zhvillimi i këtij sistemi dual duhet të bëhet përmes zhvillimit të një strukture apo komiteti e cila parasheh për përfshirjen e institucioneve qeverisëse, universiteteve dhe sektorit privat në përpilimin e</p>	<p>Oda Ekonomik e Amerikan e</p>	<p>Pranohet</p>	<p>Sipas MASHT-it, veprimet janë marrë në këtë drejtim.</p>

	kurrikulave sipas standardeve më të larta të Bashkimit Evropian.			
Masë #1: Fuqizimi i gruas në ndërmarrësi përmes lehtësimit në qasje të financave .	Përshkrimi: Kjo masë nënkupton që qasja në financa të konsiderohet si një çështje e rëndësishme të lartë dhe jo <i>si një pengesë e cila nuk është e detyrueshme</i> , pasi që është si problematikë është evidente specifikisht për gratë ndërmarrëse dhe ato aspiruese. Gratë ballafaqohen me një nivel të lartë të joaktivitetit dhe papunësisë, dhe qasja në financa është mjaft e vështirë, shpeshherë shkak i kolateralit të mangët ndër të tjera, prandaj dhe duhet kushtuar rëndësi të lartë lehtësimit në qasje të financave në mënyrë që të garantohet zhvillimi i të gjitha shtresave shoqërore. .	Oda Ekonomik e Amerikan e	Nuk pranohet	Numri për masat e propozuara është maksimumi 20 masa siç përcaktohet në Udhëzuesin e KE-së. Megjithatë, këto propozime mund të adresohen në ciklin e ardhshëm të PRE-së.
Masë #2: Zhvillimi i dialogut publiko-privat dhe rifunksionalizimi i Këshillit Kombëtar të Zhvillimit Ekonomik	Përshkrimi: Oda Amerikane ka evidentuar një përkeqësim të konsiderueshëm të dialogut publiko-privat, i cili ka rezultuar edhe me ndërhyrjen e politikës në çështje ekonomike të bizneseve. Kjo masë do të shërbente për garantimin e zhvillimit të dialogut publiko-privat si dhe do të mundësonte për rifunksionalizimin e Këshillit Kombëtar të Zhvillimit Ekonomik, i cili konsiston me anëtarë nga grupe të ndryshme të interesit, për të mundësuar për reforma të cilat konsistojnë me nevojën aktuale për zhvillimin ekonomik të tërësishëm të Kosovës e që do të reflektohej dhe në përmirësim të ambientit të të bërit biznes	Oda Ekonomik e Amerikan e	Nuk pranohet	Numri për masat e propozuara është maksimumi 20 masa siç përcaktohet në Udhëzuesin e KE-së. Megjithatë, këto propozime mund të adresohen në ciklin e ardhshëm të PRE-së.
Masa #3 Promovimi i arbitrazhit si një metodë alternative për zgjidhjen e kontesteve	Përshkrimi: Numri i lartë i lëndëve dhe koha e gjatë e nevojshme për zgjidhjen e kontesteve, ngrit nevojën për aplikimin e një mase e cila mundëson për alternativa. Zgjidhja e çështjeve përmes procedurave të arbitrazhit do të mundësonte për një trajtim më të shpejtë dhe efikas të lëndëve, duke mundësuar kështu dhe për operime më të thjeshtëzuara në mesin e prokurorëve dhe gjyqtarëve që merren me çështje ekonomike. Arbitrazhi si një metodë alternative	Oda Ekonomik e Amerikan e	Nuk pranohet	Numri për masat e propozuara është maksimumi 20 masa siç përcaktohet në Udhëzuesin e KE-së. Megjithatë, këto propozime mund të adresohen në ciklin e ardhshëm të PRE-së.

	për zgjidhjen e kontesteve do të ulte ndjeshëm kohën e nevojshme për trajtimin e lëndëve si dhe drejtpërsëdrejti do të rriste efikasitetin e strukturave për sundimin e ligjit dhe zbatimin e kontratave.			
Masa #4: Zhvillimi i sistemit dual arsimor dhe Komitetit për Zhvillimin e Kurrikulave	Përshkrimi: Hendeku i shkathtësive ndërmjet arsimit dhe nevojave të tregut të punës paraqet një problematikë e cila duhet adresuar në mënyrë imediate, pasi që si e tillë reflektohet dhe në normat e larta të papunësisë, largim të kapitalit njerëzor etj. Sistemi dual i arsimit në disa nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian ka rezultuar që të zhvilloj profile të dhura për tregun e punës, andaj kjo masë ka për qëllim iniciimin procedurave për zhvillimin e sistemit dual arsimor i cili mundëson për aftësim teorik si dhe punë praktike për studentët e që rrjedhimisht pastaj plotëson nevojat e tregut të punës. Po në të njëjten kohë, është e nevojshme themelimi i një Komiteti për Zhvillimin e Kurrikulave i përbërë nga institucionet arsimore, sektori privat si dhe organet qeverisëse, e cila drejtpërsëdrejti do të adresonte zhvillimet e vazhdueshme në sektor të ndryshëm ekonomik dhe do të mundësonte zhvillimin akademik të studenteve duke marrë parasysh tregun e punës dhe nevojat e tregut të punës.	Oda Ekonomik e Amerikan e	Nuk pranohet	Numri për masat e propozuara është maksimumi 20 masa siç përcaktohet në Udhëzuesin e KE-së. Megjithatë, këto propozime mund të adresohen në ciklin e ardhshëm të PRE-së.

ANEKSI 3: KRAHASIMI ME PROGRAMIN E MËPARSHËM

Dokumenti	Përshkrimi	2016	2017	2018 proj.	2019 proj.	2020 proj.	2021 proj.
PRE 2018	Totali I të hyrave	1,608	1,725	1,829	1,938	2069	
	Totali I shpenzimeve	1,672	1,811	2,092	2,183	2297	
	Shpenzimet rrjedhëse	1,221	1,309	1,386	1,420	1458	
	Shpenzimet kapitale	444	501	694	751	827	
	Bilanci Primar	-64	-86	-264	-245	-228	
	<i>Bilanci I përgjithshëm(sipas rregullës fiskale)</i>	-54	-96	-122	-109	-70	
	BPV	6,070	6,345	6,737	7,132	7624	
	Deficiti I përgjithshëm si% e BPV	-0.90%	-1.50%	-1.80%	-1.50%	-1.0%	
	Bilanci bankar si% e BPV	3.50%	4.50%	4.50%	4.50%	4.4%	
	Shpenzimet rrjedhëse si % e BPV	20.20%	20.90%	20.80%	20.20%	19.4%	
PRE 2019	Totali I të hyrave	1,608	1,684	1,817	1,949	2,026	2,141
	Totali I shpenzimeve	1,672	1,766	2,104	2,365	2,426	2,487
	Shpenzimet rrjedhëse	1,221	1,282	1,386	1,567	1,584	1,624
	Shpenzimet kapitale	444	468	694	770	813	835
	Bilanci Primar	-64	-82	-287	-416	-400	-346
	<i>Bilanci i përgjithshëm(sipas rregullës fiskale)</i>	-54	-55	-122	-145	-107	-151
	BPV	6,070	6,414	6,761	7,123	7,529	7,961
	Deficiti I përgjithshëm si% e BPV	-0.90%	-0.86%	-1.83%	-2.04%	-1.43%	-1.90%
	Bilanci bankar si% e BPV	3.50%	4.55%	4.72%	4.55%	4.50%	3.36%
	Shpenzimet rrjedhëse si % e BPV	20.20%	19.99%	20.50%	22.01%	21.04%	20.39%
Diferenca	Totali I të hyrave	0.0%	-2.4%	-0.7%	0.6%	-2.1%	
	Totali I shpenzimeve	0.0%	-2.5%	0.6%	8.3%	5.6%	
	Shpenzimet rrjedhëse	0.0%	-2.0%	0.0%	10.4%	8.6%	
	Shpenzimet kapitale	0.0%	-6.7%	0.0%	2.5%	-1.7%	
	Bilanci Primar	0.0%	-4.6%	8.7%	69.7%	75.3%	
	<i>Bilanci I përgjithshëm(sipas rregullës fiskale)</i>	0.0%	-42.6%	-0.2%	33.2%	53.4%	
	BPV	0.0%	1.1%	0.4%	-0.1%	-1.2%	
	Deficiti I përgjithshëm si% e BPV	0.0%	-42.7%	1.4%	35.9%	42.6%	
	Bilanci bankar si% e BPV	0.0%	1.0%	5.0%	1.2%	2.3%	
	Shpenzimet rrjedhëse si % e BPV	0.0%	-4.3%	-1.4%	8.9%	8.4%	

ANEKSI 4 KLAUZOLA PWR INVESTIME

Kutija 2. Klauzola për Investime

Në vitin 2012, si pjesë e programit të atëhershëm me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), Kuvendi i Kosovës pati aprovuar amandamentet e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, përfshirë edhe rregullën fiskale. Ndër të tjera, kjo nënkupton një kufizim vjetor të huamarrjes shtetërore në maksimum 2% të Bruto Produktit Vendor (BPV), pa marrë parasysh kapacitetin e Qeverisë për të siguruar më shumë financim të jashtëm për projekte kapitale me rëndësi publike.

Në të njëjtën kohë, Qeveria e Kosovës identifikoi nevojën për hapësirë shtesë për financim të projekteve të mëdha kapitale dhe në 2015 filloi negociatat për një program të tretë të FMN-së, i cili mes të tjerash, do të lejonte relaksim të rregullës fiskale. Me fjalë të tjera, për projekte të mëdha kapitale me rëndësi strategjike, Qeveria do të ishte në gjendje të hynte në borxh përtej rregullës fiskale prej 2% për një periudhë 10 vjeçare, me kushtin kryesor që të mos tejkalohet 30% i borxhit total të vendit. Kjo do të jepte mundësinë që Qeveria e Kosovës të kishte hapësirë fiskale shtesë prej afërsisht 1.8% mbi 2% të përcaktuar me rregullën fiskale. Në fakt, kjo ishte njohur si “amandamenti i klauzolës për investime” që paraqiti aprovimin e ndryshimeve të nevojshme legjislative nga Kuvendi, në janar 2016.

Qeveria e Kosovës mbetet e përlushtuar që në mënyrë të balancuar të përfshijë në procesin e buxhetit projekte kapitale të implementuara përmes “klauzolës për investime”, ashtu që analizimi i financimit të projekteve të tilla të bazohet në analizat për qëndrueshmërinë afatgjate të borxhit publik.

Një kusht tjetër i paraparë me dispozitat e klauzolës për investime është që Ministria e Financave të përgatisë dy herë në vit një raport narrativ për implementimin e projekteve nën këtë dispozitë. Raporti i fundit i përgatitur mbi këtë instrument ka përfshirë 7 projekte, ndërsa raporti i përgatitur në fund të 2019 do të përfshijë 21 projektet në vijim të cilat janë pjesë e tabelave të buxhetit për 2019. Vlen të theksohet se përfshirja e projekteve në klauzolën për investime realizohet në bazë se sa një projekt ka maturitet për implementim në 2019.

Si u tha më lartë, klauzola investive përfshin 14 projektet të cilat janë përmbledhur në vijim:

1. **Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore 10** – institucioni implementues për këtë projekt është Ndërmarrja Publike “Infrakos” Prishtina. Totali i kostos së projektit pritet të jetë rreth 194.5 milion EUR. BERZH, BEI, financojnë gjysmën ndërsa Bashkimi Evropian gjysmën tjetër të këtij projekti. Marrëveshjet financiare me BERZH dhe BEI janë nënshkruar dhe ratifikuar. Për sa i përket kontributit të BE-së, marrëveshja e parë e grantit tanimë është ratifikuar dhe po pritet nënshkrimi i marrëveshjes së dytë në fillim të dhjetorit 2018. Punët civile pritet të fillojnë në fillim të vitit të ardhshëm, pasi që tenderimi për fazën e parë të projektit veç se ka përfunduar tani.
2. **Rehabilitimi i Ibër-Lepencit** – institucioni implementues për këtë projekt është Ndërmarrja Publike “Ibër Lepenci” dhe vlerësimi i kostos së projektit është 25 milion EUR. Marrëveshja financiar është ratifikuar në vitin 2017 ndërsa implementimi i projektit është planifikuar në 2018.
3. **Rehabilitimi i Rrugëve Rajonale** - institucioni implementues për këtë projekt është Ministria e Infrastrukturës. Marrëveshja financiare është në fuqi dhe projekti ka vlerën prej 29 milion EUR, me financim nga BERZH. Punët në terren pritet të fillojnë në fillim të 2019-tës.
4. **Ndërtimi i Autostradës N9 Prishtinë - Pejë (SEETO Route 6 A)** segmenti Kijevë -Kline deri Zahaq - institucioni implementues për këtë projekt është Ministria e Infrastrukturës. Kosto e projektit është 193 milion EUR. Marrëveshja e Kredisë me BERZH është nënshkruar në 2017 dhe BEI në vitin 2018. Punët civile pritet të fillojnë në pranverën e vitit 2019.

5. **Punësimi dhe Konkurrueshmëria** - institucioni implementues për këtë projekt është Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Projekti financohet nga Banka Botërore dhe implementimi pritet të bëhet në 2018.
6. **Financimi Shtesë për Projektin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural** – marrëveshja për këtë projekt është nënshkruar me Agjencinë Ndërkombëtare për Zhvillim – Bankën Botërore, në 2017, dhe tanimë është ratifikuar nga Kuvendi. Kostoja e paraparë e projektit është 20.800 milion EUR dhe implentimi është planifikuar për 2018.
7. **Trajtimi i Ujërave të Zeza në Prishtinë (Ndërtimi i Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Zeza në rajonin e Prishtinës)** – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është institucioni implementues i këtij projekti. Financimi i projektit do të sigurohet përmes një marrëveshje kornizë mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës, e cila u pat ratifikuar gjatë 2017. Bazuar në marrëveshjen, projekti ka vlerën 86 milion EUR.
8. **Ndërtimi i Qarkores së Prishtinës** – institucioni implementues për këtë projekt është Komuna e Prishtinës. Projekti është në proces të vlerësimit nga Bankat, BERZH dhe BEI. Marrëveshja financiare pritet të nënshkruhet në vitin 2019, dhe punët e vrazhda pritet të fillojnë gjatë tremujorit të fundit të 2019 ose në fillim të 2020.
9. **Ndërtimi i Impianteve për Trajtim të Ujërave të Zeza në Mitrovicë dhe Gjilan** – kompanitë rajonale të ujit të Mitrovicës dhe Gjilanit janë institucionet implementuese për këtë projekt. Marrëveshjet financiare do të nënshkruhen në 2019 me BERZH dhe BEI për 50% të financimit, ndërsa 50% pritet të financohet me grant nga Korniza Investuese e Ballkanit Pernëdimor (ËBIF). Pas ratifikimit të marrëveshjeve, implementimi do të fillojë gjatë tremujorit të fundit të 2019 ose në fillim të 2020.
10. **Projekti për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Komunën e Podujevës** – komuna e Podujevës është institucioni implementues i këtij projekti. Marrëveshja financiare është nënshkruar me UniCredit Bank Austria AG, në emër të Ministrisë së Financave të Austrisë. Pas ratifikimit të marrëveshjes – që është në proces – implementimi do të fillojë në fillim të vitit 2019.
11. **Ndërtimi i Skemës për Furnizim me Ujë në Komunën e Ferizajt** – Komuna e Ferizajt është institucioni implementues për këtë projekt. Marrëveshja financiare do të nënshkruhet në 2018 me Raiffeisen Bank International, në emër të Ministrisë së Financave të Austrisë. Pas ratifikimit të marrëveshjes, implementimi do të fillojë në gjysmën e parë të vitit 2019.
12. **Ndërtimi i Skemës për Furnizim me Ujë në Komunën e Istogut** – Komuna e Istogut është institucioni implementues për këtë projekt. Marrëveshja financiare do të nënshkruhet në 2018 me UniCredit Bank Austria AG, në emër të Ministrisë së Financave të Austrisë. Pas ratifikimit të marrëveshjes, implementimi do të fillojë në gjysmën e parë të vitit 2019.
13. **Projekti për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Komunën e Shtimes** – Komuna e Shtimes është institucioni implementues për këtë projekt. Marrëveshja financiare do të nënshkruhet në 2018 me UniCredit Bank Austria AG, në emër të Ministrisë së Financave të Austrisë. Pas ratifikimit të marrëveshjes, implementimi do të fillojë në gjysmën e parë të vitit 2019.
14. **Ndërtimi i Skemës për Furnizim me Ujë në Komunën e Graçanicës** – Komuna e Graçanicës është institucioni implementues për këtë projekt. Marrëveshja financiare do të nënshkruhet në 2018 me UniCredit Bank Austria AG, në emër të Ministrisë së Financave të Austrisë. Pas ratifikimit të marrëveshjes, implementimi do të fillojë në gjysmën e parë të vitit 2019.
15. **Projekti i Kadastrës së Patundshmërisë dhe Infrastrukturës Hapësinore (REGIP)** - institucioni zbatues i këtij projekti është Agjencia Kosovare e Kadastrës. Vlerësimi i kostos totale të projektit është 16.5 milionë dollarë amerikanë. Marrëveshja e financimit (FA) ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA ËB) është në proces te negociatave dhe pritet të nënshkruhet në 2018 megjithatë, zbatimi i projektit pritet të fillojë gjatë vitit 2019 pas ratifikimit të FA.

- 16. Projekti për Përforcimin e Sektorit Financiar (FSSP)** - institucioni zbatues për këtë projekt është Fondi për Garantimin e Kredive të Kosovës (KSGF). Qëllimi i këtij projekti është të përmirësojë qasjen në financa për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Vlerësimi i kostos totale të projektit vlerësohet të jete 20 milionë EURO. Projekti është në draftim e sipër dhe pritet të negociohet në vitin 2019.
- 17. Projekti i Transportit dhe Sigurisë në Trafik** -Sistemi i Kontrollit do të kryejë detyrat komplekse të zbatimit të trafikut me Stacionet Zbatuese Fikse, Stacionet e Zbatimit të Telefonisë Celulare, Pajisjet e Zbatimit të Telefonisë Celulare, Njësitë e Zbatimit të Telefonisë Celulare dhe Njësitë e Zbatimit të Paisjeve Levizese. Projekti është miratuar nga Komiteti Kombëtar i Investimeve (NIC) që do të financohet përmes Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për Themelimin e Programit Kuadër për Bashkëpunim Financiar (Ligji Nr. 05 / L-153). Projekti është në draftim e sipër nga Ministria e Infrastrukturës si agjenci zbatuese.
- 18. Ndërrimi i gypave të asbestit në Komunën e Gjakovës** - Ndërrimi i linjave të tubave të furnizimit me ujë të asbestit - material nga çimento, të cilat janë instaluar 55 vjet më parë, në qytetin e Gjakovës. Ky investim do të plotësojë nevojën për të mbështetur furnizimin me ujë të pijshëm nga rubineti për 30 vitet e ardhshme. Agjencia e zbatimit është Komuna e Gjakovës. Projekti është miratuar nga Komiteti Kombëtar i Investimeve (NIC) që do të financohet përmes Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për Themelimin e Programit Kuadër për Bashkëpunim Financiar (Ligji Nr. 05 / L-153). Negociatat e Marrëveshjes së Financimit i nënshtrohen procedurave të Ligjit Nr. 05 / L-153.
- 19. Impianti i trajtimit të ujërave të zeza në Komunën e Ferizajt** - Projektimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të grumbullimit (Impianti i Trajtimit të Ujërave të Zeza) në Komunën e Ferizajt. Ky projekt do të zbatohet nga Komuna e Ferizajt. Projekti është miratuar nga Komiteti Kombëtar i Investimeve (NIC) që do të financohet përmes Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për Themelimin e Programit Kuadër për Bashkëpunim Financiar (Ligji Nr. 05 / L-153). Negociatat e Marrëveshjes së Financimit i nënshtrohen procedurave të Ligjit Nr. 05 / L-153.
- 20. Sistemi i kanalizimit në Komunën e Deçanit** - Zona 1: Sistemi i kanalizimit për fshatin Strellc. Zona 2: Sistemi i kanalizimit për fshatin Dubovik dhe pjesë e fshatit Isniq. Zona 3: Kanalizimi i fshatrave Lëbushë, Isniq dhe Prapaqan. Ky projekt do të zbatohet nga Komuna e Deçanit. Projekti është miratuar nga Komiteti Kombëtar i Investimeve (NIC) që do të financohet përmes Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për Themelimin e Programit Kuadër për Bashkëpunim Financiar (Ligji Nr. 05 / L-153). Negociatat e Marrëveshjes së Financimit i nënshtrohen procedurave sipas Ligjit Nr. 05 / L-153.
- 21. Rezervari i ujit të pijshëm në fshatin Verboc / Komuna e Drenasit** - Ndërtimi i ujëmbledhësit për ujë të pijshëm / nga rubineti në fshatin Verboc, i cili do të sigurojë furnizim me ujë të pijshëm në komunën e Drenasit. Ky projekt do të zbatohet nga Komuna e Drenasit. Projekti është miratuar nga Komiteti Kombëtar i Investimeve (NIC) që do të financohet përmes Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për Themelimin e Programit Kuadër për Bashkëpunim Financiar (Ligji Nr. 05 / L-153). Negociatat e Marrëveshjes së Financimit i nënshtrohen procedurave sipas Ligjit Nr. 05 / L-153.

ANEKSI 5: LISTA E TREGUESVE TË PERFORMANCËS

Masa e reformës #1: Ulja e konsumit të energjisë me anë të masave të efijencës së energjisë							
TREGUESI: Konsumi i energjisë dhe intensiteti i BPV-së							
Njësia	Toe						
Vlerat						Targeti	
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	
0.049	0.048					0.043	
TREGUESI: Konsumi i energjisë për punonjës-toe/punësuar							
Njësia	Ktoe						
Vlerat						Targeti	
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	
8.32	8.12	8.26				7.93	
TREGUESI: Humbjet e realizuara teknike dhe komerciale (%)							
Njësia	GWH						
Vlerat						Targeti	
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	
26.6%	24.5%	24.0 %	22.7%	21.4%	20.1%	18.9%	
Masa e reformës #2: Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve prodhuese të energjisë							
TREGUESI: Përqindja e energjisë që prodhohet nga burimet e ripërtërishme të energjisë							
Njësia	GWH						
Vlerat						Targeti	
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	
18.5%	18.8%	18.4%	21.3%			25%	
TREGUESI: Kapaciteti i prodhimit nga BRE							
Njësia	Ton						
Vlerat						Targeti	
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	
7.18	6.68	7	6.68			6.00	
TREGUESI: Niveli i emetimit të CO2							
Njësia	GWH						
Vlerat						Targeti	
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	
0	27	76	349	425	470	565	
Masa e reformës#3: Ndryshimet strukturore në Sektorin Agropërpunues							
TREGUESI: Përqindja e extra vlerës së shtuar/ne vit. (%)							
Njësia							
Vlerat						Targeti	
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	
	30.90	34.43	38.29	44.49	49.90	52.43	
TREGUESI: Numri i vendeve te reja							
Njësia	Nr						
Vlerat						Targeti	
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	
	1,047	1,503	1,579	2,000	2,160	2,400	
Masa e reformës #4: Konsolidimi dhe inventarizimi i tokës bujqësore							
TREGUESI:							
Njësia	Ha						Targeti
Vitet	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Konsolidimi i tokës Bujqësore	5277				25		5302

Regjistrimi i tokës së konsoliduar në regjistrin e të drejtave të pronës e paluajtshme	8616				8641		8641
Masa e reformës #5: Rritja e konkureshmerisë në industrinë prodhuese							
TREGUESI: Njësia: në %							
	Vlerat					Targeti	
Vitet	2014	2015	2016	2017		2021	
Pjesëmarrja e Industrisë Përpunuese në Eksportin e përgjithshëm	67.58%	66.13%	55.23%	55.83%		62%	
Pjesëmarrja e Industrisë Përpunuese në BPV të përgjithshëm	10.34%	10.78%	10.49%	11.47%		12%	
Trendi i eksporteve	(8.65%)	(2.76%)	(6.70%)	18.45%		2 % increase planned	
Masa e reformës#6: Ngritja e Konkureshmerisë në Sektorin e Turizmit dhe Hotelarisë							
TREGUESI:							
Njësia	Vlerat*					Targeti	
Vitet	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Nr. i punësimit ne sektorin e turizmit	19.800	21.300	23.800	25.000	27.000	29.000	32.025
Nr. bujtjeve në total	202,041	193,996	192,847	200.000	220.300	250.701	290.000
Nr. i ardhjeve ndërkombëtare	79.238	83.710	86.032	92.000	100.000	108.000	120.440
Masa e reformës #7: Miratimi i politikave të bazuara në të dhëna dhe adresimi i ngarkesave administrative							
TREGUESI: % e lejeve dhe licencave të thjeshtuara, shkruara ose shfuqizuara							
Njësia	%						
	Vlerat					Targeti	
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	
			0	0	0	10%	
Masa e reformës #8: Sigurimi i të drejtave pronësore duke adresuar informalitetin në sektorin e pronës së paluajtshme							
TREGUESI : Ngritja e % në kërkesave në zyra Noteriale për zgjidhje të lëndëve të vjetra të trashëgimisë							
Njësia	%						
	Vlerat					Targeti	
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	
				20%	30%	50%	
TREGUESI: Numri kërkesave për formalizim të transaksioneve jo-formale në vjet nga AKKVP							
Njësia	Nr						
	Vlerat					Targeti	
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	
			0	1000	2000	3000	
TREGUESI: % e azhurnim të dhënave të vjetërsuara kadastrale lidhur me pronësinë në gjeoportalin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës,							
Njësia	%						
	Vlerat					Targeti	
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	
			0	10%	20%	30%	
Masa e reformës #9: Rritja e efikasitetit në gjyqësor në zgjidhjen e rasteve							
TREGUESI: Funkcionalizimi i plote i SMIL-it							
Njësia	%						
	Vlerat					Targeti	
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	
			7%	10%	20%	30%	
TREGUESI: Funkcionalizimi i plote i SMIL-it							

Njësia	%					
Vlerat						Targeti
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
			24%	60%	80%	100%

Masa #10: Reforma e përgjithshme e inspektimeve

TREGUESI: Numri i ankesave të konsumatorëve të adresuara/trajtuara

Njësia	%					
Vlerat						Targeti
2017	2018	2019	2020	2022	2023	2021
92	144	200	300	400	450	350

Masa e reformës # 11: Zvogëlimi i EkoNrmisë Informale

TREGUESI: Zvogëlimi i hendekut tatimor (CIT, VAT, PIT) %

Njësia Të llogaritet në bazë të vlerësimit ex ante, por mesatarisht dhe sipas standardeve ndërkombëtare ndërmjet 0.02% deri 1% të BPV-së ose në vlerë për Kosovën 14-60 mil. euro. Efekti është realizuar për më shumë se 50% në vitin e parë dhe pjesa tjetër në dy vitet e ardhshme..

Vlerat						Targeti
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
				50%	70%	100%

TREGUESI: Zvogëlimi i ekonomisë informale

Njësia Të llogaritet në bazë të vlerësimit ex ante, por mesatarisht dhe sipas standardeve ndërkombëtare mes 0.04-2.28% të BPV-së. Efekti është realizuar për më shumë se 50% në vitin e parë dhe pjesa tjetër në dy vitet e ardhshme.

Vlerat						Targeti
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
				50%	70%	100%

Masa e reformës #12: Përmirësimi i mjedisit për INrvacion dhe Ndërmarrësi

TREGUESI: Numri i NVM-ve dhe bizneseve fillestare Start-Up dhe OJQ-ve të përkrahura

Njësia	Nr					
Vlerat						Targeti
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
			200	150	200	220

Masa e reformës #13: Shtrirja e infrastrukturës përkatëse të rrjetave dhe shërbimeve të TIK-ut për zhvillim socio-ekoNrmik

TREGUESI: Numri i zonave kadastrale të mbuluara me infrastrukturë fikse brezgjere

Njësia	Number					
Vlerat						Targeti
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
			37	90	140	190

TREGUESI: Numri i institucioneve publike me qasje në internet brezgjere përmes Programit KODE

Njësia	Number					
Vlerat						Targeti
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
			43	100	130	155

TREGUESI: Numri i të trajnuarve për ekoNrminë dixhitale

Njësia	Number					
Vlerat						Targeti
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
		0	0	400	800	1200

Masa e reformës 14: Lehtësimi i tregtisë përmes rritjes së efikasitetit për kosto të transaksioneve tregtare ndërkombëtare

TREGUESI: Koha e Zhdoganimit ne Imp / Exp

Njësia / Orë	Koha e zhdoganimit ne orë (Koha është nxjerrë vetëm si kohë mesatare e zhdoganimit)					
Vlerat						Targeti
	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Imp.	2.44	2.32	2.22	2.15	2.10	2.00
Exp.	1.39	1.80	1.30	1.20	1.15	1.10
TREGUESI: Reduktimi i tarifave, pagesave dhe Licencat për Imp / Exp						
Njësia	Pc					
Vlerat						Targeti
	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Fees and charges			352	345	335	320
Licences			63	60	55	50
TREGUESI: Numri i Autorizimit për OEA						
Njësia	Pc					
Vlerat						Targeti
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
			0	3	6	9
Masa e reformës #15: Zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës së cilësisë dhe fuqizimi i rolit të autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut me fokus produktet e ndërtimit						
TREGUESI: Bilanci tregtar i produkteve te ndërtimit						
Njësia	Euro					
	Vlerat *					Targeti
YEAR	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Export	30,796,534	40,561,415	51,500,000	63,500,000	76,000,000	90,000,000
Import	239,749,337	273,410,628	283,500,000	271,500,000	260,000,000	245,000,000
Trade Balance	(208,952,803)	(232,849,213)	(232,000,000)	(208,000,000)	(184,000,000)	(155,000,000)
Masa e reformës #16: Ngitja e cilësisë në arsimin dhe aftësimin profesional bazuar në kërkesat e tregut të punës						
TREGUESI: Nr. i kurrikulave te integruara në shkollat e AAP						
Njësia	Nr					
Vlerat						Targeti
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
	20	4	0	100	26	150
TREGUESI: Mësimdhënës të trajnuar për kurrikulën e re të AAP						
Njësia	Nr					
Vlerat						Targeti
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
0	0	40	40	50	100	230
Masa e reformës #17: Përmirësimi i cilësisë dhe rritja e përfshirjes së fëmijëve në arsimin parauniversitar						
TREGUESI: Rritja e numrit të fëmijëve në institucionet parashkollore						
Njësia	%					
Vlerat						Targeti
	16/17	17/18	18/19	19/20	20/21	2021/2022
3-5 Vitet old	33,9	36,0	38,0	40,0	42,0	44,0
5year old	87,6	92,4	94,0	96,0	98,0	100
TREGUESI: Numri i mësimdhënësve të trajnuar për zbatim të kurrikulit të ri dhe programe të tjera						

Njësia						
Vlerat						Targeti
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
0	4500	9300	5412	6000	5500	6000

TREGUESI: Vlera arritshmërisë në testin ndërkombëtar PISA

Njësia	Nr.					
Vlerat						Targeti
Value of achievement	2015	2018	2021		2024	2021
Reading	347	400+	430+		460+	430+
Science	378	400+	430+		460+	430+
Mathematics	362	400+	430+		460+	430+

Masa e reformës #18: Reforma në Arsimin e Lartë

TREGUESI: RAPORTI PROFESOR-STUDENT

Njësia						
Vlerat						Targeti
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
0	1,67	1,57	1,47	1,37	1,30	1,29

TREGUESI: Rritja e numrit të mobiliteteve/bursave në programet ndërkombëtare

Njësia						
Vlerat						Targeti
2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
0	98	142	220	230	240	250

Masa e reformës #19: Rritja e qasjes së të rinjve dhe grave në tregun e punës përmes ofrimit të shërbimeve cilësore të punësimit, masave aktive të punësimit dhe ndërmarrësisë

Treguesi/t	Baza 2017	Targeti 2020	Targeti 2022
Shkalla e punësimit	29.8%	31.6%	33.6%
Numri i të rinjve që përfitojnë nga MATP	3328	3727	4025
Numri i grave që përfitojnë nga MATP	3022	3384	3654

Masa e reformës #20: Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe sociale

Treguesit	Treguesi Bazë (2016)	Targeti (2020)	Targeti (2021)
Kontributet e mbledhura nga të gjithë punonjësit në institucionet publike	0%	100%	100%
Qytetarët që nuk kanë qasje në shërbime shëndetësore themelore për shkaqe ekonomike	18%	12%	nën 5%
Shërbimet shëndetësore kardio-kirurgjike për pacientë të trajtuar	50%	70% e	90%